REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

TEMA: QASJE E ELEMENTEVE GJENERATIVE NË SINTAKSËN E SHQIPES NË RRAFSHIN SINTAGMATIK

Doktorante:
Ma. Alketa Kraja (Banushi)

Udhëheqës shkencorë:
Prof.as.dr. Rrezarta Draçini
Prof.as.dr. Gëzim Puka

Shkodër, ____. ____. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

DISERTACION

i paraqitur nga:
ALKETA KRAJA (BANUSHI)

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
"DOKTOR"

Specialiteti: **GJUHËSI**

TEMA: QASJE E ELEMENTEVE GJENERATIVE NË SINTAKSËN E SHQIPES NË RRAFSHIN SINTAGMATIK

Udhëheqës shkencorë: Prof.as.dr. Rrezarta DRAÇINI
Prof.as.dr. Gëzim PUKA

Mbrohet me datë: ____. ____. 2025 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ kryetar

2. _____ anëtar (oponent)

3. _____ anëtar (oponent)

4. _____ anëtar

5. _____ anëtar

Shkodër, ____. ____.2025

Mirënjohje

E ndjej ta vë në dukje se pasuria më e madhe gjatë përpjekjeve për të realizuar këtë punim, janë njerëzit të cilët u bënë pikëtakime apo bashkudhëtarë për të ardhur deri në ditën e sotme.

Së pari i jam mirënjohëse Departamentit të Gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë së Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, që me profesorë të nderuar ndihmuan në formimin tim gjuhësor. Mirënjohëse për mbështetjen e pakursyer në rritjen time akademike dhe në dhënien e kurajës për të kërkuar te vetja gjithmonë e më shumë, duke çuar përpara e duke finalizuar studimet e niveleve të deritanishme.

Së dyti, mirënjohje të veçantë shpreh për profesorin tim të "Sintaksës teorike" në studimet magjistrale, Prof.dr. Tefë Topallin. Ishte ai që nxiti interesin e përfshirjes në studimin e një fushe e cila për mua asokohe ishte e panjohur, dhe nuk është kursyer në dhënien vazhdimisht të ndihmesës për konsultimin e një literature të gjerë në shqip, anglisht e italisht. Përfshirja në studimin e këtyre prurjeve teorike u bë një dëshirë për thellim të përhershëm të njohurive.

I jam mirënjohëse prof. as. dr. Rrezarta Draçinit që kërkoi përditësimin e vazhdueshëm të këtij materiali dhe më mbështeti në përfundimin e rrugëtimit të studimeve doktorale. Këmbëngulja, kërkesa e lartë e llogarisë ndaj vetes dhe kurajoja e transmetuar prej saj, janë vlerat që do t'i mbaj si mësime të rëndësishme përpos atyre shkencore.

Gjej me vend të shpreh mirënjohjen time për organizimet e konferencave shkencore nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike që më krijoi mundësinë të përballesha me mendimin e gjykimin e profesorëve të nderuar si Prof.dr. Ludmila Buxheli e Prof. as. dr. Enkelejda Kapia.

Falënderoj në mënyrë të veçantë Prof. as. dr. Anila Kananaj e cila që në momentet e para të rrugëtimit në studimet doktorale, nuk u kursye në këshillat, konsultimet dhe ofrimin e literaturës së përshtatshme për një studim të thelluar sidomos të segmentit të parë të studimit tonë, atij të frazës nominale.

I jam mirënjohëse të gjithë punonjëseve të Bibliotekës Unversitare që iu përgjigjën me dashamirësinë më të madhe nevojave të mia për literaturë në çdo kohë.

Së fundmi, falënderoj familjen time që m'u bë mbështetje e duruar për kohën kur u realizua ky studim.

PASQYRA E LËNDËS

Pasqyra e lëndës I
Parathënie IV
Organizimi i punimit..... V
Modeli teorik i përdorur..... VI
Objekti dhe synimi..... VII
Metodologjia..... VII
Simbole dhe shenja konvencionale..... IX

KREU I
Aspekte teorike të gramatikës gjenerative

1.1. Hyrje 11
1.2. Gramatika gjenerative..... 11
1.3. Gramatika e modelit "Parime dhe parametra" 12
1.4. Njohuri të përgjithshme të strukturës sintagmatike..... 14
1.5. Teoria X-bar 18
1.6. Termi *sintagmë* në traditën gjuhësore të shqipes dhe disa çështje problemore.. 22
1.7. Aplikime të segmenteve të caktuara të gjenerativizmit në sintaksën e gjuhës shqipe në nivel sintagme, fjalie e fraze nga studiuesit shqiptarë..... 25
1.8. Sintagma emërore..... 28
1.9. Sintagma e eptimit..... 28
1.10. Sintagma komplementuese..... 31

KREU II
Vështrim mbi një nga njësitë e sintaksës: sintagma emërore

2.1. Hyrje 33
2.2. Sintagma emërore..... 33
2.3. Paraqitja e emrit në rrafshin morfologjik
2.3.1. Gjinia 34
2.3.2. Numri 35
2.3.3. Klasat e funksionit nominal 36
2.4. Modifikatorët emërorë
2.4.1. Determinantët.....37
2.4.2. Nyjat.....37
2.4.3. (Përemrat) dëftorë 40
2.4.4. Sasiorët..... 42
2.4.5. Fjalët pyetëse..... 44
2.5. Përshtatja mes determinantëve dhe rendi relativ..... 45

2.6. Determinantë dhe SE të bashkërenditura..... 48
2.7. (Përemrat) pronorë..... 49
2.8. Pronorët dhe determinantët: rendi relativ..... 50
2.9. Nyja shquese.....52
2.9.1. Nyja shquese me emrat e përveçëm.....54
2.10. Nyja joshquese 56
2.11. Nyjat *një* e *ca* ose nyjat veçuese.....57
2.12. Mungesa e nyjes në SE të pashquara..... 58
2.13. Sintagma emërore pa nyja..... 57
2.14. Shmangia e realizimit fonetik të E kokë në SE dhe përdorimi
përemëror i determinantëve dhe pronorëve..... 61
2.15. Nyjat në përdorimin e tyre përemëror..... 66
2.15.1. Përdorimi përemëror i nyjes shquese..... 66
2.15.2. A kanë nyjet joshquese përdorim emëror?..... 66
2.16. Dëftorët në përdorimin e tyre përemëror..... 68
2.17. Sasiorët në përdorimin e tyre përemëror..... 70
2.18. Pronorët në përdorimin e tyre përemëror..... 71
2.19. Vështrim sintaksor i sintagmës e emërore (SE)
2.19.1. Emra argumentues dhe emra joargumentues..... 72
2.19.2. Subjekti dhe kundrina e drejtë (KD) e SE..... 75
2.20.1. Modifikatorët e emrit: Sintagma Mbiemërore (SMb)..... **77**
2.20.1.1. Përshtatja e mbiemrit..... 78
2.20.1.2. Pozicioni i mbiemrit dhe interpretimi semantik..... 79
2.20.1.3. Mbiemrat marrëdhëniorë..... 81
2.20.1.4. Bashkërenditja dhe nënrenditja e mbiemrave
(Parataksa dhe hipotaksa e MB)..... 82
2.20.2. Modifikatorët e emrit: Sintagma Parafjalore..... 83
2.20.2.1. Rendi i sintagmës parafjalore (SP) në SE..... 85
2.20.2.2. Rendi reciprok i SMb dhe SP..... 86
2.20.3. Modifikatorë të emrit: Fjalitë..... 86
2.20.4. Modifikatorë të emrit: Sintagma Emërore..... 88
2.20.4.1. Sintagma të përbëra? 89

KREU III
Vështrim i fjalisë në gramatikat gjenerativiste

3.1. Fjalia në disa gramatika të shqipes 97
3.2. Trajtimi dhe analiza e fjalisë në gjenerativizëm 99
3.3. Përbërësit e fjalisë sipas teorisë së roleve tematike

Struktura argumentore, funksionet sintaksore dhe rolet tematike..... 100
3.4. Mbi konceptin e valencës 103
3.5. Argumente të brendshëm dhe të jashtëm 110
3.6. Klasifikimi i fjalive 112
3.7. Rendi sintaksor
3.7.1. Rendi sintaksor në strukturën e fjalisë 118
3.7.2. Rendi i përbërësve të fjalisë 123
3.7.3. Rendi sintaksor në strukturën e frazës 125
3.8. Fjalitë eliptike 127
3.9. Fjalitë pyetëse 132
3.10. Fjalitë e mohimit në shqip..... 139

KREU IV
Fraza në gjuhën shqipe në qasje gjenerative

4.1. Hyrje. Statusi i frazës dhe problemet me terminologjinë..... 147
4.2. Fraza në sintaksat e gramatikave të shqipes..... 148
4.3. Pavarësia e përbërësve të frazës sipas dy këndvështrimeve 151
4.4. Frazat me fjali argumentore
4.4.1. Hyrje..... 152
4.4.2. Klasifikimi i fjalive ftilluese në gramatika të shqipes..... 153
4.4.3. Fjalitë argumentore në frazë..... 159
4.5. A mund të flasim për sintagma foljore të pashtjelluara?
4.5.1. Hyrje..... 165
4.5.2. Vështrim historik në disa gramatika të shqipes për trajtimin e predikativitetit të formave të pashtjelluara në fjalitë e varura..... 165
4.5.3. Trajtimi i formave të pashtjelluara në sintaksën gjenerative..... 170
4.5.4. Një dukuri e lashtë e parë në këndvështrim gjenerativ Mënjanimi i paskajores gege dhe zëvendësimi me lidhoren..... 178

PËRFUNDIME..... 181

BIBLIOGRAFI 190

ABSTRAKT 198

Parathënie

Takimi i parë me *Sintaksën gjenerative transformuese* erdhi në ciklin e dytë të studimeve, 15 vite pas shkëputjes nga bankat e auditoreve. Ky zhvillim përbënte një fushë të re që ftonte të zbuloja e të hulumtoja në vijimësi një pjesë të mirë të formimit tim teorik në Sintaksë, me gramatikën e strukturës së frazës dhe rregullat transformuese. Duke qenë gjithmonë e prirur në mësimin e gjuhëve të huaja, për herë të parë merrja përgjigje për atë që me kureshtje kishim diskutuar me profesorët për shquarësinë e emrit në shqip, ndryshe nga ato të gjuhëve që njihja e flisja. Kështu, duke mësuar për një këndvështrim të ri, tashmë sintaksor dhe gjenerativist, u përpoqa të përvetësoj sa më shumë prej kësaj teorie që asokohe në gjuhësinë shqiptare ishte pothuajse ndër hapat e parë, pavarësisht se ishte thelluar e zhvilluar në arenën botërore të studimeve gjuhësore.

Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme studimore lidhet me faktin që pavarësisht se dy dekadat e fundit ka pasur studime të herëpashershme për strukturat sintaksore në nivel sintagme, fjalie e fraze për shqipen, sërish studiuesit mbajnë qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje. Ka raste kur i njëjti studiues rimerr dhe ndryshon qëndrimin e tij, ashtu siç ka akoma çështje të pazgjidhura për të cilat shqipja duket se del përtej asaj që teoria ka parashikuar.

Me këtë punim synohet të jepet një ndihmesë modeste lidhur me organizimin strukturor të sintagmave nominale, eptimore dhe komplementuese me vlerë argumentore. Duke realizuar qasjen e elementeve të sintaksës gjenerative, jemi munduar të sjellim së pari në një renditje historiko-kronologjike trajtimin e këtyre përbërësve të frazës në gramatikat tona tradicionale, e më pas në studimet e zhvilluara jo vetëm në gjuhësinë botërore, por edhe atë shqiptare të mbështetur në Teorinë e Drejtimit e të Lidhjes e në Programin Minimalist.

Në fillim të çdo kapitulli gjendet një vështrim historik në trajtimin teorik të studimit të secilit përbërës të organizimeve që kemi zgjedhur për studim. Kjo do të mundësojë një panoramë më të plotë të trajtimit të përbërësve në gjuhësinë shqiptare dhe, në modestinë tonë, mund të themi që mund të kontribuojë në të kuptuarin e ndryshimit të teorive me njëra-tjetrën dhe në një kalim më të rrokshëm të studimit të sintaksës së shqipes nga kushdo që do i qaset këtij punimi: qoftë studiues, apo mësues i gjuhës shqipe.

Organizimi i punimit

Në kapitullin e parë paraqitet një vështrim teorik që lidhet me objektin e tezës. Janë sqaruar problemet e terminologjisë në aplikimin e sintaksës gjenerative nga studiuesit, si dhe janë dhënë sqarime për përshtatjen e kësaj terminologjie në studiuesit shqiptarë. Është paraqitur në mënyrë të përgjithshme aplikimi i kësaj teorie në tri rrafshet që përbëjnë objektin e punimit: sintagmën nominale, sintagmën e eptimit dhe sintagmën komplementuese. Në këtë syth kemi përfshirë edhe një analizë të problematikës që lind me përdorimin e termit "sintagmë" nga sintaksologë tradicionalë duke sqaruar që nuk kemi të bëjmë me pikëtakime. Pastaj është bërë pasqyrimi i studiuesve që aplikuan të parët teorinë gjenerativiste në sintaksën e gjuhës shqipe.

Kapitulli i dytë shqyrton sintagmën nominale duke bërë së pari paraqitjen e emrit në rrafshin morfologjik. Më pas analizohen modifikatorët emërorë. Ndër determinantët merren në shqyrtim nyjat, dëftorët, sasiorët, fjalët pyetëse. Për pronorët bëhet shqyrtim i dy pozicioneve të gjenerimit të tyre, herë si specifikues e herë si determinantë. Një trajtesë më të gjerë përbën shqyrtimi i nyjave shquese dhe joshquese, edhe në rastet kur bëhet fjalë për përdorimin e tyre me emrat e njerëzve dhe emrat e përveçëm të vendeve. Me rëndësi në këtë kapitull është pasqyrimi i gjetjeve gjatë analizës së rasteve kur kemi të bëjmë me sintagma emërore në të cilat shmanget realizimi fonetik i kokës. Është analizuar gjithashtu edhe përdorimi përemëror i determinantëve dhe pronorëve. Në analizën sintaksore bëhet shqyrtimi i funksioneve të subjektit dhe kundrinorit brenda SE. Gjithashtu në këtë kapitull shqyrtohen të gjithë modifikatorët e SE: SMb, SP, SE, FJ.

Në kapitullin e tretë pasqyrohen vështrimet e fjalisë në dy teori të ndryshme: gramatika tradicionale dhe vështrimi gjenerativist. Vëmendja ndalet në shpjegimin e fjalisë si konstrukt hierarkik duke analizuar përveç përbërësve të saj edhe rendin e tyre. Në këtë kapitull janë përfshirë edhe vështrime të përimtësuara për fjalitë eliptike, pyetëse dhe të mohimit.

Në kreun e katërt analizohet fillimisht statusi i frazës. Ruhet i njëjti kusht i të parit të saj përmes dy teorive të ndryshme. Studiohen përbërësit e saj sipas dy këndvështrimeve: tradicional dhe generativist.

I është kushtuar një vëmendje e veçantë frazës argumentuese dhe së fundmi duke u ndalur në fenomenin e zëvendësimit të paskajores gege me lidhoren dhe ndryshimeve që pasqyrohen në strukturat sintagmatike të dy realizimeve. Ky vështrim na vërteton se paskajorja gege e tipit *me bâ,* që pavarësisht standardit është pjesë e ligjërimit të shqipfolësve në nivele të ndryshme, ka jo vetëm tiparin e predikativitetit që i njihet me raste të kushtëzuara në gramatikën tradicionale, por i përgjigjet më së miri parimit të ekonomisë gjuhësore.

Përgjatë punimit janë përdorur si materiale ilustruese shembuj të nxjerrë nga letërsia artistike duke shfrytëzuar veprat e Ernest Koliqit, Martin Camaj, Ismail Kadare, Dritëro Agollit, Migjenit, Ben Blushit, Grigor Banushit dhe të *Albanian National Corpus* që na ka

mundësuar të aplikojmë analizat tona në stile të ndryshme të komunikimit në gjuhën shqipe për të sjellë një panoramë sa më të gjerë e të larmishme të përdorimit të shqipes.

Modeli teorik

Punimi bazohet në modelin e Parimeve dhe Parametrave të shtjelluar në Teorinë e Drejtimit e të Lidhjes propozuar nga Noam Chomsky (1981) si dhe në përpunimin që i është bërë kësaj teorie përgjatë aplikimit të saj (shih Haegeman (1994) dhe Redford (1988)).
Përshkrimi i të dhënave është mbështetur në Programin Minimalist propozuar po nga Çomski (Chomsky), edhe ky i zgjeruar nga një masë e madhe studiuesish. Në segmente të ndryshme i jemi drejtuar përpunimeve që i janë bërë kësaj teorie nga Ebnei (Abney, 1987) e Rixi (Rizzi,1997). Literatura që është dashur të konsultojmë ka qenë e gjerë për shkak të evoluimit të kësaj teorie përgjatë dekadave. Pjesa teorike është konsultuar kryesisht në gjuhë të huaj. Ndërsa një ndihmë të madhe na kanë dhënë trajtesat që lidhen me shqipen të studiuara jo vetëm në shqip, por edhe në anglisht e italisht.
Gjatë vitit të fundit të studimeve është bërë pasurimi i materialit, me prurjet e reja në studimin e shqipes në këndvështrimin e teorisë generativiste. Ndonjëherë i jemi referuar edhe punimeve doktorale që studiojnë sintaksën gjenerative të shqipes. Janë sjellë e shqyrtuar studimet e bëra nga gjuhëtarë shqiptarë e të huaj. Këtu vlejnë të përmenden studimet e realizuara nga gjuhëtarët Kallulli, D. (1995,1999), Memushaj, R. (2003,2008), Buxheli, L. (2007, 2011, 2017), Mita, J. (2005, 2008, 2017), Koleci, F. (2013), Kananaj, A. (2015), Çepani, A. (2015), Abrashi, T. (2020), Draçini, Rr. (2020), etj. e të studiuesve gjuhëtarë të huaj si Gjusti (Giusti, G. 1996, 1997, 2012), Savoja e Manxini (Savoia, L. M. e Manzini, M. R. 2015), Turano, G. (1995, 2000, 2008, 2020), etj.
Vështrimi ynë ndalet fillimisht në njësitë minimale të organizimit të fjalëve për të ardhur më pas në ndërtime më të ndërlikuara siç janë fjalia dhe fraza me fjali argumentore. Zgjedhja e modelit gjenerativist si bazë teorike për studimin tonë u bë jo vetëm se një model i tillë lidhet me zhvillimin bashkëkohor të studimit të gjuhëve, por edhe pse ai përpiqet të zbulojë mekanizmat që bëjnë të mundur përvetësimin e gjuhës duke e parë këtë proces që në zanafillën e tij e deri në kalimin nga struktura e thellë në strukturën sipërfaqësore që përfshin në vetvete ndërlidhjen e sintaksës dhe fushave të tjera të studimit gjuhësor (morfologjinë, leksikonin, fonologjinë e semantikën) me studimin shkencor të filozofisë, psikologjisë etj. Risi në punim përbën edhe përpjekja për ta parashtruar studimin në një plan gjithëpërfshirës sidomos në rrafshin e sintagmës e të fjalisë, duke bërë kështu përpjekjet e para të ndërtimit të një gramatike që përfshin prurjet e zhvillimeve në trajtimin e sintagmës emërore e të fjalisë.

Objekti e synimi

Objekti kryesor i këtij punimi është përafrimi i të dhënave të studimeve sintaksore të shqipes me teorinë sintaksore gjenerativiste. Për këtë arsye kjo tezë paraqet në mënyrë të përmbedhur studimet e bëra duke u fokusuar kryesisht në një teori bashkëkohore siç është ajo e sintaksës gjenerative.

Pa pretenduar të jetë një analizë shteruese, synojmë të sjellim qëndrimet e ndryshme të studiuesve të së njëjtës shkollë që në qendër të studimit kanë gjenerativizmin, interpretimet që i janë bërë *Teorisë së Drejtimit e të Lidhjes* dhe *Programit Minimalist* për të gjetur parametrat përmes të cilëve operon shqipja.

Në vëmendjen tonë ka qenë pasqyrimi i pasurisë së rregullave të strukturës së shqipes qoftë në nivel sintaksor (kryesisht atë nominal), qoftë në strukturën e frazës, duke pasur parasysh se "*është e natyrshme që një gramatikë gjenerative transformuese e shqipes të jetë më e pasur në rregulla të strukturës së frazës dhe në rregulla transformuese se një gramatikë e tillë e anglishtes. Shqipja është një gjuhë me eptim shumë të zhvilluar dhe me rend të lirë të fjalëve në fjali, ndryshe nga anglishtja që është gjuhë me eptim të reduktuar dhe me rend të ngulitur*."[1]

Sfida kryesore me të cilën jemi përballur gjatë zhvillimit të kësaj teze është ajo e studimit të shqipes përmes teorive gjenerativiste. Ishte e vështirë për ne shkëputja e plotë nga analiza tradicionale për të rrokur një analizë të re, edhe pse ishim të vetëdjshëm që kjo teori ka lidhje me proceset para shfaqjes së gjuhës si realizim i produktit përfundimtar në komunikim.

Sa i takon kapitullit që sheh në mënyrë të thelluar sintagmën emërore, kemi përfshirë në të të dhëna që lidhen me funksionin dhe distribucionin e përbërësve në projeksionet nominale duke pasqyruar veçantitë që shqipja paraqet në lidhjen mes emrit dhe konstituentëve të tjerë në sintagmë.

Gjithashtu kemi parë të arsyeshme të përfshijmë edhe shqyrtime që lidhen me sintagmën e eptimit dhe atë komplementuese.

Metodologjia

Mbështetja teorike që duhej për të realizuar këtë punim ka qenë një pikë shumë e rëndësishme për vetë specifikën e temës. Trajtimi i diçkaje të re përbënte fillimisht një dilemë. Për ta mposhtur këtë dilemë nevojitej studimi i thelluar teorik i gjenerativizmit si dhe qartësimi me idetë e konceptet në të cilat mbështetet kjo teori. Këtu na është dashur

[1] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU. Tiranë, f.111.

një përpjekje jo fort e vogël për t'u ndarë nga teoria tradicionale dhe për të kuptuar thelbin e ndryshimit mes dy teorive.
Baza teorike e punimit është modeli Parime e Parametra i shtjelluar në Teorinë e Drejtimit e të Lidhjes si dhe Programi Minimalist propozuar nga Noam Çomski, së bashku me përpunimet që i janë bërë nga Hegemen (Haegeman, 1994), Redford (1988) dhe Ebnei (Abney, 1987) e Rixi (Rizzi,1997).

Hipoteza e ngritur në trajtesën tonë është:
Cila është qasja e shqipes përballë gjenerativizmit?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj hipoteze kemi studiuar fillimisht gjithë bazën teorike të gjenerativizmit të paraqitur më lart dhe në veçanti të sintaksës gjenerativiste, duke ndjekur gjithashtu edhe zhvillimet që ajo ka pësuar përgjatë dy dekadave të fundit. Më pas përmes aplikimit të koncepteve teorike në ndërtimet e shqipes, është bërë vazhdimisht qasja e këtyre trajtesave me studimet e realizuara në këndvështrimin gjenerativist për shqipen. Kemi nxjerrë diferencat e qëndrimeve që kanë studiues të ndryshëm me njëri – tjetrin lidhur me të njëjtën çështje, duke përcaktuar kështu çështjet në të cilat studimet nuk kanë siguruar akoma përgjigje, meqenëse shqipja përbën një gjuhë që nuk i bindet gjithë strukturave dhe parashikimeve të pasqyruara në teori.
Në punim pasqyrohen shembuj të shqipes të krahasuara me anglishten, italishten e frëngjishten për të ilustruar veçantitë që ofron shqipja në përdorimin e saj dhe analizat e zgjeruara në këndvështrim gjenerativ.
Përveç shembujve të larmishëm që u përkasin stileve të ndryshme të ligjërimit, në këtë punim janë pasqyruar edhe skemat e ndërtimeve sintagmatike për të synuar qartësimin e realizimeve të projeksioneve në nivelet e ndryshme të sintagmës.

SIMBOLE DHE SHENJA KONVENCIONALE

1.KATEGORI SINTAGMATIKE, LEKSIKORE DHE FUNKSIONALE

C = Caktuesor
D = Determinant
E = Emër
EPT =Eptim
F = Folje
Fj = Fjali
K = komplementues, lidhëz
Mb = Mbiemër
N. Shq = Nyje shquese
Nd. = Ndajfolje
P = Parafjalë
Plot = Plotësor
PNum = projeksioni i numrit
S = sintagmë
SD = Sintagmë determinante
SE = Sintagmë emërore (ang. NP – Noun Phrase)
SEpt = Sintagmë e eptimit (ang. IP- Inflection Phrase). Në programin minimalist zevëndësohet me sintagmën kohore SKoh = ang. TP- Tense Phrase)
SF = Sintagmë foljore (ang. VP- Verb Phrase)
SK = sintagma e komplementuesit ka raste që gjendet edhe *SL*-sintagmë lidhëzore (ang. *CP* Complementiser Phrase)
SKl = sintagmë klitike (ang. ClP – Clitic Phrase)
SMb = Sintagmë mbiemërore (ang. AP- Adjectiv Phrase)
SNjoh = Sintagma e së njohurës
SP = Sintagmë parafjalore (ang. PP - Preposition Phrase)
Spec = specifikues
SS = sintagmë sasiore (ang. QP –Quantifier Phrase)
SShtj = Sintagmë shtjellimi (ang. FinP - Finitness Phrase) sintagmë që përmban elementet që tregojnë formën e pashtjelluar apo pjesëzën e lidhores.
TDL = Teoria e drejtimit dhe e lidhjes (ang. Government and binding theory)
wh = fjalë pyetëse
X' = projeksioni i ndërmjetëm i X në skemën x-bar
X^0 = pozicioni i kokës së sintagmës SX

2. SHKURTESA

Subj. = Subjekt, Kryefjalë
K.D. = Kundrinor i drejtë

3. SIMBOLE

***** = ndërtim jogramatikor
gj = gjurmë
Ø = kategori e pashprehur fonetikisht

KREU I PARË
ASPEKTE TEORIKE TË GRAMATIKËS GJENERATIVE

1.1. Hyrje

Mendojmë se është e arsyeshme të bëjmë një parashtrim kronologjik të zhvillimit të bazës teorike në të cilën mbështetet kjo tezë, si dhe të rimarrim disa prej koncepteve kyçe mbi të cilët do mbështetet trajtesa jonë.
Në këtë krye janë përfshirë momente kyç të zhvillimit të shkollës së gjenerativizmit dhe aspekte që thelluan studimin e teorive të kësaj shkolle pas lindjes së saj bazuar në propozimet e Çomskit. Duke dashur të parashtrojmë elementet sintaksore e strukturore në të tri rrafshet e qasjes sonë: sintagmë, fjali e frazë kemi përfshirë në këtë krye edhe sqarimet strukturore për tri nivelet e kësaj qasjeje: sintagmën emërore, sintagmën e eptimit dhe sintagmën komplementuese.

1.2. Gramatika gjenerative

Gramatika gjenerative është në zhvillim e sipër që nga mesi i viteve 1950 dhe ka pësuar shumë ndryshime. Për të kuptuar më mirë zhvillimin historik të ideve brenda gramatikës gjenerative, është e dobishme t'u referohemi fazave të ndryshme të zhvillimit të teorisë së saj. Vendin e parë e zë **Teoria Standarde** që u projektua gjatë viteve 1956-1965. Një aspekt thelbësor i Teorisë Standarde është dallimi midis dy paraqitjeve të ndryshme të një fjalie: *struktura e thellë* dhe *struktura sipërfaqësore*. Të dy këto paraqitje, apo përfaqësime, janë të lidhura me njëra-tjetrën nga e ashtuquajtura *gramatika transformuese*.
Pas Teorisë Standarde dhe modelit të gramatikës gjenerative të paraqitur nga Çomski, u zhvillua Teoria Standarde e Zgjeruar. Ajo u formulua në fund të viteve 1960 e në fillim të viteve 1970, përkatësisht nga 1965 deri në 1973. Objekt i saj ishin dy: *kufizimet sintaksore* si dhe *strukturat e sintagmës* (phrase structure) quajtur ndryshe: *Teoria X-bar*.
Më pas janë tre zhvillime të tjera kryesore:
i pari lidhet me Teorinë Standarde të Zgjeruar dhe të rishikuar që u formulua gjatë viteve 1973 dhe 1976 dhe përmbante: *kufizime mbi teorinë X-Bar* (Jackendoff, 1977), *supozimin e pozicionit të komplementit* apo plotësit dhe *Lëviz α*;
tjetri ishte *Gramatika racionale*, e cila u zhvillua rreth 1975 dhe vazhdoi deri më 1990. Ajo ishte një model alternativ i sintaksës, bazuar në idenë se *tema, objekti i drejtë* dhe *objekti indirekt* luajnë një rol parësor në gramatikë;
për të ardhur në *Teorinë e Drejtimit dhe të Lidhjes*, propozuar prej Çomskitt në "Leksione mbi drejtimin dhe lidhjen" (1981).
Bazuar edhe në vërejtjet dhe propozimet e gjuhëtarëve të tjerë, Çomski i përpunon vazhdimisht idetë e tij, fillimisht në "Refleksione mbi gjuhën" (1975), më pas në "Ese për

formën dhe interpretimin" (1977), "Rreth lëvizjes së *wh*-" (1977), "Mbi lidhjen" (1980) dhe në "Rregullat dhe rishkrimet" (1980). Edhe vetë *Teoria e Drejtimit dhe e Lidhjes* u rishikua duke sjellë një tjetër propozim teorik *"Parime dhe Parametra"* në punimin "Disa shënime mbi ekonominë e derivimit" (1991). Edhe pas propozimit të teorisë së *Parimeve e parametrave*, Çomski propozon një program të rishikuar të kësaj teorie që ai e quan *Programi minimalist* dhe pasqyrohet fillimisht në punimin me të njëjtin titull në 1992. Ky program është një linjë hulumtimi që mbështet hipotezën se aftësia e gjuhës njerëzore është optimale, dhe përmban vetëm atë që është e nevojshme për të përmbushur nevojat fizike dhe komunikuese të njerëzve. Teoria kërkon të identifikojë vetitë e nevojshme të një sistemi të këtillë.

Ajo që duhet nënvizuar është se nuk kemi të bëjmë me dështimin e teorisë së drejtimit dhe të lidhjes, por me një përpjekje të vazhdueshme për të gjetur zgjidhje të problemeve që teoria e drejtimit dhe e lidhjes nuk i zgjidh. Sipas *parimeve dhe parametrave* synimi mund të arrihet përmes studimit të sistemeve të veçanta, me qëllim që në këto sisteme të zbulohen të përbashkëtat, pra universalet, që përbëjnë ***parimet*** bazë të gramatikës universale, kësisoj vëmendja drejtohet në gjendjen e aftësisë ligjërimore para se kjo të ekspozohet ndaj përvojës. Gramatika gjenerative i përmbahet idesë se truri njerëzor është i predispozuar gjenetikisht për të nxënë gjuhën. Kjo predispozitë gjenetike lë vend edhe për zgjedhje të quajtura ***parametra***. Si rrjedhim i përvetësimit të këtyre parametrave të veçantë, arrihet edhe përvetësimi i një gjuhe të caktuar njerëzore. Gramatika Universale përbëhet nga nënsisteme që lidhen dhe ndërveprojnë. Gjuha formohet nga dy përbërës themelorë: nga një *sistem llogaritës* (computational system) me të cilin kuptojmë *parimet* dhe që ka të bëjë me strukturën e fjalisë, duke kuptuar me këtë strukturë rendin hierarkik të njësive, sistem i cili na mundëson zbulimin e lidhjeve në fjali; dhe nga *leksikoni* ku përfshihet lista e fjalëve të një gjuhe, veçoritë fonetike dhe morfosintaksore të njësive leksikore. Pra për të kuptuar ndërtimin e një fjalie duhet të dimë që *sistemi llogaritës i bashkon gjithmonë në lidhje binare njësitë leksikore që zgjidhen nga leksikoni*. Fjalia duhet parë si rezultat i zbatimit të rregullës së lidhjes binare të përbërësve dhe zhvendosjes së këtyre lidhjeve sipas rregullave të caktuara në çdo gjuhë.

1.3. Gramatika e modelit "Parime e parametra"

Gjithë teoria linguistike e modelit gjenerativist ka si qëllim kryesor të zbulojë universalitetin e gjuhëve të shprehur si një njësi parimesh të thjeshta e të përgjithshme. Kjo gramatikë, e quajtur ndryshe *gramatikë universale* duhet të përmbajë në vetvete një masë të madhe të gramatikave të çdo gjuhe, por duhet të jetë aq e thjeshtë sa të shpjegojë se si kjo gramatikë është e gdhendur në trurin e njeriut me anë të disa parimeve minimaliste.

Në "*Lectures on Government and Binding*" (1981) Çomski parashtron teorinë e quajtur "Teoria e Drejtimit dhe Lidhjes". Kjo teori shpreh ekzistencën e disa nënsistemeve të cilat

veprojnë me njëri-tjetrin. Ata gjenden në dy forma: si *përbërës të sistemit të rregullave* dhe *si sistem parimesh*. *Teoria e Drejtimit dhe Lidhjes* paraqet katër përbërës të gramatikës universale:

1. Leksikoni (ose struktura abstrakte morfologjike e çdo njësie leksikore)
2. Sintaksa
    a) përbërësi kategorial (teoria X-bar)
    b) përbërësi transformues (rregullat *lëviz a*)
3. Forma fonetike (FF)
4. Forma logjike (FL)

Bazat e gramatikës formohen nga leksikoni dhe përbërësi kategorial që gjendet tek sintaksa. Kjo bazë kthehet në një strukturë sipërfaqësore me anë të përbërësit transformues (lëviz α), e cila më pas shkon në filtrin e Formës Fonetike dhe Formës Logjike (FF dhe FL), të cilat ndryshojnë në çdo gjuhë. Në *strukturën e thellë* funksionet gramatikore dhe rolet tematike (*rolet θ*) përputhen plotësisht nga pikëpamja funksionale. Struktura e thellë përkufizohet si pikënisje për një derivim. Nga ana tjetër *struktura sipërfaqësore* përcaktohet si pika ku zbërthehet derivimi dhe ku përfshihen disa module të gramatikës. Struktura sipërfaqësore është niveli teorik i brendshëm i gramatikës dhe aty zbatohen një numër i gjerë modulesh. Forma Fonetike dhe Forma Logjike janë dy nivele që japin informacionin gramatikor të kërkuar për t'i dhënë një fjalie interpretimin fonetik e kuptimor. Skematikisht për Teorinë e Parimeve dhe Parametrave do të kishim këtë model:



Sintaksa zë vend mes dy niveleve, strukturës së thellë dhe strukturës sipërfaqësore. Ajo përzgjedh nga leksikoni një numër të caktuar njësish leksikore duke i renditur ato në strukturë hierarkike dhe lineare njëkohësisht, duke u bazuar në rregullat e lëvizjes dhe bashkimit të këtyre njësive. Pastaj këto lidhje zhvendosen drejt Formës Fonetike që i kthen në tinguj dhe më pas zhvendoset drejt Formës Logjike për të realizuar kuptimin. Secili prej këtyre niveleve përfshin rregullën *lëviz α*. Ndryshe nga *Teoria Standarde* e nga *Teoria Standarde e Zgjeruar*, numri i madh i rregullave transformuese thjeshtohet në një rregull

të vetëm: *lëviz α*. Ky rregull mund të lëvizë vetëm materialin leksikor, që pas zhvendosjes nga një nyjë në tjetrën lë pas një gjurmë.

1.4. Njohuri të përgjithshme të strukturës sintagmatike

Fjalët që përbëjnë një fjali mund të analizohen si elemente që i përkasin *klasave të fjalëve* të caktuara. Bëhet fjalë për disa nga ato që tradicionalisht emërtohen *pjesë të ligjëratës*: *emër, mbiemër, përemër, numëror, folje, ndajfolje, parafjalë, pjesëz, lidhëz, pasthirrma*. Disa nga këto klasa fjalësh mund të zgjerohen nëpërmjet shtimit të elementeve të tjerë gjuhësorë që i modifikojnë dhe që për këtë quhen **modifikues**[2]. Bashkësia e elementit të modifikuar e i modifikuesve përbën një **sintagmë**[3].

"Sintagma është një njësi me madhësi të papërcaktuar; si sintagmë mund të shërbejë një fjalë e vetme ose dhe një fjali e varur".[4] Ajo *"është njësi ndërtimore dhe kuptimore që qëndron midis fjalës dhe fjalisë. Nuk ka sasi të caktuar fjalësh që përbëjnë vëllimin e saj. Pranimi i sintagmës vetëm me një fjalë gjen justifikim jo vetëm nga krahasimi me gjuhët e tjera, nyjës shquese të paravendosur të të cilave i përgjigjet nyja shquese e prapavendosur e shqipes, pavarësisht se sot ajo ka marrë funksionet e një morfeme trajtëformuese të kategorisë së shquarsisë, po edhe nga modifikimet që u bën nyja shquese strukturave ku bën pjesë, siç do shohim më poshtë. Nga ana tjetër sintagma është njësi që kryen një funksion sintaksor, po në përputhje me natyrën e shqipes, funksion sintaksor mund të realizojë edhe një sintagmë e zgjeruar e përbërë nga më shumë se një sintagmë".*[5]

Sintagma mund të përcaktohet si një sekuencë elementesh gjuhësorë që ka të njëjtën shpërndarje në fjali me kategorinë që përbën pikënisjen dhe që është elementi themelor dhe jo i eleminueshëm. Kjo kategori përbën **kokën** e sintagmës. *"Midis përbërësve të sintagmave vendosen raporte të caktuara formale dhe kuptimore, të cilat kushtëzohen nga natyra e kokës së sintagmës".*[6] Sintagma vetë mund të interpretohet si një shtrirje apo "projeksion" i kokës së saj.

Jo të gjitha pjesët tradicionale të ligjëratës kanë mundësinë të zgjerohen nëpërmjet modifikatorëve. Në veçanti nuk janë të modifikueshëm *numërorët, pjesëzat e pasthirrmat*. Për sa i përket *përemrave* mund të thuhet me siguri se ata nuk mund të modifikohen, por sillen ndonjëherë si zëvëndësues jo vetëm të emrit, por edhe të krejt sintagmës që ka si kokë emrin[7] siç mund ta vërejmë në fjalinë e mëposhtme:

---

[2] Kemi përfshirë fillimisht në këtë term të gjithë përbërësit e tjerë të sintagmës përveç kokës.

[3] Nga greqishtja *sýntagma*- radhitje, rreshtim derivat *i sýntassein*- të rreshtosh sipas një rregulli (*sýn*-sin, e *táttein*-radhis), Fjalori interaktiv i Garzantit.

[4] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f. 100

[5] Dhima, Th. (2007). Probleme të njësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma), *Studime Filologjike*, Nr.3-4, f. 74.

[6] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f. 100.

[7] I referohemi njërës nga format e pranimit të termit *përemrit vetor*, për-emër, pro–noun, pro-nom, pro-nome, në kuptimin që "rri në vend të emrit".

(1) E sheh *atë pakon e madhe blu*? *Ajo* është për ty.

në të cilën *ajo* është në vend të *atë pakon e madhe blu* dhe jo vetëm për *pakon.*
Mund të modifikohen: **Emri** (që është koka e *Sintagmës Emërore*= **SE**), **Mbiemri** (koka e *Sintagmës Mbiemërore* = **SMb**), **Folja** (koka e *Sintagmës Foljore* = **SF**), **Parafjala** (koka e *Sintagmës Parafjalore* = **SP**), **Ndajfolja** (koka e *Sintagmës Ndajfoljore* = **SNd**). Elementet që mund të jenë koka të një sintagme përbëjnë **kategori leksikore**[8] ose **kategori funksionale.**♦
Në gramatikën gjenerative ndarja e fjalëve bëhet në dy klasa: kategori leksikore dhe kategori joleksikore. Në *kategoritë leksikore* përfshihen *emri, folja, mbiemri, ndajfolja e parafjala* të cilat shërbejnë si koka leksikore të sintagmave. Në *kategoritë joleksikore*[9] përfshihen pjesët e tjera të ligjëratës, të cilat mund të shërbejnë si koka *funksionale*, të sintagmave, ose të luajnë një rol ndihmës, duke shërbyer si treguese të veçorive gramatikore të kokës së sintagmës. Në kategoritë funksionale përfshihen *pjesëzat, foljet ndihmëse, infinitivi, përemrat, lidhëzat, determinantët dhe sasiorët* (quantifiers).[10]
Vërejmë fjalitë e mëposhtme:

(2) a. *Ajo vajza e vogël luan me kukull.*
b. *Është një pengesë shumë e vogël nga madhësia.*
c. *Mira luan.*
d. *Është një pengesë e vogël.*

Në (2a) sekuenca *ajo vajza e vogël* përbën një SE (koka e së cilës është emri *vajza*, grupi i fjalëve *luan me kukull* është një SF(koka e së cilës është folja *luan*) që plotësohet nga një SP *me kukulla*, në (2b) grupi tjetër i fjalëve *shumë e vogël nga madhësia* është një SMb (koka e së cilës është mbiemri *e vogël*).
Të kihet parasysh se edhe *luan* në (2c) dhe *e vogël* në (2d)) edhe pse nga pikëpamja e kategorive leksikore një folje dhe një mbiemër, analizohen edhe si sintagma (respektivisht një SF dhe një SMb), edhe pse pa modifikatorë: kjo ndodh për faktin se *luan* dhe *luan me kukulla* nga njëra anë, dhe *e vogël* dhe *shumë e vogël nga madhësia* nga ana tjetër, kanë të njëjtin distribucion, domethënë ndodhen në të njëjtat kontekste sintaksore, dhe kryejnë të

[8] Graffi, G. (2010). *Ç'është gramatika gjenerative*, Toena, Tiranë, f.79.
Kategoritë e njësive të përbëra si nga tipare të brendshme, edhe nga tipare kontekstore gramatika gjenerative i quan kategori leksikore.
♦ Më vonë do shohim sintagmën e eptimit (SEpt), sintagmën komplementuese (SK) të cilat kanë koka funksionale.
[9] Memushaj, R. (2008). *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, f.136 vendos në kategoritë joleksikore "nyjat, lidhëzat, pjesëzat trajtëformuese, përemrat që qëndrojnë para emrit, etj."
[10] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në shuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 29.

njëjtat funksione gramatikore, e për këtë arsye konsiderohen përbërës (kostituentë) të të njëjtit tip; në të njëjtën mënyrë *Mira* në (2c), edhe pse është një emër pa shtrirje, përbën edhe një SE, meqenëse është nga pikëpamja sintaksore i barasvlershëm me një SE si *ajo vajza e vogël* (2a).
Do të thuhet që në këto raste sintagmat (SF, SMb dhe SE) përbëhen vetëm nga koka (folje, mbiemër, emër), pa modifikatorë dhe mund të paraqiten në formën e mëposhtme:

(3) a. [SF[F luan]]
b. [SMb[Mb e vogël]]
c. [SE[E Mira]]

Elementet që zgjerojnë kategoritë leksikore mund të përbëhen nga elemente të tjerë të analizueshëm më tej si p.sh. nga sintagma që mund të analizohen si kokë e modifikatorë, ose struktura sintaksore më komplekse si parafjalët. Të shihet shembulli i mëposhtëm në të cilin sqarohet se si një sintagmë e vetme, një SE (*këshilla shumë të vlefshme për prindër të vështirë që të binden*, mund të përmbajë si modifikatorë sintagma të tjera, që janë të përbëra edhe ato vetë me modifikatorë.

(4) *Libri përmban* [SE[Spec N.shq *-a*] [E ***këshillë***] [SMb[[Nd *shumë*] [Mb *të vlefshme*]] [SP[P *për*] [SE[N.shq Ø] [E prindër] [SMb[Mb *të vështirë*] [Fj *që të binden*]]]]

Gjithë pjesa që ndodhet pas *përmban* përbën një sintagmë të vetme, saktësisht një SE, koka e së cilës është emri *këshilla*. Koka emërore paraprihet nga nyja shquese[11], që nuk është e analizueshme më tej nga pikëpamja sintaksore, dhe ndiqet nga dy modifikatorë: SMb *shumë të vlefshme* dhe SP *për prindër të vështirë që të binden*. Nga ana tjetër vetë SMb është e përbërë nga mbiemri *të vlefshme,* që është koka e modifikuar nga një Nd *shumë*. SP ka si kokë parafjalën *për* dhe si modifikator SE *prindër të vështirë që të binden*. Kjo SE ka si kokë emrin *prindër*, e ndjekur nga SMb *të vështirë që të binden*. Së fundmi kjo SMb ka si kokë *të vështirë*, e modifikuar nga Fj *që të binden*. Kjo fjali përbën një SK (sintagmë komplementuese).
Disa modifikatorë kanë një lidhje më të ngushtë me kokën sesa disa të tjerë. Jo të gjithë vendosin një lloj lidhjeje me kokën e sintagmës. P.sh. në sintagmat e mëposhtme përkatësisht emërore e mbiemërore SE[*një shoqe fëmijërie*], dhe SMb[*vërtetë e dashur për të gjithë*], *fëmijërie* dhe *për të gjithë* modifikojnë respektivisht kokën emërore dhe atë mbiemërore të dy sintagmave. Nëse marrim në shqyrtim dy shtrirjet e tjera të sintagmave, d.m.th. nyjen joshquese *një* dhe ndajfoljen *vërtetë*, vëmë re se këto u referohen jo vetëm kokave, por edhe "pjesës" së sintagmës të përbërë nga koka dhe modifikuesi i saj: *një* i

[11] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f.20.
"Nyja shquese zë pozicionin Specifikues (determinant) të SE sepse ajo është e papërsëritshme dhe këtu jemi në përputhje me teorinë që thotë se pozicioni i specifikuesit është një dhe i vetëm",

referohet *shoqe fëmijërie* dhe *vërtet* i referohet *e dashur për të gjithë*. Kjo mund të demonstrohet p.sh. nëpërmjet testit të zëvendësimit me një përemër[12] (Graffi: 2003,103): sekuencat *një shoqe fëmijërie* dhe *vërtetë e dashur për të gjithë* mund të zëvendësohen nga një përemër, respektivisht nga *të tillë* dhe *e tillë*, si në fjalitë e mëposhtme:

(5) a. Kam një shoqe fëmijërie. / Kam një *të tillë* edhe unë.
b. Është vërtetë e dashur për të gjithë. / Është vërtet *e tillë.*

Në (5a) *një* i referohet pra *një shoqe fëmijërie* e përemërzuar nga *të tillë* dhe në (5b) *vërtet* i referohet *e dashur për të gjithë* e përemërzuar në *e tillë*.
Pra mund të kuptojmë se struktura e brendshme e sintagmave është në fakt hierarkike dhe që ndërmjet sintagmës që përfaqëson shtrirjen maksimale të kokës dhe kategorisë leksikore të përfaqësuar nga vetë koka, ndodhen të tjera kategori "ndërmjetëse" të cilave mund t'u referohen disa modifikatorë. Në rastin e dy sintagmave të paraqitura në shembuj, lidhjet hierarkike të brendshme mund të paraqiten nëpërmjet një sistemi të kllapëzuar si më poshtë:

6) a. SE[Art një SE[E shoqe SP[13][P[Ø] SE[Efëmijërie]]]
b. SMb[Nd vërtet SMb[Mb e dashur SP[për të gjithë]]]

ose sipas diagramës pemë:

Skema 1.a.



Skema 1.b.



[12] Kriteri i zëvendësimit me anë të një proforme.
[13] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f.22.
"*Sintagmat emërore që kanë në brendësi të tyre një emër në rrjedhore të pashquar (...) nuk mund të zbërthehen në E + SE, do të themi që emri i dytë është një rrjedhore që ka parafjalën zero (Ø). Si rrjedhim, sintagma të tilla do të zbërtheheshin në E + SP*".

Quhen **modifikatorë** të gjithë elementet që zgjerojnë një kokë leksikore. Disa modifikatorë kanë në brendësi të sintagmave të njëjtat funksione që sintagmat kanë brenda një fjalie: i quajmë këto lloj modifikatorësh **plotësorë (komplementë).**[14] Vihet re në veçanti se jo vetëm F, por edhe kategoritë leksikore si E, Mb mund të seleksionojnë mes komplementëve të tyre **argumente** dhe të shoqërohen nga *elemente jashtëbërthamorë* **shtesa** (J. Mita, 2005, 18) ose **adjunktë**. Këta vetë janë të përbërë nga sintagma të tipeve të ndryshme. Argumentet kërkohen nga vetë koka leksikore me të cilën janë të lidhur semantikisht. Elementet shtesorë, edhe pse nuk janë të kërkuar domosdoshmërisht nga koka, janë të lidhur me të aq sa ofrojnë specifikime të mëtejshme të karakterit semantik, pra mund të tregojnë "vendin", "kohën", "mënyrën", "shkakun", etj.

P.sh. në një SE si *leximi i librit nga nxënësit*, SE [*i librit*] dhe SP [*nga nxënësit*] janë argumente të E *lexim*. Një E si *lexim* zgjedh gjithashtu dy argumente, njëri prej të cilëve mund të përbëhet nga një SE, tjetri nga një SP.

Për SMb, le të shihet në shembullin *i njohur* që seleksionon si argument një SP[*nga* SE] (psh. *i njohur nga të gjithë*), ndërkohë që mbiemra si p.sh. *i dashur* apo *i sjellshëm* përzgjedhin argumente të përbërë nga SP [*me* SE]: p.sh. *i dashur / i sjellshëm me miqtë*.

Shembuj të modifikatorëve shtesorë janë SP *në mal* (tregues i "vendit") në SE *shëtitja në mal*, ose SP *me klasën* (që tregon "shoqëruesin") në SE *udhëtimi im me klasën*, ose SMb *e vona* (tregues i "kohës") në SE *orët e vona*, ose SP *në shkollën e tij* (tregues i "vendit") dhe *për rezultatet e arritura* (tregues i "shkakut") në SMb *i njohur në shkollën e tij për rezultatet e arritura.*

Së fundmi, kokat leksikore mund të modifikohen edhe nga elemente të tjera, të ndryshëm nga komplementët e atributet, që përcaktohen si **kategori funksionale** dhe kryejnë funksione të ndryshme si p. sh. të tipit "sasior" ose "topikalizim" etj. P.sh. *më i sjellshëm, kaq i bukur, shumë njerëz, vetëm ajo ndërtesë* etj.

1.5. Teoria X-bar

Siç u pa më lart sipas Chomsky-t fjalia nuk është një bashkim i rastësishëm e i çfarëdoshëm fjalësh, por një organizim sipas një strukture binare rekursive. Ajo përfaqëson një marrëdhënie hierarkike mes të gjithë përbërësve, marrëdhënie që studiohet nga Teoria X-bar sipas së cilës çdo përbërës është projektimi i një koke. Bazuar në kokën, emërtohet edhe krejt përbërësi që ndryshe quhet *sintagmë*. Koka e një sintagme është element i domosdoshëm dhe qendror i projektimit të një sintagme. Ajo përbën nivelin bazë të projektimit (projeksioni zero). Siç sqaruam më lart, çdo sintagmë ka përveç kokës një

[14] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f.130.

komplement (plotësor). Koka dhe komplementi i saj formojnë një përbërës që qëndron më lart (projeksionin e ndërmjetëm) X' e që paraprihet nga një tjetër element që është *specifikuesi*. Pozicionet e specifikuesit, kokës dhe komplementit janë gjithmonë të njëjtët. Skematikisht struktura e teorisë X-bar dhe nivelet e projektimit paraqiten kështu:



Me simbolin SX shënohet çdo sintagmë që ka si kokë një kategori X që mund të jetë *kategori leksikore* E, Mb, F, P (duke krijuar *sintagmën emërore* (SE), *sintagmën mbiemërore* (SMb), *sintagmën foljore* (SF) e *sintagmën parafjalore* (SP) (në angl. respektivisht NP - *Noun Phrase*, AP – *Adjectiv Phrase*, VP – *Verb Phrase*, PP – *Prepositional Phrase*), ose *kategori funksionale* ku përfshihen *komplementuesi* që krijon sintagmën e komplementuesit (SK) (angl. *CP- Complementizer Phrase*), *eptimi* që krijon sintagmën e eptimit (SEpt) (angl. IP- *Inflection Phrase*) dhe *determinanti* (specifikuesi) që krijon sintagmën e determinantit (SD) (angl. DP- *Determiner Phrase*).
Sipas teorisë X-bar skemat që ndërtojnë kategoritë leksikore dhe ato funksionale janë skema simetrike.

Skema 2.



Sa i përket sintagmës së determinantit[15] shqipja paraqet dy mënyra të ndryshme të realizimit të kësaj sintagme. Kjo lidhet me faktin që në varësi të llojit të determinantit pozicioni i emrit nuk mbetet i njëjtë me atë të gjenerimit të tij. Së pari duhen pasur parasysh kush janë determinantët në shqip dhe si sillen ato në raport me emrin. Determinantët si *përemrat dëftorë dhe të pacaktuar* si dhe *nyja e përparme* i paraprijnë emrit si në rastet *një vajzë, kjo vajzë*. Paraqitja e strukturës së këtyre sintagmave në skemën X-bar do të ishte:

Skema 3.



Në rastet kur determinanti i ngjitet pas emrit, si në rastin e nyjave shquese, shpjegimi i pozicionit të shfaqjes së tyre mund të bëhet përmes rregullës sintaksore të zhvendosjes së emrit i cili lë pozicionin fillestar për t'u ngjitur në një pozicion më të lartë ku lidhet me determinantin. Paraqitja skematike e sqaron më mirë këtë:

Skema 4.



Përgjatë përpunimit dhe thellimit të studimeve në sintaksën gjenerative janë njohur edhe disa kategori të tjera funksionale që projektohen ndërmjet sintagmave që listuam më lart. Kështu me propozimin e Pollock[16] mund të flasim për shtimin e dy pozicioneve të ndryshme në strukturën e sintagmës së Eptimit, është fjala për kohën (T- *Tense*) dhe

[15] Për herë të parë paraqitjen e skemës X-bar për sintagmën e determinantit për gjuhën shqipe e gjejmë në *Clitics in Albanian*, të studiuese Kallulli. D. (1995) në *Working Papers in Linguistics*, vol.24.
[16] Pollock, J. - Y. (1989). *Verb movement, UG and the structure of IP*, Linguistic Inquiry 18, f. 85-111.

përshtatjen (Agr- *Agreement*) që projektojnë sintagmat SKoh (angl. TP) që është komplement i SPrsh (angl. AgrP). Po kështu edhe disa përemra të pacaktuar si *ca, disa, çdo* etj. dhe disa numërorë që nuk përshtaten me emrat që shoqërojnë, të cilët njihen në gramatikën gjenerative si kuantifikatorë (sasiorë) projektojnë një sintagmë të quajtur sintagma kuantifikatore QP (Quantifier Phrase)[17] ose SS (sintagma e sasiorit). Paraqitja e strukturës së këtyre sintagmave në skemën X-bar është si më poshtë për rastin kur një sasior merr për komplement një emër, ndërsa specifikuesi nuk është i shprehur:

Skema 5.



Ka raste të paraprirjes së emrit nga determinanti dhe sasiori si dhe raste kur determinanti i ngjitet pas emrit i cili ka edhe një sasior. Në varësi të pozicionit të determinantit, pozicioni i sasorit mund të jetë respektivisht më i ulët apo më i lartë në raport me SD. Konkretisht:

a) **Skema 6.**



[17] Për mënyrën e realizimit të kësaj sintagme shih Koleci, F. e Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, f.67-69 dhe Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes-parë në këndvështrimin gjenerativ*, Tiranë, f. 23-25.

b) **Skema 7.**



Siç vihet re në rastin kur determinanti ngjitet pas emrit kemi zhvendosjen e këtij të fundit në një pozicion më lart ku realizon paravendosjen ndaj determinantit dhe sasiori ndodhet në pozicion paraprijës.

1.6. Termi *sintagmë* në traditën gjuhësore të shqipes dhe disa çështje problemore

Njësia që sintaksa përcakton mes fjalëve dhe fjalisë dhe që në mënyrë intuitive secili prej folësve ia njeh ekzistencën, është **sintagma**. Termin *sintagmë* në gramatikat e shqipes e hasim që tek "Sintaksi" i Atë Justin Rrotës kur ai thotë se kryefjala dhe kallëzuesi janë *dy kryegjymtyrët e fjalís ase sintagmet*[18], por përveç këtij pohimi nuk gjejmë asnjë analizë apo sqarim tjetër për sintagmën. E gjejmë këtë term të përdorur gjithashtu te E. Çabej, te S. Prifti në "Sintaksa" me kuptimin e grupit të fjalëve.

Në lëmin e studiuesve shqiptarë njësia e re për shqyrtim *sintagmë* fillimisht hapi për diskutim problemet e ballafaqimit me atë që në gramatikat tradicionale të shqipes emërohej *togfjalësh*.

Në një artikull të gjuhëtarit Hilmi Agani të titulluar "*Ç'shoh të diskutueshme në ›Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme‹*", botuar në revistën "*Fjala*" në periudhën 1shkurt – 15 mars 1975, shfaqet në një diskutim krahasues sintagma në raport me

[18] Rrota, J. (2005). *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, f.451.

togfjalëshin e shqipes. Në artikull autori, duke reflektuar mbi kumtesën e Spiro Floqit, bashkëpunëtor i lartë shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, mbajtur në Konferencën e Dytë Albanologjike, Tiranë 1968, shprehet se "*Midis termave **sintagmë** dhe **togfjalësh** që u përdorën këtu nuk ekziston, mbas nesh, kurrfarë dallimi nga ana kuptimore. Termi **togfjalësh** u përdor për arsye se të tillë e morëm nga Spiro Floqi. Epërsi e saj është se është një kompozitë e shqipes. Të metat e saja janë po ato që i kanë thuaja të gjitha ekuivalentet e tyre në gjuhë të tjera, në të cilat gjithashtu është bërë ky farkim me mjetet e gjuhës përkatëse. Për termin **togfjalësh** e meta tjetër është se u përdor edhe për raste më të veçanta, qofshin ato njësi "të gramatikalizuara", "të leksikalizuara" etj; u përdor si për lidhje të qëndrueshme, si për të lira. Kjo është njëherazi njëra arsye e përdorimit këtu jo të rrallë të termit **sintagmë**. Arsyeja tjetër e përdorimit të saj është në të vërtetë një vend në veprën e Beliçit ku ky gjuhëtar arsyeton vetë për vete parapëlqimin e termit sintagmë në vend të një farkëtimi eventual serbokroat në frymën e farkëtimeve të ngjashme të gjuhëve të tjera. Beliçi thotë: "Gramatikanët sintagmat zakonisht i quajnë "grupe fjalësh" në fjali krahaso veprën e John Ries-it- Zur Wortgruppenlehre. Mit proben aus einer ausführlichen Wortgruppenlehre der deutchen Sprache der GegenWart, Prag, 1927 ku bëhet fjalë hollësisht për to), por në atë term nuk shihet uniteti i tyre i brendshëm që shprehet ose në unitetin e nocionit ose në unitetin e funksionit. Prandaj unë u ndala në termin sintagmë i cili në literaturën shkencore ka zënë rrënjë bukur mirë" (Beliç "O jeziçkoj prirodi i jeziçkom razvitku" Beograd 1958)*"[19].

Termi *togfjalësh* është përdorur së pari në sintaksën tonë nga Spiro Floqi[20] në konferencën e cituar më parë dhe pikërisht për motivimin e përzgjedhjes së kësaj terminologjie autori sqaron se *ka një farë lidhje me terma pak a shumë adekuatë të disa gjuhëve të tjera indoevropiane*[21] e për këtë Floqi liston emërtimet në gjermanisht: **Wotrgefüge** dhe **Wortgruppe**; frëngjisht: **group de mots** dhe **syntagme**, anglisht: **word-combination**, dhe **word-group phrase**; polonisht **skupienie** ose **grupa wyrazova**.

Por sintagma nuk *duhet ngatërruar me togfjalëshin e gramatikës tradicionale, i cili nuk është tjetër veçse një sintagmë që ka kurdoherë dy përbërës, njëri kryesor dhe tjetri përcaktues*[22]. Në "Gramatikën e gjuhës shqipe" gjejmë këtë përkufizim për togfjalëshin: *"Njësia sintaksore strukturore e përftuar gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplote"*[23], ndërsa për sintagmën, siç do vërejmë më poshtë, nuk ka rëndësi nëse elementet brenda tyre janë fjalë kuptimplote apo jo. Studiuesi Josif Mita thekson: "*P.sh. edhe nyja që nuk është fjalë kuptimplote, është pjesë përbërëse e sintagmës emërore. Edhe parafjala, që, gjithashtu, nuk është fjalë kuptimplote,*

[19] Agani, H. (1975). *Ç'shoh të diskutueshme në ›Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme‹,* Fjala, Prishtinë.

[20] Ky koncept u fut duke u huazuar nga gjuhësia ruse për të përcaktuar një njësi sintaksore të ndërmjetme mes fjalës sintaksore e fjalisë. Shih Memushaj, R. (2008). *Studime filologjike, 1-2*, 2008, f.154.

[21] Floqi, S. (1968). *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme* në *Studime Filologjike*, Nr 1, f.75.

[22] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f. 100.

[23] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa),* Tiranë, f. 81.

është pjesë përbërëse e sintagmës parafjalore, bile është koka e saj. Kuadri bëhet më i plotë po të shtojmë se ka sintagma edhe për lidhëzat sintaksore të fjalive të varura të nënrenditura (SK), *si dhe sintagma për eptimin (fleksionin) e foljes (SEPT). (...) edhe mohimi formon një sintagmë më vete (SMoh)".*[24] Sintagma nuk ka tipar dallues dygjymtyrësinë, ajo mund të ketë edhe vetëm një gjymtyrë siç tregon një nga rregullat e rishkrimit të Çomskit:

SF ⟶ F (SE)

që do të thotë se sintagma foljore (SF) përbëhet nga (→) folja (F) dhe elementi tjetër i vendosur mes kllapash (SE) mund të jetë ose jo, në këtë rast bëhet fjalë për një sintagmë emërore e cila nuk është e domosdoshme[25].

Sintagma thamë se është njësi sintaksore dhe ka një strukturë hierarkike që nis me elementin kokë e që rritet shkallë-shkallë në vëllim për të arritur sintagmën maksimale, ndërsa togfjalëshat kanë në përbërje të tyre dy gjymtyrë, njëra prej të cilave mund të përsëritet në togfjalëshat e tjerë të së njëjtës fjali si psh në fjalinë: *Nga dashuria e madhe për atdheun buronin ato fjalë zemre të mërgimtarëve*. mund të dallohen këto togfjalësha*: nga dashuria e madhe, dashuria për atdheun, buronin fjalë, ato fjalë, fjalë zemre, fjalë të mërgimtarëve.*[26], siç vihet re emri *dashuria* është gjymtyrë e dy togfjalëshave dhe emri *fjalë* është gjymtyrë e katër togfjalëshave, ndërsa në sintagmat e një fjalie një kokë leksikore formon sintagmë **vetëm një herë.**

"Analiza në togfjalësha është një skemë horizontale e rrafshët, që shënon bashkimet dyshe të fjalëve në mënyrë mekanike, pa zbuluar strukturën e brendshme të njëpasnjëshme të bashkimit të tyre. Kurse analiza në sintagma zbulon vendosjen hierarkike të fjalëve në mënyrë më të hollësishme, më të qartë, duke zbuluar kombinimet reale të mundshme të tyre, kombinime që kanë të bëjnë me anën formale dhe jo me semantikën".[27]

Një tjetër ndryshim vërehet edhe tek marrëdhëniet kuptimore që krijohen brenda sintagmave e brenda togfjalëshave. Të parat kanë të njëjtën strukturë për çfarëdo lloj marrëdhëniesh kuptimore, ndërsa për togfjalëshin marrëdhënia kuptimore përcakton llojin e marrëdhënieve *objektore* ose *rrethanore* me gjithë nuancat e kuptimeve.[28]

Çomski në "Strukturat sintaksore" arrin në konkluzionin se "*Gramatika duhet formuluar si një sistem autonom i pavarur nga semantika. në veçanti, nocioni i gramatikalitetit nuk mund të identifikohet me kuptimplotësinë*."[29], pra *"objekti i sintaksës është kombinimi i*

[24] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë 2005, f. 127.
[25] Për këtë shih edhe Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, fq.128, sqarimi për sintagmat foljore që përbëhen nga F dhe (FJ), si dhe për rregullat e rishkrimit të SE që përbëhet nga (Nyje shquese) dhe E *lajmi*, ose (Nyje shquese) dhe E (Fj) *lajmi se do të nisej.*
[26] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa),* Tiranë 2002, f. 81.
[27] Dhima, Th. (2007). Probleme të njësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma), *Studime Filologjike* Nr.3-4, 2007, fq 79.
[28] ASHSH, (2002). "Marrëdhënie objektore, rrethanore (hapësinore, kohore, etj)", *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë, f. 91-101.
[29] Chomsky, N. (2011). *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, f. 127.

fjalëve"[30] dhe i ligjeve që udhëheqin të tilla kombinime, ndërsa kuptimi përfshihet në vetë kombinimet e fjalëve sepse folësit nuk kombinojnë kurrë fjalë pa kuptim. Ajo që duhet theksuar në fund të kësaj paraqitjeje është se kemi të bëjmë me ballafaqimin e dy shkollave të ndryshme gjuhësore (strukturalizmit e gjenerativizmit) të cilat nën të njëjtin emërtim përfshijnë njësi sintaksore që herë u përputhen e herë u largohen kufijtë por e shohin gjuhën në këndvështrime plotësisht të ndryshme.

1.7. Aplikime të segmenteve të caktuara të gjenerativizmit në sintaksën e gjuhës shqipe në nivel sintagme, fjalie e fraze nga studiuesit shqiptarë

Aplikimi i teorive gjenerativiste në sintaksën e gjuhës shqipe nga gjuhëtarët tanë është relativisht i ri. Kontribut të rëndësishëm ka studiuesja Dalina Kallulli[31] e cila përdor teorinë gjenerativiste, kryesisht idetë e Programit Minimalist, për të analizuar sintaksën e shqipes. Studimet e saj në lëminë e sintaksës aplikohen në rrafsh krahasues mes gjuhëve të Ballkanit dhe theksojnë veçantitë e shqipes, duke kërkuar të japë zgjidhje për çështje të tilla, si: nyjat në shqipen, dublimi i klitikëve, struktura e brendshme e sintagmës emërore dhe sintagmës së determinantit.

Ndër studiuesit që kanë hartuar artikuj apo monografi të cilat bëjnë një trajtim gjenerativist të shqipes përmendim gjithashtu gjuhëtarin Rami Memushaj me tekstin universitar "Hyrje në gjuhësi" botuar në vitin 2002 dhe me "Gjuhësia gjenerative" botuar fillimisht në vitin 2003 e ribotuar me përditësime nga zhvillimet në teorinë e gjenerativizmit në vitin 2008. Studiuesi bën një përshkrim të zhvillimit të teorisë së gramatikës gjenerative duke e parë atë në raport me zhvillimet drejtimeve të mëparshme të studimeve gjuhësore. Ai paraqet konceptet bazë të teorisë gjenerativiste, fazat e zhvillimit të saj, ndryshimet që ka pësuar përgjatë rrjedhës së zhvillimit dhe të gjithë shpjegimet e tij i mbështet me zbatime e interpretime në shqip duke dhënë kështu edhe sqarime për veçoritë e shqipes. Memushaj përcakton terminologjinë lidhur me përbërësit e sintagmës, llojet e sintagmave, duke i ilustruar edhe me paraqitjet skematike. Krahas shpjegimeve për strukturat e tyre, sqaron përbërësit e fjalisë dhe shpjegon trajtimin e fjalisë së nënrenditur bazuar në mjetin lidhës. Ndalet në sqarimin e gjithë çështjeve që trajton gjenerativizmi dhe ballafaqon teorinë e këtij drejtimi me shqipen si rast konkret duke vënë në dukje përputhjet dhe mospërputhjet e duke kërkuar apo parashtruar për zgjidhje probleme që kërkojnë hulumtime të mëtejshme. Studiuesi tjetër që sjell një material të gjenerativizmit zbatuar në gjuhën shqipe është Josif Mita[32] i cili në studimin "Hyrje në sintaksën gjenerative" (2005) paraqet sqarimin dhe

[30] Graffi, G. (2003). *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, f. 18.
[31] Kallulli, D. (1995). Clitics in Albanian, *Working Papers in Linguistics*;
Kallulli, D. (2001) *Direct Object Clitic Doubling in Albanian and Greek*, *Comparative Syntax of Balkan Language*, Oxford University Press, (Edited by Maria Luisa Rivero and Angela Ralli),.
[32] Mita, J. (2008). *Hyrje në sintaksën gjenerative*; (2008) *Rendi i fjalëve dhe struktura kohore*; (2017). *Teoria e sintaksës dhe veçanti të gjuhës shqipe*

aplikimin e teorisë së parimeve dhe parametrave në shqipen. Në studimin e dytë (2008) që paraqet trajtimin gjenerativist të periudhës me fjali të varur kohore, Mitaj shtrin trajtesën e tij edhe në çështjet e rendit të kësaj fjalie në raport me fjalinë drejtuese dhe në strukturën e fjalive kohore gjithmonë parë në këndvështrim gjenerativist. Ky punim thellon vështrimin e tij në gjuhën shqipe bazuar në teorinë e *Parimeve dhe parametrave*. Në librin "Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe" (2017), Mita trajton dallimin mes argumenteve dhe shtesave, thellon studimin e veçorive të kategorive funksionale, ndalet në dallimin ndërmjet plotësorëve dhe shtesave brenda sintagmës emërore duke theksuar se sintagma emër në gjinore është një plotësor e lidhet më ngushtë me emrin sesa me sintagmën parafjalore që mund të ketë rend të lirë. Studiuesi sjell tri lloje analizash që njihen në literaturën gjuhësore për sintagmën mbiemërore, aplikon Programin Minimalist për tiparet sintaksore dhe trajton fjalitë përcaktore, sintagmën lidhëzore, mohimin dhe format e pashtjelluara në gjuhën shqipe.

Gjuhëtarja Ludmila Buxheli mbështetet në gjuhësinë gjenerative për të hartuar dy monografitë e saj për "Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe" (2007) dhe "Foljet njëvetore në gjuhën shqipe" (2011). Në monografinë e parë *duke u ndalur vetëm në një nga çështjet e gramatikës gjenerative, në atë të caktimit rasor si kusht për përndarjen ose distribucionin e emrit në fjali,* autorja përpiqet *jo vetëm të përshkruajë se si funksionon sistemi rasor në gjuhën shqipe, por edhe të shpjegojë se përse sistemi rasor i shqipes funksionon sipas disa rregullave të caktuara dhe jo sipas disa rregullash të tjera*[33] duke ndjekur analiza gjuhësore sipas gjuhësisë gjenerative kryesisht mbështetur në teorinë e rasës. Interes për punimin tonë kanë përbërë sidomos çështjet e trajtuara në këtë studim lidhur me rasën emërore dhe kategorinë PRO, lëvizja A-bar, kryefjala në ndërtimet me forma të pashtjelluara e rasa kallëzore, etj. Në monografinë e dytë të Buxhelit (2011) në mënyrë të kombinuar zbatohen konceptet gjuhësore tradicionale me ato bashkëkohore të teorisë së drejtimit dhe të lidhjes. Me interes për punimin tonë kanë qenë edhe artikujt: "Rasa emërore, kryefjala e kontrolluar nga kryefjala e fjalisë drejtuese dhe kategoria PRO në gjuhën shqipe"[34] dhe "Vështrim strukturor i kryefjalës në gjuhën shqipe", kumtesë e mbajtur në Seminarin e Prishtinës në 2010-n.[35]

Gjuhëtarja Giuseppina Turano fillimisht me disa artikuj[36] të saj dhe më pas në një botim të përbashkët me studiuesen Flora Koleci[37] sjellin për shqipen trajtimin e disa prej aspekteve të sintaksës së shqipes mbi bazën e teorisë së parimeve dhe parametrave. Gjithashtu në këtë

[33] Buxheli, L. (2007). *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, f. 7-8.

[34] Buxheli, L. (2017). *Studime gramatikore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 231 - 244.

[35] Buxheli, L. (2017). *Studime gramatikore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 245-251.

[36] Turano, G. (1995). *Dipendenze sintattiche in albanese;* (1998), *Overt and covert dependences in albanian*; (2000). *On Clitics and negation in Albanian*; (2001). *Albanian Noun Phrase;* Turano, G. & Rrokaj, Sh. "A proposito del sintagma nominale in albanese" në Rrokaj, Sh. (2007). *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, f. 47-88.

[37] Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë.

botim gjenden edhe aplikime të aspekteve të konsoliduara të programit minimalist. Ajo që bie në sy është prirja e autoreve për të ruajtur terminologjinë në anglisht, ndërkohë që në autorët e tjerë ka përpjekje të dukshme e të përbashkëta që terminologjia të përshtatet në shqip.

Studiuesja Flora Koleci në studimin e saj monografik për frazat relative[38] mbështetet në këndvështrimin gjenerativist duke trajtuar përveç historikut të studimeve tradicionale rreth periudhës me fjali të varur relative, një studim të ri mbështetur në Teorinë e Drejtimit dhe të Lidhjes si dhe në programin minimalist ku ndër të tjera sillen propozimet për sistemin komplementues të Rizzi-t (1995)[39], propozimet e Bianchi-t (1999)[40] etj.

Gjuhëtari Thoma Dhima trajton në kumtesa e artikuj të ndryshëm probleme të sintaksës së shqipes në këndvështrim gjenerativ. Interes të veçantë për punimin tonë kanë sjellë: kumtesa e mbajtur në Seminarin I të Albanologjisë, (Ohër, 2007) "Disa veçori të frazës shqipe në këndvështrimin e gjuhësisë së sotme"[41], artikulli "Mbi lëvizjen e sintagmës emërore"[42] dhe ku"Mbi subjektin e formave të pashtjelluara të shqipes".[43]

Studiuesja Anila Kananaj në studimin monografik për rrethanorin[44] trajton rrethanorin e gjuhës shqipe në fjalinë e thjeshtë dhe fjalitë rrethanore në periudhë. Në këtë punim nuk kemi të bëjmë thjesht me zbatimin e parimeve të teorisë gjenerative të anglishtes, por edhe me një përpjekje për testimin e kritereve teorike specifike për shqipen.

Të tjera studime të shqipes në këndvështrim gjenerativ me të cilat jemi konsultuar janë ato të Anila Sema Çepanit[45] e cila analizon fenomenin e anaforës në gjuhën shqipe duke evidentuar veçantitë dhe të përbashkëtat e saj me gjuhët e tjera indoevropiane. Gjithashtu studimi analizon jo vetëm marrëdhënien mes antecendentit dhe anaforës, por studion ndikimin e sintaksës dhe kontekstit në këtë fenomen. Anafora shihet si pjesë e një mekanizmi të gjerë e të ndërlikuar të strukturës dhe të gramatikës.

Studimet e këtyre gjuhëtarëve përbëjnë një bazë burimore të qëndrueshme mbi të cilën është ndërtuar ky studim.

---

[38] Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes- parë në këndvështrimin gjenerativist*, Tiranë, 2013.

[39] Rizzi, L. (1995). *The Fine Structure of the left Periphery*, Elements of Grammar. Dordrecht: Kluwer.

[40] Bianchi, V. (1999). *Consequences of Antisymmetry for The Syntax of Headed Relative*, Doctoral Dissertation, Scuola Normale Superiore di Pisa.

[41] Dhima, Th. (2013). *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Infobotues, Tiranë, f. 91-99.

[42] Dhima, Th. (2010). *Kërkime universitare 11,* revistë shkencore e Universitetit "E. Çabej", gjirokastër, f. 100-114.

[43]ASHAK & ASHSH, (2008). *Studime filologjike shqiptare* (Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007), ribotuar në Dhima, Th. (2013). *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Infobotues, Tiranë,f. 115- 121.

[44] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

[45] Çepani A. S. (2007). Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe, *Studime filologjike, Nr, 3-4*, f.87 dhe Çepani A. S. (2015). *Anafora në gjuhën shqipe*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë.

1.8. Sintagma emërore

Në një fazë të mëvonshme të punimit do të merremi më hollësisht me sintagmën emërore meqë kemi zgjedhur të bëjmë qasjen e e elementeve gjenerative në disa rrafshe të sintaksës së shqipes. Në këtë pjesë të paraqitjes po mjaftohemi me analizën e një sintagme emërore për të kuptuar strukturën e saj. Së pari duhet të rikujtojmë që i vetmi element i domosdoshëm i kësaj sintagme duhet të jetë koka, pra emri. Dy përbërësit e tjerë të sintagmës janë specifikuesi dhe komplementi/plotësi me të cilin koka E formon një projektim të ndërmjetëm E' i cili së bashku me specifikuesin formojnë sintagmën emërore të plotë SE.
Në varësi të shprehjes ose jo të specifikuesit apo të komplementit mund të kemi paraqitje të ndryshme skematike gjithashtu edhe në rastin e një emri të përveçëm apo të një përemri vetor në strukturë, paraqitet vetëm koka. Le të marrim sintagmat emërore:
a) *ky vullnet i pashoq,* b) *kjo vajzë,* c) *Shpresa/ajo*. Për to do të kishim këto paraqitje skematike:

Skema 8



1.9. Sintagma e eptimit

Në studimet për shqipen gjejmë se Memushaj, R. (2008, 153-154) sqaron se rëndësi për natyrën e fjalive paraqesin kategoritë foljore të mënyrës, kohës, vetës dhe të numrit. Pranimi i kategorive funksionale bazohet në faktin se tema e një fjalëforme sillet ndryshe nga elementet eptimore që i shtohen asaj dhe elementet eptimore lidhen ose me gjithë fjalinë, ose me kryefjalën. Meqë fjalia del si projeksion maksimal i Ept, ajo hiqet nga skema dhe në vend të saj shënohet simboli SEpt. Si specifikues i fjalive të pavarura del SE që shërben si kryefjalë, dhe plotësori i Ept është SF, meqenëse në funksionin e kokës Ept dalin foljet ndihmëse, foljet modale dhe mbaresat foljore.
Edhe Mita, J. (2005, 25-28) shprehet se përgjithësisht pranohet se Eptimi është kokë funksionale e fjalive duke theksuar se veçoritë e eptimit janë të pavarura nga veçoritë e foljes si kokë leksikore dhe anasjelltas. Kjo duket te fakti që çfarëdo lloj morfemash eptimi

të marrë folja, valencat e saj nuk ndryshojnë e pavarësisht nga morfemat e ndryshme të eptimit, veçoritë leksikore të foljes nuk ndryshojnë. Ndërsa në rastin e bashkëlidhjes së trajtave mënyrore e kohore mes fjalive të periudhës, duket se folja e fjalisë kryesore përcakton mënyrën dhe kohën e foljes së fjalisë së varur, por ajo nuk e përcakton nga ana leksikore atë. Edhe Mita pranon që fjalia është projeksioni maksimal i eptimit të foljes. Argumenti i eptimit është SF, ndërsa si specifikues i eptimit është subjekti.

Studiuesja Buxheli, L. (2007, 78) shprehet se fjalia, e pavarur apo varur, nuk mund të ekzistojë pa eptimin meqë prej tij ajo rimerr tiparin: [+e shtjelluar] ose [-e shtjelluar], prandaj si njësi sintaksore, fjalia përfaqësohet me një sintagmë eptimore. Ajo e sheh më të përligjur termin *sintagmë eptimore* në raport me termin *fjali* sepse kjo e fundit nuk e pasqyron karakterin endocentrik të saj sidomos kur bëhet fjalë për trajtimin strukturor të fjalisë. Të njëjtin qëndrim gjejmë edhe te studiuesja Turano, G. (2011, 44).

Pra eptimi (Ept) është një kokë funksionale. Ai është projeksioni më i lartë i fjalisë meqenëse përmban informacione morfosintaksore si *koha* e veprimit të shprehur nga kallëzuesi dhe *përshtatjen* që realizon lidhjen mes kallëzuesit e kryefjalës. Këtë informacion në shqip e marrim përmes dy mënyrave: ose përmes mbaresave të ndryshme, ose përmes foljeve ndihmëse.

Paraqitja e një sintagme të eptimit në rastin e përdorimit të mbaresave si në fjalinë *Skënderbeu drejtonte betejën* do të ishte:

Skema 9



Në fjalinë më sipër folja gjenerohet si kokë e SF e cila është komplement për Ept'. Në këtë pozicion ajo nuk i ka tiparet e eptimit, për këtë arsye folja e lë këtë pozicion për t'u ngjitur që të marrë elementet e eptimit si: kohë, vetë, numër, për të realizuar kështu përshtatjen me kryefjalën e vet. Për këtë arsye e gjejmë në pozicionin kokë të SEpt në sintaksën e shfaqur. Kryefjala para se të zërë pozicionin e SpecSEpt fillimisht del në pozicionin e specifikuesit

të sintagmës foljore SF. Si rezultat i zhvendosjes sintaksore ajo zhvendoset në pozicionin e specifikuesit të SEpt.
Ka raste kur kryefjala nuk realizohet fonetikisht, atëherë ajo është një *pro*. Diagrami do të ishte i njëjtë. Disa shembuj të këtij rasti janë:

(7) a) I vajti të shoqes pranë dhe u mundua ta ngrinte. (J.Xoxa, Lumi…, f. 334.)
b) Harrova të të them se në Voskopojë kishte shumë myshk. (B. Blushi, Të jetosh..., f. 209)
c) U futëm prapë në një vend të errët. (I. Kadare, Kronikë…, f. 193)
d) Donte me hypë mbi at mur e me ngrânë aso kumbullash të verdha. (E. Koliqi, Tregtar…, f. 77)

Siç u sqarua edhe më lart, në shqip elementet që realizojnë eptimin mund të jenë sintetike, si ato që sapo shqyrtuam, dhe analitike si në rastin e foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*, pjesëza që tregojnë mënyrën (*të* e lidhores) apo modalitetin (*u* për kohën e kryer të thjeshtë forma joveprore).
Diagrami i SEpt me folje ndihmëse ka disa ndryshime në pozicionet e gjenerimit dhe zhvendosjes. Konkretisht për fjalinë *Skënderbeu ka drejtuar betejën.* do të kishim:

Skema 10.



Meqenëse eptimi i foljes *drejtoj* jepet përmes foljes ndihmëse *ka(m)*, kjo gjenerohet në pozicionin e kokës së SEpt dhe realizon përshtatjen me *Skënderbeu* që zë pozicionin e specifikuesit të kësaj sintagme.

1.10. Sintagma komplementuese

Edhe komplementuesi (lidhëza) projekton një sintagmë me kokë funksionale që quhet sintagma komplementuese (SK).[46] Në kategorinë e komplementuesit përfshihen elemente të tilla si: *se, që, nëse* etj. të cilët projektojnë sintagma që marrin si komplement një sintagmë eptimore. Thënë ndryshe elementet që realizojnë lidhjen mes dy fjalive ku njëra shërben si argument apo komplement i foljes së fjalisë drejtuese janë komplementues. Në fjalitë:

(8) a) Dëgjoi se shpërndahej misër.
b) Tha që legjenda fshihte të vërtetën.

raportet që vendosen mes fjalive përbërëse të frazës janë kokë – komplement ku fjalia drejtuese përbën kokën ndërsa fjalia e varur shërben si komplement i saj. Komplementuesi *se / që* projekton SK që shërben si nyje lidhëse mes dy fjalive, pra dy sintagmave eptimore dhe sintagma eptimore që ndodhet në të majtë të skemës është projektuar si komplement i sintagmës komplementuese.

Skema 11.



Gjuhëtari Rami Memushaj (2008a, 155) e trajton në të njëjtin këndvështrim me fjalinë edhe frazën duke theksuar për këtë të fundit se për të caktuar llojin e saj mbështetemi te natyra e mjetit lidhës i cili përbën kokën e fjalisë së varur. Duke u mbështetur te Çomski, Memushaj sqaron se në teorinë x-bar koka K^0 projektohet në specifikuesin (që edhe mund

[46] Në studimet e L. Buxheli (2007) dhe A Kananaj (2015) kjo sintagmë emërtohet sintagma e lidhëzës SL. Po kështu edhe te J. Mita (2017) përdoret ky emërtim përkundër sintagmës komplementuese SK që përdor në (2005).
Në punimin tonë kemi parë të arsyeshme t'i përmbahemi emërtimit sintagmë komplementuese, por në ndonjë rast, bazuar në trajtesat e këtyre studiuesve është përdorur edhe emërtimi i shqipëruar SL.

të mungojë) dhe në K'. K' zbërthehet në kokën funksionale K^0 dhe në SEpt. Ndërsa projektimet e mëtejshme janë ato të fjalisë së varur.[47] Te studiuesi Josif Mita (2005, 45) *"sintagma e komplementuesit përputhet me skemën x-bar dhe komplementuesi K (lidhëza) është koka e sintagmës. Si argument i K është SEpt d.m.th. fjalia e nënrenditur që futet nga komplementuesi"*. Ndërsa për të analizuar se cilët elemente zënë pozicionin e specifikuesit të SK, Mita i drejtohet modeleve të anglishtes duke e shtrirë analizën e tij edhe mbi fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta, për të dalë në përfundimin se në rastet kur në shqip shprehen edhe specifikuesi edhe komplementi, qoftë në rend të drejtë, qoftë në rend të përmbysur krahasuar me atë që përcakton teoria gjuhësore, kemi të bëjmë me dy projeksione maksimale SK ku SK_1 që projektohet më lart ka të zënë vetëm një pozicion: koka ku realizohet komplementuesi *se*. Ndërsa në SK_2, zihen të dy pozicionet: *në pozicionin e specifikuesit është sintagma pyetëse kur, ndërsa në pozicionin K është folja, e cila lëviz duke lënë një gjurmë në vendin prej ku ka lëvizur.*[48]

Gjuhëtaret Turano[49] dhe Koleci[50] e vlerësojnë SK si një kategori që luan rol *të rëndësishëm* në organizimin dhe në lidhjen e njësive kallëzuesore në frazë. Ato e shohin me vend përdorimin e propozimit të Rizzi-t për analizën e frazave të nënrenditura ku përveç komplementuesit mund të shtrihen edhe elementë të tjerë si Topic, Fokus etj.

Përgjatë trajtimit të qasjes së elementeve gjenerativiste në analizën sintaksore në tri rrafshe të caktuara: ***sintagmën, fjalinë dhe frazën***, do të paraqesim aty ku lind nevoja edhe propozime teorike të tjera, përveç këtyre të paraqitura më lart.

[47] Memushaj, R. (2008a). *Gjuhësia Gjenerative*, SHBLU, Tiranë. f.155.
[48] Mita, J. (2005). Hyrje në sintaksën gjenerative, Shpresa, Prishtinë, f. 48-53.
[49] Koleci, F. Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë. f.49.
[50] Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes- parë në këndvështrimin gjenerativist*, Tiranë, f. 28-29.

KREU I DYTË
VËSHTRIM MBI NJË NGA NJËSITË E SINTAKSËS: SINTAGMA EMËRORE

2.1. Hyrje

Në këtë kapitull bëhet një paraqitje teorike për sintagmën emërore dhe funksionet që ajo përfshin brenda saj duke u mbështetur për konkretizimin e materialit të saj në shembuj dhe specifika të shqipes, por pa lënë mënjanë edhe qasjen me gjuhë të tjera, kur është parë e arsyeshme.
Në të studiohet se në ç'masë e ç'mënyrë mund të pranohen nga shqipja teoritë e sintaksës gjenerative, duke nxjerrë kështu në dukje veçantitë që përbën shqipja në trajtesa teorike të këtij lloji si dhe shpjegohen përbërësit e sintagmës emërore, duke i emërtuar ata kryesisht me terma të studimeve tona sintaksore, aty ku është e mundur, por pa lënë pas terminologjinë e studimeve të sintaksës gjenerative.

2.2. Sintagma emërore

Sintagma emërore (SE) është sintagma që ka si kokë një emër (=E). Emri mund të jetë i zgjeruar ndërmjet shtimit të modifikatorëve pre-apo postnominalë.
Ndërmjet modifikatorëve që ndodhen në pozicion prenominal gjejmë kategorinë funksionale të **determinantëve (specifikuesit)** për të cilët Memushaj thotë se shërbejnë për të treguar veçoritë gramatikore të kokës së sintagmës, prandaj quhen specifikues.[51]
Specifikuesit përbëhen nga klasa leksikore "të mbyllura": *Nyjat, dëftorët*[52]*, sasiorët, pyetësit.*[53] Nga këndvështrimi i domethënies së tyre të brendshme, kanë funksione të ndryshme: p.sh. shërbejnë për të fiksuar "referencën" e E (nyje dhe dëftorë), për të shprehur lidhje "sasiore" (numërorët dhe të pacaktuarit), ose janë elemente të interpretimeve të ndryshueshme (pyetës).
Përveç specifikuesve, janë modifikatorë me pozicion shpesh prenominalë edhe *pronorët*, që tregojnë një lidhje semantike të veçantë, atë të përkatësisë. Pronorët bashkëndajnë me përcaktuesit mundësinë për të përbërë një klasë të mbyllur, por nuk mund të konsiderohen një kategori funksionale kur kryejnë brenda SE një funksion argumentues. Edhe sintagmat mbiemërore (SMb) mund të gjenden në pozicion pronominal, pavarësisht se pozicioni i zakonshëm i tyre, si do shihet më poshtë, është ai postnominal.

[51] Memushaj, R. (2003). *Sintaksa gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f. 129.
[52] Më poshtë do të sqarojmë përse nuk përdorim termin *përemra* para dëftorëve, pyetësve dhe të pacaktuarve.
[53] Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). "A proposito del sintagma nominale in albanese" në *Çështje të gjuhës shqipe*, Rrokaj, Sh. (2007). Albatros, Tiranë, f. 47.

Në disa sintagma krejtësisht të veçanta mund të gjenden para E edhe tipa të tjerë kategorish (me vlerë plotësorësh), si një ndajfolje kohe (p.sh. *tashmë drejtues, dikur student)*.
Modifikatorët postnominalë i përkasin klasave leksikalisht "të hapura" dhe përbëhen nga sintagma si SMb, SP dhe nga fjali ndërmjet të cilave përmenden në veçanti fjalitë *relative* të cilat modifikojnë ekskluzivisht E (ose shtrirjen e tij).
SP dhe fjalitë (Fj) janë **plotësorë (komplementë)** të E dhe mund të dallohen në *argumente* dhe në *shtesa*. Në veçanti siç do shihet më pas, edhe E, ashtu si F, mund të zgjedhin argumente me funksione të *Kryefjalës (Subjektit)* dhe *Kundrinorit të drejtë (Objektit Direkt)* duke shfaqur edhe ato valencë.[54]
Fjalitë relative luajnë në krahasim me E kokë funksionin e **komplementëve**. SMb mund të jenë *shtesa.*

2.3. Paraqitja e emrit në rrafshin morfologjik

Emrat janë morfologjikisht të shenjuar për kategoritë gramatikore **të gjinisë** (mashkullore, femërore, asnjanëse), **të numrit** (njëjës ose shumës) dhe të rasës. Këto kategori tregohen nga një morfemë e vetme: p. sh. *-a* e *shtëpia* tregon në të njëjtën kohë femëroren, njëjësin, rasën emërore dhe shquarësinë; -sh e *gurësh* tregon në të njëjtën kohë shumësin dhe rrjedhoren e pashquar.

2.3.1. Gjinia

Gjinia, me E që tregojnë referentë jofrymorë, interpretohet si një kategori krejtësisht gramatikore, që i shënon E në një **klasë fleksioni** të dallueshme si **mashkullore**, **femërore dhe asnjanëse**[55]. Përkatësia në njërën apo tjetrën klasë nuk përbën ndryshim në domethënie apo në vlerë referenciale, por është e rëndësishme për sa i përket përcaktimit *të përshtatjes* së mbiemrave.
Ndryshimi i seksit "mashkull/femër" në rastet e E shenjues të frymorëve, sidomos njerëzve (që shoqërohet me një ndryshim gjinor) mund të tregohet edhe me mjete morfologjike:
1) duke i shtuar mbaresat e derivacionit formës së mashkullores si: *-e, -ar, -an, -eshë,*[56] etj.
P.sh: **m > f**: *mjek / mjeke, krushk / krushkë, shtrigë / shtrigan, fshatar / fshatare*, *profesor / profesoreshë, poet / poete, kont / konteshë, luan / luaneshë,* dhe

[54] *"...valenca nuk është një veçori vetëm e foljeve, por shtrihet edhe tek një klasë emrash, tek ata që i kemi quajtur emra argumentues*". Graffi, G. (2003). *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, 2003, fq 95.
[55] A.SH.SH. (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f. 88.
[56] Po aty, f.92

f > m *patë /patok, rosë / rosak.*
2) me dy forma të ndryshme *leksikore*[57] si *burrë / grua, mashkull / femër, vëlla / motër, ka / lopë, gjel / pulë,* etj.
3) me forma të pranëvënies së emrave. Mund të ketë raste me E kafshësh që kanë një formë të vetme leksikore, për gjininë gramatikore **m**.ose **f**. Saktësimi i seksit bëhet përmes shtimit të termit *mashkull* ose *femër* ndaj E: *delfin mashkull / delfin femër, iriq femër, / iriq mashkull,* etj.
Ka edhe raste të përjashtimeve të përputhjes së seksit ("mashkull" apo "femër") dhe gjinisë (m. e f.) si te: *roje, soprano.*
Kur seksi i individit të cilit i referohemi nuk është pertinent, përdoret në përgjithësi termi në mashkullore që konsiderohet si gjini *e pa shenjuar* p.sh: *Studenti duhet të japë provimin me zë pasi të ketë kaluar atë me shkrim,* ose në *Fëmija duhet të ketë një mënyrë të ushqyeri të shëndetshme.*
Emrat asnjanës nuk tregojnë asnjëherë frymorë.
Gjinia asnjanëse në shqipen e sotme ka një karakter mbeturinor.[58] Ajo shfaqet vetëm morfologjikisht në lakimin e shquar dhe karakterizohet nga prania e nyjes së përparme të dhe nga mbaresat *–t, -të*[59].
Në shqip shfaqet edhe dukuria e ambigjenisë. *"Në disa tipa shumësi me prapashtesa ndodh ndërrimi i gjinisë nga mashkullore në femërore, çka gjen shprehje te mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese të gjinisë femërore, që ata marrin në këtë numër. Kështu formohet një grup i veçantë emrash të dygjinishëm, që qëndron midis gjinisë mashkullore dhe femërore. (...) E e dygjinishëm shënojnë sende ose nocione abstrakte, pra janë kryesisht jofrymorësh".*[60] Këta të fundit që paraqesin këtë dukuri janë të paktë p.sh: *mal /male*, *personazh* / *personazhe, personalitet / personalitete, bakter / baktere, insekt / insekte.*
Dukuria ndodh gjatë kalimit të

a) E m.nj. në sh. dhe ky kalim realizohet:
   1) me prapashtesën –e: *mal / male, qytet / qytete, vend / vende*
   2) me prapashtesën –ra: *fshat / fshatra, vaj / vajra, mall / mallra*
b) E asnjanës me prejardhje foljore[61]: *të qeshura, të bërtitura, etj.*

2.3.2. Numri

Kategoria e numrit realizon dallimin mes **njëjësit** dhe **shumësit**[62]: njëjësi tregon që

[57] A.SH.SH. (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f. 91
[58] Po aty, f. 93
[59] Po aty, f. 93
[60] Po aty, f. 92
[61] Po aty, f. 92
[62] Po aty, f. 94

referenti të cilit i drejtohemi është një, ndërsa shumësi tregon një shumësi referentësh.
Nga ky këndvështrim E mund të dallohen në E **të numërueshëm** dhe E **masë**[63].
Janë të "numërueshëm" ata E që tregojnë referentë që mund të numërohen, në kuptimin që mund të përbëjnë një shumësi entitetesh (p.sh. *libër/libra, lugë/lugët, ujk/ujqër, plak/ pleq,* etj.). E-ve të numërueshëm mund t'i kundërvihen E e ashtuquajtur të "masës". Bëhet fjalë për E të përdorur normalisht vetëm në njëjës që aludojnë për një referent që përbën një entitet të pandashëm në një shumësi entitetesh të të njëjtit tip. (p.sh.: *qumësht, sheqer, benzinë,* etj.)
Duhet theksuar që nuk ka një raport dyfish të qartë ndërmjet numrit gramatikor dhe numrit të referentëve: në disa raste, si p.sh. në E të cilët mund t'i quanim **kolektivë**, edhe me njëjësin tregohet qenësisht në mënyrë të pandarë një bashkësi ose një shumësi referentësh: p.sh. *popull, grup, grigjë, flotë* (shumësi i këtyre E tregon një shumësi shumësish: *grupe*, *popuj* etj); në raste të tjera ka E që përdoren vetëm në shumës edhe pse referenti është i vetëm: P.sh. *syzet, darët, gërshërët, pantallonat* etj.

2.3.3. Klasat e fleksionit nominal

Gjatë fleksionit nominal prapashtesat formëformuese bëhen specifikues të kategorive të gjinisë, numrit, rasës dhe shquarësisë apo pashquarësisë. Shqipja nyjet rasore i ka të prapavendosura, me përjashtim të nyjes së përparme joshquese *një.* Është paraqitur këtu një tabelë përmbledhëse e prapashtesave formëformuese të fleksionit nominal:

Tabela 1.

Lakimi	Gjinia	Njëjës		Shumës	
		Tr.e pashquar	Tr.e shquar	Tr.e pashquar	Tr. e shquar
I	m.	Ø,-i,-i,Ø,-i	-i,-it,-it,-in,-it	Ø,-ve,-ve, Ø, -(i)sh	-t/-it,-ve,-ve, -t/-it, -ve
II	m.	Ø,-u,-u,Ø,-u	-u,-ut,-ut,un,-ut	Ø,-ve,-ve, Ø, -(i)sh	-të/-it,-ve,-ve, -të/-it,-ve
III	f.	Ø,-(j)e, (j)e, Ø, -(j)e	-(j)a,-s(ë),-s(ë), -n(ë), -s(ë)	Ø,-ve,-ve, Ø, -sh	-të,-ve,-ve, -të,-ve
IV	n.	Ø, -i,-i,Ø,-i	-it,-it,-it,-it,it	Ø,-ve,-ve,Ø, -sh	-t,-ve,-ve,-t,-ve

[63] "Është fjala për "emrat që kanë vetëm njëjësin (*singularum tantum*). Forma e njëjësit këtu s'ka atë kuptim si tek emrat që tregojnë sende të numërueshme". A.SH.SH. (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f. 95.

2.4. Modifikatorët emërorë

2.4.1. Determinantët

*Determinantët bashkëpërkojnë në gjini e numër me E kokë (përveçse kur janë morfologjikisht të pandryshueshëm). Mund të ndahen në: 1) nyja, 2) dëftorë, 3) sasiorë, 4)pyetës (elemente **wh**)*



2.4.2. Nyjat

Nyjat ndahen në shquese dhe joshquese. Format e nyjave të shqipes janë dhënë më sipër në tabelën e fleksionit nominal.

Nyjat shquese të shqipes, përveç shprehjes së shquarësisë, përdoren edhe si mjete për të shprehur kategorinë e numrit, gjinisë dhe rasës së emrit: shtëpi-a, shtëpi-ve, djal-i, djem-të, etj. Ato përfshihen në klasën e **determinantëve** (zënë pozicionin e specifikuesit në sintagmë).

Nëse do të bënim paraqitjen e skemës së SE ***libri*** paraqitja në diagram do të ishte:

Skema 12.



Paraqitja në diagrame e së njëjtës SE në gjuhë të ndryshme do të ishte:

a)the book, b)le livre, c)il libro, d)der Buch.

Skema 13.



Siç vihet re diagrami është i njëjtë si për shqipen, anglishten, frëngjishten, italishten dhe gjermanishten për SE që përmban një kokë E dhe një specifikues Nyje të shquar (N.shq.). Rasti i shqipes kur nyja shquese prapavendoset ndaj emrit kërkon një analizë më të thelluar. Në këtë rast emri lëviz para nyjës shquese duke lënë një gjurmë në vendin që kish.[64] Në derivacionin e emrave të shquar (…) përfshihet një rregull lëvizjeje që e ngre emrin nga pozicioni N (projeksioni zero) në pozicionin kokë D, ku në fakt projektohet nyja. Përmes

[64] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 20.

kësaj lëvizjeje N/E trupëzohet me nyjën që ndodhet në D. Shtresat e përshtatjes që shfaqen te N/E kontrollohen në pozicionin e ndërmjetëm Num, pozicion në të cilin kalon fillimisht N/E para se të arrijë D.

Skema 14.



[65]

Lëvizja e N/E bëhet sipas rregullës **lëviz α,** ndërsa pranojmë paraprakisht që projeksioni maksimal i N/E është një plotës (determinant) D i kokës. Memushaj[66] thotë se *me α duhet kuptuar çdo kategori që i nënshtrohet një rregulle transformuese. (...)* ***Lëviz α*** *kontrollohet nga nënsistemet e teorive të gramatikës. Ajo mund të lëvizë vetëm materialin leksikor, i cili kur lëvizet nga një nyjë në tjetrën, lë një gjurmë në vendin e mëparshëm. Veç kësaj lëvizjet duhet të jenë të tilla që të shihet jo vetëm se nga vjen një kategori që ka lëvizur, por edhe stacionet e ndërmjetme në të cilat ka kaluar, d.m.th. të shihen gjurmët e saj në çdo nivel të kalimit nga struktura e thellë te struktura sipërfaqësore dhe nga kjo te forma fonetike dhe te forma logjike"*[67].

Nyja joshquese *një* e cila paraqet një element autonom që gjendet gjithnjë para E, nuk përbën kundërshti morfologjike në lidhje më gjininë e rasën: *një vajzë / një djalë; një vajzë / një vajze / një studenteje* etj. Ajo shfaqet në diagramën pemë si nyje e projeksionit të sasiorit e dominuar nga DP (sintagma e determinantit)[68] ku D *është për specifikuesin.*

---

[65] Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Turano, G. Rrokaj, Sh. Albatros, Tiranë, f.53.

[66] Memushaj. R. (2003). *Gjuhësia gjenerative,* SHBLU, Tiranë, f.144.

[67] Të njëjtin mendim ndan edhe Kallulli D. në studimin e saj doktoral *The Comparative Syntax of Albanian: On the Contribution of Syntactic Types to Propositional Interpretation,* 1999, f.133. Po ashtu edhe Koleci.F e Turano. G në *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, 2011, f.66.

[68] *"Il quantificatore singolare një, realizza, invece, la testa Q del sintagma nominale. Va precisato comunque che in albanese il quantificatore può occupare un nodo dominato dal determinante, oppure può occupare un nodo superordinato a D°.*" (Sasiori njëjës *një*, përbën kokën Q të sintagmës emërore. Duhet sqaruar që në

Skema 15.



Në një analizë të tillë mbështetet edhe studiuesja Giuliana Giusti e cila duke aplikuar teorinë e Abney-t (1987) paraqet si kokë të sintagmës emërore në rastet e prapavendosjes së determinantit në emrat e shquar të shqipes, elementin D në të cilin shprehet shquarsia. SE del si komplement i determinantit. Emri zhvendoset nga pozicioni bazë E ku gjenerohet, në pozicionin D ku gjenerohet determinanti. Në këtë mënyrë ai bashkohet me të. Autorja mbështet mendimin se nyjat shquese janë zhveshur plotësisht nga tipari semantik dhe mbartin vetëm tipare gramatikore sintaksore si gjini, numër, rasë e shquarsi, që kanë funksion vetëm të realizojnë përshtatjen me një E. Sipas rregullës që autorja e quan *Projektim*, nyja shquese krijon aq kopje sa janë trajtat që nyja bashkon.[69]

Për t'iu kthyer analizës së mësipërme, ndër të tjera u theksua që nyjat shquese në shqip përveç tiparit të shquarsisë bartin edhe informacionin e numrit, rasës dhe gjinisë. Kjo do të bënte që të gjitha nyjat funksionale të jenë të pranishme në diagramë ashtu si në (15).

Duket se është gjetur shpjegimi për pozicionin postnominal të nyjes shquese në gjuhën shqipe. Ky arsyetim siç e pamë ka mbështetje si në zhvillimet teorike të sintaksës gjenerative që nuk lidhen vetëm me shqipen, ashtu edhe nga studiues që e shohin shqipen në qasje edhe me gjuhë të tjera. Por studiuesja Teuta Abrashi[70] duke analizuar SE [*Leka i madh*] vë në diskutim një interpretim të tillë duke përligjur qëndrimin e saj me faktin që tiparet e gjinisë mashkullore nuk pasqyrohen te nyja shquese që zgjedh emri *Leka*. Për të vërtetuar që bëhet fjalë për emra mashkullorë, Abrashi emërzon mbiemrin dhe vëren se: emrat mashkullorë të huazuar nga gjuhët e tjera si *axha, daja, hoxha* marrin nyjën shquese të femërores. Prova e emërzimit të mbiemrit dhe nyjes shquese mashkullore ***-i*** që merr mbiemri i emërzuar, lejon të mendohet se *nyja mund të ketë forma të ndryshme te emri dhe mbiemri vetëm nëse ata realizohen në të njëjtin pozicion me nyjën*, pra nëse *dalin nga leksikoni së bashku me nyjën*, d.m.th. *para se të hyjnë në sintaksë*. Këtë e mbështet edhe me shembujt me mbiemra të bashkërenditur:

---

shqip sasiori mund të zërë një nyje të dominuar nga determinanti, ose mund të zërë një nyje të mbivendosur ndaj D^0. *përkth.ynë*). Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Turano, G. Rrokaj, Sh. Albatros, Tiranë, f.53.

[69] Giusti, G. (2012). *Enclitic and proclitic artices in Albanian, Theorical and Empirical Studies in Albanian Syntax*, Monaco di Baviera, LINCOM EUROPA, vol. LSIEL 39. f.55-73.

[70] Abrashi, T. (2020). Rreth disa çështjeve të diskutueshme të sintagmës emërore të shqipes, në ASHAK, (2020). Studimet albanistike në Itali, Prishtinë, f. 407-412.

a. Vajz-a e mjerë dhe e gjorë.
b. *E mjer-a dhe e gjorë vajzë.
c. *E mjerë dhe e gjor-a vajzë.
d. E mjer-a dhe e gjor-a vajzë.

Prania e nyjës shquese në të dy mbiemrat e emërzuar shtyn në arsyetimin që këto shembuj dëshmojnë që supozimi i zhvendosjes së emrit apo mbiemrit për të përftuar sintagmën emërore të shqipes, nuk është i aplikueshëm si në gjuhët e tjera. Duke e krahasuar me nyjat e bullgarishtes e maqedonishtes që janë të prapavendosura, studiuesja vëren se ndryshe nga ato, nyja shqyese në shqipe është e integruar me emrin dhe ka komponentin semantik të zbehur. Për këto arsye si dhe për faktin që plotëson pesë nga gjashtë kriteret për të qenë një afiks, nuk e sheh nyjen shquese si klitik.
Gjithsesi në përfundim të këtij seksioni, ne do i kthehemi analizës ku ndër të tjera u theksua që nyjat shquese në shqip përveç tiparit të shquarsisë bartin edhe informacionin e numrit, rasës dhe gjinisë. Duke mbështetur mendimin e shumicës së studiuesve dhe duke pranuar që shqipja përbën raste të veçanta përjashtuese që nuk i përgjigjen rregullave të përgjithshme, do të vijojmë mbështetjen e tezës që **nyja shqipe është një klitik**. Kjo do të bënte që të gjitha nyjat funksionale të jenë të pranishme në diagramë ashtu si në skemën 15.

2.4.3. (Përemrat) dëftorë

Sipas Lyons përemrat dëftorë janë elemente *deiktikë ku k*oncepti i deiksit, që vjen nga fjala greke për "shenjoj" ose "tregoj" përdoret për të trajtuar tipare të gjuhës, që i shërbejnë "drejtimit", praktikisht atij drejtimi që lidhet me kohën dhe vendin e shprehjes."[71]. Dëftorët kanë kuptimin e përgjithshëm të të treguarit a të dëftuarit të sendit, të veçimit të tij nga sendet e tjera të së njëjtës klasë.[72] Po sipas Lyons dëftorët që tregojnë frymorë apo sende larg folësit nuk dallohen nga përemrat (është fjala për përemrat vetorë që kanë funksionin e mirëfilltë të përemrit si zëvendësues të emrit) e vetës së tretë. Ai sqaron se "Në shumë gjuhë "dëftorët nuk dallohen nga "përemrat e vetës së tretë". Kështu ndodh p.sh. në turqishte, ku *ai, ajo, ata, ato* (nqs ata rijepen me anë të një përemri), normalisht, përkthehen me *o* (turqishtja nuk ka gjini) dhe shumësi *ata* me formën e shumësit të të njëjtit dëftor, prak.me *onlar*. Në latinishten klasike (si dhe në greqishte) nuk kishte fare "përemër të vetës së tretë" kur i referohej një objekti bisede me anë të një "përemri" (që nuk ishte as folës, as dëgjues), përdorej "dëftori" përkatës *–hic*, *iste* ose *ille.* Për të plotësuar atë, (krahas tre dëftorëve të përmendur, por ndryshe nga këta që përdoren në lidhje me raportin ndërmjet largësisë dhe vetes, ishte edhe fjala *ist*, e cila normalisht nuk përdorej si kryefjalë

[71] Lyons, L. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, f.259.
[72] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f.230.

gramatikore dhe me pozicione të tjera sintaksore ishte "më asnjanësja" ndër "përemrat dëftorë" sepse qëndronte jashtë kategorisë së "largësisë"). "Përemrat e vetës së tretë" në gjuhën romane (franceze, italiane, spanjolle, etj) në të vërtetë janë zhvilluar nga "përemrat dëftorë". E njëjta gjë vlen edhe për "përemrat e vetës së tretë" në gjermanishte dhe në anglishte. Edhe "nyja shquese" është zhvilluar në të gjitha gjuhët (angl. *the*; frëngj. *le*, *la* etj), në të vërtetë janë zhvilluar nga një "përemër dëftor". Ky është çelësi i mirëfilltë i raporteve ndërmjet këtyre tri "pjesëve të ligjëratës". Që të tria kanë ndër të tjera edhe tiparin "e shquarsisë"; në këtë vështrim *der Mann* "burri", *dieser Mann* "ky burrë", *jener Mann* "ai burrë" qëndron në kundërvënie me *ein Mann* "një burrë", kurse *er* "ai" - në kundërvënie me *jemand* "dikush". Megjithatë, si *burri*, ashtu dhe *ai* meqë nuk kanë asnjë faktor largësie, qëndrojnë në kundërvënie me *ky burrë* ("proksimal" afër) dhe *ai burrë* ("distancial" larg). Ndarja tradicionale midis "nyjes", "përemrit vetor" fsheh këto marrëdhënie" [73]

Në gjuhën shqipe dëftorët shfaqen detyrimisht para kokës nominale dhe përshtaten në gjini, numër e rasë me E: ***kjo*** *studente/****ky*** *piktor;* ***këto*** *studente/****këta*** *piktorë;* ***ajo*** *studente /****ai*** *piktor;* ***ato*** *student /* ***ata*** *piktorë dhe *studente kjo/ajo, *piktor ky/ai, *studente këto/ato, *piktorë këta/ata.*

Edhe ata projektohen në pozicionin e specifikuesit pasi kryejnë funksione determinuese në SE. Diagrama pemë e SE *ajo studente është*:

Skema 16.



[73] Lyons, L. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, f.262.
".

2.4.4. Sasiorët



Në këtë kategori përfshihen një sërë determinantësh prezenca e të cilëve përcakton një interpretim "sasior" të SE së cilës i referohen. Sasiorët ndahen në nënklasa:
a) ***numërorë të mirëfilltë****,* që i referohen një sasie numerikisht të saktë (të përcaktueshme) si shoqërues të emrave që emërtojnë sende a qenie të një fare, sasia e të cilave është e numërueshme *një, dy, tre*[74] *etj.*
Numërorët të ashtuquajtur rreshtorë **nuk janë sasiorë**, meqë nuk përcaktojnë në mënyrë sasiore referentët, por tregojnë pozicionin në raport me një apo më shumë referentë brenda një bashkësie numerike, pra përfshihen në mbiemrat marrëdhëniorë[75] *i parë, i dytë, i pestë, i nëntë, etj*. Numërorët rreshtorë janë të prapavendosur ndaj E*: p.sh. shekulli i njëzettë, provimi i dytë, klasa e pestë, hyrja e katërt, etj.*

b**) (Përemra) të pacaktuar** që kanë aftësinë të specifikojnë "sasinë" e referentëve që i drejtohet SE. Sasiorët e pacaktuar mund të ndahen në:
1. **Sasiorë që tregojnë, përjashtojnë apo veçojnë një frymor apo një send në mënyrë të pacaktuar**: *një, çdo, cilido, secili, asnjë, asnjëri, njëri, gjithsecili, ndonjë, ndonjëri*, etj. *Kush* pavarësisht se është p.i pacaktuar nuk përfshihet në determinantët për këtë mbështetemi te Mitaj që thotë: "Që *kush* të lexohet si përemër i pacaktuar ka rëndësi pozicioni (në fillim të fjalisë është pyetës) si dhe disa elementë të tjerë pa praninë e të cilëve kush nuk mund të lexohet i pacaktuar. (Turano: 1995, 73) Është fjala për mohimin, intonacionin pyetës ose pjesëzën pyetëse a lidhëzat kushtore. Ai qëndron në fund të fjalisë dhe nuk ka pozicionin D sepse është një SE e zhveshur të cilat e kanë të detyruar përfshirjen

[74] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f. 204.
[75] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f. 203.

e tyre në SF. Elementet e ngurosur *di-*, *-as*, *-do*, janë operatorë që kur bashkohen me *kush* i japin respektivisht kuptimet me vlerë pohuese, mohuese, pohuese." [76]
Sasiorët **cilido, secili, asnjëri, njëri, ndonjëri** përshtaten në gjini e rasë me E kokë: njëra vajzë, asnjërit student, ndonjërin libër, etj. (të brendshëm).
2. **Sasiorë që i referohen një sasie apo tërësie të pacaktuar sendesh apo frymorësh**:

a) sasiorë që tregojnë një **sasi** të pacaktuar frymorësh a sendesh: *ca, disa, shumë, pak, mjaft, çfarëdo*. P.sh: *ca kalimtarë, disa mësues, disa libra, ca fëmijë, shumë përralla, mjaft libra, pak fjalë, etj.* Këta përemra nuk shfaqin në këto SE kategori gramatikore.

b) sasiorë që tregojnë **tërësi** të pacaktuar frymorësh a sendesh: *gjithë, tërë, mbarë. p.sh: gjithë strukturën / strukturat / shokët, tërë punën / punët / mësuesit, mbarë Shqipëria / popujt / fëmijët.* Në përfshirjen në SE këto sasiorë janë të pandryshueshëm.
Mund të përdoren në bashkime me emra të panumërueshëm, p.sh. *gjithë turma, tërë qumështi, mbarë të korrat*. Në këtë grup mund të përfshihet edhe përemri *të tjerë* që në disa përdorime sillet si një sasior. *Më jep rroba të tjera. Lajmëro nxënës të tjerë.*
Dy grupet e sasiorëve dallohen nga fakti që me elementet e grupit të parë është i mundshëm vetëm një interpretim veçues i shumësit, ndërsa me ato të grupit të dytë mund të arrihet edhe në një interpretim "kolektiv". Të shihet ndryshimi mes (9a) dhe (9b):

(9) *a. Secili fëmijë besonte se do të merrte një çmim.*
b. Gjithë fëmijët besonin se do të merrnin një çmim.

Fjalia (9a) ka një interpretim për të cilin fakti "do të merrte një çmim" i përket një fëmije të vetëm që e beson, e jo domosdoshmërisht të tjerët: pra shumësia është vetëm indirekte *(si shumë e fëmijëve të veçuar që kanë këtë opinion).* Ndërsa në (9b) përveç këtij interpretimi, mund të ketë një tjetër për të cilin besimi për të *"marrë një çmim*" i përket në fakt një tërësie fëmijësh *(që kolektivisht kanë këtë opinion).*
Sasiorët *(përveç çdo, gjithë, të gjithë, tërë, mbarë, njëfarë)* mund t'u paraprijnë, përveçse E të cilëve u referohen*, (p.sh. secili piktor, ca libra),* edhe një SP [nga SE] dhe tregojnë bashkësinë përkundrejt sasiorit që tregon një nënbashkësi (d.m.th. një pjesë): *secili nga piktorët, ca / disa nga librat, etj.*
Mes sasiorëve të këtij tipi përfshihen edhe SE *një çikë* e të ngjashme, që determinojnë një SP [P nga +SE], por që përdoret i shoqëruar nga E njëjës: p.sh. *një çikë nga ëmbëlsira, një çikë nga buka, etj.*
Me E që tregojnë masë, apo me E kolektivë, plotësi i pjesshëm është i mundur vetëm me sasiorët *shumë, pak, mjaft dhe disa:*

(10) *a. Mjaft nga gruri i sivjetëm do të eksportohet.*
b. Pak nga qumështi i djeshëm ka mbetur.

[76] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, fq 43.

2.4.5. Fjalët pyetëse

Para se të trajtojmë fjalët pyetëse sqarojmë se bazuar te Graffi[77] nuk i quajmë *përemra* pasi nuk individualizojnë asnjë njësi të saktë, por kufizohen të tregojnë rrethin në të cilin duhet kërkuar kjo njësi.
Një paraqitje e plotë për fjalët pyetëse do të përbënte një diagram të këtij lloji:

Fjalë pyetëse
- Përemra pyetës
- Ndajfolje pyetëse
- Pjesëza pyetëse

ku shembujt: *Nuk e mbante mend kur e kishte shkruar poezinë e parë.* dhe *A erdhi Agimi?* ilustrojnë përdorimet e Nd dhe pjesëzave pyetëse, në fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta, por determinantë të SE janë vetëm të ashtuquajturit përemrat pyetës, prandaj më poshtë do shqyrtohen vetëm ata.
Pyetësit gjenden në brendësi të SE që përfshihen në fjali pyetëse dhe thirrmore të drejta e të zhdrejta: ***cili, ç', çfarë, sa***[78]. P.sh.:

(11) a. *Cili pallat të ka pëlqyer?*
b. *Më thuaj sa kripë ke vënë në ujë?*
c. *Sa probleme më krijoi!*
d. *Ç'telashe më krijoi!*

Cili ka kategorinë e gjinisë, numrit e rasës, ndërsa *sa* ka vetëm kategorinë e rasës, por në SE format rasore i ka vetëm E kokë dhe jo *sa*, kurse *ç'* dhe *çfarë* janë të pandryshueshëm[79].

Cili shërben kryesisht për të dalluar një individ brenda një grupi, sepse përdoret shpesh për të veçuar një frymor a një send nga grupi ku ai bën pjesë [80]
(12) *Cilin libër zgjodhe nga ata të kësaj shtëpie botuese?*

ndërsa kur ***ç'*** ndiqet nga një emër, përdoret më së shumti për të pyetur mbi një cilësi, kërkohet përcaktimi i tiparit, i shenjës, i karakteristikës së sendit ose të frymorit.[81]
(13) *Ç'njeri ishte? (Ç'lloj njeriu ishte?)*
por përdoret edhe me interpretim sasior në fjalitë thirrmore (11.d)

[77]Graffi, G. (2003). *Sintaksa,* Dituria, Tiranë, f. 55
[78] Kemi përfshirë vetëm pyetësit që determinojnë kokën E të SE.
[79] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f. 244-245.
[80] Po aty, f. 244.
[81] Po aty, f. 244.

Sa ka kuptim sasior dhe mund të përdoret edhe në fjali thirrmore. (11.c)
Të gjithë këto fjalë pyetëse (nganjëherë edhe me kuptime eksklamative) mund t'u paraprijnë përveç SE edhe SP:

(14) a. Nga cila rrugë erdhe?
b. Me sa libra e ke mbushur çantën?
c. Për çfarë njerëzish e ke fjalën?
d. Në ç'krah të rrugës të të pres?

2.5. Përshtatja mes determinantëve dhe rendi relativ

Një E mund të paraprihet nga disa elemente: p.sh. *ato pak pemë, të gjithë këta djem.* Por jo të gjitha kombinimet janë mundshme. Ndërmjet determinantëve ka edhe mospërputhje, disa të rregullit semantik, kurse të tjera të rregullit sintaksor, që pengojnë disa sekuenca. Edhe rregulli relativ ndërmjet determinantëve është më së shumti fiks.

Në veçanti, nyja shquese dhe ajo joshquese përjashtojnë njëra-tjetrën: **një çanta, *një banka, *një studentja*; po kështu nyja joshquese dhe dëftorët përjashtojnë njëri-tjetrin (duhet vënë në dukje se dëftorët, përveçse janë elemente "deiktikë", tregojnë ngushtësisht edhe shquesi; bashkëpërdorimi i nyjes joshquese dhe dëftorit do të qe kontradiktor, prandaj **një ajo mike / *ajo një mike, *ky një piktori / një ky piktori.* Ndërsa bashkëpërdorimi i dëftorit me nyjën shquese në shqip nuk shfaq kontradiksion.
ky piktori, ato studentet.
(krah. angl. **this the boy*, frëngj. **ce le garçon*, ital. **questo il ragazzo*).

Agalliu (1975) për rastin e ndërtimeve dëftor + E shquar shprehet se dëftori ka funksion anaforik për shkak se komponenti deiktik i tij është dobësuar dhe ai rimerr një emër të pashquar të përmendur më parë gjatë ligjërimit.[82] Të njëjtin mendim mbështet edhe Kallulli (1999, 49) kur pohon se anaforizimi është një mënyrë për të identifikuar Topic. Problemi shfaqet kur këto ndërtime nuk vijnë si një rimarrje anaforike si në rastin:

(15) Ky piktori përgatitet për ekspozitë.

Duket se dëftori dhe emri i shquar konkurrojnë për të njëjtin vend të specifikuest (Spec). Në qoftë se emri lëviz nga pozicioni E në pozicionin Spec (ku veshet me nyjen shq.) është e pamundur që edhe dëftori të jetë në pozicionin Spec. Po qe se pozicioni Spec është i zënë nga emri, dëftori që zë një pozicion më të ulët, lëviz në një pozicion më të lartë.

[82] Agalliu, F. (1975). Ndërtimi Dëtor + Emër i Shquar në gjuhën shqipe, *Studime fillologjike* 1. f. 125

Një interpretim i këtij ndërtimi vjen nga Giusti (1992;1995;1996) e cila e sheh të gjeneruar dëftorin në pozicionin e specifikuesit në nivelin më të ulët të SE dhe arsyeton që shfaqja e tij në pozicionin para emrit vjen si pasojë e lëvizjes së specifikuesit nga pozicioni më i ulët në pozicionin e spesifikuesit të sintagmës së determinantit DP. Kjo sepse dëftori, si element që është i pajisur me aspekt deiktik referencial, është i vetmi që mund të ngjitet në D. Thënë ndryshe ajo e konsideron dëftorin si një sintagmë lëvizja e së cilës drejt një pozicioni specifikuesi është e legjitimuar me nevojën për të vërtetuar aspektin referencial. Problemi është se në këtë interpretim, pozicioni specifikues D është i zënë nga emri i cili është ngjitur nga pozicioni i tij për të marrë nyjën shquese. Përkundër kësaj analize, Turano e Rrokaj (2007, 76) e vlerësojnë dëftorin si kokë dhe si e tillë lëvizja e tij do jetë në pozicion koke. Për ta vërtetuar këtë autorët i referohen ndërtimeve pa dëftor të cilat do të ishin gramatikore.

(16) Piktori përgatitet për ekspozitë.

Në gjuhët ku determinanti trupëzohet me fjalën, emri i nënshtrohet zhvendosjes në pozicionin D° ku ngjitet nga pozicioni bazë i tij N°. Të dhënat e përshtatjes që shfaqen te emri kontrollohen nga pozicioni i ndërmjetëm Num ku emri kalon për t'u ngjitur në pozicionin D. Nga ana tjetër ndërtime të tipit *këta dy piktorë* parashtrojnë prezencën e një tjetër pozicioni të ndërmjetëm që është ai i sasiorit Q i cili mund të jetë në një pozicion që dominohet nga D, ose në një pozicion që dominon D°. Për këtë arsye emri lëviz nga pozicioni N në pozicionin D, ku trupëzohet me determinantin, ndërsa dëftori lëviz nga një pozicion më poshtë brenda SE në pozicionin Q.
Analiza e sheh dëftorin si një element të tipit kokë, që realizohet mbi pozicionin D°(Spec).[83] Diagrama e konkretizon këtë:

Skema 17.



[83]Turano, G & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Rrokaj, Sh. Albatros, Tiranë f. 76.

(17) Pashë një djalë. Ky djali punonte shumë.[84]

Ndërtimi (17) na bën të kthejmë vëmendjen tek struktura binare *Topic-Comment* ku *Topic* përfaqëson atë që dëgjuesi njeh tashmë, ndërsa *Comment* paraqet informacionin e ri.

Skema 18.



Të njëjtin interpretim mbështet edhe Mita (2005, 34), por me një terminologji të përkthyer në shqip e cila çon pikërisht në pranimin e strukturës *Topic-Comment* meqenëse e emërton Sintagma e së Njohurës (SN joh) projeksionin më të lartë, ndërsa me SC (sintagma e caktuesorit) emërton SD.

Skema 19.



Përemrat pyetës janë të papajtueshëm me determinantë të tjerë:

[84] Shembull i marrë nga Turano,G. Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në Rrokaj, Sh. (2007). *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, f.76.

(18) **Cili një është?*
**Këto sa mollë ke ngrënë?*

Por, me vlerë thirrmore, bashkëpërdorimi i pyetësve me sasiorët është i mundur:
Sa shumë mollë ke ngrënë!

Nyjat shquese dhe dëftorët mund të bashkëpërdoren me sasiorët që janë të përputhshëm me një kuptim të caktuar. Për sa i takon rendit relativ, dëftori paraprin sasiorin (p.sh. *këta pesë miqtë, këto pak lekët, ato pak detyrat*), por ndjekin *gjithë, tërë, mbarë (gjithë këta studentët, tërë këto vajzat, mbarë këtyre popujve).*
Kur numërorët dhe sasiorët (përveç *gjithë, tërë, mbarë)* gjenden me nyjen shquese, marrin një vlerë "përshkruese". Në këto raste sillen si komplementë "predikativë":
P.sh. përveç *tre librat që kam lexuar…, ato pak lekët që kemi...*, mund të krijohen edhe struktura predikative: *Librat që kam lexuar janë tre. Lekët që kemi janë pak.*
Një sjellje e veçantë është ajo e *tjetër* i cili mund të bashkëpërdoret me një nyje shquese dhe joshquese (*një tjetër mikut, ...*), por nuk mund të shfaqet në funksione predikative. Ndërsa mund të ndjekë sasiorë të tjerë: p.sh. (për) *asnjë tjetër student,* (prej) *ndonjë tjetër libri.* Bashkëpërdoret me një numëror: p.sh. (edhe) *pesë libra të tjerë*, (në) *tri raste të tjera*, etj.
Çfarëdo mund të paraprihet ose jo nga nyja joshquese: (*një) çfarëdo programi, çfarëdo librash* mund edhe të prapavendoset ndaj E njëjës: në këtë rast është e domosdoshme prezenca e një nyjeje joshquese (*Më sill një letër çfarëdo.),* por (*Më trego punime çfarëdo.)* nëse prapavendosen me E shumës.
Me numërorët nuk përdoret nyja joshquese. (*një/ ca tri libra)

2.6. Determinantë dhe SE të bashkërenditura

Në prani të dy SE të bashkërenditura që tregojnë dy referentë të ndryshëm, determinanti mund të mungojë në SE e dytë, nëse këto janë në shumës dhe kanë të njëjtën gjini.

(19) a. *Malet dhe fushat tona janë madhështore*.
b. *Këto lule e pemë i kam mbjellë me dorën time.*
c. *Shokë e miq të largët na erdhën për vizitë.*
d. **Shokë e mik të largët na erdhën për vizitë*

Në këto raste përftohet "elipsa" e determinantit që mund të paraqitet në strukturën sintaksore me Ø: SE [[D *këto* E *lule*] dhe [D Ø E *pemë*]].
Nëse SE e bashkërenditura janë në njëjës, mungesa e një determinanti në elementin e dytë të bashkërendimit i jep shkas një interpretimi të ndryshëm në dallim nga (19); në fakt në:

(20) a. *Njoh një iluzionist e akrobat të cirkut.*
b. *Diskutoj gjithnjë me një mësues e koleg.*

i vetmi interpretim i mundshëm është ai në të cilin *iluzionist* e *akrobat* dhe *mësues* e *koleg* i përkasin të njëjtit referent, dhe determinanti i referohet krejt sekuencës së elementeve të bashkërenditur (nuk ka në këtë rast elipsë të determinantit dhe struktura është SE [D një [E *iluzionist* (e) E *akrobat*]]). Interpretimi sipas të cilit referentët janë dy, përjashtohet, siç tregon jogramatikaliteti i një fraze si ajo më poshtë në të cilin folja në shumës imponon një interpretim të këtij lloji:

(21) **Ky iluzionist e akrobat janë të njohur.*
Nëse referentët do të ishin dy, duhej të vendosej determinanti edhe në SE e dytë:

(22) a. *Njoh një iluzionist e një akrobat të cirkut.*
b. *Ky iluzionist e ky akrobat janë të njohur.*

2.7. (Përemrat) pronorë

Pronorët kanë kategoritë e gjinisë, numrit dhe rasës, por është kategoria e vetës plotësisht paralele me atë të përemrave vetorë që i bën ata të sillen si përemra. Meqenëse kundrohen nga raporti i dyfishtë "pronë-pronar", për secilin numër shfaqin më shumë se një formë, ndërsa në varësi të numrit të pronarit, për çdo gjini në vetën e parë e të dytë dalin dy forma.

Pra pronorët për vetën I dhe II kanë nga dy palë forma për çdo numër, ndërsa për vetën III kanë katër palë forma në njëjës dhe pesë forma në shumës.
Paradigma është kjo[85]:

Tabela 2.

Veta e parë				Veta e dytë			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
M	F	M	F	M	F	M	F
im /tim *ynë/tonë*	*ime/sime/time* *jonë/sonë/tonë*	*e mi* *tanë*	*e mia*[86] *tona*[87]	*yt/tënd* *juaj/tuaj*	*jote/sate/tënde* *juaj/suaj/tuaj*	*e tu* *tuaj*	*e tua* *tuaja*
Veta e tretë							

[85] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f. 240.
[86] *e mi* dhe *e mia* lakohen si mbiemrat e nyjshëm.
[87] *tuaj* dhe *tanë* nuk lakohen ashtu si mbiemrat e panyjshëm.

Njëjës				Shumës			
M		F		M		F	
i tij *i saj* *i tyre*	*i vet*	*e tij* *e saj* *e tyre*	*e vet*	*e tij* *e saj* *e tyre* *e vet*	*e veta*	*të tij* *të saj* *të tyre*	

Pronori *i (e) vet* që përdoret vetëm në vetën e tretë, është pronor vetvetor që tregon se sendi a frymori i dhënë i përket sendit a frymorit të shënuar nga kryefjala:

(23) a. *Rudina e tregoi natyrën e vet.*
b. *Ai u bashkua me klasën e vet*.

Ky pronor ka të njëjtin shpërndarje me *i tij, i saj, e tij, e saj dhe mund të zëvendësohet me këta pronorë*:
(24) a. *Ai e kreu punën e vet.*
b. *Ai e kreu punën e tij.*

2.8. Pronorët dhe determinantët: rendi relativ

Kur shfaqen në pozicion postnominal: *libri im, këpucët e mia, nxënësit e tu, çanta e saj*, mund të kombinohet vetëm me E të shquar: *libr-i yt/im*, por **libër yt/im,* ndërsa nuk mund të përdoren në SE që kanë E të pashq, ose E të pashq me determinant një dëftor apo sasior të pacaktuar:

**një libër im*, **ky libër im*, por *ky libri im, *çdo libër im*.

Pronorët gjenerohen në specifikues të E kur ndodhen në pozicion postnominal ndaj E të shquar si dhe në ndërtimet **dëftor + E i shquar + pronor** (*ky libri im, kjo motra jote*).
Një rast të pozicionit postnominal ndaj E të shquar analizon edhe Mita i cili vëren se koka E e emrit lëviz në pozicionin C (D) për të marrë atje caktuesinë, duke lënë një gjurmë në pozicionin ku ka qenë. Nga kjo lëvizje vjen rendi E i shquar-pronor: **vëllai im** është e pranueshme sepse pozicioni C është i realizuar.[88] Ndërsa lidhur me ndërtimet *ky libri im* shqyrtuar nga Turano, Rrokaj, studiuesit shprehen: "*La sola possibilità, in albanese, di combinare un articolo indeterminato o un dimonstrativo con un nominale modificato dal possessivo è quella di ricorrere a un nominale definito*" (Në shqip, mundësia e vetme që të

[88]Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 32.

përdoret një nyje e pashquar apo një dëftor me një emër të modifikuar nga një pronor, është që emri të jetë i shquar. *përkth.ynë*). [89]

Skema 20.a



Pronorët e vetës së parë e të dytë njëjës në lidhjet me emrat e farefisnisë kanë pozicion prenominal (*im vëlla, yt vëlla*), në këto struktura përjashtojnë E e shquar, dhe pozicionin postnominal, pozicion që e kërkojnë detyrimisht E e shquar: *vëlla-i im* e **vëlla im*, por *im vëlla* dhe **im vëllai; motr-a ime* e **motër ime*, por *ime motër* dhe **ime motra*.
Në rastet kur pronorët e farefisnisë paraprijnë E e pashq. ata përbëjnë kokën e SC sepse gjenerohen në pozicionin e determinantit. *Në këtë rast marrin funksion deiktik.*
Turano e Rrokaj sqarojnë se: *Ci sembra di poter sostenere che i possessivi sono elementi di tipo XP, analizzabili dunque come specificatori della testa N. Tuttavia, va isolato l'uso del possessivo di 1 e 2 persona singolare nei contesti di parentela, contesti in cui il possessivo può comportarsi sia come elemento di tipo XP che come un elemento di tipo X°. Quando si realizza come uno specificatore, il possessivo compare postposto al nominale, poiché si origina nella posizione di specificatore di SN e viene successivamente scavalcato dal nominale che si solleva in Num°. Quando si realizza come testa, il possessivo compare*

[89]Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, f. 81.

preposto alla testa nominale poiché viene generato nella posizione del determinante. In questo caso assume la funzione di deittico".[90]
Ja një shembull i një strukture të tillë.

b.



2.9. Nyja shquese

Nyja shquese (N.shq.) përdoret kur folësi kupton që bashkëbiseduesi është në gjendje të dallojë (shquajë) referentin të cilit i drejtohet SE që përmban nyjen. Shquarja e referentit mund të ndodhë duke përdorur strategji të ndryshme: përmes kthimit në kontekstin *linguistik* (referimi **endoforik,** p.sh. përmes rikthimit të një elementi të përfshirë në diskursin e mëparshëm = **anaforë**), ose përmes kthimit në kontekstin *ekstralinguistik* (referimi **ezoforik**: p.sh. në referimin e krejt "klasës" së referentëve për të cilët flet SE, ose duke përdorur mjete "që bien në sy" (ose "paralinguistikë") si tregimi me një gisht, një lëvizje të trupit, drejtimi i shikimit, apo duke iu referuar "njohjeve të përbashkëta" që i përkasin si folësit ashtu edhe bashkëbiseduesit). P.sh:

- **Referimi endoforik (anaforik):**

(25) *Po shihja një film. Kur filmi mbaroi...*

Referenti i *filmi* është i përfshirë në diskutimin e mëparshëm; do thuhet që *një film* dhe *filmi* janë *bashkëreferentë* përderisa të çojnë tek i njëjti referent: *një film* është paraprijësi anaforik i *filmi.*

[90] Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, f. 86.
"Na duket se mund të mbështesim idenë se përemrat pronorë janë elemente të tipit XP, të analizueshëm pra si specifikues të kokës N. Megjithatë, duhet veçuar përdorimi i pronorit të vetës së parë dhe të dytë njëjës në kontekste farefisnore, ku pronori mund të sillet si element i tipit XP, por edhe si element i tipit X°. Kur realizohet si specifikues, pronori shfaqet pas emrit, pasi origjinohet në pozitën e specifikuesit të SE dhe më pas tejkalohet nga emri që ngrihet në Num°. Kur realizohet si kokë, pronori shfaqet përpara kokës emërore, pasi gjenerohet në pozitën e përcaktorit. Në këtë rast, merr funksionin e deiksit." (përkth. ynë).

- **Referimi ezoforik, që mund të ndodhë sipas tri modaliteteve:**

A. Me SE të dallueshme përmes referimit ndaj dijeve të përbashkëta:

(26) a. *Mbesa është nisur.*
b. *Kanarina iku nga kafazi.*
c. *Mësuesi sot mungon.*

B. Me SE të shquar (individualizuar) përmes një "rënieje në sy" (= me mjete paralinguistike):

(27) a. *Hap derën!*
b. *Ngrije librin nga toka!*

C. Me SE që tregojnë një klasë (në nj. apo sh.):

(28) a. *Ariu i bardhë është specie në zhdukje.*
Arinjtë e bardhë janë specie në zhdukje.
b. *Hekuri oksidohet.*
Metalet përçojnë rrymën elektrike.

Raste të veçanta të tipit të fundit të referimit janë:

1. SE që kanë një "referent të vetëm" *diell, hënë*, etj.:

(29) *Dielli lind në 06.45 minuta.*
Hëna lahet në det.

2.SE që tregojnë "përkatësi të patjetërsueshme ose të tjetërsueshme":

(30) a. *M'u thye dora.*
b. *Kam humbur çelësat.*

Në disa raste të veçanta është e mundur të shmanget Nshq. pavarësisht se SE janë të shquara (pra referentët të jenë të dallueshëm mbi bazën e njërës nga strategjitë e përmendura më lart):

a) me SE të përshtatur kur përbëjnë një listë:

(31) *Shtëpi, oborre dhe rrugë ishin të zbrazura.*
Libra, fletore e lapsa kishin mbuluar dyshemenë.

b) me çifte SE të lidhura nga këndvështrimi semantik: *atë e bir, burrë e grua,* etj. P.sh.:

(32) a. *Burrë e grua punonin që nga mëngjesi deri në darkë.*
b. *Atë e bir dilnin që pa gdhirë.*

Paraqitja në diagramë e nyjave shquese bëhet duke i parë ato si pjesë të sintagmës së determinantit DP (Abney, 1987) ku nyja projektohet në pozicionin kokë. Sqarimet e dhëna në sythin 2.4.2.

2.9.1. Nyja shquese me emrat e përveçëm

Në shqip E e përveçëm përdoren kryesisht të shquar, por mund të përdoren edhe të pashquar. E e përveçëm janë emra të veçantë, të karakterizuar nga fakti që të çojnë te referenti në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërmjet një lloj akti origjinal të emërtimit. Në këtë kuptim E e përveçëm përbëjnë në thelb SE të shquara. Po japim në vijim një skemë të rasteve më të zakonshëm lidhur me E e përveçëm të njerëzve dhe me E e përveçëm të vendeve.

Në përgjithësi vihet re që kur E e përveçëm janë të shoqëruar nga një modifikator postnominal (mbiemër), shquarsia është e detyrueshme: p.sh. *Desantila* dhe *Tirana: Desantila e bukur* dhe jo **Desantilë e bukur* dhe *Tirana e zhurmshme* dhe jo **Tiranë e zhurmshme*. Nëse modifikatori është prenominal atëherë do kishim *e bukura Desantilë, i bukuri/ i lasht-i Berat,* e në këtë rast është modifikatori që ka marrë nyjën shquese *e bukur-a, i lasht-i.* Në rastin e parë nyja shquese trupëzohet me emrin e përveçëm ndërsa mbiemri mbetet i pashquar. Analiza e këtyre sintagmave na çon në një sintagmë emërore që ka në përbërjen e saj një projeksion Fokus. Struktura do të ishte:

Skema 21.



Nyja shquese gjenerohet si morfemë në pozicionin Focus (Foc) brenda sintagmës emërore. Emri mund të lëvizë në pozicionin Foc ku i paravendoset nyjes që i bashkangjitet atij. Ndërsa në rastin e dytë në ndërtimin *i bukuri Berat* ndodh lëvizja e mbiemrit në pozicionin Foc ku është ai që trupëzohet me nyjën shquese[91].

[91] Giusti.G. (1996). *Is there a FocusP and TopicP in the Noun Phrase Structure?*, University of Venice Working Papers in Linguistics 6, f.105-128.

Skema 22.



Edhe me një përemër pronor, një E i përveçëm duhet të jetë i shquar: *Desantila ime, Tirana ime,* ndërsa pa shquarjen do kishim **Desantilë ime dhe *Tiranë ime.*

- **Shquarësia te E e njerëzve**

Shqipja dallohet nga gjuhë të tjera ku E e përveçëm të njerëzve përdoren normalisht pa nyje shquese (m. dhe f.): *ang. Bill, Barbara; fr. Pière, Mariè, it. Giacomo, Paola.*

(33) a. *Mary told me...*
b. *Mariè m'a dit...*
c. *Maria mi ha detto...*
d. *Mari**a** më tha...*

Mbiemrat e njerëzve në përgjithësi janë të shquar: (*Ismail*) *Qemali, (Shejnaze) Juka, (Prenk) Jakova*. Vetëm pak mbiemra shfaqen të pashquar (bëhet fjalë për ato mbiemra që kanë theks fundor): *(Petro) Marko*, (*Ismail*) *Kadare.* Në rastin kur bëhet fjalë për personazhe të shquar bëhet edhe shquarja e tyre: p.sh. *Markoja, Kadareja.*

- **Nyjat dhe E e përveçëm të vendeve**

E e përveçëm të vendeve janë të shoqëruar nga nyja në pjesën më të madhe të rasteve: p.sh. *Franca, Spanja, Amerika, Afrika, Europa, Atlantiku, Paqësori, Korabi, Tomori, Taraboshi, Danubi, Drini, Shkumbini, Ohri, Myzeqeja, Shampanja, Sazani, Korsika* etj. Të gjithë këto SE [N shq.[E]] nëse shoqërohen me emërtimin e tiparit gjeografik, koka e SE nuk janë më ata, por emërtimi gjeografik. Ata bëhen emri që gjenerohet në sintagmën e Njohur[92] ose plotësori i SE dhe në rastin e parë e kanë N.shq, ndërsa në rastin e dytë jo: *liqeni i Ohrit, ishulli i Korsikës, Oqeani Paqësor, lumi Danub, mali Korab, etj.*
Kushtet e përdorimit të nyjes mund të variojnë nëse SE që tregon një rajon apo shtet, është e përfshirë në një SP të paraprirë nga P *në*. Në këto raste nyja nuk përdoret, si në shembujt e mëposhtëm: *në Vlorë, në Greqi, në Brazil,* etj.

[92] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 22.

Duhet kujtuar që edhe në rastet kur E shoqërohet nga një modifikator nyja nuk mund të shmanget: *Shkodra e lashtë, Vjena klasike, Europa plakë*, etj.

2.10. Nyja joshquese

Ndërsa përdorimi i nyjes shquese tregon që bashkëbiseduesi është në gjendje të dallojë referentin të treguar nga SE, përmes përdorimit të nyjes joshquese (N joshq.) *një* (dhe të nyjes veçuese *ca*) folësi fut në diskutim një referent, për të cilin nuk i kërkohet bashkëbiseduesit që të bëjë dallimin nga klasa ku bën pjesë.

Skema 23.



SE e pashquar tregon *një* ose *disa* (në rastin e nyjes veçuese) anëtarë të padalluar nga klasa e referentëve që shenjohet nga SE. P.sh:

(34) *Këto lule t'i la një nxënës*.

Një përdorim të veçantë të nyjes joshquese ka në rastet si:

(35) *Një nxënës i rregullt nuk vjen pa detyra.*

Fjalia (35) i korrespondon fjalisë *Nxënësit e rregullt nuk vijnë pa detyra.*
Në fjali të këtij lloji, interpretimi i SE të pashquar është i ngjashëm me atë të SE të shquar, në të cilën nyja tregon në realitet një "klasë" referentësh. Nga ky përdorim i N. joshq. mund të arrihet në interpretimin se *një nxënës i rregullt* tregon një pjesëtar të paspecifikuar, të pranuar si model përfaqësues, të klasës së *nxënësve të rregullt.*
Këndvështrimi i referimit të nyjes joshquese mund të ndahet në dy lloje: "specifik" dhe "jo specifik"; në të dy rastet bashkëbiseduesit nuk i kërkohet të dallojë referentin për të cilin flet SE me nyje, por në përdorimin "specifik" ka gjithsesi vetëm një referent, që shenjohet veçmas nga folësi e që sqaron përshkrimin e SE, ndërsa në përdorimin "jo specifik" janë disa referentë të pashenjuar veçmas nga folësi që sqarojnë përshkrimin e SE.
Ndryshimi ndërmjet dy llojeve mund të tregohet nëpërmjet disa provave:

a) SE me nyje jo specifike mund të përemërzohet me *të tillë*, ajo me nyje specifike mund të përemërzohet vetëm me format klitike:

(36) a. *Desha të marr një roman shqip, por nuk gjeta* ***të tillë****.*

b. *Desha të marr një roman shqip që kam parë herën e shkuar, por nuk **e** gjeta / *por nuk gjeta të tillë.*

b) Vetëm SE me nyje jo specifike mund të jetë e shoqëruar nga determinanti *çfarëdo:*

(37) a. *Kërkoj një libër çfarëdo*.
b. *Kërkoj një libër çfarëdo *që e kam lënë që vjet këtu*.

Me E mirëfilli të shquar, si E e përveçëm, përdorimi i nyjes së pashquar është i mundur vetëm nëse E e përveçëm, *rikategorizohen* si E jo të përveçëm, kështu që të mund të interpretohet *një E i përveçëm* si një "pjesëtar i klasës së E të shquar". Kjo është e mundur p.sh. kur E i përveçëm modifikohet nga një mbiemër:

(38) a. *Një Arditë kaq të gëzuar nuk e kisha parë ndonjëherë.*
b. *Nuk më kish rënë rasti të shihja një Agim aq punëtor.*

Prania e mbiemrit *të gëzuar* lejon të imagjinohet që ekziston një klasë e përbërë nga disa Ardita (një *e trishtuar*, një *e gëzuar* e kështu me radhë).

2.11. Nyjat *një* e *ca* ose nyjat veçuese

Përdorimi i nyjes *një* është i kufizuar me E të ashtuquajtur *të numërueshëm*, të përdorur në njëjës (*një lule, një student, një çantë, një libër, një bletë, një telefon, një shtet etj.*). Me E e *masës* dhe me E e numërueshëm në shumës përdoret për pashqueshmërinë nyja veçuese *ca* (morfologjikisht identike me sasiorin e pacaktuar): p.sh. *ca qumësht, ca vaj, ca bukë, ca lule, ca studentë, ca gra*, etj.
Nyja veçuese përdoret edhe me E abstraktë, d.m.th. ata që tregojnë një entitet jo të perceptueshëm fizikisht, që si të tillë nuk janë të numërueshëm:

(39) *Duhet një vullnet i madh.*
Nevojitet një përkushtim i pakufi.
Lipset një punë e jashtëzakonshme.

Përdorimi i *një* me E të masës dhe me abstraktët e panumërueshëm interpretohet si një rast rikategorizimi. P.sh. në:

(40) a. *Kemi gjetur një verë shumë të vjetër*.
b. *Shquhet për një inteligjencë të spikatur*.

një verë dhe *një inteligjencë* tregojnë 'një lloj vere' dhe 'një lloj inteligjence', pra një nënbashkësi të një bashkësie të treguar nga E, prandaj është gjithnjë prezent një

modifikator i cili lejon të dallohen nënbashkësitë e bashkësisë të përcaktuar nga *vera* dhe *inteligjenca*.
Ka raste kur në vend të nyjes veçuese (por kuptimi nuk është plotësisht i njëjtë) mund të përdoren sasiorë të pacaktuar, si: *disa, pak*, ose thjesht mund të shmanget nyja (por kjo nuk është gjithmonë e mundur): p.sh. *në shtëpi miqsh, në shtëpi të disa miqve* etj.
Nyja veçuese mund të përfshihet në një SP dhe të paraprihet nga një parafjalë:
për ca libra, me ca qumësht, nga ca pemë, etj.

2.12. Mungesa e nyjes në SE të pashquara

Me E të masës dhe me E të numërueshëm në shumës prezenca e nyjes veçuese alternon me mungesën e saj:

(41) a. Do (*ca*) verë?
b. Kam dalë me (*ca*) shoqe.

SE e pashquara pa nyje përjashtohen nëse gjenden në pozicionin e Subjektit. Të vihet re ndryshimi mes (42a) dhe (42b) ose (42c) që janë jogramatikore pa nyje:

(42) a. Jam marrë me punë.
b.*Punë më kanë penguar / Ca punë më kanë penguar.
c.*Më kanë penguar punë. / Më kanë penguar ca punë.

Në fjalitë pavetore është e mundur të përdoret SE pa nyje në pozicionin e Subjektit postverbal:

(43) a. Nuk ka më kafe. / A ka kafe?
b. U shpërndanë libra për të gjithë.
c. Dëgjohen zëra gjithë ditën.

SE të pashquara, pa nyje, mund të gjenden në pozicionin e Subjektit edhe me folje pavetore, dhe në pozicione parafoljore, nëse formojnë një konstituent shoqëruar nga disa tipa modifikatorësh si në:

(44) a. S'ka nxënës të këtij lloji.
b. Nuk duhen drejtuar pyetje që nuk janë ndërtuar saktë.

Veç kësaj, siç u pa edhe për SE të shquara, nyja mund të mungojë kur disa SE bashkërenditen në një varg: si në rastin e (31) që po e risjellim për lehtësi në (45):

(45) *Shtëpi, oborre dhe rrugë ishin të zbrazura.*
Libra, fletore e lapsa kishin mbuluar dyshemenë.

2.13. Sintagma emërore pa nyja

Ka edhe raste të tjerë të veçantë, përveç rasteve që u panë në paragrafët e mësipërm, në të cilët disa SE shfaqen pa nyje. Bëhet fjalë për raste të ndryshëm nga ato që u panë deri këtu. Në veçanti nyja mungon:

- me një SE të përdorur si titull ose thirror: p.sh:

(shq)	Profesor!	E dashur vajzë!
(fr.)	Professeur!	Chere fille!
(it)	Professore!	Cara ragazza!

në rastin e *E dashur vajzë* për shqipen kemi të bëjmë me një rast të fokusimit të Mb. Në pozicion të fokusuar, mbiemri e privon E nga nyja e tij shquese. Në thelb, sipas Turano e Rrokaj, nëse fokusohet, mbiemri, thith elementin e shquarsisë: "*L'operazione della focalizzazione può anteporre l'aggettivo al nominale. In posizione focalizzata, l'aggettivo priva il nominale del suo articolo determinato. In sostanza, se focalizzato, l'aggettivo assorbe il tratto della definitezza*."[93]. Në rastin e cituar Mb nuk i paravendoset nyjes shquese meqenëse E nuk përdoret i shquar. Për këtë arsye kemi *e dashur vajzë* dhe jo *e dashura vajzë*. Po paraqesim diagramet për të dy rastet:

Skema 24. a.



[93]Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Shezai Rrokaj, Albatros, Tiranë, f. 62.
"Procesi i fokusimit mund ta sjellë mbiemrin përpara emrit. Kur ndodhet në pozicion të fokusuar, mbiemri i heq emrit nyjën e caktuar. Në thelb, në këtë rast mbiemri merr mbi vete funksionin e përcaktueshmërisë." (përkth.ynë)

Skema 24.b.



- me një SE në funksion të gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror, të ndajshtimit ose të përcaktorit kallëzuesor. Në të dy rastet SE nuk kanë funksion referencial, por tregojnë karakteristika që i drejtohen referentit me të cilin kanë lidhje (në këtë kuptim kanë të njëjtin funksion që do kishte një mbiemër):

(46) a. Vera është mësuese.
b. Vera, mësuese e letërsisë…
c. E kanë emëruar mësuese.

Diagrama për njërin nga shembujt do të ishte:

Skema 25.

a.



Në (46.b) ndajshtimi i veçuar *mësuese e letërsisë* sillet si shtesë në SE meqenëse ai zgjeron informaconin për E kokë.

- në eksklamacione: p.sh. *Gol! Ndihmë! Zjarr!*
- kur SE gjendet brenda një SP paraqitja është: SP = [P [SE[D Ø E]]] ose

Skema 26.



A. *për* +SE: *(flas) për sport, (luaj) për fitore, (i pazoti) për punë, (i etur) për para, (marr) për ndihmë, (veproj) për interes, (përplas) për mur, etj.*
B. *me* + SE (tregon mënyrë dhe i përgjigjet në përgjithësi një ndajfoljeje): *me dije = diturisht, me aftësi = aftësisht, me trimëri = trimërisht, me qetësi = qetësisht, me maturi = maturisht,* etj.
C. *në* + SE (tregues të një vendi): *në rrugë, në shkollë, në kinema, në stadium, në mal*, *në shkollë, në shtëpi, në shtrat, në teatër, në tren, në poltron*, *në kishë, në punë,* etj.

D. Në shprehje frazeologjike e në veçanti në bashkime me folje. P.sh.: kam *dijeni, mbaj qetësi, kall frikë, jap kënaqësi, bëj dritë, vë zjarr, mbaj shënim, fitoj kohë, ndërroj jetë, ndryshoj program,* etj.

2.14. Shmangia e realizimit fonetik të E kokë në SE dhe përdorimi përemëror i determinantëve dhe pronorëve

Kur SE është e privuar nga realizimi fonetik i E që përbën kokën e saj, determinantët marrin statusin e **përemrave**. Domethënia e përemrit atribut për determinantët në këto raste është e ndryshme, në pjesën më të madhe të rasteve nga ajo që lidhet me kategorinë e *përemrave vetorë*. Në fakt, përemrat vetorë qëndrojnë në vend të një sintagme të plotë (SE ose SP), siç tregon fakti që nuk mund të modifikohen p.sh. nga një plotës që normalisht modifikon një E:
(47) *Vajza bjonde ishte më e shkathëta mes gjithë grupit*.
Që kemi të bëjmë me një sintagmë emërore këtë na e vërtetojnë dy nga kriteret e përcaktimit të sintagmave: 1. kriteri i ndërkalljes dhe 2. kriteri i proformës ose përemërzimit:
(48) 1a. **Vajza ishte më e shkathëta mes gjithë grupit bjonde*.
1b. **Vajza ishte bjonde më e shkathëta e gjithë grupit*.
2c. *Ajo ishte më e shkathëta mes gjithë grupit*.

Shembujt tregojnë se *vajza bionde* është një sintagmë, SE[[D–a] [E vajzë] [Plot. bjonde]], në të cilën nyja shquese është determinant.

Skema 27.



Po nëse *ajo* duhet të zëvendësojë krejt sintagmën *vajza bjonde* cila është arsyeja që në shqip mund të ketë ndërtime të tilla si:

(49) *Ajo biondja ishte më e shkathëta e grupit. DËFTOR*

ku *ajo* ka zëvendësuar vetëm E kokë e jo gjithë sintagmën?

Lind nevoja për të saktësuar faktin që *ajo* nuk është kokë e një sintagme, për arsyen e thjeshtë se përemrat nuk përbëjnë koka sintagmash, pra nuk ka sintagma përemërore, e megjithatë, sërish me provën e ndërkalljes vërejmë se dy komponentët e kësaj strukture janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin (50.a) dhe se sërish kemi realizimin e kriterit të proformës (50.b):

(50) a. **Ajo ishte më e shkathëta mes gjithë grupit bjondja*.

b. *Ajo ishte më e shkathëta mes gjithë grupit*.

Në këto raste do themi se përemri zëvendëson E kokë, ndërsa determinanti bëhet ai vetë koka e SE [D-a, Plot. bionde] siç tregon fjalia:

(51) *Bjondja ishte më e shkathëta e grupit*.

Për këtë na shërbejnë shembujt në italisht e frëngjisht ku determinanti *la* është kokë e SE *la bionda* dhe *la blonde*:

(52). a. *La ragazza bionda era la più vivace del gruppo*.

La fille blonde était la plus adroite du groupe

b. **Lei bionda era la più vivace del gruppo*.

**Elle blonde était la plus adroite du groupe*

c. *La bionda era la più vivace del gruppo*.

La blonde était la plus adroite du groupe

Skema 28.



Pra përemrat vetorë qëndrojnë në vend të një sintagme të plotë dhe ata nuk mund të modifikohen nga një plotës që normalisht modifikon një E.
Në përgjithësi, kur E kokë i një SE nuk realizohet fonetikisht, determinantët mund të shoqërohen nga modifikatorë që i referohen E të shmangur.
Le të vërejmë (51):

Bjondja ishte më e shkathëta mes gjithë grupit.

Diagrama e sintagmës me kokë determinantin është:

Skema 29.



Fakti që nyja në shqip është postpozitive bën që ajo të thithet nga plotësi, njëlloj siç ndodhte me mbiemrat e fokusuar.
Që determinantët mund të shoqërohen nga modifikatorë që i referohen E të shmangur kur E kokë i një SE shmanget, e vërtetojnë edhe shembujt që vijojnë:

(53) a. *Në rafte kishte shumë libra artistikë e pak **libra** me figura*.
b. *Në rafte kishte shumë libra artistikë e pak me figura*
c. *Kostumi yt me vija është më i bukur se **kostumi** im me lule*.
d. *Kostumi yt me vija është më i bukur se im**i** me lule*.

Skema 30.

(53.c)[94]



[94] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 32.
"*Pronorët gjenerohen në specifikuesin e emrit. Kur pronori ndodhet pas emrit, koka E e emrit lëviz në pozicionin C për të marrë atje caktuesinë, duke lënë një gj(urmë) në pozicionin ku ka qenë. Nga kjo lëvizje vjen rendi emër i shquar-pronor*".

Në rastin e (53.d) pronori *im* është pajisur me determinantin (nyje shquese të E *kostum-i*), e SE. Këtë e mbështesin edhe Turano e Rrokaj kur thonw se: *"Quando si realizza come uno specificatore, il possessivo compare postposto al nominale poiché si origina nella posizione di specificatore di NP e viene successivamente scavalcato dal nominale che si solleva in Num°. Quando si realizza come testa, il possessivo compare preposto alla testa nominale poiché viene generato nella posizione del determinante. In questo caso il possessivo assume la funzione di deittico.*"[95]
Ndërsa mund të krahasohet me një përemër vetor përdorimi i një dëftori në raste si ky që vjen pas:

(54) *Klitemnestra e vret Agamemnonin, kur* ***ky*** *(Agamemnoni) kthehet në pallat*.
Në këto raste, dëftori sillet si një përemër vetor (të kihet parasysh që në (54) dëftori mund të zëvendësohet nga *ai,* dhe qëndron në vend të krejt SE, siç tregon fakti që mund
të modifikohet nga një plotës:

(55) *Klitemnestra e vret Agamemnonin kur* ***ky i lumtur për fitoren*** *(Agamemnoni i lumtur për fitoren) kthehet në pallat.*

Në përgjithësi përdorimi i determinantëve si përemra, prek vetëm mungesën e realizimit fonetik të E kokë. Natyra e vërtetë sintaksore e këtyre elementeve nuk është gjithnjë e njëjta, por sipas rasteve ka struktura sintaksore të nënvendosura:

(a) Koka nominale është e parealizuar fonetikisht, por struktura mbetet SE = [D E ...], në të cilën E është Ø, d.m.th. prezent vetëm si kategori, por pa përmbajtje fonetike. Në këtë rast mund të flitet për përemër në kuptimin që ka një **elipsë** të emrit;

(b) Determinanti bëhet ai vetë koka e SE (SE = [D ...]), dhe atëherë termi "përemër" përdoret në kuptimin e mirëfilltë, si 'zëvendësues i kokës nominale fonetikisht të parealizuar'.

Përemri dëftor ka strukturën (a) kur përdoret si formë supletive e nyjes si në (56.a), kurse rasti (b) paraqitet në (56.b):

(56) a. Vera më kalo fletoren. Atë (fletoren) aty.
b. Vera më kalo fletoren. Ø Të verdhën.
a.SE = [D *atë* E Ø] b.SE = [D –*n* E Ø Plot. e verdhë]

[95] Turano, G & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, në *Çështje të gjuhës shqipe*, Shezai Rrokaj, Albatros, Tiranë, f. 86.
"Kur përemri pronor funksionon si specifikues, ai qëndron pas emrit, pasi gjenerohet në pozicionin e specifikuesit të Sintagmës Emërore (SN) dhe më pas tejkalohet nga emri që ngrihet në Num°. Ndërsa kur shfaqet si kokë, përemri pronor qëndron përpara kokës emërore, pasi gjenerohet në pozicionin e determinantit. Në këtë rast ai merr funksionin e një elementi deiktik." (*përkth.ynë*).

Edhe nyja joshquese *një* në përdorimin e saj përemëror, në struktura si e mëposhtmja në të cilën emri është shmangur, është përemërzuar me klitikun *e*:

(57) Të pëlqejnë pikturat në vaj? Dje *e* kam parë *një të bukur*.
SE = [D *një* E Ø Plot *të bukur*]

atë dhe *një* ruajnë vlerën e tyre të determinantëve, ndërsa ndodh elipsa e E kokë, në vend të së cilës qëndron një kategori boshe e përmbajtjes leksikore.

Duhet thënë që nëse dëftori ose nyja joshquese ndiqen nga një përemër me kuptim detyrimisht anaforik si *tjetër,* përdoren format *atë* dhe *një* dhe vijon plotësori *tjetër* me vlerë të dëftorit,

(58) a. Preferon *atë tjetrin*?
b. Ma jepni *një tjetër*?

që mund të paraqitet me strukturat që pasojnë:

SE = [D *atë/ një* E Ø Plot *tjetër*]

Të njëjtën strukturë me elipsë të E kanë edhe rastet e mëposhtëm, në të cilët E i parealizuar fonetikisht mund të riintegrohet:

(59) a. Ky trofe është për konkursin e poezisë, ndërsa *ai* (trofe) është për esenë më të mirë.
b. Kisha pyetur shumë nxënës, por vetëm *pak* (nxënës) u përgjigjën saktë.
c. Kisha porositur shumë libra, por vetëm *dy* (libra) më erdhën.

Struktura (b) mund të rindërtohet në rastet kur determinanti ka në përdorimin e tij përemëror një formë të ndryshme nga ajo që ka në prezencë të E kokë: të shihen p.sh. sasiorët (vetëm me përdorim përemëror) *askush, dikush, sekush, ndokush,* që janë të papërshtashëm me prezencën e E kokë, mundësisht ngaqë zënë pozicionin e sintagmës.
Të shihet si shembull fraza që vjen më poshtë, e krahasuar në veçanti me (58.b):

(60) Kisha pyetur shumë nxënës, por vetëm *dikush* (*nxënës) u përgjigj.

Pavarësisht strukturës së këtyre sintagmave, ruajmë sërish termin e përgjithshëm *përemër* për të treguar që këto elemente përdoren në mungesë të E të cilit i referohen.

2.15. Nyjat në përdorimin e tyre përemëror

2.15.1. Përdorimi përemëror i nyjes shquese

Nyja shquese mund të përdoret si një përemër në rastet kur E i shmangur është i modifikuar nga një mbiemër;

(61) a. Nga këto pëlhurat, më pëlqen *e kuqj**a***.
b. Nga dy vogëlushet, më çapkëne është *e vogl**a***.

Prania e nyjes shquese është gjithnjë në përputhje me shmangien e E kokë të një SE në rastin kur Nyja është e ndjekur nga modifikatorë përemërorë:

(62) a. Nga gjithë punimet, më pëlqen i *im**i***.
b. Thua që libri yt është më i bukur, por *i saj**i*** është më i shituri.

ndërsa nëse E modifikohet nga një SP ose nga një fjali përcaktore, nyja nuk mund të përdoret:

(63) a. Nga këto pëlhurat më pëlqen *prej mëndafshi.
b. Nga gjithë punimet më pëlqen * që kam bërë unë.

Frazat (58a) dhe (58b) bëhen gramatikore nëse në vend të E përdoret dëftori *ai-ajo, ky-kjo:*

(64) a. Nga këto pëlhurat më pëlqen *kjo* prej mëndafshi.
b. Nga gjithë punimet më pëlqen *ai* që kam bërë unë.

Dëftori mund të përdoret në vend të E edhe me mbiemër:

(65) Nga këto pëlhurat më pëlqen *kjo e kuqja*.

2.15.2. A kanë nyjet joshquese përdorim përemëror?

Ndryshe nga nyja shquese, nyja joshquese mund të përdoret pa kufizime edhe në mungesë të realizimit fonetik të E.

(66) Këtu paska akullore! Më bëni *një të madhe*?
SE = [D një E Ø Plot. *të madhe*]

Skema 31.



Por edhe:

(67) Më bëni *një*?

Skema 32.



Edhe veçuesi *ca* mund të përdoret në SE ku nuk realizohet koka E së cilës i referohet:
(68) Paskan çelur margaritat! Dua të mbledh *ca*.

Skema 33.



Në këto raste mund të përdoren edhe sasiorë që përdoren në prani ose jo të realizimit fonetik të E kokë si *pak, ndonjë,* etj.
Edhe kur modifikatori përbëhet nga një mbiemër, përdoret veçuesi:

(69) Dua të mbledh ca të freskëta.
Skema 34.



Duhet pasur parasysh që E kokë mund të riintegrohen në sintagmat me determinant nyje joshquese meqenëse pozicioni i gjenerimit të tyre është gjithmonë ekzistues:

(70) a. Këtu paska akullore! Më bëni *një akullore të madhe*.

Skema 35.



b. Paskan çelur margaritat! Dua të mbledh *ca margarita të freskëta*.

Skema 36.



Si përfundim vërehet që diagrama e SE me determinant nyjen joshquese qoftë kur E kokë është realizuar fonetikisht, ashtu edhe kur nuk realizohet fonetikisht, paraqitet njëlloj. Kjo bën që të arrijmë në përfundimin që në shqip nyjat joshquese nuk paraqiten si proforma, prandaj nuk mund të flasim për një përdorim përemëror të tyre.

2.16. Dëftorët në përdorimin e tyre përemëror

Dëftorët shfaqen detyrimisht para kokës nominale të SE dhe përshtaten në gjini, numër e rasë me E determinant të të cilit janë: ky *djalë, kjo vajzë, këta djem, këto vajza, këtij djali, këtyre vajzave,* por **djalë ky, *vajzë kjo, *djem këta, *vajza këto*. Dëftorët *ky - kjo dhe ai - ajo* mund të kenë dy funksione të ndryshme:
sillen si proSE (zëvëndësues të SE) dhe janë bashkëreferues me SE që ndodhen në ligjërimin e mëparshëm dhe që përbëjnë paraprijësit. Në këtë rast mund të flitet për referim anaforik[96]:

(71) a. *Takova Almën, por **ajo** nuk dinte të më tregonte gjë për ngjarjen*.
b. *Ia kish thënë Mirës, por **kjo** nuk ia kish vënë veshin*.
c. *Takoi kushëririn. **Ai** i regoi që do të mblidheshin të gjithë të shtunën*.
d. *Pyeta për pikturën. **Kjo** kushtonte 500 euro.*

Kur sillen si proSE dëftorët humbasin tiparet e tyre deiktike.
Paraprijësi i një dëftori mund të jetë edhe një frazë si:

(72) a. Tirana është e bukur, kjo nuk mund të mohohet.
b. Luajtëm rëndë, këtë nuk do na e tolerojnë.

[96] Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, *Çështje të gjuhës shqipe*, Shezai Rrokaj, Albatros, Tiranë, f. 67.
"*L'anaforicità è creata dal contesto precedente. (...) In questo contesto si indebolisce la deissi a favore dell'anaforicità*".

2) përdoren si përemra në kuptimin që ndodh elipsa e E kokë, si në shembujt që vijnë më poshtë:

(73) *Ndër të gjitha (pikturat) më pëlqen kjo /kjo me bojëra vaji / kjo e ekspozuara këtu përballë/ kjo që sapo bleu shoqja jote.*

Në rastet e (73) dëftori ruan tiparet deiktike, ndërsa E i elipsuar mund të riintegrohet në SE:

(74) *Ndër gjitha më pëlqen kjo piktura / kjo piktura me bojëra vaji / kjo piktura e ekspozuar këtu përballë/ kjo piktura që sapo bleu shoqja jote.*

Në ndërtimet e tipit *kjo piktura* E kokë merr dy caktuesorë gjë që nuk duhet të jetë e pranueshme pasi tashmë e dimë se E merr një caktuesor. Mos duhet të flasim për mbingopje, gjë të cilën sintaksa nuk e pranon?
Duhet pasur parasysh se përderisa flasim për ndërtime anaforike, dëftori dhe nyja shquese nuk konkurrojnë për të njëjtin vend. Nyja shquese është determinanti që zë pozicionin C të caktuesisë, pozicion në të cilin lëviz E për të marrë caktuesinë, ndërsa dëftori përbën pozicionin e së njohurës. Kjo mbështetet edhe nga Turano e Rrokaj, të cilët kur analizojnë ndërtime të tilla, vërejnë se: (...) *il dimonstrativo è una testa e pertanto il suo movimento interessa una posizione testa. Escludiamo, tuttavia, che si tratti della testa D perchè le strutture in esame contengono un nominale definito, ovvero accompagnato dall'articolo definito enclitico il quale realizza proprio la testa D. In questa posizione si solleva anche il nominale per incorporare appunto l'articolo. Pertanto, in questo tipo di nominalizzazione la posizione testa D è già riempita dal nominale definito. Di conseguenza, il dimonstrativo deve occupare una posizione differente*.", "*A proposito del sintagma nominale in albanese*"[97] Kështu mund të shpjegohet edhe arsyeja e gramatikalizmit të SE me strukturë SE = [Njoh. Dëftor [D N.shq. EØ, Arg. Pronor]]. (*ky imi*).

[97] Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese, *Çështje të gjuhës shqipe*, Rrokaj, Sh. Albatros, Tiranë, f. 74.
"Dëftori është një kokë dhe, si e tillë, lëvizja e saj bëhet në një pozicion koke. Megjithatë, përjashtohet mundësia që të bëhet fjalë për kokën D, sepse strukturat në shqyrtim përmbajnë një emër të shquar, i shoqëruar pra nga nyja e caktuar enklitike, e cila realizohet pikërisht në kokën D. Në këtë pozicion ngrihet edhe emri për të inkorporuar nyjen. Për pasojë, në këtë tip nominalizimi pozita e kokës D është tashmë e zënë nga emri i shquar. Rrjedhimisht, dëftori duhet të zërë një pozitë tjetër." *(përkth.ynë).*

2.17. Sasiorët në përdorimin e tyre përemëror

Disa sasiorë mund të përdoren vetëm në prani të E (përdorimi *mbiemëror*), të tjerë vetëm në mungesë të realizimit fonetik të E (përdorimi *përemëror)*, të tjerë akoma kanë një përdorim si mbiemëror ashtu edhe përemëror.
Sasiorët mund të përdoren ndonjëherë në vend të krejt SE, si përemra vetorë, por në këtë rast ka një interpretim të veçantë, meqenëse referenti i SE kuptohet përgjithësisht si njeri, qenie e gjallë (nj. e sh.)

(75) a. Nuk erdhi *askush.*
b. I kam përshëndetur *të gjithë.*

përballë:

(76) a. Nuk erdhi *asnjeri nga të ftuarit.*
b. I kam përshëndetur *të gjithë të ftuarit.*

-Janë vetëm me përdorim mbiemror *çdo*, *njëfarë: çdo fëmijë, njëfarë emri, çdo shqetësim, njëfarë dyshimi,* etj.
-Janë me përdorim vetëm përemror *kush, ndokush, askush, kushdo, sekush, askush, gjithkush, njeri*, të tjerët kanë të dy përdorimet:

(77) Më kërkoi kush?
Nuk erdhi askush.
Këtë e di kushdo.

Për përmrin *kush* Mita analizon se: "*është një sintagmë emërore e zhveshur dhe sintagmat emërore të zhveshura detyrimisht duhet të qëndrojnë brenda sintagmës foljore, sepse duhet të jenë të trupëzuara me foljen. Edhe në frëngjisht:*

Il a été tué un homme (është vrarë një burrë)
**Il a été tué 'l'homme (është vrarë burri)*

fjalia që ka një subjekt pasfoljor të pashquar është formuar mirë, ndërsa fjalia që ka një subjekt pasfoljor të shquar është jogramatikore." [98]
Po i njëjti studiues kur flet për përemrin njeri në rastet e zëvendësimit me ndokush thotë:
është një ndryshore që kërkon lejues të tij mohimin: Nuk të ve re njeri.
pjesëzat pyetëse ose intonacionin: A erdhi njeri? Erdhi njeri?
dhe lidhëzat kushtore: Po erdhi njeri, prite.
Është kjo arsyeja që ky përemër përdoret kryesisht në fjali mohore pyetëse si dhe në fjali të varura kushtore." [99]
Disa sasiorë (*disa, ndonjë, asnjë,* etj. dhe numërorët) kanë një aftësi të veçantë: kur janë përemra dhe gjenden në një SE të pashquar, pjesa që shmanget, mund të jetë një element veçues, por kjo vërehet nga konteksti linguistik:

[98] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 44.
[99] Po aty, f. 44.

(78) Do të marr *ndonjë / dy / ca* (nga këto mollët).
Njoh *ca/ disa* (nga studentët e gjuhës).
Morëm *disa / tre / të tjerë* (nga botimet e fundit)

Nëse SE që përmban sasiorin, gjendet brenda një SP, nuk mund të shmanget realizimi fonetik i E kokë

(79) Është grindur me disa djem.
*Është grindur *me disa.*

Me sasiorin *të gjithë* elementi i shmangur është një SE, dhe jo një sintagmë veçuese

(80) a. Do t'i marr *të gjithë* (librat).
b. *Do t'i marr t*ë gjithë* (nga librat.)

2.18. Pronorët në përdorimin e tyre përemëror

Në përdorimin e tyre përemëror (në mungesë të realizimit fonetik të E kokë), pronorët janë gjithnjë të shoqëruar nga nyja shquese:

(81) a. Plaga ime është më e rëndë sesa e jotja
c. Meqë ra fjala për baballarët, dje njoha të sajin.
d. Prindërit tuaj nuk i lajmëruan. Tanët sigurisht që i lajmëruan të parët.

Edhe në frëngjisht e italisht ndodh i njëjti shoqërim:

(82) a. Libri yt është interesant. Imi**,** jo!
b. Ton livre est interessant, le mien non.
c. Il tuo libro è interessante. Il mio, no.

por në shqip mund të shoqërohen edhe nga determinantë të tjerë;

(83) a. Plaga ime është më e rëndë sesa ajo e jotja.
b. Libri yt është interesant. Ai imi, jo!
c. Meqë ra fjala për baballarët, dje njoha atë të sajin.
d. Prindërit tuaj nuk i lajmëruan. Ata tanët sigurisht që i lajmëruan të parët.

Ndërsa në gjuhët e tjera që përmendëm, pronorët shoqërohen me nyjat shquese, por nuk mund të shoqërohen nga determinantë të tjerë. Kështu:

(84) a. Libri yt është interesant. Ai imi, jo!
b. Ton livre est interessant. *Ce le mien non!
c. Il tuo libro è interessante. *Quel il mio no!

Nëse pronori paraprihet nga një sasior (përfshi nyjen joshquese), mund të përdoret edhe forma përemërore e nyjes dhe e sasiorit e ndjekur nga një SP veçuese që përmban pronorin, i cili sërish shoqërohet nga nyja shquese:

(85) a. Alma ka mjaft lapsa, kështu që do më japë ndonjë nga të sajët.
b. U tregova prindërve, prandaj jam e bindur që do vijë dikush nga të mitë.

2.19. Vështrim sintaksor i SE

2.19.1. Emra argumentues dhe emra joargumentues

Struktura e brendshme e SE është e ngjashme në disa aspekte me strukturën e frazës së thjeshtë, dhe E kokë luan në SE të njëjtin rol që luan folja në frazë.
Mita thotë se në një fjali si *kritika e tij ndaj Luanit*... roli i përemrit *e tij* është i njëjtë me rolin e sintagmës emërore *Agimi* në fjalinë *Agimi kritikoi Luanin*. Atëherë përemri *e tij* zë pozicionin e specifikuesit në SEPT. Pra, përkufizimi më i përshtatshëm për Subjektin do të ishte: *Subjekti është ai element që zë pozicionin e specifikuesit të SEPT ose të SE*. SpecSEPT dhe SpecSE janë dy pozicione që kanë të njëjtën natyrë, d.m.th.. janë pozicione specifikuesi (pra pozicione që nuk përsëriten) me të cilin "nisin" SE dhe SEPT. Pra, nuk është pa kuptim të flasësh për subjekt si në fjali ashtu edhe në SE

Skema 37.



Por ky lloj diagrami, me Subjektin e sintagmës emërore në Determinant në SE, na hap një problem teknik: subjekti zë pozicionin e nyjës shquese për të cilën më parë kemi thënë se zë pozicionin Deteminant në SE. Dy elemente nuk mund të rrinë në të njëjtin vend. Për të zgjidhur këtë problem i referohemi Sintagmës së caktuesorit (SC) koka e së cilës do të ishte caktuesori dhe argumenti do të ishte SE.

Skema 38.



Ashtu si folja është një kokë që përzgjedh argumentet e saj p.sh. Subjekt dhe KD (këto të përbërë nga SE), ose tipe të tjerë plotësish bërthamash (të përbërë p.sh. nga SP)), edhe E, nëse posedojnë disa karakteristika, mund të analizohen si koka që seleksionojnë një numër të caktuar argumentesh.[101] Emrat e këtij tipi quhen **argumentues** sipas Graffit i cili thotë se: "*Në përgjithësi, emrat që nga pikëpamja e tipareve kontekstuale janë joargumentues, janë ata që në bazë të tipareve të brendshme përcaktohen konkretë, kurse ata argumentues kanë tiparin e brendshëm të abstraktëve. Përveç kësaj, emrat e kësaj klase, nëse përdoren me një vlerë konkrete, bëhen joargumentues*" [102].

Përveç kësaj, ashtu si në fjali mund të gjejmë plotës ekstranuklearë (të përbërë nga SP, SNd), këta mund të shfaqen edhe në SE.

SE që tregojnë një strukturë funksionale të ngjashme me atë të fjalisë janë në përgjithësi ato koka, E i të cilave derivon nga një folje (ose e lidhur semantikisht me të): p.sh. *dëshirë (*e lidhur me *dëshiroj), refuzim (refuzoj), nisje (nisem), arritje (arrij), largim (largoj), përshkrim (përshkruaj), përgjigje (përgjigjem),* etj. Le të shohim fjalitë e mëposhtme:

(86) a. Edlira refuzoi ofertën
b. Refuzimi i ofertës nga Edlira

(87) a. Zëdhënësi përshkroi situatën
b. Përshkrimi i situatës nga zëdhënësi.

(88) a. Beni largoi librin menjëherë.
b. Largimi menjëhershëm i librit nga Beni…

(84) a. Drita u nis për pushime.
b. Nisja e Dritës për pushime.

[100] Mita, J. (2005). Mbi konceptin e Subjektit, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 30.
[101] Graffi, G. (2003). *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, f. 72,
"*Me disa ndryshime, (...) edhe emrat, ashtu si foljet shfaqin valenca; kjo gjë nuk është e çuditshme, sepse shumë emra e kanë prejardhjen nga foljet*."
[102] Graffi, G. (2003). *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, f. 74.

(89) a.Të rinjtë janë përfshirë fuqimisht në këtë organizatë, për shkak të objektivave të saj.
b. Përfshirja e fuqishme e të rinjve në këtë organizatë, për shkak të objektivave të saj.

Në këto shembuj dallojmë këto përkime funksionale: në (86) mes SE *Edlira*, Subj.i *refuzoi,* dhe SP *nga Edlira*, që ka të njëjtin rol në SE që ka si kokë E *refuzimi*. SE *ofertën* dhe *i ofertës* janë respektivisht K.D. të F *refuzoi* dhe të SE me kokë *refuzimi.* Emërtimin dhe analizën lidhur me sintagmën *i ofertës* do e mbështesim në qëndrimin e Mitës i cili e quan sintagma e së njohurës (SNjoh). Në analizën e tij ai vëren që: "*Një rast pak i ndërlikuar për shqipen janë sintagmat emërore që kanë brenda një emër në gjinore (libri i studentit /refuzimi i ofertës (sh.ynë)), sepse do të kishim një SE e cila do të zbërthehej në E+SE, gjë që nuk shkon me teorinë e sintagmave, sepse koka e një sintagme nuk mund të ketë si argument një sintagmë që është e njëjtë me sintagmën maksimale që formon ajo kokë (...) Një problem tjetër që lind këtu është se SE i studentit (ose i ofertës sh.ynë) meqë ka dy nyja (që të dyja të ndryshueshme), duhet të ketë dy pozicione specifikuesi. Kjo gjë përsëri nuk shkon me teorinë e sintagmave ku siç thamë, pozicioni i specifikuesit (determinantit. sh.ynë) është i vetëm dhe i papërsëritshëm.*
Për këto lloje sintagmash emërore, do të shikojmë prejardhjen e nyjes së përparme të gjinores. Duke pasur parasysh se kjo "nyjë e përparme" është përftuar nga përsëritja mekanike e nyjës së prapme të E paraprijës (Demiraj, 258) dhe nyja e prapme e emrit paraprijës në zanafillë, ka qenë një dëftor anaforik fonetikisht i reduktuar, me kuptim leksikor shumë të zbehur dhe si rrjedhim, edhe me një përdorim sintaksorisht të kushtëzuar (Demiraj, 297), nyja e përparme e gjinores duhet të zërë pozicionin E Njohura (meqë një dëftor anaforik është gjithnjë gjëja e njohur) dhe emri në gjinore është një SNjoh (sintagma e njohura)."[103]
Në (87) funksioni i Subjektit i kryer nga *zëdhënësi* në (a) kryhet në SE e (b) nga SP *nga zëdhënësi*, ndërsa funksioni i K.D. në (a) kryhet nga SE *situatën*, ndërsa në (b) nga SNjoh *i situatës*.
I njëjti realizim i Subj. kryhet nga *Beni* dhe *nga Beni* në (88.a) dhe (88.b), ku SE *librin*, kryen funksionin e K.D. si në Fj ashtu edhe në SE; SNd *menjëherë*, modifikator i F, i korrespondon SMb *i menjëhershëm*, modifikator i E, me të njëjtin funksion të elementit ekstranuklear tregues të "kohës".
Në (89), funksioni i Subj. që në (a)kryhet nga SA *Drita*, në (b) kryhet nga SNjoh *e Dritës.* Po te (89) SP *për pushime* është një argument si i F *u nis* ashtu edhe E *nisja*, argument që tregon "vendin".
Në (89) ka simetri perfekte ndërmjet komplementëve të F *janë përfshirë* dhe të E *përfshirja*; *në organizatë* është një argument i përbërë nga një SP; Nd *fuqimisht* dhe Mb *i*

[103] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 21.

fuqishëm kanë të njëjtin funksion të atributit në Fj (a) dhe në SE e (b); njëlloj *për shkak të objektivave të saj* është një komplement ekstranuklear rrethanor që tregon "shkakun".

Ka një ndryshim të rëndësishëm mes fjalisë (Fj) dhe SE për sa i takon shprehjes së argumenteve. Në Fj këta nuk mund të shmangen, pasi shkaktojnë jogramatikalitetin e vetë Fj. P.sh. të gjitha Fj kanë një Subj. (i shprehur me një SE, ose një përemër, ose që nxirret nga fleksioni verbal), ashtu si janë ***detyrueshmërisht të pranishëm*** argumentet e tjerë (KD., KZh., etj, shih. p.sh. jogramatikalitetin e **Zëdhënësi përshkroi* ose **Vera dha* me shmangien e argumenteve). Ndërsa në SE shprehja e argumenteve është gjithnjë ***e mundshme***: p.sh. *nisja u la për nesër, refuzimi ishte i patakt, përgjigja vonoi shumë,* etj.
Jo të gjithë E kanë një strukturë argumentuese në kuptim të ngushtë: E që shënojnë sende dhe që nuk lidhen me koka verbale, nuk zgjedhin argumente të tipave që sapo pamë. P.sh. *gur, shtëpi, dyqan, arë,* etj. Edhe pse emërtojnë referentë "konkretë" dhe jo "ngjarje" nuk janë të përputhshëm me argumente si Subj., K.D., etj.
E megjithatë edhe ato mund të modifikohen nga SNjoh, SMb ose SP: *libri i Verës*, *gur i rëndë, shtëpi pushimi, dyqan në qendër, arë e mbjellur,* etj. që vendosin me E kokë marrëdhënie të veçanta, specifike, të deduktueshme nga semantika e E kokë dhe modifikatorët e tij e, më në përgjithësi, nga konteksti gjuhësor dhe jashtëgjuhësor. P.sh. te *dyqan në qendër* është semantika e P *në* që tregon se mes *dyqan* dhe *qendër* ka një lidhje të veçantë që mund të përcaktohet "vendi". Në raste të tjera lidhja mes kokës dhe modifikatorit varet nga ndërveprimi i semantikës së elementeve leksikorë të pranishëm dhe nga konteksti jashtëgjuhësor: lidhjet e këtij tipi mund të emërtohen gati-argumentale. Për shembull relacioni mes *shtëpi* dhe *pushimi* mund të perifrazohet *shtëpi për të bërë pushime*; nëse në vend të *shtëpi* të ishte si E kokë p.sh. *shesh*, SE *shesh pushimi* do të perifrazohej si *hapësirë ndërmjet shkallëve të një ndërtese ku mund të pushohet*. Në *libri i Verës*, relacioni mes *i Verës* dhe *libri*, i shprehur sintaksorisht nga SNjoh, mund të jetë i tipave të ndryshëm, sipas kontekstit jashtëgjuhësor: Vera mund të jetë pronarja ose autorja e librit, ose mund të jetë edhe një lidhje më e largët në kuptimin që mund të bëhet fjalë për librin që Vera na ka dhuruar, ose thjesht na ka folur për të në ndonjë rrethanë.

2.19.2. Subjekti dhe kundrina e drejtë (KD) e SE

Ndryshe nga Fj(alia), në të cilën Kryefjala dhe Kundrinori i Drejtë (leksikorë) shprehen nëpërmjet SE, Subjekti (Subj.) dhe Kundrinori Drejtë (K.D.) i SE shprehen ndryshe:
a) me një SNjoh [*i/e/të/së* SE] (*qarkullimi i makinave, ardhja e fëmijëve*, *pranimi i ftesës,* etj.);
b) me një pronor (*nisja e tij, përshkrimi i saj, përshëndetja e tyre,* etj);
c)me një klasë të veçantë mbiemrash (të quajtur *argumentues*) (vetëm me funksion të Subjektit: *vendimi qeveritar, pushtimi turk, vullneti popullor, qëndrim ligjor.*etj)

E me stukturë argumentuese mund të klasifikohen në grupe që paraqesin veti sintaksore të ndryshme:

1) E që i korrespondojnë folje (F) jokalimtare, si: *fjetja, dremitja, dalja, qarkullim, dyshim, qëndrim, ecja, buzëqeshje, rënie, pendim*, *vrapim*, etj.

Me këto E Subjekti shprehet nga një SNjoh [*i/e/të/së* SN], ose nga një pronor, ose një mbiemër argumentues: *fjetja e Mirës/ fjetja e saj, qëndrimi i nxënësve, buzëqeshja e nënës/ buzëqeshja e saj/ buzëqeshje amënore,* etj.

2) E që përshkruajnë gjendje apo veprime psikike me dy argumente (Subjekt dhe K.D.) si: *dëshirë, dashuri, frikë, neps, mall*, etj. Këto E kur shoqërohen nga një SNjoh mund të interpretohen sipas kontekstit edhe si Subj. edhe si KD. *dashuria e vajzës* mund të interpretohet edhe si Subj. (*Dashuria e vajzës ishte e madhe*) edhe si KD. (*Dashuria e vajzës (për vajzën) ia kishte zbukuruar ditët*).

Nëse këto E janë të shoqëruar nga një SP [*për* Përemër vetor], mund të interpretohen si K.D.: psh: *kujtimi për ju*.

Si Subj. paraqiten këto E edhe kur shoqërohen nga një pronor *dashuria e vajzës/ e saj, malli im,* ndërsa interpretohen KD kur E shoqërohet përveçse me pronor edhe me një SP: *dashuria e vajzës për librat, malli im për motrën.*etj.

3) E me strukturë semantike që kanë vetëm një interpretim kundrinor (objektiv). Këtu përfshihen E si: *marrja, qepja, kapja, shkarkimi* në SE si: *marrja e letrës, qepja e fustanit, kapja e armikut, shkarkimi i drejtuesit* SNjoh të të cilave nëse kthehen në struktura frazale do kishin interpretim "pësor" pavarësisht se shfaqen në rolin e Subj: *armiku u kap, letra u mor, fustani u qep, drejtuesi u shkarkua.* dhe vepruesi do të shprehej me SP [*nga* SE]: *marrja e letrës nga Beni, qepja e fustanit nga mamaja, kapja e armikut nga ushtarët, shkarkimi i drejtuesit nga ministri,* etj.

4) Klasa e fundit përfshin E si p.sh. *përshkrim, interpretim, blerje, lexim* etj, argumentet e të cilëve i korespondojnë në strukturën semantike roleve të VEPRUESIT dhe të OBJEKTIT. Këta E mund të përdoren qoftë si "veprues", qoftë si "pësorë". Si E veprues, SNjoh mund të ketë qoftë interpretim kryefjalor, ashtu edhe kundrinor (*përshkrimi i librit (Përshkrimi i librit të ndihmon të njohësh mirë karakterin e këtij personazhi; Përshkrimi i librit u bë nga vetë autori), thirrja e nxënësve*, por *leximi i poetes* vs *leximi i poezisë*). Por ndryshe nga E veprues, kur shprehet vetëm pronori, mund të kemi gjithnjë interpretim të dyfishtë *përshkrimi i tij, leximi i saj (tij))*.

Kjo shpjegohet duke supozuar që kur pronori interpretohet si Subjekt, E është përdorur si veprues, ndërsa kur interpretohet si K.D, E është pësues. Në rastet kur E është pësues mund të shprehet edhe vepruesi me SP [*nga* SE]: *leximi i saj (poezisë) nga poetja.*

2.20.1. MODIFIKATORËT E EMRIT: SINTAGMA MBIEMËRORE

Në këtë paragraf dhe në paragrafët e mëtejshëm do të flitet për një tjetër tip modifkatori të E, atë që përfaqësohet nga SMb, koka e të cilit është e formuar nga mbiemra (=Mb) të ashtuquajtur **cilësorë**[104], pasi shprehin cilësi të E që modifikojnë. Pjesa më e madhe e Mb (me përjashtim të Mb marrëdhëniorë) kanë ndaj E funksionin e **komplementëve** kur flitet për modifikatorë jo argumentues. Studiuesi Xhafer Beqiraj (2016) i njeh mbiemrit funksionin atributiv meqenëse vetë ekzistenca e mbiemrit lidhet me këtë funksion që në zanafillë e për ta mbështetur këtë autori sjell shembuj nga tekstet e vjetra të shqipes ku përdoret mbiemri duke e krahasuar më pas edhe me përdorime të mbiemrit në gjuhë të ndryshme nga ku rezulton se funksioni i tij është ai i atributit të cilin studiuesi e quan një universale. Më pas Beqiraj sqaron se kategoritë gramatikore të mbiemrit nuk janë të mëvetësishme me përjashtim të shkallës, gjë që do të thotë se këto kategori, përveç shkallës, janë të painterpretueshme e duke u lidhur me emrin në SE, Mb u cakton vlera pozitive tipareve të tij, domethënë përshtat gjininë, numrin dhe rasën me emrin.[105]

Pozicioni më i zakonshëm i Mb ndaj E kokë është ai *pasemëror,* që për këtë arsye mbahet si pozicioni kryesor nga pikëpamja sintaksore. Mb (edhe pse jo të gjithë, siç do shihet më poshtë) mund të gjenden edhe para E: p.sh. *një mik i këndshëm / një i këndshëm mik.*

Në këto raste për shqipen flitet për fokusimin e Mb. Edhe në artikullin e studiuesve Turano e rrokaj gjejmë një arsyetim të tillë: *"In posizione prenominale, l'aggettivo viene sempre pronunciato con una intonazione marcata, indicativa del fatto che l'aggettivo contiene specificazini di focus. Per questa ragione assumeremo che l'aggettivo occupa la posizione di specificatore di una proiezione FocusP".*[106]

Pozicioni paraemëror (prenominal) përjashtohet kur Mb është i shoqëruar vetë nga një modifikator, p.sh. një Nd ose një SP. P.sh.: *një i bukur libër, por një libër vërtet i bukur,* dhe jo * *një me të vërtetë i bukur libër, një i këndshëm djalë,* por *një djalë i këndshëm për të gjithë,* e jo * *një i këndshëm për të gjithë djalë.*

Kur gjendet në pozicion postnominal Mb paraprihet nga, dëftorët dhe sasiorët: p.sh. *këta/ miqtë e paharruar, disa / pak miq të paharruar* / *të gjithë miqve të paharruar*.

---

[104] "*Mbiemrat cilësorë emërtojnë veti a cilësi që rroken drejtpërsëdrejti me shqisa, ose që janë vetëm të mendueshme, të përfytyrueshme si ngjyrë (...), shtrirje hapësinore, madhësi, formë (...), shije (...), veti fizike e gjendje shpirtërore (...), ose cilësi të karakterit e cilësi mendore...*".ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, f. 155.

[105] Beqiraj, Xh. (2016). *Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, Mirgreealb, Tiranë, f. 227-235.

[106] Turano, G. & Rrokaj, Sh. (2007). A proposito del sintagma nominale in albanese*, Çështje të gjuhës shqipe*, Rrokaj, Sh. Albatros, Tiranë, f. 65. "Në pozicion paraemëror, mbiemri shqiptohet gjithnjë me një intonacion të theksuar, gjë që tregon se ai përmban specifikime të fokusit. Për këtë arsye, pranojmë se mbiemri zë pozitën e specifikatorit të një projeksioni FocusP." *(përkth.ynë)*

Për sa u takon pronorëve, rendi relativ është i lirë: *miqtë e tu të paharruar, të paharruarit miqtë e tu.* Edhe me numërorët e mirëfilltë rendi është i lirë: *dy të paharruarit miq / të paharruarit, dy miqtë e tu…* (por *dy miqtë e paharruar* e jo * *të paharruar dy miq).*

2.20.1.1. Përshtatja e mbiemrit

Mb përshtaten në gjini e numër (edhe rasë nëse flasim pr Mb të nyjshëm) me E kokë të SE në të cilën ndodhen: *djalë lozonjar / vajzë lozonjare, djalin lozonjar / djemtë lozonjarë, djalë i shkathët / djalit të shkathët,* etj.
Një Mb mund t'i referohet edhe dy E të bashkërenditur.
Në rastet kur Mb është në pozicion postnominal dhe E e bashkërenditur kanë numër e gjini të ndryshme, Mb do të ketë numrin dhe gjininë (edhe rasën për Mb e nyjshëm) e E më afër tij pasi i përket SE me kokë E pranë tij. psh:

(90) *Nalt e pritte buzqeshun plaka e dritores, veshë* ***me brandavekë e bohçe të bardhë*** *përpara.*

SE [E brandavekë] e SE [E bohçe SMb [Mb të bardhë]]

Në rastet kur E e bashkërenditur përputhen në numër e gjini me njëri-tjetrin, referimi i Mb mund të jetë ambig.p.sh: *bimë dhe lule të freskëta*. Mbiemri mund të interpretohet si referent ose i të dy E, ose i E më të afërt.
Në këto raste janë njohjet kontekstuale që zhveshin nga ambiguiteti interpretimin dhe shënojnë në sekuencën lineare njërën apo tjetrën strukturë që natyrisht përftohet sipas interpretimit. Këto struktura të ndryshme sintaksore shoqërohen nga një distribucion i ndryshëm i pauzave:

SE [[E bimë e E lule] SMb [Mb të freskta]]
SE [SE [E bimë] e SE [E lule SMb [Mb të freskëta]] .

Në pozicionin pronominal Mb nuk mund të modifikojë E të bashkërenditur përveçse në rastin kur E janë në shumës dhe kanë të njëjtën gjini: **i spikaturi karakter e tipar*, **të spikaturat karaktere dhe tipar*, por *të spikaturat karaktere e tipare*. ose *të freskëtat bimë e lule, të ëmblat kujtime e çaste* etj. Në këtë rast nuk mund të flasim për referim ambig pasi Mb i fokusuar ka thithur caktuesinë e të dy E e në këtë mënyrë ai u referohet të dyve: [të spikaturat [karaktere e tipare]], [të freskëtat [lule e bimë]], [të ëmblat [kujtime e çaste]].

2.20.1.2. Pozicioni i mbiemrit dhe interpretimi semantik

Topika e Mb në shqipen paraqet veçanti sepse siç u tha më lart Mb mund të gjendet si në pozicion *prenominal* ashtu edhe në pozicion *postnominal.* Në gjuhën shqipe pozicioni më i shpeshtë i Mb është ai postnominal[107].
Pozicioneve të ndryshme në raport me E u përgjigjen interpretime të ndryshme të Mb. Mb postnominalë kanë aftësinë të kufizojnë bashkësinë e referentëve të shënuar nga E dhe, kur gjehen në SE të shquara, të kontribuojnë në individualizimin e referentit për të cilin flet SE: për këtë arsye mund të emërtohen **restriktivë[108] /kufizues** ose ose edhe **referencialë** por kanë edhe një funksion **përshkrues /deskriptiv[109]** P.sh.

(91) a. Punoj me fëmijët.
b. Punoj me fëmijët parashkollorë.

(92) a. Mora një libër / Mora librin.
b. Mora një libër të ri. / Mora librin e ri.

SE e shquar *fëmijët* i (91.a) interpretohet si "klasa" ose bashkësia e referentëve të cilëve u vihet emri *fëmijë*: shtesa e mbiemrit *parashkollorë* e ngushton klasën në një nënklasë (ose nënbashkësi), ajo për të cilën përdoret si emërtim sintagma *fëmijët parashkollorë*; në (92.a) *libër/librin* tregojnë një "pjesëtar" të klasës së shënuar nga termi *libër*: me nyjen shquese nënkuptohet që edhe dëgjuesi është në gjendje të shquajë atë *libër* të veçantë; shtimi i Mb *të/i ri* përcakton nënklasën e librave (ajo e shenjuar nga shprehja *libra të rinj*), pjesëtar i së cilës është *libri* në fjalë: në brendësi të kësaj nënbashkësie dëgjuesi do të dallojë, nëse SE është e shquar, se për cilin *libër* bëhet fjalë.
I njëjti fenomen i individualizimit të referentit mund të vërehet në italisht dhe frëngjisht:

(93) a. Bëra punë të mrekullueshme!
b. Ho fatto un lavoro magnifico! / un magnifico lavoro
c. J'ai fait un travail magnifique! / un magnifique travail[110]

Në të kundërt Mb prenominalë nuk kanë funksion ngushtues e as referencial (individualizimi i referentit të SE ndodh gjithsesi) ata përfshijnë gjykime të vlerave të folësit për determinantët referentë (për këtë arsye këto mbiemra mund të quhen edhe **konotativë /me ngjyrime**).

[107] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa),* Tiranë, f. 103
[108] nga latinishtja *restrĭctus* – pjesore e së shkuarës e *restrĭngere* që formohet nga *re-* që nënkupton *lëvizje pas* dhe *strĭngere* që do të thotë *shtrëngoj*. Fjalori interaktiv Garzanti
[109] nga latinishtja e vonë *descriptīvu* që do të thotë *përshkrues*. Fjalori interaktiv Garzanti
[110] Në frëngjisht e italisht zakonisht Mb kanë rend të lirë në SE.

(94) a. I largëti kujtim i rinisë ...
b. E freskëta erë…

Disa Mb përdoren gati vetëm në pozicion postnominal, meqenëse kuptimi i tyre e bën të vështirë një interpretim konotativ: të shihen p.sh. Mb që tregojnë formë (*katrore, i rrumbullakët*, etj.) ose ngjyrë (por për këta të fundit pranohet të paktën në nivel stilistik të lartë, edhe pozicioni prenominal kur tregohet një cilësi karakterizuese: *e bardha borë, e zeza natë*, etj), Mb e kombësisë ose të përkatësisë në përgjithësi (shtetas *shqiptar /italian / francez / europian, qytetar durrësak/ shkodran/ parizien, banor verior*, etj.)
Një Mb me vlerë shtuese gjendet pas E edhe kur ai vetë është i modifikuar, por në këtë rast veçohet gjatë shqiptimit (me vlerë parentetike[111]):

(95) a. Nxënësit, *thellësisht të prekur,* nuk ia hiqnin sytë mësuesit.
b. Lulja, *vërtet e bukur,* sikur i jepte jetë dhomës.

Nga cilësia e të qenit vlerësues dhe jo restriktiv, Mb prenominalë mund të modifikojnë edhe E të përveçëm, që emërtojnë referentë si të thuash "unikë", nga të cilët nuk mund të shkëputësh nënbashkësi: *e vogla Anilë, e ëmbla Driolë, i ndrojturi Laert*[112], etj
Pozicioni pre-ose postnominal, mund të ketë efekte edhe në domethënien e brendshme të disa Mb, që ruajnë kuptimin e tyre të mirëfilltë kur gjenden në pozicionin që e quajtëm kryesor, pra pas E, ndërsa marrin një kuptim tjetër në pozicion prenominal në gjuhë si frëngjishtja e italishtja, por jo gjithnjë në shqipen[113]. Le të shohim çiftet e mëposhtme të fjalive:

(96) a. la femme pauvre / la donna povera (një grua e varfër materialisht)
la pauvre femme / la povera donna (një grua e mjerë),
gruaja e varfër / e varfra grua

b. le grand homme / il grande uomo (njeri i ditur, intelektual)
l'homme grand / l'uomo grande (burrë i madh nga trupi)
i madhi burrë / burri i madh

Ekziston edhe një lloj klase e Mb që karakterizohet nga fakti që ka gjithnjë vetëm funksion referencial-restriktiv, pavarësisht nga pozicioni ndaj E. Bëhet fjalë për Mb të veçantë si Mb kohorë të cilët mund të quhen **deiktikë** si: *i djeshëm, e nesërme, e shkuar, i ardhshëm, i kaluar,* etj. dhe për një grup Mb që mund të emërtohen **anaforikë** pasi për interpretimin e

[111] që vjen nga greqishtja *parénthesis* që do të thotë *ndërvendosje,* derivat i *parentithénai- me futë*, Fjalori interaktiv Garzanti
[112] Këto mbiemra kanë të inkorporuar nyjen shquese.
[113] Në rastet kur SE nuk ka determinant nyjen shquese ky pohim nuk qëndron. Krah *e varfra grua* vs **e varfër grua*, dhe *i madhi burrë* vs **i madh burrë*

tyre i duhet referuar kontekstit linguistik (paraprijës apo edhe pas tyre): *ndjekës, pasues, pasardhës, i ndryshëm, i ngjashëm*, *i njëjtë,* etj.
Interpretimi i këtyre Mb mund të bëhet edhe duke iu referuar kontekstit ekstralinguistik. P.sh. në:
(97) Krijoni një portret të ngjashëm (me këtë që po shohim tani).
ose në:
(98) Më duhet material i njëjtë për numrin e ardhshëm të revistës. (në krahasim me atë që sapo botuam).

2.20.1.3. Mbiemrat marrëdhëniorë

Përveç Mb me funksion atributiv (cilësues) që u përshkruan më lart, ekzistojnë edhe Mb që kryejnë funksionin e *plotësit* të emrit. Quhen Mb **marrëdhëniorë (të relacionit**) pasi nuk tregojnë një "cilësi" të E që modifikojnë, por vendosin me E një raport të veçantë. Ata e japin tiparin e sendit, emrin e të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërtimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim a me një numër.[114] Mb e këtij grupi të cilët *për një pjesë të mirë të kuptimit të tyre janë sinonimikë me rasat e zhdrejta të emrave, që përbëjnë temën fjalëformuese të tyre..."* [115], nga pikëpamja morfologjike janë Mb kryesisht të prejardhur dhe gjenden vetëm në pozicion *postnominal.* Ata mund të kenë me E dy lloj marrëdhëniesh:
(a) Mb mund të kryejnë brenda SN funksionin e Subjektit, dhe emërtohen atëherë **argumente** të SE). P.sh:

(99) vendimi qeveritar (=vendimi i qeverisë) / pushtimet barbare (= pushtimet e barbarëve) / qarkullimi automobilistik (= qarkullimi i automjeteve)

Një Mb nuk mund të ketë funksionin e K.D.
Në një sintagmë si *pushtimi anglez,* Mb *anglez* mund të tregojë vetëm Subj. dhe jo K.D., ndryshe nga *pushtimi i anglezëve,* në të cilin SNjoh *i anglezëve*, mund të ketë interpretimin si Subj. por edhe si K.D. Pamundësia e Mb që të shprehë K.D. sqaron jogramatikalitetin e shembujve si **kthimi familjar* etj. *kthimi* është E i lidhur me F joveprore, pra karakterizohet nga fakti që Subj. i tij gjendet në pozicionin strukturor të K.D., ndërsa është gramatikor ndërtimi *kthimi i familjes* me SNjoh.
(b) ndërmjet Mb dhe E kokë mund të ketë një relacion semantik specifik të lidhur me domethënien e Mb dhe të E, dhe me kontekstin në të cilin është përdorur SE, marrëdhënie të tilla, si: *marrëdhënie lëndore, d.m.th. të përcaktojë sendin e dhënë për nga lënda prej së cilës përbëhet, (...) marrëdhënie përkatësore, dmth ta përcaktojë sendin e dhënë për nga*

[114] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f. 156.
[115] Po aty. f. 156.

përkatësia e tij (në kuptimin më të gjerë të fjalës), nëse i përket një sendi, një vete apo një koncepti abstrakt (...). Por ai mund të shprehë edhe marrëdhënien e sendit të dhënë me një veprim (...), me një çast kohor (...), me një pikë hapësinore (...) dhe me një numër... [116] p.sh: *shfaqje teatrale/ shfaqje muzikore,* etj. Edhe në këto raste ka shpesh një harmoni, përkim mes Mb dhe SP, p.sh: *shfaqje me muzikë* etj.
Të vihet re që Mb marrëdhëniorë nuk mund të gjenden në pozicion predikativ, prej ku buron jogramatikaliteti i shembujve si: * **Shfaqja ishte teatrale, *Shfaqja ishte muzikore* kundrejt *Shfaqja ishte e bukur.*

2.20.1.4. Parataksa (bashkërenditja) dhe hipotaksa (nënrenditja) e mbiemrave (Mb)

Kur dy ose më shumë Mb postnominalë bashkërenditen (numri i Mb të bashkërenditur teorikisht është i pafundëm), mund të shfaqen dy mundësi interpretimesh, te lidhura me strukturat sintaksore të bashkërenditjes;
a) Mb e bashkërenditur i referohen referentit, ose bashkësisë së referentëve të shquar nga E kokë. P.sh: në *djalë i zgjuar dhe i pashëm, shfaqje e bukur dhe bashkëkohore, fëmijë të zhurmshëm e të pabindur,* ose *libër interesant dhe edukues*, etj, *djali* është edhe *i zgjuar* edhe *i pashëm*, *shfaqja* është edhe *e bukur* edhe *bashkëkohore*, *fëmijët* janë edhe *të zhurmshëm* edhe *të pabindur*, *libri* është edhe *interesant* edhe *edukues,* etj. Në këto SE bashkërenditja i përket dy Mb (ose më mirë të thuhet dy SMb, koka të të cilave janë dy Mb), dhe mund të vlerësohet kështu:

SE [E djalë] SMb [SMb [Mb i zgjuar] dhe SMb [Mb i pashëm]].
SE [E shfaqje] SMb [SMb [Mb e bukur] dhe SMb [Mb bashkëkohore]]
SE [E fëmijë] SMb [SMb [Mb të zhurmshëm] dhe SMb [Mb të pabindur]]
SE [E libër] SMb [SMb [Mb interesant] dhe SMb [Mb edukues]]

Nga kjo strukturë, nëse mbiemrat janë antonime, pra kanë kuptime të kundërta ose të papërputhshëm, bashkërendimi jep mundësi për sintagma jogramatikale, p.sh: **djalë i zgjuar dhe budalla, *libër interesant dhe i mërzitshëm.* Por nëse E është në shumës rezultati i bashkërenditjes së antonimeve jo domosdoshmërisht është jogramatikal, meqenëse në këto raste mund të arrihet një tjetër interpretim, i lidhur me strukturën e përshkruar në (b);
(b) Në rastet si *djem të zgjuar e budallenj, shfaqje të bukura e të shëmtuara*, *fëmijë të zhurmshëm e qetë, libra interesantë e të mërzitshëm,* çdo Mb mund t'i referohet bashkësive të ndryshme respektivisht të *djem, shfaqje*, *fëmijë*, dhe *libra*. Në këto raste, bashkërenditja nuk u takon dy Mb, por dy SE, në të dytën e të cilave është shmangur realizimi fonetik i E kokë:

[116] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f.156.

SE [SE [E djem] SMb [Mb të zgjuar]] dhe SE [E Ø] SMb [Mb budallenj]].
SE [SE [E shfaqje] SMb [Mb të bukura]] dhe SE [E Ø] SMb [Mb të shëmtuara]].
SE [SE [E fëmijë] SMb [Mb të zhurmshëm]] dhe SE [E Ø] SMb [Mb të qetë]].
SE [SE [E libra] SMb [Mb interesantë]] dhe SE [E Ø] SMb [Mb të mërzitshëm]].

Në pozicion prenominal në përgjithësi gjenden maksimumi dy Mb të bashkërenditur (rrallë edhe më tepër): p.sh: *e egra dhe e pamëshirshmja jetë, i gjeri dhe i thelli debat, i dashuri dhe i largëti atdhe, i egri dhe i hidhuri realitet*. Ndryshe nga rasti i Mb postnominalë, kur bashkërenditen më shumë Mb, në shumës, prenominalët e bashkërenditur i referohen një bashkësie të vetme referentësh (ajo e përcaktuar nga E) dhe struktura e vetme që pranohet është ajo me dy SMb të bashkërenditura: kështu nuk mund të kemi sintagma të tipit **të zgjuar e budallenj djem* me kuptimin *djem të zgjuar* dhe *djem budallenj* pra me bashkërenditjen e dy SE dhe shmangien e realizimit fonetik të E kokë të SE së parë të bashkërenditur.
Në pozicion postnominal mund të gjenden edhe Mb të nënrenditur p.sh: *vepër artistike e vjetër, makina fshirëse franceze shumë të fuqishme*. Në këto raste çdo Mb i shtuar në të djathtë ka vlerë ngushtuese mbi gjithë pjesën tjetër të SE (duke filluar që nga E) që gjendet në të majtë të saj: d.m.th.. *fshirëse* ngushton bashkësinë e *makina*, *franceze* ngushton bashkësinë e *makina fshirëse* e kështu me radhë.

2.20.2. MODIFIKATORËT E EMRIT: SINTAGMA PARAFJALORE

Emrat, ashtu si foljet, mund të modifikohen nga SP të tipave të ndryshëm, që funksionojnë si plotës të kokës emërore. Le të shihen shembujt që vijojnë:
(100) *dashuria për librat, dëshira për fitore, vendimi për nisjen, refuzimi për bashkëpunim, arritja në Durrës, shtëpia në mal, rruga për në pyll, biseda për fëmijët, pica me proshutë, piktura me bojëra vaji, peshkimi me rrjetë, peshkimi me grep*.
Siç u pa, edhe E mund të përzgjedhin një Subj. ose/dhe një K.D., por ndryshe nga Fj, Subj. dhe K.D. e E shprehen nga SNjoh ose SP, dhe jo siç ndodh në Fj:
ndërtimi i urës nga vullnetarët, që i korrespondon *vullnetarët kanë ndërtuar urën,* ose *kapja për dore*, që i korrespondon (*dikush) kap dorën*.
Përveç shprehjes së ndryshme të Subj. dhe K.D., SP plotës të E i korrespondojnë në përgjithësi komplementëve që modifikojnë F. Ato nga këndvështrimi i marrëdhënieve[117] funksionale mund të tregojnë:
vend: [*nga* SE], [*te/k* SE], [*në* SE], [*për* SE], [*mbi* SE], [*nëpër* SE], [*prej* SE].

[117] Këto marrëdhënie janë listuar nga ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia),* Tiranë, f. 388-396.

kthimi nga sholla, takimi te dera, vajtja në fshat, nisja për shkollë, shtrirja për tokë, fluturimi mbi qytet, ecja nëpër pyll, ikja prej qytetit.

shkak: [*nga* SE], [*nën* SE], [*prej* SE]

shkrirja nga nxehtësia, tërheqja nën trysninë e pushtetit, frika prej errësirës.

mjet: [*pa* SE], [me SE],

shëtitja pa Entelën, lexim pa syze, lajmërimi me zjarre, lajmërimi me telefon, etj.

shoqërizim: [*me* SE]

fasule me mish, Beni me Mirën, etj.

lëndë: [*me* SE], [*prej* SE]

urë me dru, shkallë prej druri, syze prej ari, statuja prej balte, etj.

tipar, cilësi: [*me* SE], [*pa* SE], [*prej* SE]

pyje me pisha, fushë më lule, natë pa hënë, qiell pa yje, pamje prej kapadaiu, etj.

qëllim: [*për* SE]

lëvizja për shkollën, lëvizja për shkrimin e shqipes, etj.

përmbajtje: [*për* SE], [*mbi* SE]

studim për jetën e kafshëve, studim mbi pjellorinë e tokës, etj.

kufizim: [*për* SE]

shquarje për inteligjencë, etj.

sasi: [*prej* SE]

flotë prej 30 anijesh, etj.

E e lidhur semantikisht me F përzgjedhin në përgjithësi të njëjtët tip elementesh të seleksionuar nga F prej të cilave rrjedhin. P.sh:

(101) a. *Fëmijët grinden për lojrat – grindja e fëmijëve për lojërat.*
SE [E fëmijët] SF [F grinden SP[për SE[E lojrat]]]
SE [E grindja SNjoh. [Njoh.e fëmijëve] SP[për SE[E lojërat]]]

ku F *grinden* zgjedh për Subj. SE *fëmijët*, ndërsa E *grindja*, koka e SE, ka për Subj. SNjoh *e fëmijëve*, dhe shkaku paraqitet në të dy rastet si në Fj, ashtu edhe në SE me SP *për lojrat*.

b. E kanë dëbuar nga puna. - dëbimi nga puna
c. Është ndarë nga miqtë. - ndarja nga miqtë
d. Janë fshehur nën shtrat nga frika. – fshehja nën shtrat nga frika

Përveç këtyre SP, modifikatorë si të F edhe të E, ekzistojnë dy tipa të veçantë SP të selektuara tipikisht nga E, dhe që nuk gjenden si plotës të F. Bëhet fjalë:

1) për SP [*për* SE], me vlerë të përgjithshme të "qëllimit" ose të "destinacionit", si në:
(102) *furçë për dhëmbë, bojë për mure*, *biçikletë për gara, veshje për fëmijë, etj.*

Kjo lloj SP gjendet vetëm kur SE brenda SP është pa nyje e në përgjithësi nuk të drejton në një referent të qartë. Këto ndërtime janë të barasvlershme me SP.[118] :
(103) furçë dhëmbësh, bojë muresh, biçikletë garash, veshje fëmijësh,

Relacioni mes E kokë dhe SP ndonjëherë është i shenjuar jo nga parafjala që prin SP, por nga ndërveprimi mes kuptimit së E kokë të SE, kuptimit të E brenda SP (p.sh: nëse është *dru* ose të ngjashme, SP do të tregojë lëndën, nëse E tregon një hapësirë gjeografike ose objekt, si *qyteti, shtëpi*, etj, SP do të tregojë një relacion vendor, e kështu me radhë).

2.20.2.1. Rendi i sintagmës parafjalore (SP) në SE

Në një SE mund të gjenden disa SP, sipas tipit të E kokë. P.sh: *marrëveshja me ndërmarrjen për eksportin, nisja për Berat me nxënësit, etj.*
Në disa raste pozicioni reciprok i SP mund të ndryshojë:

(104) diskutimi me nxënësit për letërsinë / diskutimi për letërsinë me nxënësit;
udhëtimi me avion për Bruksel / udhëtimi për Bruksel me avion;
lajmi për kthimin nga Amerika / lajmi nga Amerika për kthimin;
urdhri për tërheqjen nga vija e frontit / urdhri nga vija e frontit për tërheqjen,

por në raste të tjera rendi i SP është i pandryshueshëm:

(105) bastet për garat me kuaj, fustani prej mëndafshi për Elsën

në krahasim me:

(106) *bastet me kuaj për garat, *fustani për Elsën prej mëndafshi

Zakonisht rendi i SP në SE varet nga lloji i marrëdhënieve që vendosen mes E kokë dhe plotësit parafjalor. Qëndrojnë pranë E disa nga SP që janë modifikatorë "tipikë" të E, në veçanti SP me funksion të Subj.:*thirrja nga nxënësit, kapja nga autoritetet,*
SP e tjerë modifikatorë të E janë më pak të lidhur me E kokë. Lidhja më pak e ngushtë e këtyre SP me E kokë shpjegon jogramatikalitetin e shembujve të (106), ku ky lloj komplementësh / plotësish paraprin SP e lidhura më shumë me E.
Nëse një E modifikohet nga dy SP që kanë të njëjtin tip të relacionit me kokën, janë të mundur të dy rendet:

(107) udhëtimi nga Tirana (për) në Vlorë / udhëtimi (për) në Vlorë nga Tirana
frika prej heshtjes në errësirë / frika në errësirë prej heshtjes

[118] Më lart kemi sqaruar se ndërtimet E + E në rrjedhore janë SE = [E + SP], dhe E në rrjedhore është SP [P Ø]

2.20.2.2. Rendi reciprok i SMb dhe SP

SMb dhe SP mund të gjenden kryesisht në pozicione postnominale (në marrëdhënie të nënrenditur me njëra-tjetrën), si modifikatorë të një elementi nominal. P.sh: *shtëpia e verdhë me kopsht, piktura e re në ekspozitë, lulja e sapoçelur në vazo, zogjtë e sapoardhur në fole, etj.*
Për sa i takon rendit reciprok të SMb dhe SP, Mb pararijnë normalisht SP meqenëse siç e kemi sqaruar më lart Mb *pëlqehet* me emrin pranë tij.

(108) *fjala e ëmbël për të vëllanë, lutja e pashpresë për falje, shikimi i pandarë nga rruga, çaj jeshil për dobësim*
Por:
(109) **fjala për të vëllanë e ëmbël, * lutja për falje e pashpresë, *shikimi nga rruga i pandarë, *çaj për dobësim jeshil*

Ka raste kur SP dhe SMb mund të shkëmbejnë vendet (E kokë të SE dhe SE brenda SP janë të pashquar dhe janë të të njëjtit numër dhe gjini), por në këtë rast nuk kemi të njëjtën strukturë të SE, pasi Mb nuk është më modifikator i E kokë të SE, por Modifikator i E kokë të SE të përfshirë në SP:

(110) *dëshirë të shfrenuar për aventurë / dëshirë për aventurë të shfrenuar*
ndjenjë të pastër për miqësi /ndjenjë për miqësi të pastër

2.20.3. MODIFIKATORË TË EMRIT: FJALITË

E mund të modifikohen edhe nga fjali. Graffi vlerëson se: *"Veçoritë e valencës nuk janë tipike vetëm për foljet, por edhe për një klasë emrash, të ashtuquajturit emra argumentues. Është pra, e arsyeshme të pritet që fjalitë e varura mund të jenë argument jo vetëm i foljeve, por edhe i emrave argumentues. Fjalitë e shënuara me të pjerrët në shembujt (64) ilustrojnë raste tipike të plotësorëve emërorë, domethënë të fjalive që janë argument i emrit (përkatësisht fakt, ide, urdhër) që përbën kokën e sintagmës emërore (SE):*

(64) a. Fakti që ushtarët janë sjellë kështu nuk çuditi askënd.
b. Ideja që ushtarët mund të silleshin kështu nuk i kishte vajtur në mendje askujt
c. Urdhri që ushtarët të silleshin kështu nuk ishte dhënë nga askush.
Fakt, ide urdhër, etj janë emra argumentues si nisje, ndërtim, përshkrim, dhe të tjerë të ngjashëm; ndryshimi në krahasim me këta të fundit qëndron kryesisht në faktin që

argumenti i tyre ka formën e një fjalie... "[119] Fjali të tilla nuk kanë të bëjnë me çfarëdo emri. Ky lloj modifikimi gjendet kryesisht me E argumentues.
Mitaj argumenton që "*në periudhën:*

Ata shfaqën mendimin se djali mund të shërohej.

fjalia e varur se djali mund të shërohej është argument i emrit mendim. Fjali të tilla nuk kanë të bëjnë me çfarëdo emri, por vetëm me një grup të kufizuar semantik emrash abstraktë. (Gramatika II: 527). Pra ashtu si fjalitë kryefjalore dhe kundrinore që zgjidhen nga folje të caktuara, ashtu edhe këto lloj fjalish zgjidhen nga emra të caktuar. përderisa ato afrohen me fjalitë kundrinore dhe kryefjalore që ftillojnë folje të grupeve semantike të caktuara (Gramatika II: 531), nuk janë fjali të varura përcaktore ftilluese (Gramatika II: 530), por ***fjali argumente të emrave****. Fjalitë përcaktore ftilluese, në të vërtetë largohen mjaft nga fjalitë përcaktore të mirëfillta. Ato vetëm në dukje ngjajnë si përcaktore, por në strukturën e tyre sipërfaqësore nuk mungon asnjë sintagmë emërore (siç ndodh në fjalitë përcaktore), që do të ishte e pranishme në strukturën e thellë. "*[120] Pra për E prejfoljorë lloji i fjalisë së përzgjedhur është i njëjtë si për E ashtu edhe për F. Le të shihen shembujt e mëposhtëm në të cilët fjalitë e përzgjedhura nga F dhe nga E janë të llojit argumentues:

(111) a. Mendoi *se do të ndahej me ta*.
b. Mendimi *se do të ndahej me ta* e trishtoi shumë.
c. Dëshironte *(që) të kalonin bashkë pushimet*.
d. Dëshira *që të kalonin bashkë pushimet* qe e pakët.

E ashtu si F mund të modifikohen edhe nga fjali të llojit shtesore (fjalitë përcaktore lidhore, që bëjnë punën e një mbiemri)[121] (p.sh: "shkakore", "qëllimore", "kohore", "lejore") si në shembujt e mëposhtëm:

(112) a. Përpjekjet që të ndërtonim palestrën e shkollës e dhanë rezultatin.
b. Ardhja e miqve kur po niseshim, na pengoi.
c. Këmbëngulja pavarësisht se i ishim kundërvënë të gjithëve, na ndihmoi për fitore.
d. Zhgënjimi i tij që erdhi vonë, ishte i dukshëm.

Këto lloj sintagmash që kanë në përbërje të tyre një fjali, ose në pozicion argumenti (mendimi se do të nisej), ose në pozicionin e shtesës (*një libër që ndodhej në tryezë*), quhen sintagma emërore komplekse.[122]

[119] Graffi, G. (2003). *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, f. 151.
[120] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 205.
[121] Po aty, f. 207.
Për fjali shtesore shih edhe Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, QSA, IGJL, Tiranë.
[122] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 208.

Disa nga këto fjali nuk janë fjali argumentale[123], do i quajmë (atributive) ndërsa karakterizohen nga fakti që mund të modifikojnë çfarëdo elementi nominal, pavarësisht nga lloji i E kokë:

(113) *atë taktikë që e kishte përdorur disa herë, ajo ngjarje që u ndërroi jetët*
ëndrrat që i ngjanin rrjetave të merimangës, Edlira që e kishte pritur me padurim

Nëse E modifikohet, përveçse nga një fjali, edhe nga modifikatorë të tjerë (SMb dhe SP), fjalia zakonisht ndjek si SMb edhe SP. P.sh:

(114) *lulja e re që ka çelur / *lulja që ka çelur e re;*
*pushimet e vjetshme që i bëmë në mal/ *pushimet që i bëmë në mal e vjetshme*
*bluza prej mëndafshi që kam blerë / * bluza që kam blerë prej mëndafshi*
*pyjet me dushk që u dogjën verën e kaluar / *pyjet që u dogjën verën e kaluar me dushk.*

Vetëm me SP të lidhur më pak me E, atributivja mund të jetë edhe e paravendosur (edhe nëse është më pak e natyrshme):

(115) *djali nga Italia që njohe në konkurs / djali që njohe në konkurs, nga Italia*
aktivitetet për mjedisin që zhvilluam në shkollë / aktivitetet që zhvilluam në shkollë për mjedisin

2.20.4. MODIFIKATORË TË EMRIT: SINTAGMA EMËRORE

Një E mund të modifikohet edhe nga një SE, me funksion të *atributit*. Meqenëse ka gjithnjë vlerë ndajshtimore SE modifikator i E quhet **ndajshtim**. SE mund ta prijë ose të ndjekë E kokë:

- kur ndjek E, përbën një strukturë parentetike (i të njëjtit lloj të Mb ndajshtimorë postnominalë):

(116) a. Miku i tij, profesor i gjuhësisë në Universitet, ...
b. Maria, e fejuara e Karlit, ...
c. Ministri, përgjegjësi kryesor i politikës ekonomike, ...

[123] Është fjala për fjalinë përcaktore *dalluese* e *përshkruese*. (ASHSH: Gramatika II; 528),

2.20.4.1. SINTAGMA TË PËRBËRA?

Vështrimi ynë në këtë syth do të ndalet në ndërtime të sintagmave emërore të tipit:

(117) a.vendin tonë të bukur,
b. mësuesit tanë të paharruar,
c. shoqen time të dashur,
ç. takimin e tyre të përhershëm,
d. ëndrrën e saj të bukur.

Nëse vështrojmë përbërësit e sintagmës dhe marrëdhënieve brenda sintagmës kuptojmë që kemi të bëjmë me SE në të cilat ka vend për t'u thelluar sepse nëse do segmentonim lidhjet mes kokës E të sintagmës dhe komponentëve të tjerë do kishim ndërtime që nuk rrinë në këmbë. A kemi lidhje të dy sintagamave në brendësi të sintagmave që kemi emërtuar nën (117)? Si realizohet gjenerimi i secilit prej përbërësve?
Së pari shohim sjelljen brenda një fjalie duke zbatuar provat që përcaktojnë kufijtë e tyre për t'u bindur që kemi të bëjmë me një sintagmë.

(118) a. Turistët e çmojnë shumë *vendin tonë të bukur*.
b. Nderojmë sot *mësuesit tanë të paharruar*.
c. Takova *shoqen time të dashur*.
ç. Lanë *takimin e tyre të përhershëm*.
d. Thuri *ëndrrën e saj të bukur*.

a. Prova I: Lëvizja e sintagmave brenda fjalisë:

(119) a. *Vendin tonë të bukur* e çmojnë shumë turistët.
b. Turistët, *vendin tonë të bukur* e çmojnë shumë.
c. Mësuesit tanë të paharruar vlerësojmë sot.
ç. Sot, mësuesit tanë të paharruar vlerësojmë.
d. *Shoqen time të dashur* takova.
e. *Ëndrrën e saj të bukur* thuri.

Por:

(120) a.*Vendin tonë çmojnë shumë turistët të bukur.
b.*Të paharruar mësuesit tanë sot nderojmë.
c.*Mësuesit nderojmë sot të paharruar.
ç.*Shoqen time takova të dashur.
d.*Të përhershëm takimin e tyre lanë.
e.* Ëndrrën thuri e saj të bukur.

b. Prova II: Mosndërprerja

(121) a. **Tani** turistët e çmojnë shumë vendin tonë të bukur.
b.* Turistët e çmojnë shumë vendin tonë **tani** të bukur.

(122) a. Nderojmë sot **kudo** mësuesit tanë të paharruar.
b.*Nderojmë sot mësuesit tanë **kudo** të paharruar.

(123) a. Takova **dje** shoqen time të dashur.
b. *Takova shoqen time dje të dashur.

(124) a. Lanë atje takimin e tyre të përhershëm.
b.*Lanë takimin atje e tyre të përhershëm.

(125) a. Thuri gjithmonë ëndrrën e saj të bukur.
b.*Thuri ëndrrën gjithmonë e saj të bukur.

Prova III: Zëvendësimi me një përemër.

(126) a. Turistët **e** çmojnë shumë **atë**.
b. I nderojmë sot ata.
c. Takova atë.
ç. Lanë atë.
d. Thuri atë.

Na mjaftojnë këto prova për të kuptuar që kemi të bëjmë me sintagmë si në rastin *vendin tonë të bukur* ashtu edhe në *mësuesit tanë të paharruar*. Pyetja që vjen më pas lidhet me mënyrën se ***si lidhen dy plotësorët (komplementët) me kokën E***. Pra do të kishim diagrame të tilla:

Skema 39.

a.


b.


c.


d.


d.



Diagramët nuk janë të saktë për faktin se nuk pranohen degëzime treshe dhe vërejmë që plotësit gjenerohen njëkohësisht, gjë që nuk është e mundur. Për të kuptuar më mirë këto ndërtime na duhet të shohim llojin e lidhjes të kokës me secilin prej komponentëve të SE. Kështu mund të pranohen SE *vendin tonë* dhe *mësuesit tanë*, por do të kishim **vendin të bukur* dhe **mësuesit* (sh) *të paharruar*. Kjo na bën të kuptojmë që lidhja e komponentëve *të bukur* dhe *të paharruar* është lidhje që nuk bëhet drejtpërdrejt me kokën E, por me SE respektivisht *vendin tonë* dhe *mësuesit tanë*.

Nga ky përfundim do kishim diagrame të tilla:

Skema 40.

a.



b.



c.



ç.



e.



Sërish kjo paraqitje nuk na bind sepse nuk pasqyron gjithë komponentët e SE dhe as llojin e lidhjes e gjenerimit të secilit prej tyre. Për të qenë të sigurtë le t'i analizojmë më hollësisht lidhjet e secilit përbërës.

Së pari të kujtojmë atë që kemi parë më lart për lidhjet E+Pronor. Sqaruam se pronorët gjenerohen në specifikues të E kur ndodhen në pozicion postnominal ndaj E të shquar (J.Mita, 2005, f.32). Po paraqesim të sqaruar njërin nga shembujt:

Skema 41.



Siç vihet re nga diagrama në gjuhët ku determinanti (specifikuesi) trupëzohet me emrin, këta të fundit lëvizin nga niveli më i ulët në pozicionin ku është gjeneruar specifikuesi në mënyrë që të bashkohen me të, kjo për faktin se të dy, si emri ashtu edhe specifikuesi, kanë tipare referenciale.[124] Ndërkohë që sa i përket mbiemrit në SE gjejmë këtë sqarim: *roli i një sintagme mbiemërore nuk është shumë i ndryshëm nga ai i një shtese. Ajo e cilëson emrin duke sjellë një të dhënë të re, por jo të qenësishme dhe jo të domosdoshme.*[125]
Kjo do na çonte në një paraqitje të tillë:



Konkretisht do dilnim në diagramën pemë për SE1.a:

[124] Turano, G. (2011) Struktura e brendshme e sintagmës mbiemërore, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Koleci, F. & Turano, G. (2011). SHBLU, Tiranë, f. 67.
[125] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 24.

Skema 42.



dhe për SE 1.b do kishim diagramën:

Skema 43.



Po kështu edhe për:

Skema 44. (117.c)



Për (117.ç) do kishim

Skema 45



Për 117.e do kishim:

Skema 46



Po ndërtimet

(127) a. djalin e madh të motrës,
b. librin e ri të gjuhës
c. malin e veshur të Lëpushës
d. shoqen time të shkollës

si paraqiten në lidhjet e tyre?

Edhe në rastin e këtyre sintagmave do vemë re që lidhja e përbërësve të fundit nuk mund të bëhet drejtpërdrejt me emrin. Të krahasohen:

djalin e madh	por jo	*djalin të motrës
librin e ri	por jo	* librin të gjuhës

malin e veshur	por jo	* malin të Lëpushës
shoqen time	por jo	* shoqen të shkollës

Në Gramatikën e shqipes II (2002, f.221) emrat në gjinore në formime të tilla janë quajtur fjalë përcaktuese pa një emër funksioni sintaksor të mirëfilltë duke i parë ato si elemente të domosdoshme që formësojnë emrin si gjymtyrë e caktuar brenda një fjalie. Kjo na shtyn të analizojmë SE ku E në gjinore nuk duket se mund të lidhet drejtpërdrejt me kokën e SE, por njëkohësisht nuk sillet as si një përcaktor, por si një fjalë përcaktuese (sipas sintaksës tradicionale). Për këtë na ndihmon sintaksa gjenerative. Ndërtimet mund të paraqiten si E_{kall} + Mb + E_{gjin} dhe $_{Ekall}$ + Pron + E_{gjin}.

Kështu në rastet E + Mb e kemi tashmë të qartë si lidhen në SE. Pamë që Mb sillet si shtesë për E kokë të SE, po kështu thamë se në lidhjen e E kokë të SE me pronorin e prapavendosur, projeksioni më i lartë ishte caktuesori. Lind pyetja cila është lidhja që realizohet me E në gjinore? A është kjo lidhje me nivelin E^0 apo me SE? Kjo na vë përpara kërkesës për të përcaktuar nëse SE_{gjin} është plotësor apo shtesë për E kokë të SE. Mita e sheh këtë rast si shumë të vështirë për t'u trajtuar. Ai mendon se "*Ndërtimet me gjinore në sintaksën e shqipes (dhe në përgjithësi të gjitha ndërtimet me nyjë të përparme) janë shumë të vështira për t'u trajtuar. Gjinorja e gjuhës sonë është një SC e veçantë: ajo jo vetëm merr një caktuesor prapa (si të gjitha SC e zakonshme), por ka edhe një nyjë të përparme, e cila është pjesë integrale e emrit në gjinore, dhe formalisht përputhet me format rasore të nyjave të prapme të emrit prijës. (...) një ide e mirë për trajtimin e gjinores së gjuhës sonë do të ishte ajo e Adger-it (2003), i cili vendos sipër sintagmës emërore një Se (e me të vogël njëlloj si f e vogël). Në të vërtetë, ideja e tij në thelb është ajo e Larsoni-it (1988) për guaskën e SF*."[126]

Na duhet të kuptojmë gjithashtu nëse lidhja E + Mb + Plotësor është një parim apo parametër.

Nëse e krahasojmë me anglishten e frëngjishten nuk do gjenim një rend përbërësish të tillë:

*the book new of language
*le livre nouveau de langue.

Kjo vërteton që rendi i përbërësve është parametër. Diçka tjetër që vihet re është se lidhja e SE_{gjin} nuk mund të jetë e drejtpërdrejtë me kokën. Sintagma emërore në gjinore tregon pronarin dhe kështu ajo sillet si shtesë në raport me SE[127]. Kjo na çon në përfundimin se diagrami me të drejtë do të ishte:

Skema 47.

[126] Mita, J. (2017). *Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, Faik Konica, Prishtinë, f. 85
[127] Po aty, f..92.



Po kështu për fjalitë e tjera do kishim:

Skema 48.

a.



c.



apo

ç. [SC [C -*n*] [SE [E [Spec *time*] [E *shoqe*]]]

KREU I TRETË
VËSHTRIM I FJALISË NË GRAMATIKAT GJENERATIVISTE

3.1. Fjalia në disa gramatika të shqipes

Përgjatë studimeve të gjuhësisë tradicionale vërejmë përpjekjet e gjuhëtarëve për të dhënë një përkufizim për fjalinë, përpjekje që dëshmojnë një bazë të përbashkët: mbështetjen në raportin e gjuhës me mendimin. Problemi është i tillë, sa për këtë njësi, deri më sot janë dhënë rreth 300 përkufizime dhe kjo përpjekje ka filluar që nga antikiteti me Protagorën, Dionis Trakasin, Apolon Diskolin, Donatin e Priscianin[128] për të ardhur deri në ditët e gjuhësisisë bashkëkohore. Në sintaksa të ndryshme të gjuhëtarëve shqiptarë gjejmë përkufizime jo të njëta për fjalinë.

Studiuesi A.Xhuvani në "*Sintaksa shqip (pjes'e dytë)* " shkruan se *fjalija âsht mendimi ynë i çfaqun me të folun a me të shkruem*[129] në të cilën ka dy gjymtyrë kryesore: *kryefjala* dhe *kallëzuesi.* Fjalitë mund të lidhen në periudhë e cila quhet *e përzieme*.[130] Po kështu Ilia Gjuhëtari Dilo Sheperi quan fjali *njê mendim ose njê gjykim të shfaqur me anë fjalësh*[131] duke i përcaktuar në përbërje *kryefjalën* dhe *kallëzuesin*. Nëse fjalitë bashkohen me njëra-tjetrën *përbêjnë kështu një periudhë.*[132]

Studiuesi Justin Rrota e quan fjalinë *nji mendim i diftuem me fjalë*[133] së cilës i njeh dy kryegjymtyrë: *subjektin* dhe *predikatin* dhe mund të jetë *ja vetmas: F. e veçueme, ja në lidhuni me të tjerat: F. e përbâme.*[134]

Gjuhëtari Kostaq Cipo shkruan se *fjalia shpreh një gjykim, një mendim*[135] dhe ajo ka së paku dy pjesë një nga të cilat *subjekt* e tjetra *predikat,* ndërsa radhitja në një e disa fjalive për të është një *periodë*.[136]

Studiuesi Stefan Prifti thotë se fjali është *njësia sintaktike që shpreh një mendim të caktuar*.[137] Gjuhëtari Mahir Domi në "*Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa*" e përkufizon fjalinë *një tog fjalësh ose dhe një fjalë e vetme që shfaq një mendim e gjykim të caktuar.*[138] Dy *pjesët kryesore* të fjalisë i quan *kryefjalë* dhe *kallëzues* dhe kur fjalitë

[128] Robins, R. H. (2007). *Histori e gjuhësisë*, Përkthim i G.Lafe, Dituria, Tiranë, f. 53-96.
[129] Xhuvani, A. (1938). *Sintaksa shqip, pjes'e dytë për klasët e ulta të shkollave të mesme*, Tiranë, f .28.
[130] Po aty, f. 28.
[131] Sheperi, I. D. (1972). *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes (për shkolla të mesme*), Ribotim, Romë, f. 139.
[132] Po aty, f. 140.
[133] Rrota, J. (2005). *Sintaksi i shqipes*, Botime françeskane, botim III, Shkodër, f. 5.
[134] Po aty, f. 6.
[135] Cipo, K, (1952). *Sintaksa*, Tiranë, f. 8.
[136] Po aty, f. 15
[137] Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, f. 38.
[138] Domi, M. (1954). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Tiranë, f. 5.

bashkohen në *grumbull fjalish që tregojnë një mendim të plotë* kemi të bëjmë me *periudhë* ose *frazë*.[139]

Në gramatikën e gjuhës shqipe të ASHSH jepet ky përkufizim për fjalinë: "*Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht, të shqiptuara me një intonacion mbarimi, dhe që shpreh një gjykim, një pyetje, një dëshirë, një nxitje a një ndjenjë, si dhe qëndrimin e folësit ndaj realitetit të brendisë së kumtimit*"[140] e ka dy gjymtyrë kryesore *kryefjalën* dhe *kallëzuesin*.

Studiuesi Mehmet Çeliku në "Sintaksë e gjuhës shqipe. Përbërësit sintaksorë" thotë që *të dy variantet* (fjalitë e thjeshta e të përbëra: shënim i yni) *janë njësi kumtuese, gramatikore dhe intonacionore*[141] dhe të dy përmbajnë *bërthama predikative*[142]. Ndërsa gjuhëtari Remzi Përnaska e sheh fjalinë si "*lidhje tërësore të fjalëve, sipas lidhjeve të gramatikës së një gjuhe dhe që është mjeti themelor i formimit e shprehjes së mendimit, ndjenjës dhe vullnetit*."[143]

Duhet pohuar se hartuesit e sintaksave të para të shqipes, deri në vitet 1960-1970, formuar si filologë dhe tekstologë më vonë, nga kultura të ndryshme, që nga ajo helene (si Xhuvani e Sheperi), gjermanike (J. Rrota) dhe latine (Cipo, Domi), kanë sjellë në një masë edhe arritje të shkollave gjuhësore ku studiuan.

Vëmë re që përkufizimi për fjalinë në gjuhësinë tonë tradicionale lidhet me kritere semantike e logjike - sintaksore. Gjithashtu ajo që i bashkon gjuhëtarët në përkufizimin e tyre për fjalinë është kriteri i kundërvënies mes gjymtyrëve kryesore të kryefjalës dhe kallëzuesit, ky i fundit shprehës i predikativitetit. Në strukturalizëm fjalia analizohet nga pikëpamja e strukturës së përbërësve të saj, nga pikëpamja funksionale dhe nga pikëpamja semantiko-sintaksore.[144]

Për gjenerativistët *karakteristika kryesore që e bën fjali një kombinim të caktuar fjalësh është ajo e të qenit një strukturë predikative*[145] duke e përcaktuar këtë të fundit si një lloj i veçantë marrëdhënieje ndërvarësie jo vetëm me kryefjalën, por edhe me argumentet. Vetë predikati në më të shumtën e rasteve është i pajisur me një shprehje formale që mund të jetë një folje e mënyrës së shtjelluar, por jo medoemos, ndërsa të gjitha gjykimet janë predikativitete, por jo të gjitha predikativitetet janë gjykime.[146]

---

[139] Po aty, f. 162.
[140] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi 2, Sintaksa,* Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 111.
[141] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe. Përbërësit sintaksorë*, Ilar, Tiranë, f. 333.
[142] Po aty, f. 333.
[143] Përnaska, R. (2015). *Gjuhësi...gjuhësore*, Maluka, Tiranë, f. 87.
[144] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHLU, Tiranë, Toena, (botim II, 2003), f.109.
[145] Graffi,G. (2003). *Sintaksa- strukturat e ligjërimit*, Dituria, f. 125.
[146] Po aty, f.128.

3.2. Trajtimi e analiza e fjalisë në gjenerativizëm

Ajo që përbën një përpunim të teorive të mëparshme deskriptiviste dhe strukturaliste, lidhet me faktin që analizën e fjalisë në përbërës, gjenerativizmi e bën mbi metodën e përndarjes, hierarkisë që nënkupton ndarjen e njësive gjuhësore sipas lidhjeve të varësisë ndërmjet përbërësve të një fjalie duke marrë sintagmën si njësi pune. Kështu nga pikëpamja strukturore fjalia ka jo vetëm strukturë lineare, por edhe strukturë hierarkike e cila zbërthehet në tregues sintagmatikë. Nga pikëpamja funksionale ajo mund të ketë *sintagmën emërore* të kryefjalës dhe *sintagmën foljore* që është kallëzues i fjalisë, *sintagma emërore* që mund të jenë argumente dhe *sintagmat e shtesorëve*, ndërsa nga pikëpamja semantiko-sintaksore mund të kuptojmë nëse SE ka një emër frymori ose jo, të përgjithshëm ose jo, folja mund të jetë kalimtare ose jo që kërkon elemente të mirëpërcaktuara të shprehur me SE, SP ose Fj.[147] Kështu, fjalia:

(128) *Sumbullat e vesës përkulnin fijet e holla të barit.* (J.Xoxe, Lumi i vdekur, f.52)

në pikëpamjen strukturore hierarkike të përbërësve të saj do të paraqitej:

Skema 49.



SE *sumbullat e vesës* në funksionin e kryefjalës së fjalisë dhe është specifikues i Sept që dominon SF dhe argument i jashtëm i saj, SF *përkulnin* kryen funksionin e kallëzuesit në fjali ndërsa SE *fijet e holla të barit* ka funksionin e kundrinorit të drejtë përndryshe një argument i brendshëm (komplement) i SF, *e vesës, e holla* dhe *të barit* janë përcaktorë respektivisht të kryefjalës e kundrinorit të drejtë dhe janë modifikatorë të SE respektivisht të SE_1 dhe SE_2.

Së fundi në analizën semantiko - sintaksore do kishim emrin *sumbullat* një emër jofrymor, konkret, i përgjithshëm që lidhet me *përkulnin* që është folje që kërkon domosdoshmërisht një kundrinor të drejtë të shprehur me emër konkret.

[147] Topalli, T. (2011). *Gramatikë e gjuhës shqipe – sintaksa e fjalisë*, Shkodër, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Instituti i Studimeve Albanologjike, f. 604.

3.3. Përbërësit e fjalisë sipas teorisë së roleve tematike
Struktura argumentore, funksionet sintaksore dhe rolet tematike

Liliane Haegeman (1994) duke e metaforizuar konceptin e përbërësve të fjalisë, shprehet se predikatët sillen si skenari i një pjese dhe se argumentet e predikateve janë si rolet që përmban skenari, për performancën e duhur të të cilit duhet të përfshihen të gjithë pa përjashtim. Gjithashtu në skenë nuk duhen lënë aktorë pa ndonjë rol. Si këta të fundit sillen adjunktët (shtesorët).[148] Rikujtojmë këtu se argumentet shfaqen si përbërës të domosdoshëm për predikatin që përkon me kryefjalën e kundrinorët në gjuhësinë tradicionale, por në gjenerativizëm shihen si të tillë edhe disa nga rrethanorët. Gjithashtu nuk duhet barazuar koncepti i *adjunct* me *rrethanorët*. Për të kuptuar më mirë lidhjet mes predikatit të fjalisë drejtuese dhe argumenteve të tij, duhet pasur parasysh se këto të fundit përcaktohen bazuar në rolet tematike. Sipas teorisë së *roleve tematike* të cilat "*janë një koncept sintaksor për numrin, llojin dhe vendosjen e argumentëve të detyrueshëm dhe shprehin marrëdhënien që këta formojnë në lidhje me veprimin apo gjendjen e përshkruar nga folja*",[149] marrëdhënia sintaksore u referohet marrëdhënieve tematike semantike. Thënë ndryshe, një folje në një strukturë të caktuar u përcakton fjalëve që hyjnë në marrëdhënie me të një rol semantik që mund të jenë ai i:

vepruesit (iniciuesi i një veprimi ose shkaktari i realizimit të një veprimi të vullnetshëm ose të pavullnetshëm),

përjetuesit (përjeton perceptimin e një veprimi a ngjarjeje të shprehur nga predikati),

pësuesit (objekti frymor ose jofrymor që pëson një veprim të caktuar, apo që i nënshtrohet një veprimi të shprehur nga predikati i fjalisë),

përfituesit (objekti frymor për të cilin kryhet veprimi),

pikësynimit-qëllimi (objekti drejt të cilit kryhet veprimi, frymor ose jofrymori drejt të cilit lëviz diçka në mënyrë të drejtpërdrejtë ose abstrakte),

marrësit (ai që merr diçka),

instrumentit (mjeti me anë të cilit kryhet apo ndodh diçka),

lokativit (vendi në të cilin është vendosur apo ndodh një ngjarje e shprehur nga predikati i fjalisë) apo

burimit (objektin nga fillon lëvizja, në kuptim fizik apo abstrakt).♦

---

[148] Haegeman, L. (1998). *Introduction to Government and Binding Theory*, Blackwell Textbooks in Linguistics, Oxford UK & Cambrige USA, botimi i dytë, f. 44.

[149] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, QSA, IGJL, Tiranë, f.37.

♦ Në studiues të ndryshëm ndryshon numri i roleve tematike. Në këtë segment janë listuar rolet tematike të paraqitura në vep. e cit. të Anila Kananaj bashkë me shpjegimet që studiuesja jep për to. (2015; 42-47). Më shumë informacion për rolet tematike dhe atë çfarë shprehin ato mund të shihen te Haegeman, 1998, vep e cit. f.50 e cila njeh këto role tematike: *a. AGENT/ACTOR: the one who intentionally initiates the action expressed by the predicate. 2.PATIENT: the person or thing undergoing the action expressed by the predicate. 3.THEME: the person or thing moved by the action expressed by the predicate. 4.EXPERIENCER: the entity that experiences some (psychological) state expressed by the predicate.*
5. BENEFACTIVE/BENEFICIARY: the entity that benefits from the action expressed by the predicate.

Këto marrëdhënie emërtohen edhe me termin "*rolet theta*", por ekziston një ndryshim mes asaj që përfaqësojnë këto dy terma pasi rolet theta tregojnë vetëm numrin e argumenteve që kërkon një folje, ndërsa marrëdhëniet e roleve tematike, përveç aspektit sintaksor e semantik që pasqyrohet në rolet theta, janë më të larmishme sepse shohin edhe natyrën e marrëdhënies së kuptimit të foljes me kuptimin e emrit[150] duke sqaruar në mënyrë më specifike veçoritë që duhet të kenë argumentet e foljes.[151] Po çfarë janë argumentet e një foljeje? Çfarë është struktura argumentore?
Në fjalitë:

(129) a) Vajza hapi dritaren.
b) Krokodili hapi gojën.
c) Dritarja u hap nga era.

folja *hap* në (1.a) e (1.b) kërkon që të plotësohet me një kryefjalë dhe një kundrinor, të cilët përbëjnë elementet e domosdoshme në fjali që ndryshe i quajmë argumente, përndryshe fjalitë do të ishin jogramatikore:

*Vajza hapi.
*Krokodili hapi.
Ose
*Hapi.

Pra folja *hap* kërkon të sqarohet kuptimisht nga një Veprues i cili në (129.a) është *vajza,* në (129.b) është *krokodili* ndërsa në (129.c) është *era;* dhe një Objekt mbi të cilin bie ky veprim, respektivisht në: *dritaren, gojën, dritarja*. SE [*vajza*], [*krokodili*] dhe SP [*nga era*] marrin rolin tematik të vepruesit, ndërsa SE *dritaren, gojën* dhe *dritarja* marrin rolin e pësuesit. Gjithë kjo lidhet me përcaktimin e *roleve tematike* ose *roleve theta* që përcakton një folje. Në fjalitë (129.a) dhe (129.b) është kryefjala që merr rolin e vepruesit ndërsa në (129.c) meqenëse folja është joveprore, veprues është kundrinori i zhdrejtë me parafjalë. Në rastin e (129.c) vërejmë se dritarja edhe pse në funksionin e kryefjalës, pra argument i

6. GOAL: the entity towards which the activity expressed by the predicate is directed; 7. SOURCE: the entity from which something is moved as a result of the activity expressed by the predicate. 8. LOCATION: the place in which the action or state expressed by the predicate is situated.
Carnie, A. (2006), *Syntax, A Generative Introduction*, Oxford: Blackwell Publishers Ltd, f. 229 liston: *1. AGENT: The doer of an action (under some definitions must be capable of volition). 2.EXPERIENCER: The argument that perceives or experiences an event or state. 3.THEME: The element that is perceived, experienced or undergoing the action or change of state; 4. GOAL: The end point of a movement.*
5. RECIPIENT: A special kind of goal, found with verbs of possession (e.g., give). 6.SOURCE: The starting point of a movement. 7. LOCATION: The place an action or state occurs. 8. INSTRUMENT: A tool with which an action is performed. 9. BENEFICIARY: The entity for whose benefit the action is performed.
10. PROPOSITION: The thematic relation assigned to clauses.
[150] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, QSA, IGJL, Tiranë, f. 37.
[151] Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f. 168.

jashtëm i së njëjtës folje *hap*, nuk i caktohet i njëjti rol tematik nga e njëjta folje me argumentet e jashtme të (129.a) dhe (129.b) meqenëse rolin e vepruesit e ka marrë SP [nga era]. Duhet thënë se kjo varet nga forma veprore ose joveprore e foljes dhe lidhet me ndryshimin e rrjetës së roleve theta. Nëse do të shihnim shembuj të së njëjtës kryefjalë (argument të jashtëm) në fjali me folje të ndryshme do të kuptonim se vërejmë që ajo nuk merr gjithnjë të njëjtat role tematike:

(130) a) *Studentët* dorëzuan punimet. (vepruesi)
b) *Studentët* u argëtuan. (përjetuesi)
c) *Studentët* u dërguan për specializim. (pësuesi)
d) *Studentët* morën leksionin nga profesori. (përfituesi)

Kjo na bën të arrijmë në konkluzionin se kur flasim për funksione sintaksore, argumente dhe role tematike, nuk mund të vëmë shenjë barazimi mes tyre. Jo gjithmonë argumentet me të njëjtat funksione sintaksore, marrin të njëjtat role tematike. Kjo varet nga kuptimi i foljes dhe marrëdhënia që ajo ndërton me rolet tematike. Funksionet sintaksore marrin role tematike të cilat i cakton predikati bazuar edhe në kuptimin e tij, nga ana tjetër është valenca e foljes ajo që përcakton numrin e argumenteve.

Një pyetje tjetër që kërkon sqarim lidhet me mundësinë apo jo të vendosjes së shenjës së barazimit mes argumenteve dhe komplementëve.

Nëse u referohemi përdorimeve të bëra e shpjegimeve të dhëna këtyre dy termave do vërenim se te Buxheli (2007, 78) duke iu referuar shembujve *Petriti lexon [$_{SE}$ librin]; Unë besoj [$_{SEpt}$ të vij shpejt];* gjejmë sqarimin se me *komplement* ose *plotësor* kuptohet një SE ose Sept e domosdoshme që plotëson kuptimin e foljes. Ndërsa për termin tjetër në po të njëjtin studim, në shënimet e faqes 145 thuhet se me *argument* kuptohet *çdo element sintaksor që kërkohet domosdoshmërisht nga një fjalë e sinonim me të është termi "valencë"*. Ky interpretim duket sikur çon në vendosjen e shenjës së barazimit mes dy koncepteve.
Kananaj (2015, 48) e bën më të qartë dallimin mes komplementit dhe argumentit kur sqaron se argumentet i takojnë rrafshit semantik, ndërsa komplementet rrafshit sintaksor, por të gjithë komplementet janë argumente. Autorja sqaron edhe adjunktët, të cilët ndryshe nga komplementet e një foljeje të cilët varen nga kuptimi i brendshëm semantik i predikatit, (adjunktët) *përfaqësojnë pjesëmarrës fakultativë, jo të domosdoshëm për gramatikalitetin e realizimit të kuptimit semantik të foljes*[152], edhe pse përgjatë studimit sqaron që edhe adjunktët mund të dalin si komplementë.

[152] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f.48.

3.4. Mbi konceptin e valencës

Teoria e valencës përbën një nga teoritë thelbësore për klasifikimin e përbërësve të frazës në përbërës *argumentorë* dhe *shtesorë*. I pari strukturalist që e formuloi atë në mënyrë koherente ishte Tesnière[153] i cili, ndryshe nga linguistët e tjerë europianë të shkollës strukturaliste, që ishin përqendruar në fonologji dhe morfologji, e sheh fjalinë jo si rezultat i kombinimit të fjalëve të izoluara të rreshtuara, por si një strukturë, një bashkësi e organizuar në brendësi të së cilës fjalët janë lidhur falë raporteve të varësisë reciproke. Dallimi mes rendit linear të fjalisë bazuar në vijimësinë e fjalëve që vëzhgoheshin në aspektin fonik e në shkrimin tradicional, dhe një rendi strukturor të tipit hierarkik, përbën origjinën e teorive sintaksore moderne.

Valenca, një term i marrë nga fjalori teknik i kimisë, përshkruhet si mundësia e një foljeje për të hyrë në kombinime me një numër të caktuar dhe disa tipa elementesh gjuhësorë e për t'i lidhur pas vetes për të krijuar fjali. Këto elemente që duhet të përdoren së bashku me foljen, Tesnière i quan "*aktantë*" [154], emërtim të cilit në literaturën e sotme generativiste i përgjigjet termi "argumente"[155]. Sipas Tesnièr-it me aktantë kuptohen frymorët dhe sendet që marrin pjesë në shkallë të ndryshme gjatë veprimit të emërtuar nga folja dhe pa praninë e tyre ky veprim nuk mund të kryhet. Aktantëve mund t'u shtohen edhe elemente të tjera siç janë "*rrethanorët*"[156] (shtesorët) që paraqesin rrethanat e kryerjes së veprimit. Aktantët që seleksionohen nga folja nuk mund të jenë më shumë se tre. Tesnière ka parasysh këtu funksionet sintaksore themelore: *kryefjalë, kundrinor i drejtë* dhe *kundrinor i zhdrejtë*. Ndërsa *rrethanorët* mund të shfaqen në fjali në një numër të çfarëdoshëm. Ndryshe nga Tesnière, i cili fliste vetëm për valencë sintaksore foljore pa shtruar problemin e natyrës së kësaj vartësie dhe të roleve semantike, *stuktura argumentore* ose *valenca*, sot vështrohet si një dukuri leksikologjike të cilën e kanë edhe njësi të tjera leksikore[157] si mbiemrat, parafjalët, emrat prejfoljorë[158]. Struktura argumentore e një fjale përfaqëson një dukuri leksikologjike, sepse lidhet me specifikën e vetë fjalës. Përveç aspektit logjik ajo ka edhe aspektin sintaksor, morfologjik e semantik[159]. Në aspektin sintaksor të strukturës argumentore të fjalës, struktura e argumenteve foljore tregon numrin e elementeve,

[153] Tesnière, L. (1988). *Éléments de syntaxe structurale*, Klincksieck, botim i dytë, Paris.

[154] Koncepti i valencës rimerret e përpunohet nga Hays (1964). Dependency theory: A formalism and some observations, *Language 40*, f..511–525 dhe Gaifman (1965). Dependency systems and phrase-structure systems, *Information and Control 8(3)*, fq.304–337, përfaqësues të DG (dependency grammar) dhe më pas nga gramatika gjenerative.

[155] Termi *temë* ose *argument* përdoret nga N. Chomsky si sinonim i *valencë* ose *aktant*. Sipas tij gjuha përbëhet nga struktura gjuhësore, të paraqitura simbolikisht me formulën *P(x, y)* ku *P* është për predikatin dhe *x* e *y* përfaqësojnë kategoritë ose argumentet që i bashkohen predikatit..

[156] Emërtim i përdorur nga Tesnière

[157] Shehu, H. (2004). Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, in *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, f. 159. përveç emrit e foljes i njeh valencë edhe ***mbiemrit, numërorit, përemrit, ndajfoljes***.

[158] Matheus, P. (2007). *Valency Theoretical, descriptive and Cognitive issues*, botuar në *Trends in linguistics, studies and monographs, 187*, Berlin-New York, f. 3.

[159] Buxheli, L. (2011). *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*, Botime albanologjike, Tiranë, f. 94.

minimalisht të domosdoshme, për realizimin e kuptimit të foljes, por edhe natyrën e këtyre argumenteve.

Për të paraqitur raportet hierarkike nga të cilët varet kuptimi i fjalisë, Tesnièr përdor grafikë në të cilët fjalët nuk shfaqen në rendin e tyre të artikulimit, por vendosen sipas pozicionit që zënë në hierarkinë e fjalisë, duke krijuar kështu grupime të ndërmjetme të dallueshëm nga *nyjet*. Çdo *nyje*[160] lidh një element me elementet e tjera që varen prej tij. Këtu *folja* përcaktohet si *nyje qëndrore* e fjalisë dhe zë vendin më të lartë në hierarki[161] ku I është përdorur për foljen[162], O për emrin, A për mbiemrin.[163]



Duhet pasur parasysh se mes gramatikës së valencave të Tesnièr-it dhe gramatikës gjenerative të valencave ekzistojnë dallime të cilat jemi munduar t'i vënë në dukje përgjatë prezantimit të konceptimit të Tesnièr-it.

Në gjuhësinë shqiptare fillimisht studiuesi A. Kostallari shprehet se *"Shumica e autorëve që trajtojnë nocionin e valencës kuptojnë me këtë term "aftësinë e një njësie gjuhësore për t'u lidhur me njësi të tjera të gjuhës, duke pasur parasysh si strukturën, ashtu edhe semantikën e tyre" (M.D. Stepanova) pra valenca shihet në thelb si një potencialitet lidhjesh në plan leksiko-semantik, morfologjik, sintaktik e fjalëformues*" pra mund *të ndihmojë për të shpjeguar burimin e natyrën e dykuptimësisë në kompozitat bisemantike.*[164]

Në monografinë "Rrethanori në gjuhën shqipe"[165] studiuesja Anila Kananaj duke u ndalur në dallimet mes dy konceptimeve të valencës sqaron se:

a) analiza gjenerative e fjalisë fillon me gjetjen e konstituentëve e jo të foljes si te Tesnière.

b) kryefjala dhe kallëzuesi në gjenerativizëm trajtohen ndryshe (si konstituentë: kryefjala në pozicionin e specifikuesit[166], ndërsa kokë e fjalisë mund të jetë një kategori funksionale dhe jo vetëm një kategori leksikore) qoftë nga gramatika e Tesnièr-it (që e sheh kallëzuesin

[160] Tesnière në pemën e tij përdor fjalë për emërtimin e nyjave, ndërsa në pemën e gramatikës gjenerative përdoren simbole kategorish.

[161] Në gramatikën gjenerative pohohet se nuk ka fjali pa kryefjalë dhe ajo zë vendin e specifikuesit në pemën e fjalisë, kjo na çon në arsyetimin se nuk mund të jetë folja nyja qendrore e fjalisë dhe në fakt në gramatikën gjenerative si nyje qendrore e fjalisë shihet eptimi, lidhëza, etj.

[162] Në fakt në këtë skemë marrin kuptim vetëm fjalitë me folje, por dihet se ekzistojnë edhe fjali pa folje. Këto të fundit marrin një vëmendje të veçantë në gramatikën gjenerative.

[163] De Santis, C. (2016). *Che cos'è la grammatica valenziale*, Carocci, Roma, f. 22-23

[164] Kostallari, A. (1958). *Studime filologjike*, f.44.

[165] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 56-60.

[166] Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, SBLU, Tiranë, f. 154-155.

si të vetmen gjymtyrë kryesore të fjalisë), qoftë nga gramatika tradicionale që i sheh si gjymtyrët kryesore të fjalisë.
c) Në gramatikën gjenerative pranohet koncepti i valencës (e cila mund të përshkruhet në nivelin logjik, semantik e leksikor) edhe për emrat prejfoljorë, mbiemrat[167] e parafjalët.
ç) Në pemën strukturore të fjalisë në gjenerativizëm nyja më e lartë nuk është folja siç ndodh në pemën e Tesnièrit.
d) Në gramatikën gjenerative dega që bashkon dy nyja në pemën e fjalisë nuk shënon element të strukturës sintaksore, por thjesht jep lidhjen e elementit të varur me atë drejtues, ndryshe nga Tesnière që me vijën që lidh dy nyjat emërton një element të strukturës sintaksore.
e) Gramatika gjenerative merr parasysh edhe ndërtimet e fjalive pa folje, pra të gjitha tipave të fjalive. Nëse mungesa e kryefjalës në fjali sipas Tesnière do të paraqitte një strukturë pa këtë nyje, gramatika gjenerative e ruan në skemën pemë pozicionin sintaksor të gjymtyrës (kryefjalës) duke e pasqyruar me pro/PRO.
d) Ndryshe nga fillesat e zhvillimit të saj, gramatika gjenerative i kushton vëmendje ndërveprimit të sintaksës me semantikën. Tesnièri nuk e bën këtë duke vënë një kufi të prerë mes dy disiplinave.

Ka disa kritere për dallimin e *argumenteve*[168] nga *shtesorët (adjunktët)*:
Kananaj shprehet se ata *nuk lidhen drejtpërdrejt me kokën, por në nivelin e ndërmjetëm, i cili në skemën pemë shënohet me x-bar. Ata janë të përsëritshëm dhe ndryshe nga komplementët (plotësorët) që mund të realizohen vetëm një herë në një kokë, mund të ketë disa shtesorë për të njëjtën kokë.*[169]
Graffi në sqarimin e kriterit semantik thotë "*ndërsa argumentet tregojnë njësitë e përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e përshkruar nga folja, rrethanorët japin vetëm kontekstin në të cilin zhvillohet një proces i tillë."*[170] Megjithatë duhet sqaruar që në kontekste të caktuara ka adjunktë që janë të domosdoshëm sepse pa to fjalia do të ishte jogramatikore. Sipas Kananaj (2015, 50) *"Komplementet*[171] *mund të jenë jo vetëm kundrina e përcaktorë, po edhe përbërës që mendohen fakultativë për kuptimin e fjalisë, siç janë një pjesë rrethanorësh të gramatikës tradicionale shqiptare.*"
Në fjalinë:

---

[167] Për valencën e mbiemrit gjejmë pohime te Haegeman, L. (1994). *Introduction to Governement and Binding Theory*, f.46-48, te gjuhëtari Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, f.168; dhe një trajtim i gjerë i bëhet valencës së mbiemrit në gjuhën shqipe nga sutdiuesi Beqiraj, Xh. (2016). *Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, f. 218-225.
[168] Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, f.130. *"...në gramatikën gjenerative termi "argument" përdoret për të emërtuar edhe sintagmat emërore që lidhen me foljen (kryefjalët dhe kundrinorët) ..."*
[169] (Kananaj, 2015, 49)
[170] Graffi, G. (2003). *Sintaksa- strukturat e ligjërimit*, Dituria, f.62
[171] Risjellim në vëmendje që: *të gjithë komplementët janë argumente. Komplementët i përkasin rrafshit sintaksor ndërsa argumentet i përkasin rrafshit semantik*.

(131) Larg ai dalloi njërin krah të Tabir Sarajit. (I. Kadare, Pallati i ëndrrave, f.8)

Nëse heqim *larg* që është një rrethanor, fjalia mbetet gramatikore, por nëse provojmë të heqim kundrinorin e drejtë *njërin krah të Tabir Sarajit*, fjalia do të ishte jogramatikore.

(132) a. Mark-Alemi dalloi njërin krah të Tabir Sarajit.
b. *Larg ai dalloi.

Kjo vërteton se argumentet, ndryshe nga shtesorët, janë elemente të domosdoshëm.
Ndërsa në fjalitë:

(133) a. Ai pa nga ndërtesa.
b. Gruaja u ndje keq.

nëse heqim rrethanorët, të cilët zakonisht i përfshijmë te shtesorët, përkatësisht për (133.a) [SP *nga ndërtesa*] dhe për (133.b) [SNd *keq*], fjalitë nuk do ishin gramatikore. Shembulli na vërteton se kemi të bëjmë me raste kur rrethanorët tradicionalë të shqipes përfshihen në komplementë.
Në fjalinë (131) folja *dalloi*, në rolin e predikatit, kërkon dy argumente për shkak të informacionit të saj leksikor, argumente të cilat projektohen në fjali në funksionin e kryefjalës [SE *Mark-Alemi*] dhe kundrinës [SE *njërin krah të Tabir Sarajit*] e pasqyruar në (131) dalloi: Folje [SE, SE].
Ndërkohë në shembullin:

(134) a. Andrea pi një kafe.
b. Andrea pi.

në rastin e përdorimit të foljeve kalimtare edhe si jokalimtare, nuk vërtetohet fakti që kundrinori për këtë folje është një element jo i domosdoshëm, por folja pranon dy lloje ndërtimesh: njërin me dy argumente (134.a) dhe tjetrin vetëm me një argument (134.b).
Bazuar në valencën e tyre, foljet mund të klasifikohen në: jovalente ose të quajtura edhe *me valencë zero*, njëvalente, dyvalente dhe trivalente.[172]
Kështu në shembujt:
(135) a. Kurti vdiq.
b. Kurti hapi derën.

[172] De Santis, C. (2016). *Che cos'è la grammatica valenziale*, Carocci, Roma, f. 23.
"Tesnier-i e pranon mundësinë që një folje mund të shfaqet në klasa të ndryshme meqenëse një folje mund të ketë një numër të ndryshëm aktantësh sipas domethënies. Ai vëren gjithashtu se jo gjithmonë të gjitha vendet e vëna në dispozicion nga një folje mund të mbushen".

c. Kurti i dha dorën të panjohurit. [173]

njësia leksikore [SE Kurti] përfaqëson argumentin e vetëm që mund të marrë folja *vdiq* në fjalinë (135.a) simbolikisht e paraqitur në:

vdiq: FOLJE [Kurti] ose vdiq: FOLJE [SE]

duke treguar që folja *vdes* është njëvalente (njëargumentore) dhe është jokalimtare.

Në fjalinë (135.b) dy njësitë leksikore që janë argumente të domosdoshme për realizimin e foljes *hapi*, pra mbushin valencat e kësaj foljeje duke u paraqitur në këtë strukturë:

hapi: FOLJE [Kurti, derë] ose hapi: FOLJE [SE, SE]

Në fjalinë (135.c) folja *jap* përmban tri argumente: SE *Kurti*, SE *dorën*, SE të *panjohurit* paraqitur në mënyrë strukturore si më poshtë:

jap: FOJE [Kurti, dorën, të panjohurit] ose jap: FOLJE [SE, SE, SE]

Në paraqitjen e pemës strukturore të fjalisë vërejmë pozicionet sintaksore të këtyre argumenteve:

Skema 50: Kurti hapi derën



Nga skema kuptojmë se SE *Kurti* në funksionin e kryefjalës është argument *i jashtëm* i foljes *hapi* për faktin se kjo SE nuk lidhet drejtpërdrejt me foljen *hap*, por vetëm përmes eptimit [EPT]. Ndërsa SE *derën*, ndryshe nga SE *Kurti*, është argument *i brendshëm* i foljes *hap* sepse strukturalisht hyn në lidhje varësie drejtpërdrejt me foljen pa ndërhyrjen e ndonjë sintagme tjetër si në rastin e SEPT.[174]

[173] Arsyeja që një nga argumentet është i nënvizuar ndërsa të tjerët jo, lidhet me faktin se strukturalisht argumentet foljore të shprehura me anë të SE në rolet e kryefjalës e të kundrinorit, nuk janë të barasvlershme për sa i përket varësisë nga folja.

[174] Sipas *Governement and Binding Theory*. (N.Chomsky; 1988)

Kështu, në llojin e parë, **jovalente**, të klasifikimit të foljeve, futen folje që nuk mund të lidhen me asnjë argument: *p.sh.veson*, *bubullon,* etj. kryesisht folje që tregojnë dukuri të natyrës.
Në folet **njëvalente** përfshihen folje të shoqëruara vetëm nga një argument që mund të jetë një **SE** *p.sh. Vdiq shpresa*, ose një **Fj** *p.sh. Dihet se mundi shpërblehet* ose *Flitet që rapsodi do të vijë.*
Folje njëvalente janë foljet e klasifikuara si njëvetore në Gramatikën e Gjuhës shqipe 1, (2002)[175] dhe në këto raste argumenti i vetëm mund të jetë i jashtëm.[176]

Foljet **dyvalente** shoqërohen nga dy argumente ndër të cilët njëri është patjetër një **SE**, ndërsa tjetri mund të jetë edhe **SP** ose një **Fj**: p.sh. *Mira vështron detin*. ose *Mira vështron nga deti*. ose *Mira mendon se do të marrë pushimet*.

Foljet **trivalente** shoqërohen nga tri argumente dhe mund të shoqërohen me **SE** dhe një **Fj.** Ato kanë një argument të jashtëm dhe dy argumente të brendshme. P.sh *Unë i jap librin shokut. Mira i jep nxënësit ç'i duhet*.

Ndarja në bazë të valencës duket se përkon pjesërisht me atë që gramatika tradicionale i klasifikon si *folje pavetore*, *kalimtare* dhe *jokalimtare*, ndërkohë që për foljet trivalente nuk ka një klasë që u përgjigjet atyre.[177] Për të vërtetuar mospërputhjen, në krahasimin mes foljeve "*pavetore*" dhe atyre "*jovalente*" Graffi (2003, 67) vëren se kjo e fundit lidhet me aktin krejt formal të shfaqjes pa argumente, ndërkohë që klasifikimi tradicional bazohet në konceptin e vetës që në një farë kuptimi nuk qëndron, sepse këto folje përdoren në vetën e tretë njëjës. Emërtimi bazohet në një nocion jogramatikor të vetës e më së shumti në atë të "vepruesit" i cili në fakt mungon (**vetëtin vetëtima*). Nga ana tjetër vepruesi mungon edhe në fjali me folje pësore e ato nuk mund të klasifikohen me folje që tregojnë dukuri meteorologjike:

(136) Po punohet çdo ditë me shumë përkushtim.

Edhe folja *duhet* që klasifikohet si pavetore në gramatikën tradicionale listohet si folje njëvalente dhe jo jovalente duke na sjellë një shembull tjetër që vërteton se klasat e foljeve *jovalente* dhe *pavetore* nuk përputhen. Le të shihet:

(137) Këtej s'mund të kalojë njeri.

[175] Të tilla janë: *hingëllin, hungëron, kakaris, mjaullin, pëllet, fryn, bleron, gjelbëron, ushton, folje të tipit (s'më) besohet, (më) duket, (s'më) kujtohet, ndodh, (më) pëlqen, qëllon, rastis, kur ndiqen nga një fjali e varur kryefjalore, disa folje kalimtare si: di, lejoj, ndaloj, them,* etj., të përdorura në formë joveprore kur folësi nuk mund apo nuk do ta përcaktojë atë që e kryen veprimin e shprehur prej tyre.
[176] Mbi konceptin e argumenteve të brendshëm e të jashtëm do shkruajmë më poshtë.
[177] Graffi, G. (2003). *Sintaksa- Strukturat e ligjërimit*, Dituria, Tiranë, f.66-67.

Po kështu edhe klasat e foljeve njëvalente dhe dyvalente nuk kanë përputhje të plotë me kalimtaret dhe jokalimtaret. Në përkufizimin tradicional lidhen dy kritere: njëri semantik e tjetri formal. Sipas gramatikës tradicionale "*folje kalimtare (tranzitive) quhen ato folje të cilat emërtojnë veprime që nuk mbeten te ai që i kryen, por shkojnë e bien mbi një person a send tjetër, që në fjali shprehet me anë të një emri, përemri a çdo fjale tjetër të emërzuar në rasën kallëzore pa parafjalë. Folje kalimtare, pra, quhen ato që kanë mundësi të marrin kundrina të drejta*".[178] Ndërsa folje jokalimtare *"quhen ato folje, të cilat emërtojnë veprime që mbeten tek ai që i kryen"*[179] Pyetja jonë lidhur me qëndrueshmërinë e aspektit semantik të përkufizimit, ka parasysh raste si në fjalinë (8) ku nuk mund të flasim për veprime që kalojnë nga kryefjala në kundrinor:
(138) .... ndjeu prapë <u>dëshirën</u>... (I.Kadare, Pallati i ëndrrave, f 168)

Apo në rastin e fjalisë:
(139) ... kuptova <u>se ajo qe lodhur</u> ... (F. Kongoli, Ne të tre, 1985, Albanian Corpus)

Në këto fjali pjesa e nënvizuar sillet si kundrinor ndaj kallëzuesit, por a mund të flitet për kalim të veprimit nga kryefjala në kundrinor?
Informacioni leksikor që jepet sipas klasifikimit të valencës është më i gjerë sepse sqaron që struktura sintaksore e fjalisë ku ajo bën pjesë të ketë një kryefjalë dhe një kundrinor, ndryshe nga foljet njëvalente që marrin vetëm kryefjalën.
Po kështu klasifikimi i foljeve sipas vetës dallon nga klasifikimi i foljeve sipas valencës. Kjo e fundit, siç parashtruam, përmban gjithë informacionin për argumentet e domosdoshme për realizimin e kuptimit të foljes, ndërsa nëpërmjet kategorisë gramatikore të vetës kuptojmë lidhjen mes kryefjalës dhe foljes, që nënkupton lidhjen me vetëm njërin prej argumenteve të foljes. Në shqipen, foljet, kalimtare ose jokalimtare, zgjedhohen në tri vetat,[180] por po kështu në vetën e tretë përdoren edhe foljet njëvetore. Kjo bën që informacioni i marrë nga klasifikimi sipas vetës të jetë i dallueshëm nga ai sipas argumenteve të domosdoshëm. Si përfundim, mund të themi se çdo folje ka strukturën e saj argumentore që janë sintagma të kërkuara domosdoshmërisht nga ajo për realizimin e kuptimit, dhe klasifikimi mbi bazën e valencës së tyre sjell informacion më të plotë rreth lidhjeve sintaksore që nevojiten për realizimin e kuptimit të secilës prej tyre.
Na intereson të ndalemi në këtë klasifikim për të kuptuar e shpjeguar sjelljen si argumente të fjalive me nënrenditje ndaj predikatit të fjalisë drejtuese. Gjithashtu vëmendja jonë do të ndalet në fjalitë argumentore kryefjalore, argumentore kundrinore dhe kallëzuesore. Në periudhë, këto lloj fjalish mbushin valencat e foljes kallëzues të fjalisë drejtuese.

[178] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f.265.
[179] Po, aty, f.266.
[180] Në *Gramatikën e gjuhës shqipe* thuhet se folja është në vetën e parë njëjës apo shumës kur kryefjala e fjalisë përfaqëson folësin (folësit), në vetën e dytë, bashkëbiseduesin dhe në vetën e tretë kryefjala përfaqëson një apo disa persona a sende që nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. (Gramatika 1;2002, 167)

3.5. Argumente të brendshëm dhe të jashtëm

Folja u cakton rolet tematike (semantike) argumenteve të saj. Në parimin gramatikor të quajtur **kriteri tematik** thuhet se çdo argumenti i caktohet një dhe vetëm një rol tematik dhe çdo rol tematik i caktohet një dhe vetëm një argumenti[181]. Ky kriter zbatohet vetëm për argumentet dhe jo për shtesat të cilat janë fakultative dhe nuk luajnë rol në gramatikalitetin e një fjalie. Në fjalinë:

(140) Vili dëgjonte tingullin e lahutës.

[SE *Vili*] dhe [SE *tingullin e lahutës*] janë argumentet e foljes dyvalente e cila u shënon rolet tematike të **Vepruesit** *Vili* dhe **Temës** *tingullin e lahutës.* Nëse paraqitet në skemë do të kishim:

[SEPT [Spec [Vili]] [EPT' [Ept [-nte]] [SF [F [dëgjo] [SE [tingullin e lahutës]]]]]] ose

Skema 51.



Nga diagrama kuptohet qartë se vepruesi është argument i jashtëm, ndërsa tema është argument i brendshëm. Po kështu në fjalinë:

(141) Heshtja i dha një peshë të keqe gjithçkaje. (I. Kadare, Hija, 1985, AC)

agumentet *një peshë të keqe* dhe *gjithçkaje* janë argumente të brendshme, ndërsa *heshtja* është argument i jashtëm siç shihet në skemën 3:

[181] Chomsky, N. (1988). *Lectures on Governement and Binding – The Pisa Lectures*, Dordrecht – Holland/ Providence RI – USA, Foris, f. 36.

Skema 52.



Folja *dha* i ka caktuar së pari rolin tematik të temës SE *një peshë të keqe* e më pas e gjithë sintagma është bashkuar me argumentin e provuesit [182] *gjithçkaje*. Për ta sqaruar më mirë skematikisht, bazuar në ndërtimet ditranzitive do të kishim:

Skema 53.



Kështu "*roli tematik që i caktohet nga folja sintagmës në pozicionin e argumentit të foljes quhet roli tematik i brendshëm dhe argumenti që merr këtë rol quhet* ***argument i brendshëm****. (...) Roli tematik, që i caktohet nga folja së bashku me argumentin e saj të brendshëm sintagmës në pozicionin e specifikuesit të SF, quhet roli tematik i jashtëm dhe argumenti që merr një rol të tillë tematik quhet* ***argument i jashtëm.****"*[183]

[182] Për të vërtetuar larminë e numrit dhe emërtimeve të roleve tematike kemi sjellë variantin e emërtimit të rolit tematik të pësuesit sipas Koleci, F. (2011). *Foljet ditranzitive* in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2011, f.53.
[183] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f. 69.

3.6. Klasifikimi i fjalive

Fjalitë, në gramatikën tradiconale, klasifikohen bazuar në funksionimin e tyre: si *pyetje*, *pohime*, *thirrje* dhe *urdhra.*[*] Për t'i shkuar deri në fund pasqyrimit të plotë të klasifikimit të fjalive duhet të shtojmë që:

- fjalitë **dëftore** klasifikohen në fjali që paraqesin:
  - një veprim real,
  - mundësi,
  - pamundësi,
  - domosdoshmëri ose
  - supozim të kryerjes së një veprimi.
- fjalitë **pyetëse** të cilat kanë tipare dalluese:
  - intonacionin e veçantë,
  - përdorimin e mjeteve gramatikore pyetëse,
  - rendin e gjymtyrëve,

klasifikohen në:

- pyetëse të mirëfillta,
- pyetëse jo të mirëfillta,
- pyetëse thirrmore
- pyetëse tërësore
- pyetëse të pjesshme
- pyetëse të zhdrejta,
- pyetëse retorike.

- Fjalitë **nxitëse**
- Fjalitë **dëshirore**.

Sipas *marrëdhënieve me realitetin* fjalitë i klasifikojmë në:

- fjali **pohuese** ku pohimi është:
  - i sigurt,
  - i pasigurt,
  - pohuese me kuptim mohor e anasjelltas.
- Fjali **mohuese** ku mohimi është:
  - i përgjithshëm,
  - i pjesshëm,
  - njësh,
  - i shumëfishtë,
  - intensiv,
  - kategorik.

[*] Këtyre lloj emërtimesh të cilat paraqesin klasifikimin sipas intonacionit apo qëllimit të thënies, në shqip u përgjigjen fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore.

Kurse klasifikimi kryesor mbështetur në përbërjen e fjalive është *të thjeshta* apo *të përbëra*. Këto të fundit ndërtohen nga shumë fjali të thjeshta të cilat, bazuar në tiparet e tyre, quhen fjali *kryesore* dhe fjali *të varura*. Këto fjali të thjeshta mund të jenë me njëra-tjetrën të bashkërenditura nga ana gramatikore dhe fjali, njëra prej të cilave *"modifikohet" nga një ose disa fjali të varura, që lidhen gramatikisht me të.*[184] Siç vihet re në gramatikat e shqipes klasifikimi bëhet bazuar edhe në karakteristika strukturore: *dykryegjymtyrëshe*, *njëkryegjymtyrëshe* ose *të plota* apo *të paplota*, të cilat mund të jenë *të zgjeruara* ose jo.

Kështu klasifikimi më i hollësishëm do na tregonte se:

- fjalitë **e paplota** mund të klasifikohen në:
  - fjali të paplota të mirëfillta,
  - fjali të paplota të kontekstit,
  - fjali të paplota situative.

Në to vërejmë mungesën e kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorëve dhe praninë e rrethanorëve e përcaktorëve.

- Fjalitë **njëkryegjymtyrëshe**:
  - vetore
    - me vetë të përcaktuar,
    - me vetë të papërcaktuar,
    - me vetë të përgjithësuar;
  - <u>pavetore</u>
    - me folje e shprehje pavetore,
    - me folje të dukurive natyrore,
    - me folje që kthehen pavetore;
  - emërore
    - përshkruese,
    - emërtuese,
    - treguese;

- Fjalitë e **pagjymtyrëzueshme**:
  - të pohimit,
  - të mohimit,
  - nxitëse,
  - pyetëse,
  - thirrmore.

Le të shohim paraqitjen në diagramin pemë të disa prej tipave të fjalive sipërpërmendura.

[184] Lyons, J. (2010). *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Tiranë, Dituria, (botim i parë në 2001), f.173.

a) Fjalia dëftore:

(142) Mihali e njihte botën nga leximet në Akademinë e Voskopojës.
(B. Blushi, Të jetosh në ishull, f.178)

Skema 54.



b) Fjalia pyetëse[185]

(143) Ç'ka qenë Homeri? (I. Kadare, Dosja H, f.58)

[185] Turano, G. (2011). *Fjalia pyetëse; Pyetëset wh*, in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes,* SHBLU, Tiranë, f.92.
"*Frazat pyetëse të tipit **wh** kanë një strukturë të veçantë, pasi elementi pyetës i tyre del gjithnjë në krye, ndërsa kryefjala, që normalisht zë vetë këtë pozicion, shtyhet në fund të fjalisë"*

Skema 55[186].



c) fjalia nxitëse dhe urdhërore.*

(144) Tregomë të vërtetën.

Skema 56.[187]



[186] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, Shpresa, f. 177.
"*Në fjalitë pyetëse të shqipes, folja, pasi është ngjitur në pozicionin EPT, vazhdon lëvizjen deri në pozicionin K"*

* Në të dy rastet është marrë parasysh ndërtimi me folje në urdhërore, për këtë arsye kemi një model skeme pemë.

[187] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, Shpresa.
Trajtat e shkurtra të vetës I dhe II mund të realizohen si brenda projeksionit SEPT, ashtu edhe brenda projeksionit SK. Kur vendosen pas foljes këto trajta realizohen brenda projeksionit SEPT. Folja lëviz në kokën K, kurse trajtat realizohen një pozicion më poshtë.

Për ta përmbledhur, në analizën e kritereve të klasifikimit Graffi (Graffi, 2003) vëren se ndarja e fjalive bazuar në funksionin e tyre nuk ka të bëjë aq shumë me funksionin, sesa me modalitetin. Për ta konkretizuar ai jep rastet e fjalive:

(145) a. Këtu pihet shumë cigare. b. A ke një cigare?

që në varësi të situatës së komunikimit nuk japin përkatësisht një *pohim* dhe një *pyetje*, por pasqyrojnë respektivisht një *urdhër* dhe një *dëshirë*. Kështu ai përfundon përmbledhjen e kritereve tradicionale të klasifikimit të fjalive në:

1) kriteri i *modalitetit*
2) kriteri i *kundërvënies mes fjalive kryesore dhe të varura*
3) kriteri i *polaritetit*
4) kriteri i *diatezës*.[188]

Fjalitë që analizuam strukturalisht më lart janë fjali të klasifikuara në bazë të modalitetit. Bazuar në kriterin e kundërvënies mes fjalive *kryesore*[*] dhe fjalive *të varura* do të na duhet të merremi me një tjetër njësi më të ndërlikuar të ndërtimit, *frazën*. Më poshtë do ta trajtojmë atë më gjerësisht. Për momentin po paraqesim skemat e disa prej tyre pa u hyrë analizave të hollësishme.

Skema 57 (146) Pritnin të vinte rapsodi..



[188] Graffi, G. (2003). *Sintaksa – Strukturat e ligjërimit*, Tiranë, Dituria, f.130-134.

[*] Termi krijon diskutime për faktin se jo në të gjitha rastet, e ashtuquajtura fjalia kryesore mund të qëndrojë pa fjalinë e varur. Kjo lidhet me teorinë e valencës së foljes e cila është trajtuar më parë. Do të ishte më me vend të përdornim termin fjali drejtuese në vend të kryesore. Arsyetimin e mbështetjen për këtë emërtim do e paraqesim në një moment tjetër të studimit tonë.

[189] Turano, G. (2011). in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes,* SHBLU, Tiranë, f. 111. Për foljen në mënyrën lidhore duhet marrë parasysh edhe elementi që realizon mënyrën e foljes, kështu përcaktohet një pozicion sintaksor i etiketuar SM (sintagma mënyrore) që krijon vend për pjesëzën *të*.

(147) U hodh nga shtrati dhe iu afrua dritares (I. Kadare, Dosja H, f.210)

Skema 58[190]



Duhet vënë në dukje se kriteret e sipërpërmendura për klasifikimin e fjalive shpesh kryqëzohen me njëri-tjetrin. Kështu në fjalinë (146) mund të flasim për fjali të varur nga pikëpamja e funksionit, por edhe për fjali me folje në diatezën veprore.

Fjalia mohuese:

(148) Studenti nuk (s') foli.

Skema 59.



[190] Mita, J. (2017). *Teoria e Sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, Prishtinë, Faik Konica, f. 251-252

[191] Rothsttein, S. D, (1991). *Heads, projections and category determination*, në *Views on Phrase Structure*, Dordrecht, Kluer, K. Leffel and D. Bouchard, San Diego: Academc Press. f.108.
*"Lidhëza **dhe** nuk ka tipare kategoriale dhe tiparet kategoriale i merr nga njësia."*

Në rastin e përdorimit të pjesëzës mohuese ***mos*** diagrami i fjalisë ndryshon. Kjo lidhet me faktin se pjesëzat mohuese nuk mund të dalin të veçuara dhe kanë rend të ngulitur. Vendi i mohimit në shqip është sipër SEPT, përpara pozicionit Koh. Në mohimin me *mos*, e cila zë pozicionin pas pjesëzave ***të*** të lidhores, ***për të*** të paskajores, ***duke*** të përcjellores thuhet se këto të fundit zënë pozicionin më të ulët të fushës K:

Skema 60.[192]



Ajo që kemi bërë deri tani është përballja e klasifikimit tradicional me pasqyrimin hierarkik të përbërësve të fjalisë, kjo e fundit është metodë që i përgjigjet teorisë së sintaksës gjenerative. Kështu përgjatë paraqitjes së skemave pemë për secilën prej fjalive ne kemi konkretizuar segmentimin e fjalisë në përbërës duke pasqyruar kategoritë gramatike dhe funksionale.

3.7. Rendi sintaksor

3.7.1 Rendi sintaksor në strukturën e fjalisë

Rendi është i kudondodhur në sintaksë, përndryshe në gjuhë e në ligjërimin e përditshëm, të folur e të shkruar. Jashtë kësaj vëmendjeje, nuk mund të generohen fjali gramatikore e semantike nga një emetues tek një destinator. Për shembull, fjalët: ***lexoj, i ri, po, roman, Çela, shkrimtar, të, Zija;*** mund të generohen në fjali sipas një rendi të caktuar, sipas qëllimit të thënies; kështu do të kemi:

a. rendin asnjanës:

[192] Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f.122.

Po lexoj me një frymë romanin e ri të shkrimtarit Zija Çela.



b. rendin emfatik

Romanin e ri të shkrimtarit Zija Çela po lexoj me një frymë.

Me një frymë po lexoj romanin e ri të shkrimtarit Zija Çela.

Por do të kishim një ndërtim jogramatikor nëse nuk i përmbahemi rendit të fjalëve në shqip:
* Të shkrimtarit Zija Çela po lexoj romanin e ri.
Simbolet që janë shënuar poshtë fjalëve të grupuara sipas gjymtyrëzimit paraqesin mënyrën se si në traditën tonë gramatikore-sintaksore, prej disa dhjetëvjeçarësh, është shënuar rendi.
Përkatësisht:
S - subjekti kryefjalë
P - predikati, kallëzues me llojet e tij
O - objekti, kundrinori, me llojet e tij: O1...O2 (i zhdrejtë e me parafjalë)
C – c(k)omplementi, rrethanorët
A - atributi, cilësori, përcaktorët me llojet e tyre.
Le të shohim edhe rastin:
Shqiptarët kanë një histori të lashtë në Ballkan.



Ekzistojnë mënyra të ndryshme të kombinimit të fjalëve në fjali, por jo të gjitha janë ndërtime apo kombinime gramatikore. Përdoruesit e gjuhës, ndër të tjera, janë në gjendje ta bëjnë dallimin mes ndërtimeve gramatikore e atyre jogramatikore nisur edhe nga rendi i fjalëve në fjali. Meqë sintaksa studion ndërtimin e fjalive, ajo studion edhe rendin e gjymtyrëve në fjali. Rendi i fjalëve është një mjet për të shprehur lidhjet sintaksore e si i tillë është objekt studimi i sintaksës. Bazuar në këtë njësi sintaksore gjuhët ndahen në gjuhë me rend të lirë të fjalëve dhe në gjuhë me rend të ngulitur. Nëse i referohemi shqipes vërejmë se ndryshimi i rendit të gjymtyrëve brenda fjalisë nuk ndikon shumë në gramatikalitetin e tyre, kjo për faktin që janë mjetet morfologjike që lejojnë dallimin e funksioneve të fjalëve, ndryshe nga gjuhë të tjera në të cilat rendi është i ngulitur. Shqipja është një gjuhë me sistem të pasur rasor dhe për të shenjuar lidhjet sintaksore përveç mbaresave rasore përdoren edhe parafjalët. Kjo e bën më të lirë rendin në fjali në gjuhën

shqipe ndryshe nga rastet kur mungojnë mjetet gramatikore për të përcaktuar gjymtyrët, rendi i këtyre të fundit bëhet i ngulitur.[193] Të krahasohen:

(149) a. John saw the dog.
Xhoni pa qenin.
b. The dog saw John
Qeni pa Xhonin
me
c. Vajza e pa macen.
d. Macen e pa vajza.

Çdo vendosje konkrete e gjymtyrëve në fjali kushtëzohet nga rëndësia që ato kanë në atë fjali, nga pesha e tyre kumtuese dhe shprehëse emocionale.[194] Rendi lidhet me theksin logjik dhe kjo mund të krijojë forma të ndryshme të ndërtimeve të fjalive në të folur e në të shkruar. Në gjuhën e folur një peshë të rëndësishme luan intonacioni i cili sqaron më qartë se ku bie theksi, ndërsa në të shkruar kjo nuk mund të pasqyrohet fort qartë. Rrethanat semantiko-sintaktike përcaktojnë më mirë ku bie theksi, ndërsa në gjuhët e shkruara dallohet një prirje për të pasur një rend të ngulitur dhe mbi bazën e ruajtjes ose prishjes së këtij rendi përcaktohet edhe gjymtyra, fjala apo pjesa e fjalisë mbi të cilën bie theksi. Megjithatë, pavarësisht se disa gjuhë klasifikohen si gjuhë me rend të lirë sintaksor, është vërejtur që ka një prirje për të pasur një pozicion të preferuar të gjymtyrëve në fjali. Kështu 75% e gjuhëve të botës përdorin rendin: SE_{Kr} F SE_{Kn} ose SE_{Kr} SE_{Kn} F, 10- 15% përdorin rendin F SE_{Kr} SE_{Kn}*. Ndërkohë që ndër gjashtë mundësitë logjike të renditjes së gjymtyrëve më kryesore të fjalisë renditen edhe F SE_{Kn} SE_{Kr}, SE_{Kn} SE_{Kr} F, SE_{Kn} F SE_{Kr}.[195]
Le të marrim në shqyrtim fjalinë:

(150) Mark-Alemi shpejtoi hapat. (I. Kadare, Pallati i ëndrrave, f.22)

Rendi në këtë rast është SE_{Kr} F SE_{Kn}.
Nëse do provonim ta ndryshonim rendin do kishim:

(151) a. Mark-Alemi hapat shpejtoi. sipas SE_{Kr} SE_{Kn} F
b. Shpejtoi Mark-Alemi hapat. sipas F SE_{Kr} SE_{Kn}

[193] Çabej, E. (2008). *Hyrje në indoeuropianistikë- leksionet e Prishtinës*" botime Çabej, f. 223.
"*Lidhur me topikën e fjalëve në fjali, me vendin që zenë fjalët e ndryshme, pjesët e fjalisë brenda fjalisë, aty mbretëron ky parim: Sa më e pasur është një gjuhë në sistemin e flekcionit, aq më e lirë është topika. Topika bëhet më e shtrëngueshme, më obligatore, më e ngulët, sa më shumë varfërohet flekcioni*" .
[194] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II,* Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 413.
* Ku F është për folje kallëzues, SE_{Kr} është për sintagmën emërore kryefjalë dhe SE_{Kn} është për sintagmën emërore kundrinor në vend të simboleve të përdorura zakonisht S-subjekt, P-predikat, O-objekt
[195]Mita, J. (2008). *Rendi i fjalëve dhe struktura e fjalive kohore*, Faik Konica, Prishtinë, f. 9.

c. Shpejtoi hapat Mark-Alemi. sipas F SE_{Kn} SE_{Kr}
d. Hapat Mark-Alemi shpejtoi. sipas SE_{Kn} SE_{Kr} F
e. Hapat shpejtoi Mark-Alemi. sipas SE_{Kn} F SE_{Kr}

Ndërtime të tilla nuk janë gjithmonë të pëlqyera për një përdorues të shqipes, por ai është në gjendje të kuptojë mirë në secilin prej ndërtimeve se kush është subjekti apo kryefjala, kush është objekti apo kundrinori dhe cili është veprimi i emërtuar nga folja kallëzues e kjo ndodh për shkak të fleksionit i cili shfaqet në mënyrë të pasur në gjuhën shqipe duke i dhënë mundësinë folësit apo lexuesit të kuptojë se kush është kryefjala, meqenëse ajo është gjithmonë në rasën emërore pa parafjalë, kush është kundrina e drejtë meqenëse ajo është gjithmonë në rasën kallëzore pa parafjalë.
Gjuhësia strukturaliste njeh dy lloje rendesh: rendin e gjymtyrëve të fjalisë dhe rendin e pjesëve të thënies (të temës e të remës).[196] Gjymtyrëzimi aktual dallon *temën* nga *rema*. Zakonisht kumtimi fillon me të njohurën për dëgjuesin (tema) për të kaluar më pas te informacioni i panjohur ose i ri (rema). Në fakt tema dhe rema janë të njohura të dyja për folësin, por për dëgjuesin rema përbën thelbin e asaj që po kumtohet. Rema përmban qendrën kumtesore të fjalisë për faktin se ajo përmban synimin e kuptimit.
Lidhur me rendin e gjymtyrëve në fjali mund të thuhet se dallojmë:
1.a) *rendin e drejtë* ($SE_{kryefjalë}$ + $F_{kallëzues}$, $F_{kallëzues}$ + $SE_{kundrinë}$, $F_{kallëzues}$ + $SE/SP/SNd_{rrethanor}$)
1.b) *rendi i anasjelltë* ($F_{kallëzues}$ + $SE_{kryefjalë}$, etj);
2.a) *rendin neutral*, (temë + remë) dhe
2.b) *rendin emfatik afektiv* (remë + temë). (Gramatika II, 2002, 414).
Në renditjen 1 (a dhe b) rendi është dhënë sipas analizës funksionale sintaksore, ndërsa në 1 (a dhe b) kriteri i klasifikimit është ai i gjymtyrëzimit aktual të fjalisë.
Në fjalitë njëkryegjymtyrëshe nuk mund të flasim për topikë apo rend meqenëse ato përmbajnë vetëm remën si në rastet: *Vetëtin. Bubullin*. Po në lidhje me gjymtyrët e dyta në këto fjali mund të flasim për rend të drejtë apo të anasjelltë. p.sh. *Ruajta qetësinë. Mendimin ia thashë.*
Nëse do i kthehemi fjalive (151) do vërenim që ndryshimi i rendit të gjymtyrëve nga (150) ka sjellë theksimin e remës. Në (151.a) theksohet veprimi ndërsa në (151.e) theksohet kundrina. Megjithatë ka raste kur ruhet rendi i preferuar i shqipes, pra SE_{Kr}+F, e megjithatë kemi rend emfatik, i cili përkon me theksin logjik që bie mbi kryefjalën. Në këto raste është kryefjala që përbën remën në fjali.

(152) ***Të gjithë*** *punonin*.

[196] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë) - një vështrim i ri teorik*, Ilar, Tiranë, f.271.

Do të quajmë *të shenjuara nga këndvështrimi sintaksor* ato fjali në të cilat gjymtyrët e tyre nuk ruajnë vendet e preferuara apo rendin e drejtë, por kanë lëvizur në mënyrë të tillë që të shprehin diçka më shumë nga përmbajtja e tyre p.sh:

(153) a. Mësuesi sqaroi nxënësin.
b. Nxënësin e sqaroi **mësuesi**.
c. **Nxënësin**, e sqaroi mësuesi.

Të gjitha fjalitë më sipër kanë të njëjtin gjymtyrëzim dhe paraqesin pothuajse variante të së njëjtës fjali, por përmes: *lëvizjeve nga pozicionet e preferuara*, *intonacionit emfatik* apo *pauzave* paraqesin kumtime të ndryshme të veshura me shpjegime të tipit gjuhësor apo jogjuhësor. Shenjimi jogjuhësor, i quajtur ndryshe *shenjim pragmatik*, dallohet nga shenjimi gjuhësor për faktin se ky i fundit është i dukshëm, si në rastet e spostimit të SE_{Kn} (nxënësin), por ka raste të tjera kur një fjali është e pashenjuar në aspektin sintaksor e megjithatë në të gjejmë vlera të shenjimit pragmatik. Kjo mund të ndodhë atëherë kur intonacioni, pa lëvizur asnjë prej gjymtyrëve nga pozicioni i tyre i preferuar, shenjon në mënyrë pragmatike një nga gjymtyrët, si në rastin e cituar te (152). Prandaj shenjimi pragmatik nuk është në vetvete i njëjtë me shenjimin sintaksor. Kjo mund të dallohet në fjalinë (153.a) ku, nëse do bënim një pushim pas $SE_{Kr,}$ nuk do kuptohej qartë nëse dallimi apo shenjimi do vinte për arsye fonetike apo sintaksore siç do të ndodhte në rastin e 153.b. Për këtë arsye do të quajmë *të shenjuar pragmatikisht* atë fjali prej së cilës mund të nxirren informacione të veçanta në kontekstin gjuhësor apo jashtëgjuhësor, ose për të cilën nevojitet një kontekst gjuhësor i caktuar që të përdoret e interpretohet në mënyrë të saktë. Me *kontekst gjuhësor* kemi parasysh rastet e përdorimit më përpara të elementeve të fjalisë, ndërsa me *kontekst jogjuhësor* kemi parasysh njohjet e mëparshme të folësit apo dëgjuesit të cilat mund të përfshihen në të folur si temë apo të rimerren si temë e përdorur më parë në diskutim.

Mjetet prozodike që mund të përdoren për të dhënë konotacione të ndryshme pragmatike janë të ndryshme (të karakterit *emfatik* që ka parasysh karakteristika fonetike – akustike si theksi, pushimet, intonacioni), por është e rëndësishme që të dallohen mes tyre. Mjafton të kuptojmë që shpesh pauzat nuk përkojnë me kufijtë sintaksorë e si të tilla ato nuk përputhen me analizën sintaksore të fjalisë.

Në "*Rendi i fjalëve dhe struktura e fjalive kohore*" studiuesi Josif Mita bën një përmbledhje të trajtimit të rendit të fjalëve sipas disa studiuesve dhe disa shkollave. Fillimisht Mita përmend *shkollën logjike* të Por Ruajalit me vlerësimet universale që *ka një lidhje të ngushtë ndërmjet kategorive të mendimit (logjike) dhe kategorive të gjuhës*, dhe *pavarësisht nga shumë ndryshime sipërfaqësore të gjitha gjuhët e botës shprehin të njëjtat kategori të mendimit.* Kjo shkollë pranon se nga pikëpamja logjike ekziston vetëm një rend normal, universal, i fjalëve në fjali: *subjekt, predikat*, por nuk përjashtohen shumë shmangie nga ky rregull. Gjithashtu përmend *shkollën psikologjike* të G. Gabelencit dhe

G. Shtajntalit nga të cilët sjell pohimin se *çdo gjymtyrë që qëndron para foljes kallëzues shfaqet si subjekt psikologjik*. Për Sh. Bato thotë se dallonte dy tipa të rendit: *gramatikor* (shkencor), ku fjala e drejtuar vjen pas drejtueses dhe rendin *oratorik* (e zemrës), ku ndërtimet shfaqen me inversion prirur nga interesi i folësit. K. Bekker dallon dy forma: *gramatikore* dhe *logjike.* Atij i njihet merita se përveç inversionit liston ndër mjetet e gjymtyrimit aktual edhe theksin logjik i cili nuk është i kufizuar nga format gramatikore. Beazée i klasifikon gjuhët në *analoge* (rendi i fjalëve përputhet me rendin e ideve) dhe *traspozitive* (nuk ka përputhje të rendit të fjalëve me rendin e ideve). Ky i fundit kritikohet nga A. Wejli që pohon se *formimi i sintaksës nuk është i njëjtë me formimin e ideve dhe rendi i fjalëve shërben për të shprehur qoftë rendin e ideve, qoftë rendin sintaksor*. Weil niset nga koncepti që kryefjala shënon atë për të cilën flitet në fjali kurse kallëzuesi bën të njohur diçka për kryefjalën. Pasuesi i A. Wejlit, V. Mathesius, i cili thelloi idetë për gjymtyrimin aktual të fjalisë dhe i njihet merita për paraqitjen e dy termave *temë* e *remë*[197], dallon rendin *e zakonshëm, objektiv* të fjalëve (nga e njohura te e panjohura) dhe *rendin emocional, subjektiv* (nga e panjohura). L.Tesnière që beson se sintaksa ekziston vetëm në bazë të lidhjes që është një fakt hierarkik, thotë që ka dy tipa të rendit në vijë të drejtë: *zbritës* (centrifugal) ose *ngjitës* (centripetal). Në të parin elementi që drejton i paraprin elementit të varur, ndërsa në të dytin elementi që drejton e ndjek elementin e varur.[198]

3.7.2. Rendi i përbërësve të fjalisë

Në fjalitë me ndërtim SE_{Kr} + F + SE_{Kn} këndvështrimi pragmatik, sintaksor dhe fonologjik përputhen[199]. Fjalisë mund t'i mungojë kryefjala pa prishur asnjë ekuilibër në të tre nivelet. Rastet kur kjo kryefjalë mungon janë kur ajo mund të kuptohet nga konteksti, ndërsa kryefjala normalisht nuk shprehet në fjali njëkryegjymtyrëshe vetore me vetë të papërcaktuar dhe vetë të përgjithësuar si dhe në fjalitë pavetore (që tregojnë fenomene natyrore). Duke përjashtuar rastet e sipërcituara si normale, nëse kryefjala nuk është shprehur kemi të bëjmë me fjali të shenjuara pragmatikisht, por jo sintaksorikisht, meqë folja, në këtë rast kalimtare, mund të qëndrojë pa kryefjalë:

(154) a. Luajnë nesër.
b. Nuk fliste asnjë fjalë.

---

[197] Topalli, T. (2011). Gramatikë e gjuhës shqipe- Sintaksa e fjalisë, Shkodër, f. 631.
[198] Mita, J. (2008). *Rendi i fjalëve dhe struktura e fjalive kohore*, Prishtinë, f. 17- 23.
[199] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II,* IGJL, Tiranë, f.146.
"Rendi kallëzues-kryefjalë është rend i anasjelltë, por neutral kur fjalia nuk ka temë, pra të dyja kryegjymtyrët përbëjnë remën. Kjo ndodh sidomos kur kallëzuesi është shprehur me folje që shënojnë në mënyrë të përgjithshme të ndodhur, të shfaqur, të paraqitur, etj, dhe është në trajtë joveprore ose jokalimtare, si foljet dukem, shfaqem, dal, dëgjohem, ndihem, (më) kujtohet, etj. Midis gjymtyrëve kryesore nuk bëhet pauzë, ato ndodhen në të njëjtën sintagmë. (...) Ky rend është neutral edhe kur kallëzuesi përbën temën e kryefjala remën.".

Nëse vërejmë fjalitë (155) do kuptojmë që fjalitë kryefjalore në periudha kanë prirjen të vendosen pas F e në këto raste nuk kemi të bëjmë me shenjim sintaksor, por pragmatik.

(155) a. Dihet se durimi është bimë e hidhur, por frutin e ka të ëmbël.
b. Kuptohej që rezultatet do të dilnin të nesërmen.

Po kështu kemi të bëjmë me raste të pashenjuara kur flasim për kryefjalën e zhvendosur në fund të fjalisë që ka një kallëzues emëror. Kjo për faktin se kryefjala përbën remën.

(156) Mbi tavolinë është darka jote. E jotja është edhe **dhurata**.

Po kështu edhe fjalitë me foljet jokalimtare nëse kanë rendin SR_{Kr} + F+ Plotës (rrethanor) kanë rend të pashenjuar:

(157) a. Fëmijët lahen në det.
b. Të vërtetat thuheshin nën zë.
c. Ëndrrat fikeshin ngadalë.

Lëvizja e kundrinorit nga pozicioni i tij në 6.b do të sillte një shenjim të tij. Kjo lëvizje do të kërkohej në rastet kur folja përbën fokusin si p.sh:

(158) a. Nxënësit shumë libra nuk i kanë dorëzuar.
b. Doreta pushimet do t'i bëjë patjetër.

Ka një faktor që e bën pragmatike lëvizjen e kundrinës dhe F në fjalitë e mësipërme, është pesha e një konstituenti në informacionin e fjalisë. Kështu mohimi në (158.a) dhe ndajfolja që përforcon kuptimin e foljes në (158.c) bëjnë që kjo F të spostohet në fund të fjalisë. Një konstituent me peshë ka tendencë të spostohet në fund të fjalisë për arsye ritmike dhe për faktin që fundi i fjalisë është pikërisht vendi ku vendoset informacioni më i rëndësishëm[200] ndërkohë që zakonisht një përbërës me peshë është zakonisht përbërës i pasur me informacion.
A kemi të bëjmë me fjali pragmatikisht të pashenjuara kur kundrinori i zhdrejtë me parafjalë paraprin kundrinorin e drejtë? Le të shohim fjalitë në (159).

(159) a. Soba kishte mbushur *me avull* dhomën.
b. Vajza kishte endur *me shoqet* me punë mbushje flamurin.
c. Vajza *me shoqet* kishte endur me punë mbushje flamurin.

[200] Salvi, G. (1988). in Renzi, L. & Salvi. G .& Cardinaletti, A. (1988). *Grande grammatica italiana di consultazione*, f.135.

Në fjalinë (159.a) nuk mund të flasim për shenjim pragmatik, gramatikor apo fonologjik edhe pse rendi nuk i përgjigjet asnjërit nga kriteret e vendosura për të përcaktuar rendin neutral. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë nuk pëson as rënien e theksit logjik, as ndonjë pushim intonacionor para saj. Gjithashtu nuk është zhvendosur në fund të fjalisë për të pasqyruar informacion me peshë, kjo është arsyeja që mund ta shohim si rend neutral. Nga ana tjetër, duket se ka njëfarë pushimi pas kundrinës së zhdrejtë te (159.b) dhe ky fakt tregon që kemi lëvizje të kundrinës jashtë rendit të zakonshëm, ndërsa në rastin e (159.c) kemi të bëjmë me një rast ku kundrina e zhdrejtë me parafjalë përbën të njohurën dhe duhet të qëndrojë në krye të fjalisë. Në *Gramatikën e shqipes II* (ASHSH, 2002, f.418), stili neutral i njihet kundrinës së zhdrejtë vetëm në raport me kallëzuesin e më pas shtohet kriteri tjetër distribucional *zakonisht në fund të fjalisë* (po aty). Në rastin e (159.c) përveç kriterit të të njohurës (temës) parashtrohet edhe kërkesa që kundrinori i zhdrejtë të mos jetë i theksuar. Si përfundim mund të flasim për stil neutral në (159.a) dhe (159.c) edhe pse nuk plotësohen kushtet për përcaktimin e këtij rendi sipas gramatikës së shqipes. Ndërkohë kuptojmë se plotësorët (SE_{Kd} dhe SE_{Kzh}) në një fjali të pashenjuar ndjekin gjithmonë F qoftë kjo kalimtare apo jokalimtare e nëse kemi praninë e një SE_{Kd} ai preferohet t'u paraprijë plotësorëve të tjerë që rendi të jetë neutral. Rastet që bëjnë përjashtime shenjojnë pragmatikisht ose gramatikisht fjalinë.

3.7.3. Rendi sintaksor në strukturën e frazës

Edhe në frazë rendi merr të njëjtën rëndësi si në fjali, por studimi i tij na vë përpara disa vështirësive nisur prej këndvështrimeve të ndryshme studimore. Vështirësia e parë që hasim lidhet me përcaktimin e njësisë së punës në analizën e rendit. Në gramatikën gjenerative njësia e punës është sintagma, por në historinë e gramatikës së shqipes, madje edhe në Gramatikën e Akademisë së Shkencave nuk është kjo njësia me të cilën operohet. *Në gjuhësinë teorike është pranuar fakti që njësia më e madhe e analizës gramatikore mbi bazën e së cilës përshkruhen marrëdhëniet distributive të përzgjedhjes dhe të përjashtimit është fjalia*.[201] Njëkohësisht fjalia është edhe njësia më e vogël kumtuese që del zakonisht me një bërthamë kallëzuesore që mund të bashkohet me fjali të tjera në raporte e mjete të ndryshme, për të formuar një njësi zakonisht më të madhe, *periudhën*.[202] Pa i hyrë në këtë syth një analize historike të trajtimit të çështjes të cilën e kemi bërë në segmentin hyrës të trajtimit të frazës, na duhet të thellohemi kryesisht në marrëdhëniet që vendosen mes përbërësve të frazës (periudhës) qofshin këto të emërtuara tradicionalisht si pjesë fjalie, sifjali, fjali, apo në këndvështrimin gjenerativist të para si fraza argumentore apo shtesore.

[201] Topalli, T. (2011). *Gramatikë e gjuhës shqipe- Sintaksa e fjalisë*, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Instituti i Studimeve Albanologjike, Shkodër, f. 603.
[202] ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 60.

Analiza e përbërësve në frazë është e ngjashme me atë të të fjalisë vetëm se këtu marrëdhëniet shtrihen ndërmjet njësish më të mëdha organizative të cilat edhe ato vetë sillen si struktura fjalish. Pra kemi të bëjmë me një lidhje marrëdhëniore e cila vendos ndërmjet përbërësve të frazës pothuajse të njëjtat marrëdhënie logjike që pamë ndërmjet përbërësve të fjalisë, por duke pasur disa kushte më specifike që përcaktojnë rendin e përbërësve. Kjo nënkupton që edhe rendi i fjalive të frazës varet nga të njëjtat kritere logjike, por tashmë duhet zgjeruar këndvështrimi në disa mjete të cilat e kushtëzojnë këtë rend. Kështu në nivel periudhe flasim për *marrëdhënie bashkërenditjeje* e *nënrenditjeje* në nivel kryesor klasifikimi të marrëdhënieve mes përbërësve më të mëdhenj. Nënklasifikimi i tyre bazuar në mjetet lidhëse do ishte: *me mjete lidhëzore* e *pa mjete lidhëzore*. Bazuar në këndvështrimin gjenerativist, marrëdhëniet që kanë me fjalinë drejtuese i ndajnë në fjali *argumentore* dhe fjali *shtesore*.

Studiuesi Spiro Floqi (1976; 3) në studimin "Disa vrojtime për rendin e fjalive në periudhën" botuar në *Studime filologjike* përcakton si periudha me *rend të ngulur* të fjalive përbërëse periudhat me fjali *bashkërenditëse* dhe periudhat *asindetike*. Gjithashtu ai sheh me rend të ngulur postpozitiv edhe periudhat e nënrenditura: përcaktore (sepse kushtëzohen nga antecedenti), fjalitë e varura kryefjalore, fjalitë kallëzuesore lidhëzore, fjalitë rrjedhimore, fjalitë shkakore, dhe me rend të ngulur prepozitiv fjalitë e varura kallëzuesore me përëmrin lidhor ç, fjalia shkakore me shprehjet lidhëzore *duke qenë se, duke marrë parasysh se*, etj ndërsa tipet e tjera të përiudhave i sheh me rend të lirë të vendosjes së fjalisë së varur. Mbështetur në këto arsyetime të Floqit, në Gramatikën e ASHSH-së (2002, f.433), përcaktohen me rend të ngulitur ato fjali bashkërenditëse të cilat:

1) nëse ndryshojnë topikë mund të pësonin ndryshime në marrëdhëniet mes përbërësve. Këtu bëhet fjalë për fjalitë e bashkërenditura asindetike;

2) në fjalinë e dytë ka fjalë që përmendin fjalë të fjalisë së renditur përpara.

3) kur ndryshimi i rendit të fjalive do sillte prishjen e renditjes kohore të veprimeve (suksesioni kohor)[203]

4) kur në fjalinë e dytë ka tregues leksikor të pasimit si *pas pak*.

Rendi i fjalisë shihet i lidhur jo vetëm nga gjymtyrimi aktual i periudhës, por edhe me marrëdhëniet kuptimore mes fjalive të periudhës. Ka raste kur ai është i ngulur për të shprehur një marrëdhënie të caktuar kuptimore. Floqi sjell shembullin e fjalisë së varur që ka lidhëzën *që* e ndiqet nga një kallëzues në lidhore dhe që mund të marrë dy vlera të ndryshme kuptimore bazuar në rendin ndaj fjalisë drejtuese. Mund të sillet si *qëllimore* apo *rrjedhimore* respektivisht në rendin prepozitiv e postpozitiv. Gjithashtu sqarohet rasti i ndryshimit në nuancën e marrëdhënies së përgjithsme kur kemi të bëjmë me rendin e fjalisë së varur me lidhëzën shkakore *ngaqë*. Nëse kemi rend postpozitiv, fjalia e varur shpreh shkak, nëse kemi rend prepozitiv, fjalia e varur shpreh marrëdhënie shkak-qëllim[204]. Sa i takon topikës së fjalisë drejtuese jo rrallë ajo gjendet edhe në mes të fjalisë së varur dhe ky

[203] Floqi, S. (1976). Disa vrojtime për rendin e fjalive në periudhën, *Studime filologjike*, N3, f.113.
[204] Po aty, f.115 - 116.

fenomen grupohet në tipe periudhash të përbëra nga dy fjali dhe në tipe periudhash me së paku tri fjali. Këto raste kanë lidhje me ruajtjen e rendit të fjalëve të fjalisë së pavarur (grupi i parë), ose me pozicionin e mjetit lidhës që ka një pozicion të caktuar meqë mund të jetë përemër apo ndajfolje (grupi in dytë).

Një interpretim ndryshe i rendit lidhet me degëzimin e periudhës. Kështu për periudhën thuhet se është degëzuar djathtas (right-branching constuction[205]) në rastin kur fjalia e varur vihet pas drejtueses. Nëse fjalia e varur vendoset para drejtueses thuhet që periudha ka degëzim majtas (left-branching construction), ndërsa vendosja në mes quhet degëzim në mes (nested construction) atëherë kur fraza A dhe B formojnë një ndërtim të tillë ku A është tërësisht brenda B.

Degëzimi djathtas është më i natyrshëm sepse informacionit bazë që përmban fjalia drejtuese i shtohet një informacion i ri. Degëzimi majtas e bën marrësin të presë për informacionin e rëndësishëm, pra krijon njëfarë tensioni në tekst.[206]

3.8. Fjalitë eliptike

Në "Gramatikën e gjuhës shqipe 2" të ASHSH-së thuhet se fjalitë eliptike janë fjali të një tipi të veçantë, specifikë e të cilave është mungesa e kallëzuesit.[207] Në fjalitë eliptike kallëzuesi nuk shprehet jo sepse ai nxirret nga konteksti siç ndodh në fjalitë e paplota, por sepse nënkuptohet nga ndërtimi i kumtimit të fjalisë në tërësi e kjo ndodh në ato fjali të cilat përsëriten si të vërteta të përgjithshme, si përfundime të pranuara nga të gjithë. Kryesisht fjalitë eliptike përdoren në fjalët e urta.

Problemi i elipsës në gjuhësinë shqiptare trajtohet nga Stefan Prifti i cili pas një ekspozeje të mendimit të gjuhëtarëve të huaj lidhur me fenomenin dhe diskutimeve të mbështetjes së saj në aspektin sintaksor apo logjik sipas qëndrimeve të ndara të këtyre studiuesve, arrin në përfundimet se, përcaktuar nga arsye të ndryshme subjektive apo objektive, elipsa është një fenomen i natyrshëm. Duke analizuar konceptin e ekonomisë së mendimit ose të gjuhës, përkundër mendimeve të Th. Boreas, A. Martinet, J. Marouzeau dhe M. Cohen, të cilët mbrojnë idenë se *ekonomia e mendimit lidhet me prirjen për të patur rezultate të mëdha me përpjekje të vogla dhe lënien mënjanë të çdo gjëje që nuk është esenciale për mendimin*, Prifti mbron qëndrimin që ky fenomen përfshin gjithë kapacitetet dhe përbën aktivitetin më të lartë të mendjes dhe se ky fenomen nuk ndodh vetëm në rastet kur ndikohet e kuptohet nga konteksti në të cilën ndodh ligjërimi, për arsye emocionale apo volitive, por edhe në përdorime të pavetëdishme. Si përfundim, ai vendos ta shohë elipsën në pikëpamjen sintaksore dhe konstruktet në të cilat duhet të konsiderohet e paqenë duke dalë përtej kufizimit të mungesës së një gjymtyre, por duke pranuar që elipsa mund t'u përkasë

[205] Chomsky, N. (1965). *Aspects of the Theory of Syntax*, Cambrige, Mass. MIT Press, f.13.
[206] Mita, J. (2008). *Rendi i fjalëve dhe struktura e fjalive kohore*, Faik Konica, Prishtinë, f. 182.
[207] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2,* Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 406.

disa gjymtyrëve e ndonjëherë edhe fjalive.[208] Konkretisht, ai, pasi sqaron rastet kur nuk ka elipsë, shprehet se kemi elipsë të gjymtyrëve të fjalisë ku përfshihen rastet e elipsës së:

a. kryefjalës

1. kur kallëzuesi është në vetën e parë e të dytë, njëjës ose shumës të tipit:

Kur (unë) s'punova, u pendova. *ose*

(ti)U bane nanë, u bane gjamë.

2. kur kallëzuesi është në vetën e tretë:

Erdhi (mësuesi). Shpejt në vende.

Nëse në rastin e gjuhësisë tradicionale bëhet evidentimi i elipsës, përmes qasjes gjenerative mund të zbulohet marrëdhënia dhe hierarkia e lidhjeve që krijohen brenda këtyre strukturave kaq interesante të logjikës e ligjërimit. Kështu në rast i elipsës së kryefjalës me BPS (Bare Phrase Structure- pemën e strukturës x-bar) do të kishte këtë pamje:

(160) (Djali) Asht i shtëpis së mirë. (Migjeni, Vepra. f.208)

Skema 61.



b. kallëzuesit:

(161) Zemër e kulluar- zemër e gëzuar.

Mik i paftuar, sofër pashtruar.

Po pasqyrojmë me një tjetër BPS elipsën e kallëzuesit dhe kryefjalës:*

(162) (Djali) (është) tregtar i zoti. (Migjeni, Vepra. f.208)

[208] Prifti. S. (1966). Elipsa në sintaksën e shqipes, *Studime filologjike*, N3, f. 127.

* Ka një arsye përse nuk kemi ndjekur renditjen lineare të gjymtyrëve në këtë formulim. Kjo për faktin se në këndvështrimin e gjenerimit të përbërësve SEPT (respektivisht sintagma, ku në nivelin në të ulët folja-kallëzues merr tiparet e eptimit, është më lart se SE1 (kryefjala) e cila zë pozicionin e specifikuesit të SEPT.

Skema 62.



c. në kryefjalë e kallëzues njëkohësisht

(163) Si me të, si pa të, njëlloj.

Në gjymtyrët e dyta:

1. në përcaktorin kallëzuesor (plotësori kallëzuesor- sipas Priftit)

(164) Gjyshin e gjeti të plakur, gjyshen jo.

2. në përcaktor (cilësori) E hasim këtë elipsë kur kemi të bëjmë me një mbiemër prejfoljor i plotësuar nga një gjymtyrë e dytë sepse në rastet e tjera, cilësori brenda gjymtyrës së cilësuar ka tendencën të emërzohet dhe kalon në elipsën e gjymtyrës.

(165) I gjalli (njeriu i gjallë) me të gjallët, i vdekuri me të vdekurit.

Ndërsa: Verë (e ruajtur) në vozë druri, jo në plastikë.

3. elipsë në kundrinë:

(166) **a. K.D:** Ai mori (rrugën) për nga fushat.

b. KZh: I ra përmes (Parkut Qendror).

(167) **4. plotësorin e vepronjësit**, Ejani, u bë dreka (nga unë).

(168) **5. plotësorin e pjesës,** E ngatërroja me ndonjë vajzë tjetër (nga ato) që njihja.

(169) **6. plotësorin e pronës**, -Mos e ke ti lapsin tim? - Jo nuk e kam (lapsin tënd).

(170) **7. plotësorin e kohës**, -Mësim keni nesër? -Po, mësim kemi (nesër).

(171) **8. të vendit**, Kush i bën gropën tjetrit, bie vetë (në të).

(172) **9. të qëllimit**, -Do shkosh për peshk? -Jo, s'do shkoj (për peshk).

(173) **10. të mënyrës,** - U ndave mirë në provim? – Po, u ndava (mirë).

(174) **11. të mjetit,** - Ke udhëtuar me avion? – Po, kam udhëtuar (me avion).

(175) **12. të shoqërimit**, -Unë do shkoj me shoqet e mia, ti me (shoqet e) të

tuat.

(176) **13. të sasisë,** Ai foli shumë, por unë s'fola (shumë).

(177) **14. të kufizimit** -Ai s'është për këtë punë? –Po kush është (për këtë punë)? -Agimi është (për këtë punë).

(178) **15. të krahasimit**. Pula e botës është më e majme (se pula jote).

Ndërsa për elipsën ***në fjali*** autori e sheh atë në:

(179) **1. fjalinë e pavarur,** I bukur nuk qe. Përkundrazi (qe i shëmtuar).

(180) **2. në fjalinë kryesore,** Kur i jep, (i jep) si burrë, kur i kërkon, (i kërkon) si pulë.

(181) **3. në fjalinë kryefjalore**, Mos (ec ti) shpejt, se rrëzohesh.

(182) **4. në fjalinë kundrinore**, Unë ju dija (se ishit) trima, ju qenkeni lepuj.

(183) **5. në fjalinë ndajshtimore**, Ne (që jetojmë) këtej, i themi "furkulicë".

(184) **6. në fjalinë kufizore**, Ai është i zoti (të luftojë) edhe me pushkë edhe me penë.

(185) **7. në fjalinë kushtore** Fusha (po qe) pa zot, gjithkush e kullot.

(186) **8. në fjalinë apodozë**, Sa mirë (do të bëje), sikur të vije me mua.

(187) **9. në fjalinë kohore**, Ai ka shfaqur talent qysh (kur ishte) i vogël.

(188) **10. në fjalinë e mënyrës**, Këndonte (si të këndonte një) bilbil.

(189) **11. në fjalinë qëllimore**, U nis herët, të bëhemi gati (të nisemi) herët edhe ne.

(190) **12. në fjalinë rrjedhore**, Thërriste (sa dëgjohej) në kupë të qiellit.

(191) **13. në fjalinë krahasore**, Si (është) vendi (është) edhe kuvendi.

Ndërsa në elipsën ***në gjymtyrë të periudhës*** Stefan Prifti në studimin e tij dallon:

(192) **1. elipsën e fjalisë së pavarur** - Po a të don vllau ndopak? – e pvetë plaka.
- (Jo vetëm më do, por) Edhe fort- ia pret çika.

(193) **2. elipsa e fjalisë kryesore** - Po satanai nuk flinte, - (ai flinte) aq sa fle lumi.

(194) **3. elipsa e fjalisë kryefjalore** -Mos fol ashtu. Nuk të ka hije (të flasësh ashtu)

(195) **4. elipsa e fjalisë kundrinore** -E pimë nga një? - Dua (ta pimë), po s'më bën mirë.

(196) **5. elipsa e fjalisë ndajshtimore** Desh ta zgjaste bisedën, po s'ish koha (që ta zgjaste).

(197) **6. elipsa e fjalisë kushtore** Të mos e marrë vesh se na mbyti (nëse e merr vesh)

(198) **7. elipsa e fjalisë apodozë** Sikur të ishin të gjithë! (sa mirë do të qe).

(199) **8. elipsa e fjalisë qëllimore** Të dhamë dorën (që ti të ecje para) dhe ece para.

(200) **9. elipsa e fjalisë krahasore** Argjironë më mirë ta vrisnin shkëmbinjtë (sesa të binte robinjë).

Në fakt në gramatikën gjenerativiste elipsën e shohim si një nga fenomenet që lidhet me ekonominë gjuhësore. Ajo mund të përfshihet në provat që vërtetojnë se një vijimësi fjalësh

përbën një sintagmë. Kështu prirja jonë për të shmangur tepritë na shtyn që ndonjëherë të heqim një sintagmë e në këtë mënyrë përdorim elipsën *që jo vetëm nuk e gjymton kuptimin e përgjithshëm, por bën që thënia të jetë më lakonike dhe më e pëlqyeshme për bashkëbiseduesit*.[209]
Le të shqyrtojmë:
Elipsë në fjali:

(201) a. Një alternativë me dy ftyra, siç janë të gjitha alternativat. (…) Qashtu njeriu ia luejti lojen…kujt?... **Vetes! Vetes**! - bërtet morali prej mërgimit.[210]
b. Njerëzia kundër njerëzisë, domethanë lufta në vetvete, me një fjalë tjetër: revolucion![211]
c. Qetësia e kishës filloi të trazohet…kapela të kuqe e të zeza, petka të bardha e të kaltërta, çarapë të mëndafshtë e pambuku, fytyra me mustakë dhe pa mustakë, të qeshuna e të ngërdheshuna.[212]
d. – Politikë - jo![213]

Elipsë në periudhë:
(202) *Mbas këtyne fjalive mjaft, por jo krejt t'arsyeshme të shokut, unë shikojshe njeriun, kalin, karrocën, të gjithë të kryqëzuem në një gjendje mundimi e dhimbjeje të jashtëzakonshme dhe nuk dijshe se kush ka të drejtë: kali apo njeriu, unë apo shoku i em? Ndoshta dhe kali dhe njeriu dhe unë dhe shoku i em, ndoshta asnjeri*.[214]

Meqenëse flasim për elipsë atëherë kur folësi i një gjuhe priret për të shmangur tepritë dhe heq një sintagmë në ligjërimin e tij, përkufizimi ynë për sintagmën nuk përkon me përkufizimin e *Gramatikës së shqipes II* të ASHSH-së (2002) sepse në këtë të fundit flitet vetëm për mungesë kallëzuesi, por ne duke u mbështetur edhe në analizën e S. Priftit mund të vërejmë prirjen për të pasur edhe elipsë të gjymtyrëve të tjera. Kështu mund të flasim për elipsë të SE_1 e të SF p.sh:

(203) a. (Djali) Asht i shtëpis së mirë.
b. (Djali) (është) tregtar i zoti.[215]

Mund të kemi edhe elipsë të SE të kundrinës:

[209] Koleci, F. (2011). Rregulla sintaksore të bashkimit të fjalëve in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, f. 30.
[210] Migjeni, (1988). Sokrat i vuejtun – apo derr i kënaqun? në *Vepra*, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, f.109.
[211] Po aty, "*Ose...ose*", f. 113.
[212] Po aty, "*Në kishë*", f.143.
[213] Po aty, "*Programi i një reviste*", f.156.
[214] Po aty, "*Ngjarje pa lëvizje*" f. 146.
[215] Po aty, "Studenti në shtëpi", f. 208.

c. I shkoftë lypa mbarë (fëmijës)![216]

Skema 63.



Arrijmë në konkluzionin që elipsa është një fenomen që ndikohet nga prirja e folësve për të ekonomizuar gjuhën dhe që sjell ngjeshjen e mendimit, ngjyrimin e komunikimit dhe vënien në dukje në ligjërim të elementeve më të qenësishme për folësin. Ajo prek pothuajse të gjithë strukturat e fjalisë apo frazës duke mos u kufizuar vetëm në mungesën e kallëzuesit.

3.9. Fjalitë pyetëse

Fjalitë pyetëse janë fjali me anë të të cilave folësi pyet për dikë apo diçka që nuk e di apo për t'u siguruar lidhur me një fakt apo informacion. Ato mund të jenë pyetëse dialogjike dhe monologjike[217] bazuar në situatën e komunikimit ku përfshihet. Pyetjet mund të bëhen dy mënyrash:

a) drejtpërsëdrejti me fjali të pavarura të mëvetësishme, asindetike a të bashkërenditura ose me fjali kryesore dhe quhen ***pyetje të drejta*** apo

b) përmes fjalish kryefjalore, kundrinore a përcaktore të varura prej një fjale që shpreh kërkesë, apo informatë e në këtë rast quhen ***pyetje të zhdrejta***.

P.sh. Ç'bëhet andej? Nuk e di ti sa kushton injoranca?

Fjalitë pyetëse karakterizohen:

a) *nga intonacioni pyetës* i cili në çdo rast mbaron me një notë më të lartë dhe merr një rëndësi të veçantë atëherë kur fjalia nuk ka fjalë pyetëse;

[216] Po aty, "Qershiat", f.163.

[217] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, IGJL, Tiranë, f.136.

b) *përdorimi i fjalëve pyetëse* që mund të jenë përemra pyetës, ndajfolje pyetëse, të cilat zakonisht vihen në fillim të fjalisë, apo pjesëza pyetëse që mund të vihen në krye, në mes e në fund të fjalisë;
c) *topika e gjymtyrëve të fjalisë pyetëse*. Zakonisht gjymtyra për të cilën pyetet, qoftë e shprehur me fjalë pyetëse apo jo, ka prirjen të vihet në fillim të fjalisë.
Fjalitë pyetëse mund të jenë[218] ***të mirëfillta*** (kur janë dialogjike dhe kërkojnë medoemos një përgjigje) dhe ***jo të mirëfillta*** ku përfshihen fjalitë ***nxitëse – pyetëse*** (këto fjali nuk shërbejnë për të pyetur, por për të shprehur nxitje, për të shfaqur me forcë një pohim apo mohim- pyetjet retorike, për të shprehur një hipotezë) dhe pyetëset ***thirrmore***[219] (fjalia ka ngjyrim afektiv e i bashkëngjiten ndjenjat e folësit si habi, kënaqësi, mërzi etj)
Pyetjet mund të jenë ***tërësore*** (kur i referohen kallëzuesit bashkë me një pjesë të fjalisë) apo ***të pjesshme*** (kur pyetet për një element të thënies, autorin, objektin e një veprimi, tiparin e një sendi a karakterizimin e këtij tipari, rrethanat e një veprimi).
Pyetjet mund të jenë:
-informuese (kur pyetet për diçka që nuk e di folësi),
-vërtetuese (kur e do ta vërtetojë atë që di në mënyrë të pasigurtë përmes pohimit apo mohimit të bashkëbiseduesit),
-veçuese (shprehin dy anët e alternativës)
-deliberative[220] (kur folësi vë në pyetje çfarë duhet të bëjë sepse luhatet mes dy qëndrimesh, pohimesh a mohimesh.
Nëse krahasojmë klasifikimin e pasqyruar deri tani bazuar në gramatikën tradicionale vërejmë që paraqet larmi emërtimesh të cilat lidhen me aspekte semantike, sintaksore e intonacionore. Ndryshimi kryesor që bie në sy kur krahasohet me klasifikimin e sintaksës gjenerative është prirja e kësaj të fundit për të thjeshtuar këto klasifikime. Kështu në këndvështrimin e gramatikës gjenerative fjalitë pyetëse klasifikohen në pyetëse ***wh-*** dhe në pyetëset ***po-jo***.
Emërtimi i parë lidhet me nistoret e fjalëve pyetëse në anglisht (*who, where, when, what, why*). Prandaj themi se kemi të bëjmë me një fjali pyetëse ***wh-*** atëherë kur ajo përmban një element pyetës si *kush, kur, ku, çfarë* etj. Këto fjali ndërtohen nga lëvizja e elementit *wh* në fillim të fjalisë që emërtohet ***lëvizja wh***,[221] kurse fjalitë pyetëse *po-jo* përfshijnë fjalitë të cilat marrin si përgjigje ***po*** ose ***jo*** dhe në shqip mund të formohen si pyetëse ose me

[218] Po aty, f.136-147.
[219] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe – përbërësit sintaksorë (vështrim i ri teorik)*, Ilar, Tiranë, f. 282, emërtimi për to është ***pyetëse emocionale.***
[220] Po aty Çeliku (2012) i ndan këto lloj pyetësesh në ***pyetëse pohuese***: *Ç'të prisnim më? (Dalim tani)* dhe në ***pyetëse mohuese***: *(A ma jep mua?) Si ta jap ty?*, f.281 - 282
[221] Buxheli, L. (2007). *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, f. 140. e quan këtë lëvizje me termin ***lëvizja A*** dhe sqaron që *SE kush, cili, kë, çfarë ndodhen në pozicionin A-bar duke u zhvendosur nga një pozicion fillestar [+Rasë, +Rol semantik] në një pozicion më lart, që karakterizohet [-Rasë, -Rol semantik]. Në këto raste, zhvendosja e përemrave pyetës në krye, në mënyrë lineare para foljes shoqërohet me një gjurmë në pozicionin e kryefjalës apo kundrinës të cilët janë pozicione [+Rasë, +Rol semantik].*

pjesëzën pyetëse **a**, ose vetëm përmes intonacionit.[222] Kështu do të kishim pyetëse *wh* në rastet:

(204) a. Kë ftoi Mira?
b. Ku ka qenë Mira?

dhe pyetëse *po- jo* në fjalitë:

(205) a. Ju jeni Mark-Alemi?
b. A more përgjigje?

Sintagmat që përmbajnë element pyetës quhen sintagma w*h*. Ato mbushin vendin e specifikuesit të lidhëzës[223]. Struktura e sintagmave *wh* për gjuhën shqipe është[224]:

Skema 64.



[222] Turano, G. (2011). Fjalia pyetëse in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes,* SHBLU, Tiranë, f. 91.
[223] Mita, J. (2017). *Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe,* SHB "Faik Konica", Prishtinë, f.141.
[224] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f.150.

Ato mund të kryejnë funksionin e argumentëve të foljes kur kanë një përemër pyetës në përbërjen e tyre dhe nëse janë rrethanore, sillen si shtesore. Siç e thamë edhe më parë fjalitë pyetëse *wh* dallohen për faktin se përemrat pyetës vendosen në krye të fjalisë ndërsa kryefjala që zë pikërisht pozicionin nistor, spostohet në fund të fjalisë. Po cili është pozicioni që zënë në strukturën e fjalisë sintagmat *wh*? Le të shohim një rast. Në fjalinë 1.b elementi pyetës *kë* është element argumentor. Ai gjenerohet brenda sintagmës foljore duke marrë aty rolin tematik dhe rasën. Kështu do kishim:

(206) Mira ftoi kë?

Një ndërtim i tillë është gramatikor për shqipen, por nuk është i zakonshëm. Në këtë rast do kishim ato lloj pyetjesh në të cilat folësi e njeh që më parë përgjigjen.[225] *Kë* në këtë rast ka rolin e kundrinorit për foljen *ftoi*.

Të gjitha fjalitë pyetëse kërkojnë që elementi pyetës *wh* të zhvendoset nga pozicioni fillestar drejt periferisë së majtë të fjalisë. Meqenëse pozicioni L^0 në fjalitë pyetëse mbart tipare *wh*, elementet *wh* zhvendosen drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës komplementuese[226] (lidhëzore) SL. Ngaqë SL përfaqëson periferinë e skajshme të fjalisë, edhe elementet pyetëse dalin në krye të saj.

Skema e mëposhtme paraqet propozimin e strukturës së SC* ideuar nga Rizzi[227] strukturë kjo e quajtur *Force-Finitennes* që përfshin në ndërtimin e saj përveç komplementit edhe elementet *topic* (të njohurën) dhe *focus* (të panjohurën) që mund të përmbajë një mesazh. Pozicioni më i lartë i kësaj strukture shërben për të përcaktuar llojin e fjalisë e në kokën e saj $Force^0$ gjenerohen komplementuesit, në STop pasqyrohet informacioni i topikalizuar pra i thënë që më parë, në poicionin SFoc që shpreh të panjohurën vendosen elementet e fokalizuara. Në nyjen SFin renditen formantë që u përgjigjen ndërtimeve të tilla si ato angl. *to see*, ital. *di vedere,* frëngj. *de voir* dhe shqip paskajorja gege *me pa*. Ndërsa nyja e fleksionit (Eptimit) zë pozicionin më të ulët në këtë sistem. Meqenëse në fjalitë pyetëse kategoritë *topic* dhe *fokus* dalin shpesh, atëherë ky sistem ndihmon në analizën e sintagmës komplementuese të këtyre fjalive[228]. Vendi që zënë elementet *wh* në këtë strukturë është ai i specifikuesit të sintagmës SFoc.

---

[225] Turano, G (2011). në Koleci, F. Turano, G. (2011) *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes,* SHBLSH Tiranë, i emërton *pyetëse të llojit eko*.

[226] Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLSH, Tiranë, f. 154. shprehet se:
"*Në teorinë x-bar lidhëza në periudhat me nënrenditje quhet komplementues (complementizer) dhe ne do ta japim me simbolin K. Koka K^0 projektohet në specifikuesin (që edhe mund të mungojë) dhe në K'. Kjo, nga ana e vet, zbërthehet në kokën funksionale K^0 dhe në sintagmën eptimore SEPT, d.m.th. në një fjali të pavarur*."

* Sqarojmë se meqë arsyetimet në këtë pjesë mbështeten në analizën e bërë nga Turano, Sintagma Lidhëzore do të zëvendësohet me termin që përdor autorja SC për Complementizer Phrase.

[227] Rizzi, I. (1977). *The Fine Structure of the Left Periphery*. In: Haegeman, L., Ed., *Elements of Grammar*, Kluwer Academic Publishers, Amsterdam, f. 281-337.

[228] Koleci, F. & Turano. G, (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes,* SHBLSH, Tiranë, f.94-98.

Skema 65.



Këtë na e vërteton fakti që këto sintagma mund të paraprihen nga elemente të topikalizuar si në rastet:

(207) a. Mira, ku punon?
b. Beni, çfarë bëri?
c. Nxënësit, ku shkuan?
d. Letrën, kur e dërguan?

Ndërsa ndërtime me fokus do kishim:

(208) a. Letrën dërgoi Drini. (jo pakon).
b. Revistën lexoi Mira. (jo librin)
c. Qytetin pamë të parin. (jo fshatin)
d. Degët mblodhi plaku. (jo frutat)

Edhe në strukturat e fjalive pyetëse *po-jo*, Turano vëren se rendi i fjalëve është i ndryshëm nga ai i fjalive dëftore përkatëse. Pjesëza ***a*** që është tipike për këto lloj ndërtimesh meqenëse, nuk ka fleksion, ka statusin e një operatori modal pyetës . Ajo nuk është në gjendje të mbajë asnjë rol tematik e për këtë arsye nuk bën asnjë zhvendosje. Turano përcakon si pozicion të saj pozicionin kokë Foc^0 meqenëse ajo mund të paraprihet nga një element i topikalizuar e të dalë në fjali në të cilat të paraprihet nga një tjetër komplementues.

(209) a. A ka motra Lindita?[229]
b. Po Lindita a ka motra?

[229] Po aty, f. 105 -106.

Skema 66. (209.a)



Skema 67. (209.b)



Paraqitja në pemë e dy shembujve të strukturave të pyetëseve *wh*:

(210) Çfarë vendi beson se merrte në konkurs?

Skema 68.



(211) Kush mendon se e ka fituar ndeshjen?

Skema 69.



3.10. Fjalitë e mohimit në shqip

Një nga dukuritë universale të gjuhëve është mohimi. Përmes tij *mohohet përmbajtja e gjithë fjalisë, ose një element i saj, qenia e një fakti, shprehet dëshira a kërkesa për të mos u bërë diçka, për t'u parandaluar një veprim, gjendje, pyetet për vërtetësinë e mosqenies së diçkaje.*[230]

(212) a. Ajo s'ka të bëjë fare me shpjegimin që u bën ëndrrave populli. (I.Kadare, Pallati…f.73)

[230] ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f.154.

b. Nuk kemi bukë të tepërt. (B. Blushi, Të jetosh në ishull, f.37)
c. Ujët e sternës nuk shkumonte. (I. Kadare, Kronikë...f.55)

Hulumtimet për mohimin në gjuhën shqipe, bërë nga profesor Xheladin Gosturani janë në rrafshin e një monografie serioze. Në to evidentohet se mohimi në shqip realizohet përmes mjeteve gramatikore që janë pjesëzat e mohimit ***nuk, s', mos, as, jo, pa, ja*** të cilat qëndrojnë përgjithësisht para foljes, por nuk përjashtohet mundësia që mohimi të bjerë mbi gjymtyrë të tjera të fjalisë. Nisur nga ky kriter i mohimit kemi të bëjmë me *mohim të përgjithshëm* nëse mohohet folja-kallëzues, dhe kemi të bëjmë me *mohim të pjesshëm,* nëse mohohet një gjymtyrë tjetër e fjalisë. Mbi bazën e mjeteve të shprehjes në këto dy ndarje, bëhen nëndarje të tjera në *mohim të përgjithshëm të thjeshtë* dhe *të përbërë* si dhe *mohim të pjesshëm të thjeshtë* e *të përbërë*. Në mohimin e përbërë vërehet *mohimi i dyfishtë, i shumëfishtë, i përforcuar* dhe *intensiv*.[231]
Nëse shqyrtojmë disa prej pjesëzave mohuese vërejmë se pjesëzat mohuese ***nuk*** e ***s'*** janë pjesëzat që përdoren më dendur për shprehjen e mohimit dhe kanë një topikë të ngulitur para foljes. Ato mund të këmbehen me njëra – tjetrën por mund të thuhet se kanë përdorim të ndryshëm nga njëra-tjetra bazuar në situatat ligjërimore dhe stilet.

(213) a. Nuk rishtypi butonin me shenjën e gjelbër, por atë me të kuqen. (G.Banushi, Mëria e zanave, f.257)
b. Gati sa s'thirra nga gëzimi.
c. *Nuk askush foli
d. * Gati sa thirra s'nga gëzimi.

Këto pjesëza mohuese *qëndrojnë gjithnjë menjëherë para trajtës foljore të thjeshtë dhe kur kjo e fundit është e përbërë, atëhere ato rrinë përgjithësisht para pjesës ndihmëse duke u mohuar në këtë mënyrë e gjithë trajta foljore e përbërë ose e gjithë shprehja foljore*.[232]
Edhe pjesëza ***mos*** ka rend të ngulitur në fjali dhe qëndron para foljeve në urdhërore, dëshirore. Në rastet e mohimit me lidhore apo me forma të pashtjelluara, pjesëza *mos* hyn mes pjesëzës të të lidhores apo pjesëzave *për të* e *duke* të formave të pashtjelluara dhe trajtave të foljes.

(214) a. *Mos prit* shi në korrik, se mbete me një shënik. (Fjalë të urta, f. 169)
b. *Mos* ia *urofsha* as armikut, o zot. (Lumi i vdekur, f.355)
c. Ishte munduar të tregohej i drejtë, *të mos* i *binte në qafë* askujt, *të mos* i *hante hakun* as personave që ishin në hetim, dhe më kryesorja, *të mos cënonte* aspak ligjin. (G. Banushi, Simfonia e pambaruar, f.9)

[231] Gosturani, Xh. (1976). Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij në gjuhën shqipe II, Llojet e mohimit gjuhësor*, Studime filologjike, Nr.2*, f. 36.
[232] Po aty, f. 37

d. *Për të mos gabuar*, u tha që më përpara kushtet e vlerësimit.
e. "Vërtet, Zana, ti ke diçka prej artisteje" - thashë duke e shikuar me vërejtje dhe *duke mos i vënë* rëndësi emrit të regjisorit.(D. Agolli, Trëndafili në gotë, A.C)

Pjesëza *mos* qëndron para pjesëzës përemërore u të foljeve në pësore si dhe para trajtave të shkurtra të përemrit vetor qofshin këto edhe të bashkuara.

(215) a. Mos u krih në sy të qerozit. (Fjalë të urta, f.272)
b. Mos e humb besën se të humbet varri. (Fjalë të urta, f.111)
c. Mos ia kqyr dokën, po kqyria kokën. (Fjalë të urta, f.437)

Pjesëza ***as*** gjendet para foljes apo para trajtave të shkurtra ose pjesëzës u të pësores, ndonjëherë pasohet nga që duke e theksuar mohimin.

(216) a. Alma as kishte prekur gjë me dorë gjithë ditën.
b. As i kujtohej ajo që kishin biseduar.
c. As u shkonte ndër mend të largoheshin nga aty.
d. Fëmijët as që kishin provuar ta merrnin topin nga frika.

Mohimi i shqipes shfaq përkime në ndërtimin e tij me italishten, por nuk përputhet me ndërtimin e mohimit në anglisht. Le të krahasojmë shembujt:

(217) a. ***Mos*** ki frikë.
Non aver paura.
Do***n't*** be afraid.

b. ***Nuk/s'*** pashë ***as***kënd.
Non ho visto ***ness***uno.
I have ***not*** seen anyone.
* I have ***not*** seen ***no*** one.

c. Kjo rrugë ***nuk/s'*** të çon ***kurr***kund.
Questa strada ***non*** ti porta da ***ness***una parte.
This road does***n't*** lead you anywhere.
*This road does***n' t*** lead you ***no***where.

Për secilin nga shembujt shqip janë përdorur mjete të ndryshme gramatikore të mohimit. Për shqipen në (a) është përdorur pjesëza mohuese ***mos***, që në italisht ka gjegjësen e saj ***non*** dhe në anglisht ka formën e shkurtuar ***n' t***. gjithashtu shembujt paraqesin mohimin e thjeshtë të shqipes e italishtes në (217.a) dhe atë të përbërë në (217. b) e (217. c). Mjetet gramatikore në secilin prej rasteve janë të ndryshme për shqipen sepse në (b) mjeti i dytë

gramatikor i mohimit është përemër, ndërsa në (217. c) mjeti i dytë gramatikor është një ndajfolje.

Në krahasimin që u bëjmë shembujve vërejmë se në fjalitë e shembullit (217. a) kemi përkim të numrit të mjeteve gramatikore të mohimit, por nuk e vërejmë këtë përkim në topikën e tyre në raport me foljen e fjalisë. Kështu në shqip e italisht pjesëzat mohuese përkatësisht ***mos*** e ***non*** vendosen para foljes, ndërsa në anglisht mjeti gramatikor mohues ***-n't*** është prapavendosur në raport me foljen.

Dallimet thellohen në (217.b) e (217.c) atëherë kur në shqip dhe italisht ndërtohet mohimi i përbërë, pra fjalitë janë gramatikore me përdorimin e dy mjeteve gramatikore të mohimit, ndërsa në anglisht përemri *anyone* dhe ndajfolja *anywhere* nuk ndërtohen me element mohues, por pohues, pra në vend të negativeve ***no*** *one* dhe ***no****where* që do të ishin përkthimet ad literam, janë përdorur gjegjëset pozitive me ***any***. E nëse provojmë ta shtojmë mjetin e dytë gramatikor të mohimit, fjalia në anglisht do të qe jogramatikore. Ky fenomen lidhet me faktin që shqipja e italishtja përfshihen në gjuhët polinegative *meqenëse në një fjali mund të përdoren njëherësh disa elemente mohuese*. Xheladin Gosturani njeh si karakteristike të mohimit të dyfishtë në shqipen[233] ndërtimet:

1) **P + m + F** ose **m + F + P**

(ku ***P*** është për përemrat mohues si *askush, kurrkush, askurrkush, asnjëri, asnjëra, asnjeri, asnjë, asndonjë, asgjë, kurrgjë, askurrgjë, asgjësend, asgjëkafshë, hiçgjë, hiçgjëkafshë, kurrfarë*; ***m*** është për pjesëzën mohuese dhe ***F*** për foljen) ;

2) **N + m + F** ose **m + F + N**

(ku ***N*** është për ndajfoljet mohuese *kurrë, askurrë, kurrkund, askund, asgjëkundi, kurrsesi, në asnjë mënyrë, aspak, asfare, fare, hiç, hiçfare, asnjëherë, asndonjëherë, kurrnjëherë*)[234]

(218) a. Askush nuk paguante mirë për tekstet antike. (Eskili, ky humbës i madh, f.48)
b. Asnjeri nuk kishte ndërmend të flinte. (I.Kadare, Kronikë në gur, f.191)
c. Kurrkund nuk gjeta Gjergj Elez Ali. (Epos)
d. Nuk di fare si do ia bëj.

Ka raste në shqip që përdorimi i mohimit të përsëritur çon në pohim si në (219).

(219) Syri i stërvitur i Katrinës nuk mund të mos vinte re vuajtjen e Alma Vokshit. (G.Banushi, Mëria ... f.275)

Një aspekt me rëndësi për mohimin është topika e mjeteve gramatikore të mohimit. Kështu ato dalin përpara disa klasave fjalësh, si: para foljeve, emrave si në shembullin: ***Pa*** *letra* ***mos*** *më eja më në derë!*, por edhe mund të dalin edhe më vete, si b.f., në shembullin: *Këtë,* ***mos****!* (Kur i flasim një fëmije të mos prekë diçka, për shembull, thikën, gërshërët etj.)

Në analizën tonë duhet të kujtojmë që mohimi është një kokë funksionale ashtu si eptimi. Nga parashtrimi i bërë më sipër, pjesëzat e mohimit ***nuk*** dhe ***s'*** shfaqen sinonime dhe zënë gjithmonë të njëjtin pozicion, por kjo nuk ndodh me pjesëzën ***mos***. Ajo ka tjetër distribucion në raport me ***klitikët*** dhe pjesënzën ***të*** të lidhores, ***u*** të pësores apo ***për të*** e

[233] Po aty, f.44.
[234] Po aty, f.46.

duke të formave të pashtjelluara. Meqenëse pjesëzat mohuese e kanë të detyruar pozicionin para foljes ashtu siç ndodh me trajtat e shkurtëra, kuptohet që përveç këtyre të fundit nuk mund të vendoset ndonjë element tjetër mes tyre dhe foljes, pra vendi i mohimit duhet të ndodhet sipër pozicionit të eptimit. Bazuar në këtë do kishim:

Skema 70.



Në fjalinë dëftore mohuese *Agimi nuk erdhi* diagrama do të ishte[235]:

Skema 71.



[235] Mita, J. (2005). *Hyrje në gjuhësinë gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, f.118.

Në ndërtimet e mohimit me format e foljore me pjesën ***do*** kemi një strukturë dyshe[236] ku folja do ngrihet në pozicionin EPT në SEPT duke lënë pas një gjurmë, por edhe folja tjetër ngrihet në pozicionin e EPT duke lënë pas një gjurmë, ndërsa mohimi ndodhet mbi pozicionin Koh,[237] d.m.th. mbi *do* të së ardhmes apo kushtores.

Për fjalinë *Mira nuk do të besojë.* do kishim diagramën
Skema 72.



Sipas Turano (On clitics..) shtresa më e ulët e K është vendi ku lëvizin foljet e mënyrës urdhërore dhe format e pashtjelluara të paskajores dhe përcjellores. Pjesëzat *të* e lidhores,

[236] Turano, G. *On Clitics and Negation in Albanian.* (dorëshkrim)
[237] Mita, J. (2017). *Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, Faik Konica, Prishtinë, f. 217-218.

për të e paskajores dhe *duke* e përcjellores vendosen në pozicionin K duke i lënë prapa trajtat e shkurtra të cilat vendosen para foljes. Për këtë arsye diagrami i mohimit me ***mos*** i paraqet këto pjesëza në pozicionin më të ulët të fushës K.

Skema 73.



Në analizën e strukturës së mohimit të shumëfishtë në gjuhën shqipe, vihet re se *elementi mohues c-komandon elementin me polaritet mohor (EPM) në fjalitë me rend neutral të përbërësve* (Adger, 2003, cituar sipas Kananaj, 2015). Ky EPM në shqip përforcohet nga pjesëza mohuese ***as*** ose ndajfolja ***kurrë***, të cilat veprojnë si operatorë mohues brenda fjalisë. Në përputhje me modelin e propozimeve të Rizzit* (1995), ForceP mbushet nga elementet që përcaktojnë tipin mohor të fjalisë; TopP përmban temën, e cila në shumicën e rasteve përfaqësohet nga kryefjala; ndërsa elementi mohues fillimisht pozicionohet në Spec-FocP, duke lëvizur jashtë SKoh (TP) për të marrë interpretim rematik. Në kokën e FocP vendoset elementi remë, i cili shënjon pjesën e re të informacionit brenda strukturës së fjalisë.[238]

* Këtë propozim e kemi pasqyruar në sythin për fjalitë pyetëse.

[238] Kananaj. A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 139-140.

Në këtë kuadër, Mita[239] e thellon shpjegimin duke vënë theksin te natyra formale e mohimit. Ai shton se në rastin e mohimit të shumëfishtë, lidhja ndërmjet elementeve të mohimit është një **lidhje përshtatjeje**, e kuptuar si barazim tiparesh formale brenda një fushe sintaksore të caktuar. Mohimi, si tipar formal, paraqitet me vlerë [MOH]; përbërësit e mohimit të shumëfishtë mbajnë tiparin [MOH] të pashpjegueshëm, i cili duhet të futet në marrëdhënie përshtatjeje me pjesëzën *nuk*, që mban tiparin [MOH] të shpjegueshëm. Në sajë të kësaj marrëdhënieje, tiparet e pashpjegueshme eliminohen dhe derivimi i fjalisë qëndron.
Ky arsyetim i paraqitur në diagramë në një fjali mohore do të ishte:

(250) Thuhet *se ajo urë kurrë nuk shembej*.
Skema 74.



[239] Mita. J. (2017). *Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, Prishtinë, f. 221.

KREU I KATËRT
FRAZA NË GJUHËN SHQIPE NË QASJE GJENERATIVE

4.1. Hyrje
Statusi i frazës dhe problemet me terminologjinë

Në gjuhësinë gjenerative termi *frazë*[240] (angl. Phrase) i përgjigjet sintagmës, ndërsa në gramatikën e shqipes ky term u përdor së pari nga M.Domi[241] për të emërtuar ato që më parë ishin quajtur *periudha*[242], *perioda* apo *fjali të përbâme*[243].
Në krahasimin e termave *phrase*, *sentence* dhe *clause* që gjenden si gjegjëset në anglisht për përdorimet e mësipërme, vërejmë se *frazat* shihen si grup fjalësh që janë pjesë të një fjalie, *sentenca* emërton fjalinë e cila mund të ketë në përbërje të saj *clauses* të cilat përkojnë me pjesët e fjalisë.[244] Edhe T.Topalli i kushton vëmendje krahasimit të trajtimit që i bëhet koncepteve të *clause* dhe *phrase* nga gjuhëtarë të drejtimeve të ndryshme

[240] Në Thomai, J.; Samara, M.; Haxhillazi, P.; Shehu, H.; Feka, Th.; Goga, A.; Memisha, V. ASHSH. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 290 termi ***frazë*** përkufizohet:
"1. Tërësi fjalësh të lidhura sipas rregullave gramatikore, të cilat shprehin një mendim të plotë; periudhë: *ndërtimi i frazës."*
Në Rokaj, Sh.; Belluscio, G (2011). *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë: shqip-italisht-frëngjisht-anglisht*, Arbëria, Tiranë, f. 111 jepet:
"*fraz/ë, -a, at, frase, phrase; sentence*" së bashku me variantet e përdorimit *frazë argumentuese*, *asindetike, bërthamë, dëftore, e inkuadruar ose e varur, e kufizuar, e mundshme, e ndërshtënë ose e ndërkallur, e (pa)kryer, e përbërë ose e zgjeruar*.
[241] Domi, M. (1955). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Tiranë, f.162.
[242] Xhuvani, A. (1922) e Sheperi, I.D. (1972) në tekstet e gramatikave për shkollat e mesme. Ky emërtim ruhet edhe në *Gramatikën e gjuhës shqipe* 2 (2002) të ASHSH-së. Gjithashtu në *Fjalorin e termave të gjuhësisë* (1975) në 6 gjuhë të Akademisë së Shkencave të RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i terminologjisë, botuar në Tiranë, f. 176 termi periudhë del "periudhë –a, -at : Rus. саожное преадаоже – ние, период - Fr. phrase complexe, période – Angl: complex sentence; compound sentence – Germ Periode, Satzgefüge; zusammengesetzter Satz. – It. Periodo.
[243] Justin Rrota (1942) dhe Selman Riza
[244] Le të krahasojmë shpjegimet e Oxford Dictionary dhe Cambridge Dictionary
- phrase. noun. noun. /freɪz/ 1(grammar) a group of words without a finite verb, especially one that forms part of a sentence. https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/american_english/phrase_1
-phrase noun [C] a group of words that is part of, rather than the whole of, a sentence; https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/phrase
- Oxford: sentence. [countable] (grammar) a set of words expressing a statement, a question or an order, usually containing a subject and a verb. In written English sentences begin with a capital letter and end with a full stop/period (.), a question mark (?) or an exclamation mark (!). ... I was too stunned to finish my sentence.
-Cambridge: sentence. noun (c) a group of words, usually containing a verb, that expresses a thought in the form of a statement, question, instruction, or exclamation and starts with a capital letter when written.
-Oxford: clause- 1(grammar) a group of words that includes a subject and a verb, and forms a sentence or part of a sentence In the sentence "They often go to Italy because they love the food," "They often go to Italy" is the main clause and "because they love the food" is a subordinate clause.
-Cambridge: clause- noun (c) a group of words, consisting of a subject and a finite form of a verb:

gjuhësore duke vënë në dukje ndryshimet e secilit prej këtyre koncepteve.[245] Një analizë e plotë e këtyre fakteve na çon në përfundimin se përdorimi në shqip i termit *frazë* nuk përkon me atë që ka anglishtja.
Në gjenerativizëm *sintagmë* mund të jetë një fjalë e vetme, por flitet edhe për sintagmën eptimore, sintagmën e komplementuesit ose sintagmën lidhëzore etj, të cilat emërtuar në këndvështrimin e traditës sonë gramatikore, do të përbënin fjali, fjali/pjesë të një periudhe, apo vetë periudhën. Meqenëse në studimet e gjuhëtarëve që kanë hartuar çështje gjuhësore sipas këndvështrimit gjenerativist për shqipen, termi *sintagmë* është i dallueshëm nga ai i *frazës,* edhe ne preferojmë që në këtë punim termi *frazë* t'i referohet konceptit tradicionalist të *periudhës*, dhe termi *përbërës të frazës* t'i referohet koncepteve të *pjesëve të fjalive të përbëra*, *fjalive të nënrenditura*, *njësive kallëzuesore*, *fjalive të varura* etj.

4.2. Fraza në sintaksat e gramatikave të shqipes

Në këtë syth do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur se cila ka qenë njësia e punës në gramatikat më përfaqësuese të studimit gjuhësor të shqipes.
Studiuesi M. Lambertz operon me termin "periudhë"[246], si një term i mbarë gjuhëve indoeuropiane në atë kohë, me ndikim nga latinishtja dhe logjika që sundonte edhe mendimin sintaksor shekuj me radhë në degën e Sintaksës.

Në tekstin për "*Njohunit e para të sindaksës shqipe – pjes' e parë për klasët e nalta të fillores*" gjuhëtari A. Xhuvani shtjellon njësinë e ***periudhës***, nisur nga metoda induktive, duke e përqasur me njësinë-fjali, si për shembull:

F j a l i

Zogjt fluturojnë n'erë. Peshqit bajnë not n'ujë.

P e r i u d h ë

Zogjt fluturojnë n'erë **e** peshqit bajnë not n'ujë.

Pas kësaj, ai jep edhe rregulla: *Periudhë quhet bashkimi i dy a ma shumë fjalive të lidhuna me nji mënyrë, qi të rrëfejnë nji mendim të plotë; ...në nji periudhë janë edhe aqë fjali sa*

[245] Topalli, T. (2011). *Gramatikë e gjuhës shqipe- Sintaksa e fjalisë*, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Instituti i Studimeve Albanologjike, Shkodër, f. 596.
[246] Vepra "*Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*" (Die hypothetische Periode im Albanischen") u hartua nga albanologu Maximilian Lambertz dhe u botua gjermanisht në revistën "Indogermanischhe Forschungen" (Studime indigermane) (më 1914-1915, vëllimi i 34-t. Studimi i albanologut austriak është përkthyer nga Veniamin Dashi dhe plotësuar nga historiani Edmond Malaj, përgatitur për botim e pajisur me shënime nga T. Topalli, (2011) në serinë e botimeve albanologjike, Tiranë.

janë edhe kallëzuesit foljorë [247] shoqëruar me shembuj të veçantë. Ai e klasifikon në periudhë *të thjeshtë* nëse ka një fjali dhe në *të përzieme* nëse ka më shumë se një fjali.

Studiuesi I. D. Sheperi e quan ***periudhë*** bashkimin e dy ose më shumë fjalive kryesore të thjeshta ose të plotësuara. Ai shton që edhe një fjali mund të përbëjë periudhë nëse e shfaq mendimin e plotë.[248]

Po kështu, gjuhëtari J. Rrota thotë që fjalia mund të jetë ***e përbâme*** nëse është *në lidhní me tjera*.[249] Fjalia e përbame mund të jetë ndërtuar prej fjalish *të para*, ose fjalish *të dyta a të mvarshme*. Për rastin e parë *të fjalive të para* autori jep shembullin:

1. Ha pshesh n'ujë e bàj kujdesin e huej.

duke arsyetuar se *si njana, si tjetra fjali ketu janë kuptimisht (logjikisht) krejt të pamvarme, ase në veti: d.m.th. se mund të mirren vesht të dyja edhe damas, e nuk rrjedhin prej shoqja shoqes*[250]. Ndërsa në fjalinë:

2. Rueje zogun, sa t'a késh në dorë.

thotë se gjymtyra e dytë *mvaret prej së parës e nuk ka në vetveti nji kuptim të plotësuem, po u shkëput nga gjymtyra e parë. Kjo gjymtyrë pra, e cila ka nevojë t'i pështetet njaj fjalie të pamvarshme, thirret fjali e dytë ase e mvarshme*.[251]

Studiuesi K. Cipo e quan ***periodë*** radhën e fjalive me kuptim të plotë e të vazhduar dhe simetrikisht të ndrequra duke dhënë shembullin:

Hamza i qahet Sulltanit se Skënderbeu nuk i dha pjesën e principatës së Matit, që i binte si trashëgim nga i ati po edhe si çpërblim të mundimeve dhe të betetjave pranë tij; e dyta, shpresa që t'i trashëgonte të gjitha sa fitoi Skënderbeu humbi, posa ky u martua dhe bëri një djalë; e treta, kishte frikë që Skënderbeu, dyke zbatuar politikën e tij qëndralësore do të gjente një shkak që t'i rrëmbente edhe atë krahinë të veckël që i kish falur në një çip të Shqipërisë, nga turpi i botës që të mos e lente të ngordhë për bukë.

Ai thotë se ***periodë*** mund të quhet edhe një fjali e vetme, kur është mjaft e zgjeruar dhe shpreh kuptim të plotë, duke dhënë shembullin:

Gëzimi i kësaj fitoreje të çkëlqyer u turbullua nga lajma e zezë e vdekjes së Pal Dukagjinit.[252]

---

[247] Xhuvani, A. (1922). *Njohunit e para të sindaksës shqipe – pjes' e parë për klasët e nalta të fillores,* "Vlora", Vlorë, f. 32 -33.

[248]Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe- sidomos e toskënishtes (për shkolla të mesme*), Vlorë, , ribotuar në Romë, 1972, f. 140.

[249] Rrota, J. (1942). *Sintaksi i shqipes për klasën II, III, IV K.U. të shkollavet të mjesme*, Shtypshkronja "A. Gj. Fishta", Shkodër, Ribotim III, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f.6.

[250] Po aty, f. 61

[251] Po aty, f. 61.

[252] Cipo, K, (1952). *Sintaksa*, Instituti i shkencave, Tiranë, f. 15.

Ndërsa gjuhëtari M. Domi shprehet se grupet e fjalive që shërbejnë për të shprehur një mendim të plotë, më të plotë se mendimi që shpreh një fjali, quhen ***periudha*** ose ***fraza***. Në një periudhë zakonisht ka aq fjali sa ka folje dhe periudha mund të jetë *e thjeshtë* nëse ka vetëm një fjali e nëse ka më shumë se një quhet periudhë *e zgjeruar*.[253]

Gjuhëtari S.Riza quan *fjali të përbâme*[254] atë fjali në të cilën ndërthuren fjalitë e thjeshta dhe dallon llojet përbâmjoro-bashkërendore dhe përbâmjoro ndënrendore. Në këtë të fundit dallon *ndënfjalinë* dhe *kryefjalinë*.[255]

Në "Gramatikën e gjuhës shqipe 2" të ASHSH-së (2002) thuhet *se periudhë është njësia e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësish kallëzuesore në formë fjalie, në raporte të caktuara*.[256]

Studiuesi S. Prifti e përkufizon ***periudhë*** një *sistem fjalish të lidhura gramatikisht midis tyre, që shprehin një mendim të plotë, të mbaruar dhe ajo përbëhet me jo më pak se dy fjali* duke vënë në dukje përveç *ndryshimit cilësor* edhe një *ndryshim kuantitativ*. Ai shton se periudha është një *grupim fjalish të lidhura gramatikisht në një tërësi unike të cilat mund të jenë kryesore ose të varura*. [257]

Gjuhëtari T.Topalli arsyeton se mes termave *periudhë*, *frazë* apo *fjali e përbërë* më i godituri dhe më shkencori është termi ***periudhë*** sepse etimologjikisht i përgjigjet më mirë përmbajtjes gjuhësore të përbërësve të saj, është term i traditës së gjatë gjuhësore, shpreh më mirë hierarkinë e njësive sintaksore duke bërë dallimin mes paragrafit dhe tekstit, nuk krijon pështjellim me njësi të tjera si dy termat e tjerë, gjatë analizës zbërthehet më mirë në fjali të cilat quhen njësi kallëzuesore pasi i mungon intonacioni i përfunduar, por kanë përherë të shprehur predikativitetin.[258]

Studiuesi M.Çeliku thotë se fjalia e përbërë (periudha) është një variant fjalie[259]. Në ***fjali*** ai përfshin edhe fjalitë e thjeshta edhe fjalitë e përbëra duke i parë të dyja si dy nënlloje të ngjashme të cilat dallojnë nga numri i bërthamave predikative. Periudha pavarësisht se është trajtuar si njësi e veçantë sintaksore në sintaksën tradicionale, nuk arrin dot të ngrihet

[253] Domi, M. (1955). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Tiranë, f.162.
[254] ASHAK, (1997). Selman Riza, *Vepra 2,* Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 13, Prishtinë, f. 501.
[255] Po aty, f. 519.
[256] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2,* Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f.61.
[257] Prifti, S. (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe (pjesa e dytë)*, Universiteti i Prishtinës, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, f.169-175.
[258] Topalli. T, (2004). Fjali e përbërë, frazë apo periudhë?*, Gjuha jonë*, Nr.1-2, f. 77- 83.
[259] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe - përbërësit sintaksorë*, Ilar, Tiranë, f.333 shprehet se "*njeh dy njësi sintaksore: 1. përbërësi sintaksor barasvlerës i sintagmës dhe 2. fjalia."*

në nivelin e një njësie të veçantë sintaksore. Në arsyetimin e tij për dallimin e periudhës nga fjalia e thjeshtë, Çeliku thotë se ajo përbëhet nga dy a më shumë ***sifjali***, term ky që përdoret për herë të parë në gjuhësinë shqiptare dhe që autori e lidh me termin anglisht *clause* si dhe që përcaktohet nga tipari i mungesës së njërit nga tiparet themelore të fjalisë që është intonacioni i përfunduar. Për këtë arsye ai e gjen të pambështetur përdorimin e termit *fjali* për pjesët përbërëse të periudhës. Gjithashtu studiuesi vë në dukje se si fjalia e thjeshtë ashtu edhe ajo e përbërë *kanë në ndërtimet e tyre lidhjen e drejtpërdrejtë në lidhje dyshe ku njëri nga përbërësit është drejtues e tjetri i varur*.[260]

Gjuhëtari M.Totoni thotë se ***fraza e përbërë*** është bashkimi i dy ose më shumë fjalive, të cilat i quan *fraza të thjeshta*, dhe që karakterizohen nga bashkëlidhja gramatikore, intonacionore dhe përmbajtësore.[261]

Studiuesi R. Memushaj në "Hyrje në gjuhësi" shprehet se njësi të sintaksës janë *gjymtyra e fjalisë*, *sintagma* dhe *fjalia.*[262]

Si përfundim mund të themi që në tekstet e gramatikave shqiptare operohet me termat *periudhë*, *periodë, fjali e përbërë, frazë* nga të cilët ne do të përdorim pikërisht këtë të fundit. Ndërsa në raport me terminologjinë e përbërësve të tjerë të një fraze me dy apo më shumë predikatë ku mbizotërojnë termat *fjali, fjali kryesore* ose *e varur, njësi kallëzuesore, bërthama kallëzuesore, pjesë,* na duket më gjithëpërfshirës termi *përbërës* pavarësisht se për arsye specifikimesh do të përdorim edhe termat *frazë e përbërë, fjali drejtuese* e *fjali e nënrenditur* duke pasur parasysh gjithmonë sintagmën, konkretisht sintagmën komplementuese (SK), sintagmën e eptimit (SEPT) apo sintagmën foljore të pashtjelluar (SFpsht).

4.3. Pavarësia e përbërësve të frazës sipas dy këndvështrimeve

E prekëm pak më lart problemin e përbërësve të frazës në gramatikat e shqipes dhe ajo që bie në sy është se në pothuajse të gjithë përfaqësuesit e gramatikës tradicionale flitet për njësi kallëzuesore prej të cilave përbëhet fraza apo periudha. M.Domi i gjen arsyet e quajtjes *pjesë të fjalisë së përbërë* te mungesa e tipareve të mëvetësishme të fjalisë së periudhës që lidhen me plotninë e tyre kuptimore e strukturore dhe intonacionin e mbarimit.[263] Po kështu në Gramatikën e shqipes së ASHSH-së thuhet se njësive

[260] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe - përbërësit sintaksorë*, Ilar, Tiranë, f.49-50.
[261] Totoni, M. (2012). *Sintaksa e gjuhës shqipe - Fraza e përbërë*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Arbëria, Tiranë, f. 7.
[262] Memushaj, R. (2008). *Hyrje në gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë, f.239.
[263] Domi, M. (1955). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Botim i Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës, Tiranë, f. 165.

kallëzuesore prej të cilave përbëhet periudha u mungon karakteri kuptimor relativisht i plotë dhe nuk kanë intonacion të plotë dhe të përfunduar me përjashtim të fjalisë së fundit të vargut.[264] Te M. Çeliku gjejmë interpretimin se intonacioni i përfunduar i mungon të gjitha sifjalive[265].

Ndërkohë që në sintaksën gjenerative pavarësia e përbërësve lidhet me valencën. Nëse një përbërës me valencë i ka të realizuara të gjitha argumentet e domosdoshme, atëherë ai është i pavarur.

Në gjuhësinë gjenerative duke u bazuar në kritere si ato të domosdoshmërisë dhe roleve tematike, flasim për fraza me fjali argumentore e shtesore. Në fjalitë argumentore përfshihen ato fjali që shërbejnë si argumente për foljen e fjalisë drejtuese♦ dhe kryejnë një funksion sintaksor në lidhje me fjalinë drejtuese duke përbërë një përbërës të rëndësishëm në plotësimin e valencës gramatikore e logjike të predikatit. Këto përbërës të frazës në aspektin strukturor janë ***sintagma me koka funksionale të komplementit SK*** (fjali të nënrenditura që e kanë të fonetikisht të realizuar ose të parealizuar mjetin lidhës, e që në rastin e mosrealizimit fonetik mund të vendoset pa prishur gramatikalitetin kuptimor të fjalisë); ***të eptimit SEpt*** (fjali të nënrenditura që kanë folje të shtjelluar dhe që nuk e kanë të shprehur e që nuk e pranojnë mjetin lidhës as kuptimisht e as strukturalisht); ***apo të formave të pashtjelluara SShtj***.

4.4. Frazat me fjali argumentore

4.4.1. Hyrje

Në këtë krye paraqitet kronologjikisht klasifikimi tradicional i fjalive të frazës për të ardhur te qasja e re gjenerative e cila mbështetet në klasifikimin në përbërës argumentorë dhe shtesorë. Klasifikimi i fjalive në frazë do të mbështetet në të njëjtat kritere të aplikuara për fjalinë, por duke pasqyruar ndryshimet që dikton në nivel sintagme realizimi i predikatëve në fjali dhe në frazë. Bëhet fjalë për dallimet mes sintagmave funksionale dhe atyre leksikore, konkretisht për sintagmën komplementuese (SK) dhe sintagmën foljore që përcaktojnë fjalitë e një fraze dhe fjalinë e thjeshtë.

Fokusi ynë në këtë syth do të jenë fjalitë argumentore të cilat ngjasojnë me ato që në sintaksën tradicionale, bazuar në kriterin funksional, janë klasifikuar si *fjali ftilluese*, emërtim në të cilin përfshihen fjalitë *kryefjalore, kundrinore* e *kallëzuesore*, etj. Do të sqarojmë *çfarë janë fjalitë argumentore, kush përfshihet në fjalitë argumentore dhe si projektohen ato*.

[264] ASHSH, (2002).*Gramatika e gjuhës shqipe 2*, IGJL, Tiranë, f. 424-425.

[265] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe – Përbërësit sintaksorë*, Ilar, Tiranë, f.333.

♦ Ne do i quajmë kryesore vetëm fjalitë e frazës me bashkërenditje, ndërsa fjali drejtuese do të quhen ato fjali që nuk janë të plota kuptimisht pa fjalinë që varet prej tyre.

4.4.2. Klasifikimi i fjalive ftilluese në gramatika të shqipes.

Katër janë kriteret për klasifikimin e fjalive të nënrenditura në gramatikat e gjuhëtarëve shqiptarë: 1) *kriteri funksional* që bën paralelizmin e fjalive të periudhës me gjymtyrët e fjalisë; 2) *kriteri semantik*; 3) *kriteri semantiko-strukturor* dhe 4) *kriteri strukturor-semantik*. Në pjesën më të madhe të gramatikave të shqipes përdoret kriteri funksional për klasifikimin e fjalive të nënrenditura.

Aleksandër Xhuvani shfrytëzon kryesisht kriterin funksional për klasifikimin e frazave me nënrenditje, por ndonjëherë i referohet edhe kriterit strukturor♦.

Ai shprehet se *fjalitë e lidhuna bashkë mund të shërbejnë si kryefjalë e fjalisë së parë, si kundrinë e saj, ase mund të kallëzojnë kohën, shkakun, kushtin, etj*.[266] Për fjalitë kryefjalore Xhuvani sqaron se *ndërtohen tue u lidhë me fjalin'e parë me lidhëzat,* ***se, që****, me përemrat lidhorë* ***kush, ai që, ajo që****, dhe me mënyrën* ***paskajore*** e ndërtimet me këto të fundit quhen *të pashtjellme*.[267] Fjalitë kundrinore janë *posi kundrina te fjalitë e para dhe ndërtohen tue u lidhë me fjalin'e parë me lidhëzat* ***që që, të, se*** *dhe me mënyrën* ***paskajore***.[268]

Ilia Dilo Sheperi i quan *plotës* fjalitë *e dyta apo të varme* që dallojnë nga *fjalit'e para apo kryesoret*.[269] Ai përmbledh në llojin e *fjalive të caktimit* ato fjali që kufizojnë ose caktojnë kuptimin e gjerë të foljes kryesore me anë të lidhëzave *që* e *se* ku për këto të fundit respektivisht thotë se ***që*** *e caktimit e tregon mendimin si më të vërtetë (mendim objektiv), kurse lidhëza* ***se*** *e tregon mendimin si mendim të kryefjalës (mendim subjektiv).* Fjalitë e caktimit sipas Sheperit shërbejnë si *emëra* d.m.th. përdoren

a) si kryefjalë të fjalisë kryesore. P.sh. Duket se nuk do të vijë.
b) si kallëzues ose të kryefjalës: *E pashë që erdhi*, ose të kundrinës
c) si kundrinë: *Më thanë se erdhi.*
d) si një shpjegim të saj: *Më bëri një të mirë që më dërgoi librat.*[270]

Justin Rrota, duke u mbështetur në kriterin funksional, shprehet se *gjymtyrët e fjalis së përbame kanë ndërmjet vetit po njatë lidhní, përpjekje e kuptim, qi kanë pjesët e fjalisë së thjeshtë. Kështu sikurse smadhimet e fjalis së thjeshtë plotsore vlejn për m'e caktue ma mirë subjektin (emnin) dhe predikatin e fjalis, njashtu edhe fjalit e dyta, prej së cilash ndërtohet fjalija e përbàme, s'kanë qellim tjetër, veç m'e caktue mà mirë e me e plotësue kuptimin e fjalive të para a të dyta, prej së cilash mvaren*.[271] Ai dallon po aq *fjali farësh së*

♦ Është fjala për fjalitë e nënrenditura relative.

[266] Xhuvani, A, (1938). *Sintaksa shqip –pjes'e dytë për klasët e ulta të shkollavet të mesme*, SHB "Kristo Luarasi", Tiranë, f.31.

[267] Po aty.

[268] Po aty, f. 32.

[269] Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe – sidomos e toskënishtes- për shkolla të mesme*, Vlorë, ribot, Romë, 1972, f. 139.

[270] Po aty, f. 173.

[271] Rrota, J. (1942). *Sintaksi i shqipes për klasën II, III, IV K.U. të shkollavet të mjesme*, Shtypshkronja "A. Gj. Fishta", Shkodër, Ribotim III, 2005, Botime Françeskane, Shkodër, f. 60.

dyta sa janë farët e gjymtyrvet të fjalis së thjeshtë: *fjali subjektit, predikatit, atributit, objektit dhe advërbjarit*. Për fjalinë e subjektit Rrota pasi sqaron që zë vendin e subjektit dhe lidhet me lidhëzat *qi, se*, përemrat e adverba apo fjalë pyetëse: *kush, kur, si, a thue*; me përemra lidhorë *kush, njaj i cili, shka, ai qi, kuj, kê*; apo edhe pa lidhëza duke u ndarë fjalitë prej shenjave të pikësimit.
Më poshtë Rrota bën një pohim interesant i cili mund të lidhet në një farë mënyre intuitive me atë që në teorinë e drejtimit e të lidhjes të gjuhësisë gjenerative quhet *drejtimi rasor*. Gjuhëtari flet për përemrin lidhor *kush* që i prin fjalisë së subjektit apo objektit dhe shprehet se ky përemër *shkon n' atë rasë qi e lypë predikati i vet, d.m.th. i vërbit të fjalis në të cilën âsht; pa e këqyrun rasën, qi lypë predikati i fjalis nga e cila mvaret: Kujt t'i kande (njai të cilit), lê të shkojë. Kuj (ai të cilit) i djegë miza nuk bàn zà.*[272] Për fjalinë e objektit Rrota pasi sqaron pyetjet së cilave u përgjigjet, thotë se lidhet në të gjitha ato mënyra si fjalia e subjektit.[273]
Fjalia e predikatit zë vendin e fjalës predikative, d.m.th. rri si emër predikati me *foljet jam, bàhem, dukem, etj* që kërkojnë fjalë ndihmëse për kuptim të plotë dhe prihet nga përemri ose ndajfolja lidhore dhe lidhëzat *qi, se*.[274]

Kostaq Cipo gjithashtu shfrytëzon kryesisht kriterin funksional dhe i ndan fjalitë me nënrenditje në fjali *subjektore, objektore, atributore dhe ndajfoljore*. Gjithashtu Cipo dallon edhe nivelin e shkallës në lidhjen e një fjalie.[275] Sipas Cipos fjali kryesore quhet ajo *që nuk varet nga të tjerat, po kuptim të plotë vetiu nuk ka në mos u ndihmoftë nga fjalitë e varura*. Fjali e varur quhet *ajo që varet nga kryesorja ose nga një tjetër e varur*.
Fjalitë e varura janë *subjektore kur hyjnë në punë si subjektë të fjalisë nga ku varen* dhe *objektore kur përdoren si kundrina të drejta të fjalive nga ku varen.*[276] Kur shpjegon fjalinë ***subjektore*** Cipo sqaron përveç lidhëzave *që* e *se* edhe foljet *të cilat shkojnë me fjalitë subjektore* duke listuar*:*
1)foljet pavetësore duket, lipset, duhet;
2) lokucionet pavetësore: është mirë, është keq, s'është e udhës, qënka thënë;
3) foljet e vetës së tretë njëjës të diatezës pësore si: flitet, thuhet, pëshpëritet, etj.[277]
Sipas Cipos fjalia subjektore është gjithnjë fjali e shtjelluar dhe vetëm gegërishtja ka fjali subjektore me formë të pashtjelluar.
Për fjalinë ***objektore*** Cipo thotë se hyn në punë si kundrinë e drejtë e fjalisë kryesore ose e një fjalie të varur, lidhet përmes lidhëzave *që, se* dhe foljet që kanë nevojë për një fjali objektore nuk janë gjithnjë po ato që marrin kundrina të drejta. Foljet që marrin fjali objektore janë foljet që tregojnë *të parë, të dëgjuar, të kuptuar e të thënë*. P.sh.

[272] Po aty, f. 77-78.
[273] Po aty, f. 82.
[274] Po aty, f.79.
[275] Cipo, K. (1952). *Sintaksa*, Instituti i shkencave, Tiranë, f.10.
[276] Po aty, f. 9
[277] Po aty, f. 86.

Profesori tha se nuk ish i kënaqur me nxënësit.
Kish dëgjuar se do të vinin shumë të urtë në kryeqytet.
Mora vesh se po botohen shumë libra të bukura.
Vura re se plani nuk ish shtruar mirë.
Më vonë kuptova ku e kish hallin.[278]

Cipo vë në dukje edhe ndryshimin e lidhjes së fjalisë objektore në rastin e mohimit në fjalinë kryesore. Në këto raste lidhja nuk realizohet me lidhëzat, por me lidhëzën kushtore *në*. Nëse fjalitë objektore varen nga foljet transitive: *nuk di*, Cipo thotë se *bëhen sakaqë fjali subjektore*. (*Se kush po troket në derët*. vs *Nuk di se kush po troket në derët*)[279] Cipo i sheh fjalitë pyetëse të zhdrejta si një nga llojet e fjalisë objektore. Ato janë të tilla sepse nuk kanë të shprehur pyetjen, varen nga të njëjtat folje si fjalitë objektore dhe lidhen me fjalinë kryesore me lidhëzën *se*. Fjalia pyetëse e zhdrejtë e ndërtuar pa përemra pyetës lidhet me fjalinë kryesore me anë të lidhëzës kushtore ***në*** ose të pjesëzës pyetëse ***a***.

Stefan Prifti i ndan fjalitë e varura në emërore, ku përfshin kryefjaloret, kallëzuesoret, cilësore, ndajshtimore dhe kundrinore; si dhe në fjali të varura ndajfoljore.[280]

Mahir Domi thotë se fjalitë e varura bëjnë në periudhë po atë punë që bëjnë pjesët e ndryshme të fjalisë. Ai klasifikon fjalitë e nënrenditura në kryefjalore, kundrinore, lidhore e caktuese që bëjnë po atë punë që bën një cilësor, vendore, kohore, shkajkore, qëllimore, mënyrore, krahasore; rrjedhore, kushtore e lejore.[281]
Për fjalinë kryefjalore thotë që shërben si kryefjalë e fjalisë nga e cila varet dhe vë në dukje edhe foljet me të cilat shkon:
a) folje moskalimtare a mesore të vetës së tretë njëjës: ndodh, ngjan, rastis, (më) pëlqen, duhet, lipset, duket, etj. (Duket se sonte do të bjerë shi)
b) folje të vetës së tretë njëjës të trajtës pësore si: thuhet, flitet, dihet, shihet, kuptohet.(Flitet se filarmonia po përgatit çfaqjen e një opere)
c) shprehje pavetore të formuara prej foljes jam e një emri, mbiemri a ndajfoje. (Ish e pamundur t'afroheshe; Është marrëzi të mendosh kështu.)
ç) shprehje të tjera pavetore. (Më vjen keq që s'erdha mbrëmë te ti. Më bie ndër mend se me këtë njeri jam njohur njëzet vjet më parë.)[282]

[278] Po aty, f. 87.
[279] Po aty, f. 88.
[280] Prifti, S. (1970). *Sintaksa e gjuhës shqipe II*, (libër universitar), Prishtinë.
[281] Domi, M. (1955). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Botim i Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës, Tiranë, f.185-188.
[282] Po aty, f. 190-193.

Fjalisë kundrinore po ashtu i përcakton foljet me të cilat shkon si folje që tregojnë të thënë, të ndier e të menduar, folje që tregojnë dëshirë e vullnet lidhen me fjalinë nga e cila varen me lidhëzat që e se, ose drejtpërdrejt kur folja është në mënyrën lidhore.[283]

Selman Riza për fjalinë *përbamjoro- nënrendore* thotë që *âsht ajo fjali e përbâme në të cilën një fjali e thjeshtë që quhet: fjali e ndënrendueme a ndënfjali, përban një gjymtyrë të njaj fjalie tjetër*, *gjithashtu të thjeshtë që quhet fjali ndënrenduese a kryefjali*. *Kryefjalija, e marrun vetëm, e njëj fjalie përbamjoro ndënrendore âsht pra gjithmonë e gjymtë meqenëse së pakti njâna prej të sajavet gjymtyrë,- përbân një fjali të tânë, pikërisht, ndën fjalinë e fjalisë përbamjoro ndënrendore.*[284]
Sipas gjymtyrës që përbën fjalia e varur Riza dallon fjalitë *të përtukallëxueme* gjegj. *ndënanore, ndënfjalitë kallxuese ndënfjalitë kundranore, rrethanore, caktuese* dhe *ndajshtuese.*[285]

Spiro Floqi te fjalitë kryefjalore dallon tipin *lidhëzor ftillëzonjës* e tipin *përemëror korrelativ*.[286] Ai mbështetet në kriterin semantiko-strukturor e mjetin lidhës si dhe në elementet korrelative për të dalluar tipin ftillëzonjës të fjalive ku përcakton tipin lidhëzor ftillëzonjës (dëftor dhe urdhëror) me dy nëntipet:

- lidhëzor ftillëzonjës pyetës ose i pasigurisë,
- përemëror relativ ftillëzonjës dëftor.[287]

Gramatika e gjuhës shqipe e ASHSH-së klasifikon si fjali kryefjalore atë fjali e cila kryen ndaj fjalisë kryesore një funksion të ngjashëm me atë të një kryefjale të një fjalie dykryegjymtyrëshe dhe në të dallon dy klasifikime:

1) *sipas mjetit të lidhjes* dhe i ndan në: fjali kryefjalore *lidhëzore* dhe fjali kryefjalore *përemërore*;
2) *sipas mjetit të lidhjes dhe llojit kumtues të fjalisë së varur* dhe i ndan në: *fjali lidhëzore*, *fjali përemërore* dhe *fjali të pyetjes së zhdrejtë.*[288]
Sa i takon fjalive kallëzuesore të tilla quhen ato fjali të cilat kryejnë funksionin e pjesës emërore të kallëzuesit emëror ose funksionin e përcaktorit kallëzuesor. Gramatika i ndan

[283] Po aty, f. 194-196.
[284] Riza, S. (1997). *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 13, Prishtinë, f. 519.
[285] Po aty.
[286] Floqi, S. (1965). Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme, *Studime Filologjike*, Nr. 3-4.
[287] Floqi, S. (1967). Disa tipe semantiko-strukturore të përiudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative. *Studime Filologjike*, Nr.3, f. 21-30.
[288] ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, f. 503.

bazuar në kriterin semantiko – strukturor në: a) tipi lidhëzor jokorrelativ, b) tipi përemëror jokorrelativ, c) tipi ndajfoljor korrelativ.[289]

Për fjalinë kundrinore Gramatika përcakton se quhet ajo fjali e periudhës e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kryen një funksion të ngjashëm me atë të një kundrine (të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë ose të zhdrejtë me parafjalë)[290]. Këto fjali të varura bashkohen me kryesoren:

1) ***me lidhëza ftilluese*** të mirëfillta se, që, ose funksionalisht ftilluese, ndërsa kur kallëzuesi është në mënyrën lidhore edhe drejtpërdrejt (me anë të pjesëzës të);
2***) me përemra lidhorë*** të pacaktuar
3) ***me përemra e ndajfolje pyetëse***, dhe me ***pjesëza*** të paraprira herë-herë nga lidhëza ftilluese.

Fjalia kundrinore lidhëzore, e cila ftillon kuptimin e një kallëzuesi foljor të fjalisë kryesore apo drejtuese të shprehur me folje kalimtare veprore, është ***fjali dëftore*** kur bashkohet me lidhëzat *se, që, si, sikur* dhe ftillon kuptimin e foljeve: *them, flas, tregoj, rrëfej, dëftoj, lajmëroj, ankohem, bërtas, thërras, çirrem, grindem, pëshpërit, qahem, përfundoj, përgjigjem, përsërit, shtoj, deklaroj, dëshmoj, gënjej, kërcënoj, kritikoj, kujtoj, lëvdohem, mohoj, njoftoj, njoh, padit, paralajmëroj, përmend, pohoj, pranoj, provoj, qortoj, raportoj, shënoj, shkruaj, shpall, shpjegoj, theksoj, vërtetoj* etj.

Fjalia ***kundrinore lidhëzore*** mund të jetë dëshirore a urdhërore (e zhdrejtë) kur plotëson një folje a një shprehje foljore që tregon dëshirë, shprehje të vullnetit, të kumtuar si: pranoj, ëndërroj, parapëlqej, kundërshtoj, dëshiroj, dua, kërkoj, miratoj, uroj, autorizoj, lejoj, këshilloj, propozoj, lutem, porosit, bëj thirrje, rekomandoj, udhëzoj, urdhëroj, ndaloj.
Fjalitë ***kundrinore me përemra lidhorë*** mund të lidhen me folje apo shprehje foljore veprore të çdo kuptimi leksikor dhe bashkohen me përemrat e pacaktuar *kush, ç, çfarë, gjithë ç', gjithë sa, gjithçka*.
Fjalitë ***kundrinore pyetëse të zhdrejta*** shkojnë me foljet *pyes, them, rrëfej, tregoj, kuptoj, kujtoj, sjell ndër mend, mësoj, marr vesh, di, hetoj, zbuloj* etj, dhe mund të bashkohen me kryesoren me fjalë pyetëse si *përemra pyetës* në rasa të ndryshme të shoqëruar ose jo nga parafjalë (*kush, cili, ç', çfarë, çka, sa*); përemri pyetës i ngurosur *se* (*nga se, me se*) dhe nga *ndajfolje përemërore pyetëse* (*sa, pse, ku për ku, gjer ku, nga, kur, deri kur, që kur*); pjesëzat *a, mos, në, nëse*.
Fjalia kundrinore thirrmore e zhdrejtë mund të lidhet me fjalën sa e si të cilat kanë humbur kuptimin pyetës për sasinë e për mënyrën, por shprehin habi e admirim që shprehen me intonacion thirrmor.

[289] Po aty, f. 511.
[290] Po aty, f. 515.

Menella Totoni përdor kriterin strukturor semantik.[291] Duke i parë të metat e klasifikimit funksional mendon se brendia e kryefjalës e shprehur me sintagma emërore dhe brendia e kryefjalës së realizuar me fjali të nënrenditur nuk kanë lidhje nga pikëpamja kuptimore dhe nuk kanë një funksion analogjik të plotë. Mospërputhja kushtëzohet së pari nga pamundësia e lidhjes kuptimore të emrit foljor që zëvendëson foljen e fjalisë së nënrenditur, me foljen e fjalisë kryesore.[292] Ngjashmëria me gjymtyrët e fjalisë nuk ka rëndësi për organizimin e frazës, pra është një tipar i jashtëm. Ky tipar nuk përcakton veçoritë e strukturës së frazës dhe karakterin e marrëdhënieve ndërmjet fjalive. Sipas tij kriteri strukturor –semantik e bën klasifikimin më objektiv klasifikimin e frazave me fjali të nënrenditur sepse vë në dukje faktorët që marrin pjesë në organizimin strukturor e kuptimor të frazave me fjali me nënrenditje. Nga ana tjetër ai shprehet se është e vështirë të zbatohet vetëm një kriter për shkak të problematikës së ndërlikuar që përfshin fraza me nënrenditje. Fillimisht përdor kriterin strukturor bazuar në praninë ose në mungesën e fjalës mbështetëse. Kështu ai vendos fjalitë ftilluese në nënklasën e frazave me nënrenditje pa fjalë mbështetëse. Kjo klasë karakterizohet nga *përdorimi i lidhëzave* të cilat dalin si elemente përbërëse të fjalive të nënrenditura duke luajtur një rol kryesor në organizimin dhe kuptimin e frazës, si dhe *rendi i lirë* i fjalive të frazës.

Në frazat që shprehin marrëdhënie ftilluese, Totoni përfshin ato fjali ku *fjalia kryesore ka në përbërjen e saj folje ose grupe foljore që shprehin procese të ndryshme kuptimi, mendimi, hamendjeje, perceptimi, nxitje, dëshire, të cilat shprehin mundësi a pamundësi, domosdoshmëri a rastësi, vlerësim intelektual e emocional, folje a togje foljore, që nga pikëpamja informative nuk janë të plota a të mjaftueshme, kurse fjalia e nënrenditur ftillon a sqaron kuptimin e përgjithshëm të këtyre foljeve, duke zënë vendin e kryefjalës, të kundrinorit të drejtë a të kundrinorit me parafjalë e, në raste të veçanta, edhe të përcaktorit kallëzuesor të kryefjalës së fjalisë kryesore e të kundrinorit të drejtë.*[293] Ai pohon se fjalia e nënrenditur është valencë e foljes ose e togut foljor të fjalisë kryesore. Klasifikimin e ftillueseve e bën duke u bazuar në modalitetin e kumtimit në: fraza ftilluese dëftore, fraza ftilluese hamendësuese, nxitëse, dëshirore, e domosdoshmërisë, e vlerësimit, pyetëse; dhe sipas lidhëzës, sipas kuptimit të kallëzuesit që ftillojnë dhe pjesëzave pyetëse pas lidhëzës. Fjalia e nënrenditur ftilluese meqenëse zë pozitën e një gjymtyre që mungon në fjalinë kryesore, del si përbërës i strukturës së fjalisë. Ajo mund të jetë temë ose remë e frazës në varësi të rënies së theksit logjik të frazës në një gjymtyrë të saj.

Frazat me fjalë mbështetëse mund të kenë si të tillë (fjalë mbështetëse) një mbiemër që mund të jetë me funksion përcaktor i veçuar apo i paveçuar dhe të një përcaktori kallëzuesor. Fjalë mbështetëse mund të jetë edhe një formë e pashtjelluar. Format e shtjelluara zgjerohen prej fjalive ftilluese dhe dalin kryesisht si kundrina të drejta e të

[291] Totoni, M. (2000). *Fraza me nënrenditje*, SHBLU, Tiranë, .
[292] Totoni, M. (2012). *Sintaksa e gjuhës shqipe - Fraza e përbërë*, UT, FHF, Arbëria, Tiranë, f. 25.
[293] Po aty, f. 22.

zhdrejta, rrallë si kryefjalë. Ndërsa ftillueset palidhëzore zakonisht organizohen si ligjëratë e drejtë dhe e zhdrejtë.

Një tjetër studiues, Mehmet Çeliku[294], mbështet klasifikimin e tij në karakterin e lidhjeve dyshe të varësisë së lidhjes së fjalive të frazës dhe në teorinë e valencës. Karakteri i lidhjeve sintaksore të përbërësve mund të jetë *i domosdoshëm* e *fakultativ* duke dalluar këto lloje:

1. sifjali nënrenditëse plotësore që plotësojnë në mënyrë të domosdoshme një folje a një emër të sifjalisë kryesore; si plotësorë të foljes mund të jenë: kryefjalore, kundrinore, kallëzuesore; si plotësorë të emrit janë sifjali përcaktore ftilluese e dalluese.
2. sifjali nënrenditëse përcaktore-lidhore-shtesore (fakultative) që modifikojnë një përbërës emëror të sifjalisë kryesore (përcaktore përshkruese, ndajshtimore e vlerësuese (kjo e fundit modifikon gjithë sifjalinë drejtuese)
3. sifjali nënrenditëse rrethanore shtesore që modifikojnë gjithë sifjalinë drejtuese.

Ky klasifikim ngjason me klasifikimin që në anglisht u bëhet përkatësisht: *complement*, *relative* dhe *adverbial clauses*.

Meqë e kemi thënë edhe më lart se fjalitë argumentore analizohen si sintagma të komplementuesit po sjellim këtu edhe një analizë të mjeteve lidhëse që përdoren zakonisht në frazat lidhëzore ndryshe komplementuese. Është fjala për monografinë "Frazat lidhëzore në gjuhën shqipe" të Rozana Rushitit[295] e cila në studimin e lidhëzave polisemantike *që* e *se*, thotë se janë lidhëza ftilluese, semantikisht boshe me burim përemëror (formuar nga ngurosja e trajtave rasore të përemrave), që lidhin fjali të nënrenditura kryefjalore, kundrinore e kallëzuesore e përcaktore në përmbushje të valencave të foljeve apo shprehjeve foljore kallëzues të fjalive drejtuese dhe të emrave. Këto dy lidhëza ndërkëmbehen me njëra-tjetrën, por specifika e kuptimit të tyre varet nga kuptimi i foljes së fjalisë drejtuese si dhe nga mënyra e foljes së fjalisë së nënrenditur dhe pozicioni i saj. Edhe këtu gjejmë vlerësimin se fjalia e nënrenditur kryefjalore është valencë e foljes që zakonisht është në vetën e tretë njëjës kalimtare të diatezës veprore ose pësore ose jokalimtare. Funksioni i saj si kryefjalë përcaktohet nga kuptimi leksiko-gramatikor i foljes që mund të tregojë kumtim, perceptim, proces të menduari, dëshirë, vullnet, ose një thënie që vlerësohet nga një pikëpamje nga fjalia drejtuese.

4.4.3. Fjalitë argumentore në frazë

Në këndvështrimin gjenerativist ato që pamë deri tani si fjali ftilluese (ku siç vumë re nga studiuesi në studiues kishte edhe ndryshime në nënllojet që përfshiheshin brenda këtij emërtimi, por e përbashkëta është se flitet kryesisht për fjalitë kryefjalore, kundrinore e

[294] Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe – përbërësit sintaksorë (vështrim i ri teorik)*", Ilar, Tiranë, f. 356.
[295] Rushiti, R. (2015). *Frazat lidhëzore në gjuhën shqipe*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, f.29.

kallëzuesore) quhen ***fjali argumentore***. Këto fjali përbëjnë argumentet për foljet e fjalive me të cilat lidhen dhe një nga kriteret për t'u klasifikuar si argumente është se ato janë *të domosdoshme* për kuptimin e këtyre predikateve ndryshe nga rrethanorët të cilët me pak përjashtime siç e kemi sqaruar janë fakultativë. Për të saktësuar konceptin e domosdoshmërisë së këtyre fjalive në raport me fjalinë drejtuese së pari duhet të shqyrtojmë me kujdes marrëdhënien që ato ndërtojnë me fjalinë nga e cila varen. Vërejmë se fjalitë drejtuese/kryesore në frazë nuk janë të pavarura sidomos në rastin kur predikati i tyre është i pangopur në valencat e tij dhe këto valenca mund të mbushen me argumente të cilat dalin edhe me vlera fjaliore. Në këtë rast flasim për fjali argumentore. Kjo lidhet me konceptin e valencës të cilin e kemi sqaruar më lart. Graffi[296] sqaron se ndërtime të tilla si:

(251) a) *Thuhet
b) *Provohet katërcipërisht.

dalin jogramatikore dhe duhet të jenë detyrimisht të shoqëruara nga fjali të tjera. Në këto raste lind nevoja të diskutohet e sqarohet fakti nëse është fjalia e quajtur *kryesore* ajo që shpreh mendimin kryesor. Për të sqaruar më mirë këtë pikë të diskutueshme të analizës tradicionale, Graffi i drejtohet pikërisht teorisë së valencës duke vënë në dukje se është nevoja e foljes (në rastin tonë *thuhet* e *provohet*) që të kenë të shprehur argumentet që mund të jenë të shprehura edhe me fjali. Ashtu siç ndodh me kategoritë përbërëse në fjalinë e thjeshtë, edhe struktura e fjalisë drejtuese e frazës mund të plotësohet përmes argumenteve - fjali të varura. Për arsye të pamundësisë së qëndrimit të vetme të këtyre fjalive ne do e quajmë fjali *drejtuese* e jo *kryesore* atë fjali e cila plotësohet nga fjali të varura prej saj, ndërsa *fjali kryesore* do të quajmë ato fjali prej të cilave nuk varen fjali të tjera.
Përbërësit e frazës mund të jenë argumente ose adjunktë (shtesorë). Dimë se ndër argumentet e një foljeje përfshihen kryefjala e kundrinori. Në përshtatje me objektin e studimit tonë lind nevoja e sqarimit të kriterit të dytë të klasifikimit të tyre: *caktimi i roleve tematike*. A u caktohen role tematike fjalive kryefjalore e kundrinore? Nëse po, a u caktohen këtyre fjalive të njëjtat role tematike si sintagmave emërore që kryejnë funksionet e kryefjalës apo kundrinorit?
Për këtë duhet të krahasojmë caktimin e roleve tematike të argumenteve në një fjali me caktimin e roleve tematike në një frazë me fjali kryefjalore apo kundrinore.

(252) a) Vajza di të vërtetën.
b) Vajza di që nuk i thanë të vërtetën.

Së pari vemë në dukje që folja ***di*** është folje dyvalente dhe kërkon të ketë të shprehur një argument të jashtëm kryefjalë [+human] në rastin e fjalive (252.a) e (252.b) [SE *vajza*] e

[296] Graffi, G. (2003). *Sintaksa - strukturat e ligjërimit*, Dituria, f.132 - 133.

cila në të dy fjalitë mer rolin tematik të vepruesit, dhe një argument të brendshëm (komplement) në funksionin e kundrinorit që në (252.a) është [SE të vërtetën] së cilës i caktohet roli tematik i temës, ndërsa në (252.b) argumet i brendshëm është sintagma komplementuese [SK *që nuk i thanë të vërtetën*] e cila kryen pikërisht funksionin e kundrinorit. Ajo që duam të sqarojmë është ***nëse i caktohet një rol tematik edhe sintagmës komplementuese ashtu si SE në (2.a)***?
Nga një vështrim i kujdesshëm i fjalisë kuptojmë se jo gjithmonë funksioni sintaksor përcakton rolin tematik. E kemi parë edhe më herët në punimin tonë këtë. Le të shqyrtojmë rastin e kalimit të foljes në joveprore:

(253) E vërteta dihet nga vajza.

Vërejmë se pavarësisht se kemi kalimin e kryefjalës në kundrinë të zhdrejtë [SP nga vajza], ky ndryshim funksioni nuk shoqërohet me ndryshimin e rolit tematik. Në fjalinë me shndërrimin në pësore, argumenti i jashtëm SE *e vërteta* sërish mbetet *tema*, ndërsa argumenti SP ka rolin e *vepruesit*. Në (252.b) ku argumenti është i shprehur me sintagmë komplementuese nëse provojmë ta zëvendësojmë krejt këtë sintagmë do të dilte *Vajza di atë/diçka*. Në këtë rast mund të themi që SE që zëvendësoi SK merr rolin tematik të temës. Që një SK mund të ketë rolin tematik të temës, e gjejmë edhe në një shembull mbështetës në *An Introduction to Syntactic Analysis and Theory*[297] ku *Mary thinks* <u>*that it is raining*</u> paraqet një ndërtim me SK. Në këtë pikë mund të bëjmë pohimin se fjalive mund t'u caktohen role tematike kur ato janë argumente të një predikati të një fjalie drejtuese.
Problemi që lind nga ky pohim lidhet me rastet kur argumenti në gjuhën shqipe është i shprehur për të njëjtin predikat si në fjalinë drejtuese, ashtu edhe me fjali argumentore, e meqenëse predikati cakton vetëm një herë një rol tematik, çfarë rolesh marrin këto fjali?
Të shohim shembujt:

(254) a) [SK *Se duhet punuar shumë për suksesin*], [SE *kjo*] dihet nga të gjithë.
b) [SK *Që ishte i mençur*], [SE *këtë*] e pranonin të gjithë.
Në të dy frazat e mësipërme vërejmë se kemi të bëjmë me SK në funksionet e subjektit në (254.a) dhe objektit në (254.b). Ajo që vemë re është se edhe fjalia drejtuese i ka të realizuara këto funksione sintaksore me dëftorë: respektivisht (254.a) <u>*kjo*</u> dhe (254.b) <u>*këtë*</u>, pra duket se valencat e predikateve të fjalive drejtuese i kanë të realizuara argumentet e kryefjalës e kundrinorit. Si shpjegohet prezenca e dy kryefjalëve dhe dy kundrinorëve për të njëjtën folje? Cilës prej tyre folja i cakton rolin theta, SE apo sintagmës komplementuese SK? Nëse predikati cakton një herë një rol theta, cila prej sintagmave në të njëjtin funksion sintaksor nuk merr një rol theta? Së fundmi lind nevoja të sqarojmë se në ç'pozicion

[297] Sportiche, D.; Koopman, H.; Stabler, E. (2014). *An Introduction to Sintactic Analysis and Theory*, Wiley Blackwell, f.142.

realizohen këto argumente të dubluara? Referuar (254.a) është e pamundur të kemi dy sintagma në pozicionin e specifikuesit për SF *dihet.*

Një rast të ngjashëm me (254.a) e kemi parë në kapitullin e dytë kur trajtoheshin ndërtime me dy caktuesorë (§ 2.5 f.44-45). Duke iu referuar Mitës (2005, 33) dhe Turanos zgjidhja e rastit të shqipes në ndërtime të tipit *ky djali* ku SE shfaqej me dy determinantë *ky* dhe *–i*, u bë përmes *sintagmës të së njohurës* (SNjoh). Logjika e asaj analize të bërë nga Mita na duket e përshtatshme për t'u aplikuar edhe në këtë segment sepse në të dy rastet qoftë të SNjoh, qoftë në frazat me SK të tipit (254.a) kemi dy pretendentë për pozicionin Spec në raport me SEpt të fjalisë drejtuese. Ajo çfarë ndodh është se SK shfaqet si specifikues i sintagmës së komplementuesit SK, ndërsa [$_{SE}$ *kjo*] realizohet në pozicionin e specifikuesit të SEpt.

Skema 75.



Vërejmë se përemrat dëftorë në dy ndërtimet u referohen sintagmave komplementuese që në (254.a) është subjekt e në (254.b) është kundrinë. M.Totoni e sheh këtë si rimarrje në fjalinë kryesore të fjalisë së nënrenditur.[298] Nëse heqim fjalitë argumentore, do të kishim fjali me ndërtim të saktë gramatikor, por që kërkojnë patjetër informacione të dhëna paraprakisht në ligjërim të cilave u referohen. Kjo bën që të kuptojmë se kemi të bëjmë me anafora.[299] Trajtimin e këtij fenomeni e gjejmë edhe te B.Liko[300] e cila analizon këtë fenomen. Autorja mbështet tezën që folja i cakton rol tematik vetëm sintagmës

[298] Totoni, M. (2012). *Sintaksa e gjuhës shqipe - Fraza e përbërë*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Arbëria, Tiranë, f.25.

[299] Çepani, A. (2007). Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe, *Studime filologjike*, Nr. 3-4, f.100.

[300] Liko, B. (2017). *Trajtimi gjenerativist i përbërësve të frazës në planin funksional*, tezë doktorale, f.134-136.https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/03/Brikena-Liko-varianti-p%C3%ABr-web-doktorata.pdf&attachment_id=0&dButton=false&pButton=false&oButton=false&sButton=true&pagemode=none&_wpnonce=e08a010ae6

komplementuese dhe ky përemër nuk është argument. Këtë përfundim e arrin bazuar te Turano e cila njeh praninë e një *pro plotësuese* (angl, *pro expletive*, it. *pro espletivo*) që është një *kryefjalë bosh* e që shërben për të mbushur pozicionin e kryefjalës kur kësaj të fundit i mungon roli tematik. Paravendosja e fjalisë së nënrenditur shoqërohet me shfaqjen e përemrit që e rimerr atë. Lëviz fjalia e nënrenditur argumentore duke lënë gjurmë në pozicionin fillestar. Përemri nuk është i domosdoshëm, por thekson informacionin e fjalisë së nënrenditur. Në rast të vendosjes pas fjalisë së nënrenditur, nuk do kishim shfaqjen e këtij përemri meqë në atë pozicion nuk mund të rimerret një informacion që nuk është dhënë. Së dyti, kjo mund të shpjegohet edhe nga pikëpamja strukturore. Gjatë paravendosjes së fjalisë së nënrenditur, krijohet një vend bosh që krijon mundësinë e vendosjes së këtij përemri.[301]



Kemi parë përgjatë shqyrtimit të fjalisë e më pas të frazës që argumentet mund të shprehen me SE, SP, SNd dhe me SK. Meqënëse duam të analizojmë fjalitë argumentore, pra argumentet e shprehura me fjali, përndryshe SK, në këtë pikë të zhvillimit të analizës sonë lind nevoja të kuptojmë ***nëse ka një kusht të caktuar apo ka folje që kanë tipare të veçanta që kërkojnë që një nga argumentet të jetë i shprehur me SK***?

Folja e fjalisë drejtuese duhet të kërkojë t'i plotësohet kuptimi përmes veprimesh e gjendjesh, meqenëse fjalitë argumentore nuk mund të emërtojnë njerëz dhe sende konkrete. Pra marrja e një argumenti SK lidhet me kuptimin e foljes. Nëse do i drejtoheshim një liste të reduktuar të foljeve në shqipen që janë cituar nga gramatikanët tanë si folje që marrin argumente të ndërtuara me SK do kishim:

autorizoj, bëj thirrje, bërtas, çirrem, dëftoj, deklaroj, dëshiroj, dëshmoj, dua, duhet, duket, ëndërroj, flitet, gënjej, grindem, kërcënoj, kërkoj, këshilloj, kritikoj, kujtoj, kundërshtoj, lajmëroj, lejoj, lëvdohem, lipset, lutem, miratoj, mohoj, ndaloj, ndodh, njoftoj, njoh, padit, paralajmëroj, parapëlqej, përfundoj, përgjigjem, përmend, përsërit, pëshpërit, pohoj,

[301] Po aty, f. 141.

porosit, pranoj, propozoj, provoj, qëllon, qahem, qortoj, raportoj, rekomandoj, rrëfej, shënoj, shkruaj, shpall, shpjegoj, shtoj, theksoj, them, thërras, thuhet, tregoj, udhëzoj, urdhëroj, uroj, vërtetoj,etj.
Le të shohim se cilin nga argumentet kërkojnë që të jetë SK për disa prej tyre për të kuptuar si duhet ndërtuar analiza:

autorizoj- është folje që kërkon që argumenti i jashtëm të ketë tiparet [+, - human] që nënkupton që mund të jetë një SE, por nuk mund të jetë një SK, ndërsa argumenti i dytë me funksionin e kundrinorit mund të dalë përveçse me SE edhe me SK:
[$_{SE}$ Komandanti/ Komanda] autorizoi [$_{SE}$ tërheqjen] [$_{SP}$ nga fushëbeteja].
[$_{SE}$ Komandati/ Komanda] autorizoi [$_{SK}$ *që trupat të tërhiqen*].

besoj – mund të marrë SK në funksion të kundrinorit. Argumenti i jashtëm duhet të ketë tiparet [+human], pra nuk mund të jetë një SK.
[$_{SE}$ Albani] beson [$_{SE}$ shokët].
[$_{SE}$ Albani] besonte [$_{SP}$ te shokët]
[$_{SE}$ Albani] *u* beson [$_{SE}$ shokëve.]
[pro] Beson [$_{SP}$ te shokët].
[pro] Besoj [$_{SK}$ se së shpejti do dalin rezultatet.]

dëshmoj – mund të marrë SK qoftë në funksion të kryefjalës e qoftë në funksion kundrinori.
[$_{SE}$ Të pranishmit] *i* dëshmuan [$_{SE}$ ngjarjen] [$_{SE}$ hetuesit]
[$_{SE}$ Vajza] dëshmoi [$_{SK}$ se kishte parë gjithçka].
[$_{SK}$ Të luftosh për idealet e tua] dëshmon [$_{SE}$ karakter të fortë].
[$_{SK}$ Të jesh i matur] dëshmon [$_{SK}$ se ke eksperiencën e mjaftueshme]

Nuk është qëllim i punimit tonë evidentimi dhe analiza e të gjithë foljeve që do të merrnin një sintagmë komplementuese si argument prandaj nuk do ndalemi gjatë në analizën e mësipërme.

Përfundime:
Nga kjo analizë vemë re që:
- ka folje që mund të marrin dy argumente të shprehura me SK, në funksion të objektit e të subjektit.
- Foljet që kërkojnë argumentin e jashtëm me tipar [+human] nuk mund të marrin një SK që përbën argumentin e jashtëm.
- kërkesa e foljeve për argument të jashtëm me tipar [+human] nuk kushtëzon disa folje për të marrë argumente të brendshme të shprehura me fjali argumentore.
-kalimi i një foljeje nga veprorja në joveprore shoqërohet me ndryshimin e numrit të argumenteve.

4.5. A mund të flasim për sintagma foljore të pashtjelluara?

4.5.1. Hyrje.

Një ndër çështjet e diskutuara gjerësisht në Sintaksën e shqipes lidhet me format e pashtjelluara. A përbëjnë ato ndërtime me vlerë fjaliore? Gjuhëtarët janë ndarë në këtë pikë dhe shpesh kriteret që përcaktojnë këtë karakteristikë të tyren nuk bashkëpërkojnë. Duke parë me interes çështjen si dhe duke dashur të qasim gjuhësinë gjenerative në trajtimin e këtyre përbërësve të frazës, e pamë të arsyeshme të përfshijmë në punimin tonë edhe një kapitull lidhur me trajtimin e ndërtimeve të pashtjelluara standarde e gege në sintaksën gjenerative të shqipes.

Fillimisht në kapitull do paraqesim një vështrim historiko-krahasues lidhur me njohjen ose jo të predikativitetit të këtyre formave, funksionin dhe vendin e tyre në frazat e nënrenditura. Më pas do të paraqesim trajtimin gjenerativ të këtyre formave të pashtjelluara duke u përqendruar edhe në paraqitjen skematike të tyre.

Së fundmi do t'i drejtojmë sytë në krahasimin e formës që ka tërhequr vëmendjen më të madhe, është fjala për paskajoren gege dhe ndryshimet strukturore e kuptimore që ndodhin në rastet e zëvendësimit të saj me mënyrën lidhore.

4.5.2. Vështrim historik në disa gramatika të shqipes për trajtimin e predikativitetit të formave të pashtjelluara në fjalitë e varura

Predikativiteti i formave të pashtjelluara është një çështje e diskutuar shumë në gjuhësinë shqiptare. A.Xhuvani thotë se *fjali të lidhuna bashkë quhen edhe ato që ndërtohen me mënyrën* ***paskajore*** *dhe* ***përcjellore*** *p.sh. Nxuna mirë me këndue e me shkrue; iku tue bërtitë*.[302] Këto lloj fjalish ai i quan fjali *të varme të pashtjellme*.

I.D. Sheperi i njeh ***paskajores*** aftësinë për të krijuar fjali të varura kushtore. P.sh. *me qênë i urtë, kishe me fitue shumë.*[303] Ajo ndërton gjithashtu edhe *fjali qëllimi: Kërkon të punojë (ose me punue), Vete të punojë (ose për me punue)*.[304] Ndërsa ***përcjellorja*** *krijon fjali kohe: Duke ardhur më thoshte*.[305]

J. Rrota i njeh paskajores sidomos në gegnisht aftësinë që *mund të rrijë edhe në vend të fjalivet të vërteta* e këto fjali quhen *fjali të zgidhuna*. Shembujt dhe funksionet janë:

1. fjali e subjektit: s'âsht njerzí me ia pré kuj fjalën në gojë;

2. fjali e objektit: Mendoj me shkue përjashta;

[302] Xhuvani, A. (1938). *Sintaksa shqip –pjes'e dytë për klasët e ulta të shkollavet të mesme*, SHB "Kristo Luarasi", Tiranë, f. 31.

[303] Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe – sidomos e toskënishtes- për shkolla të mesme*, Vlorë, ribot, Romë, 1972, f. 167.

[304] Po aty, f. 174.

[305] Po aty, f. 175.

3. fjali e atributit: Dishiri me u mbajtun dishka mbi tjerë të vërbon;
4. fjali (e advërbjarit) mënyrore: Në vend qi me punue, kërkon pijetoret;
5. fjali (e advërbjarit) rrjedhore: S' jam aqë i trashë, sa mos me të marrë vesht;
6. fjali (e advërbjarit) qëllimore: Kam ardhë me të ndihmuem;
7. fjali (e advërbjarit) qyshkore: me e diejtë nieri kur des, i a bân vorrin vetit. [306]
Pjesorja sipas J. Rrotës mund të rrijë në vend të fjalive të dyta në rastet kur zëvendëson:
1. nji fjali atributit: Jo; nji djalë të ri, dhanë kaqë fort mbas pijet e lojet, s'kam ndeshë kund endè;
2. si fjali advërbjarit mënyrore: Me të zi e kapem atë natë shpín, lagë e bâmë shkalc prej rruget;
3. nji fjali advërbjarit shakore: Rrethuem prej anmikut, dhe lodhun e fikun unit, qyteti s'pat kahë me i mbajtë, e rá në dorë;
4. nji fjali advërbjarit qyshkore: Luâjt, marrë qysh të vogjël, mund të zbuten pa të vështirë;
5. nji fjali advërbjarit lêjore a konçesive: Shkrimi, me gjithse grisë prej motit, mund të lexohej mjaft mirë.[307]
Po sipas tij përcjellorja (gjerundi) mund të zëvendësojë në fjali të dyta:
1. kohore: tue këthye (ndërsa këthejshem) në shpí, më rá në mend puna jote;
2. qyshkore: Tue m'a pague mirë (ne m'a paguejsh mirë), ndoshta më mbushet mendja m'e shitë;
3. lêjore: Tue mundun me shkue (me gjith se mund të shkojsh) me tjerë, me sa mend don me ndêjë mbas shokësh?
4. shkakore: Tue më dhimbtë kështû kryet (mbasi po më dhemb), s'kam si vij në shkollë;
5. mënyrore: Fëmijët duelen prej shkollet tue këndue e tue bërtitë të madhe.[308]
K. Cipo thotë se *kur është në trajtë të pashtjellur, fjalia shkajkore, ahere gjëndet në mënyrën përcjellore: P.sh. Duke ditur (fj. shkajk) që beteja do të mbante shumë kohë, Skënderbeu i vuri ushtarët të hanë mëngjezin posa kish nisur të zbardhullonte agimi.*[309]
Gjithashtu kemi fjali kohore:
- me asnjanësin e paçquar të pjesores me parafjalën me në krye: p.sh. Me të parë Skënderbeu të dy krahët e ushtërisë së tij të fituar, bëri një sulm tjetër, u vërvit si shigjetë në mes t'armiqve.
-me asnjanësin e paçquar të pjesores dhe me fjalën një në krye. P.sh. Një të marrë mjeku djalin, e shpuri në shtëpi.
-me asnjanësin e shquar të pjesores: të marrët djali shaminë e së bukurës së dheut, u kthye sakaqë në shtëpi.

[306] Rrota, J. (1942). *Sintaksi i shqipes për klasën II, III, IV, K.U. të shkollavet të mjesme*, "A.GJ. Fishta", Shkodër, ribotim i tretë, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. 99-100.
[307] Po aty, f. 100-101.
[308] Po aty, f. 101.
[309] Cipo, K. (1952). *Sintaksa*, Instituti i shkencave, Tiranë, f.89.

- me mënyrën përcjellore. P.sh. Duke parë Skënderbeu të dy krahët e ushtërisë së tij të fituar, bëri edhe një sulm tjetër.[310]
Për fjalinë krahasore thekson se *nuk kanë trajtë të pashtjelluar në toskërishtet*.[311]
Fjalia qëllimore mund të jetë e shprehur *me mënyrë të pashtjellur d.m.th. me anë të lokucionit për të + particip.p.sh. Nuk është për t'u çuditur*.[312]
Për fjalinë kushtore e pranon që *rrallë mund të kemi ndërtim kushtor me formë të pashtjellur. P.sh. E drejta e të dhënit urdhër mund të fitohet vetëm me të patur durim (=vetëm në paçim durim); pa bërë dëm, s'të thotë njeri plaç(në qoftë se nuk bën dëm), Duke u martuar në këse rrethanash të ngushta, të cilat pa dyshim s'ishin për dasmë, Skënderbeu do të futte zjarrin në shtëpi të tij*.[313]
Për fjalinë e mënyrës thotë që mund të ketë *gjerunt* dhe *particip*, për lejoren thotë që *rrallë mund të gjejmë ndërtime me mënyra të pashtjelluara. P.sh. Pa qenë të urdhëruar (=ndonëse nuk qenë të urdhëruar) nga njeri, vajtnë e u bënë tre nga tre*.[314]
Në fjalinë kushtore janë ndërtimet *me lokucionin parafjalor për të + particip. P.sh. Ish bukë për t'ua hedhur pulave*.[315]
M. Domi në tekstin për shkollën shtatëvjeçare "Gramatika e gjuhës shqipe - Sintaksa" shkruan: *Si kallëzues foljor mund të kemi jo vetëm një folje të mënyrës paskajore a përcjellore, por edhe një folje të mënyrës pjesore në trajtën e një mbiemri foljor të rasës emërore a kallëzore. P.sh. Një të parë t'ëmën, fëmija u hodh dhe e përqafoi. Të hymen ti, ra zilja*.[316] Më pas bën dallimin mes fjalive të shtjellura e atyre të pashtjellura duke theksuar për këto të fundit se mund të jenë me kallëzues në paskajore, pjesore, përcjellore kur mund t'i kthejmë në fjali të shtjelluara. P.sh. Do dal në Pazar për të blerë qershi (= që të blej qershi). Duke shkuar rrugës (= ndërsa shkoja rrugës), pashë tët vëlla.[317] Ai i njeh paskajores gege mundësinë për të krijuar fjali kryefjalore: *Duhet me qenë i papërkulshëm përpara vështirësivet e pengesavet*;[318] gjithashtu edhe fjali kundrinore: *S'deshi me ardhë me mue*.[319]
Po kështu thotë *për fjalitë caktuese: Ardhi koha për t'u nisur ose për me u nisë.*
Fjalia kohore[320] mund të jetë *e pashtjellur* e të ketë foljen në mënyrat *pjesore, përcjellore* e *paskajore*. Fjalia shkakore gjithashtu mund të jetë e ndërtuar me *përcjellore e pjesore* e shpesh me *paskajoren gege*: Sa gëzohem me të pamë ty shëndosh e mirë.[321]
Fjalitë qëllimore *të pashtjellura* ndërtohen:

[310] Po aty, f. 89-90.
[311] Po aty, f. 91.
[312] Po aty, f. 92.
[313] Po aty, f. 96.
[314] Po aty, f. 97.
[315] Po aty, f. 97.
[316] Domi, M. (1955). *Gramatika e Gjuhës shqipe, Pjesa e dytë, Sintaksa, tekst për shkollën shtatëvjeçare*, Tiranë, f. 33.
[317] Po aty, f. 163.
[318] Po aty, f. 192.
[319] Po aty, f. 197
[320] Po aty, f. 212.
[321] Po aty, f. 222.

*a) me paskajoren e dytë formuar nga pjesorja e shoqëruar nga shprehja **për të**: Për të kaluar klasën duhet punë e regulltë;*
*b) në gegërishte me paskajoren ose me paskajoren të shoqëruar nga parafjala **për:** Kam ardhë me u fjalosë me ty. Vajta në Pazar për me blemë zarzavate.*[322]
Fjalitë mënyrore ndërtohen me *përcjelloren, me pjesoren* shoqëruar me fjalëzën ***pa***, në gegërisht me *paskajore* shoqëruar nga lidhëzat ***si, sikur, sikurse***.[323]
Fjalitë krahasore me *paskajoren gege* të shoqëruara nga ***si, porsi***. Po këto fjali mund të merren edhe si fjali të mënyrës. P.sh. *Mos i merr punët me të tallme, si me qenë fëmi*.[324]
Fjalitë rrjedhore *të pashtjellura* ndërtohen me *paskajore* ndonjëherë të shoqëruar nga lidhëza ***sa*** dhe me *paskajoren e dytë **për të / për me** + pjesore*. [325]
Fjalitë kushtore *të pashtjellura* ndërtohen me *pjesore* e shoqëruar nga parafjala ***pa***, *përcjellorja* dhe *paskajorja gege*.[326]
Fjalitë lejore *të pashtjellura* ndërtohen me *pjesore, përcjellore e paskajore*.[327]
Në "Albanian Grammar"[328] të Martin Camaj (1984, 234) paskajores gege i njihet aftësia për të ndërtuar fjali urdhërore të buta[329] si: ***me më ndihmue** në këtë punë*. Në shembujt e tjerë që përdor në këtë gramatikë u njeh predikativitet edhe formave të tjera të pashtjelluara si në rastin kur jep sqarimet për mungesën e rolit të formave të pashtjelluara në përshtatjen mes kryefjalës dhe kallëzuesit: *qe, isha **tue ardhë** (**duke ardhur**)*. f. 237, ashtu edhe kur trajton fjalitë e bashkërenditura dhe të nënrenditura sipas mënyrës së lidhjes së tyre: duke përdorë formën pa+pjesore: ***pa punue (punuar)** s'i del kujt buka,* apo paskajoren *si me lé, ashtu me dekë. f.243.* Gjithashtu format e pashtjelluara shihen si kallëzues te:
- fjalitë kryefjalore: ***me u bâ** zot i vehtes, lypet prej çdo të riut*. f.247,
- fjalitë kundrinore: *Zoja dinte **me bâ me hangër** mirë; e pau **duke shkuar** rrugës; si ka mujtë **me i rá** në tê se unë jam grue e jo burrë.* f.247
- fjalitë përcaktore: *ishte i vocërr i vocërr, qi me më zi **me e pá**; **me** ia **pasë** lakmi gjithkushi.* f.248.
- fjalitë kohore: ***pa mos thënë** një, nuk bëhen dy; **për pa vdekë**, s'kam **me ta harrue** nderën; **me një të ardhur** nga puna, Agimi mori e shkroi letrën; **duke udhëtuar** Sofroni pau vende shumë të bukura*. f.249.
- fjalitë shkakore: *milingona, **duke mos ditur** not, u mbyt; **tue mos ditë** gjuhën e huej, merrej vesh me shenja*. f.250.
- fjalitë kushtore: ***me vrá** grueja burrin e vet a këdó, prindja e kësaj do t'apin arsye për atë gjak; **me ndejë** në shpi, s'më len grueja, **me dalë** në arë, më han harusha*. f.252.

[322] Po aty, f. 226.
[323] Po aty, f. 230.
[324] Po aty, f. 234.
[325] Po aty, f. 237.
[326] Po aty, f. 242.
[327] Po aty, f. 248.
[328] Camaj, M. (1984). *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries,* collaborated on and translated by Leonard Fox, , Otto Harrassowitz. Wiesbaden.
[329] Po aty, f. 234: "*In Geg, mildly imperative sentences are often constructed with te **Infinitive***".

- Fjalitë mënyrore: *këqyrte në hapësí si **me qenë** i verbët; Yjtë e ndezur aqe larg/lozin vallen e dëshirës/**dyke ndrityr** varg e varg/ nëpër terr të hapësirës*.f.253.
- Fjalitë lejore: *gjithsí **me e dhogaritë**, nuk del ndryshe hesapi; edhe **duke m'u lutur**, s'shkoj atje ku doni ju*.f. 254.
- Fjali qëllimore me ndërtimet ***për të fitue (fituar)**; **për me fitue**; **për të mësuarë** botën, i vjen ndoresh shumë; Kush asht trim e kush asht djalë/**për me ma zanë** blegën në mal; **Për me mujtë me hypë** njéri te Zoti, i u desht Zotit me zdrypë te njéri*.f. 255.
- Fjali krahasore*: lumi ishte aq i cekët, sa **me e kalue** me parmendë; ma mirë me urue se **me nemë***. f.256.

Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme, në *Gramatika e shqipes 2* të ASHSH-së (2002), formave të pashtjelluara të shqipes u njihet vlera predikative vetëm në rastet kur e kanë të shprehur kryefjalën e tyre[330] ndërkohë që në raste të tjera, ato nuk mund të krijojnë fjali brenda frazës edhe nëse kanë një kryefjalë të përbashkët me kallëzuesin e fjalisë drejtuese, edhe nëse zgjerohen me gjymtyrë si kundrinorët apo rrethanorët. Problemin e vlerësimit apo jo si kallëzues të këtyre formave e gjejmë më vonë të trajtuar nga M.Domi në artikullin "Mbi funksionin sintaktik të ndërtimeve me trajtat foljore jovetore" që botohet për herë të parë në përmbledhjen I të veprës së tij më 2013. Pasi analizon qëndrimet ndaj formave të pashtjelluara në gramatika të huaja dhe thellohet në analizën e tipareve dhe karakteristikave të secilës formë të pashtjelluar, autori shprehet në përfundime se "*... ne mendojmë se kemi arsye të shumta, të mjaftueshme për të pranuar vlerën kallëzuesore të trajtave të paskajores së varur e të përcjellores në përgjithësi e të ndonjë përdorimi të pjesores e për t'i marrë ndërtimet përkatëse sinonimike të fjalive të varura të zakonshme, si fjali të varura të tipit strukturor të veçantë. Në vështrimin e përgjithshëm të fjalive të nënrenditura mund të bëhej diskutimi i çështjes, duke u vënë në dukje vlera kryesisht fjaliore e këtyre ndërtimeve, veçoritë e tyre, me shpjegimin ndoshta të pozicionit të veçantë të tyre.*"[331]

Qëndrime të ndryshme për predikativitetin e këtyre formave gjejmë edhe te studiuesit Osman Myderrizi, Salih Kolgeci, Stefan Prifti, Spiro Floqi, Menella Totoni, Remzi Përnaska, Mehmet Çeliku e Seit Mansaku. Studime për këto forma e sidomos të paskajores janë bërë edhe nga studiues të tjerë e mund të përmendim këtu Shaban Demiraj (Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, 1965; Gjuhësi ballkanike, 1994), Selman Riza (Sistemi foljor i letrarishtes, 1994), Besim Bokshi (Pjesorja e shqipes, 1998), Mehmet Çeliku (Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe, 2000), Nuhi Veselaj

[330] ASHSH, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe* 2, ILGJ, Tiranë, f. 180.
"*Mungesa e treguesve morfologjikë për mënyrën, kohën e vetën dhe arsyet që u vunë në dukje më lart, bëjnë që forma të tilla të pashtjelluara të mos u përgjigjen të gjitha kërkesave të kallëzuesit (i cili nuk mund të kuptohet jashtë lidhjes kallëzuesore), po ashtu as edhe kërkesave të gjymtyrës kryesore të një fjalie njëkryegjymtyrëshe të nënrenditur. Prandaj, vetëm në ato raste kur format e pashtjelluara lidhen me një emër a përemër në rasën emërore, me të cilin hyjnë në marrëdhënie kallëzuesore, mund të flitet për funksion kallëzuesor të formave të pashtjelluara*."
[331] Domi, M. (2013). *Vepra I – Studime sintaksore*, *"Mbi funksionin sintaktik të ndërtimeve me trajtat foljore jovetore"*, Kristalina KH, Tiranë, f. 394.

(Paskajorja çështje e shqipes standarde, 2000), Tafil Kelmendi (Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore, 2010) etj.

4.5.3. Trajtimi i formave të pashtjelluara në sintaksën gjenerative

Objekt i studimit tonë është qasja gjenerative ndaj këtyre problemeve dhe kjo na çon në hulumtimin rreth mënyrës si shihen dhe si analizohen lidhjet që ndërtojnë këto forma të pashtjelluara me përbërësit e tjerë. Më pas natyrshëm kuptohet nëse kanë apo jo vlera të një fjalie.

Me zbatimin e teorive të sintaksës gjenerative diskutimet lidhur me këtë çështje anojnë në vlerësimin si fjali të nënrenditura me kryefjalë PRO, përveç rasteve kur kanë të shprehur kryefjalën e tyre. Këtë pohim për shqipen e gjejmë te Buxheli[332]kur shprehet se *kategoria PRO ndeshet në fjali të varura të pashtjelluara pra në fjali me EPT [-Pr, -K].*♦ Një kryefjalë PRO është një kryefjalë e pashprehur fonetikisht, ndryshe nga **pro** që i përket mospërdorimit të përemrave vetorë të vetës së parë e të dytë në shqip:

(155) a. Ata shtyheshin PRO për të parë.
b. Hyri në shtëpi PRO pa/duke ndezur dritën.
c. PRO me të thënë këtë, ia mbathi.

Për të kuptuar më shumë për predikativitetin e formave të pashtjelluara dhe për të kuptuar sintagmën në të cilën ato përfshihen i drejtohemi së pari ndërtimit të tyre, elementit që i dallon këto forma nga njëra-tjetra: pjesëzat ***me, për të, duke, pa, me të, një të***. Ajo që dimë për të gjitha format e pashtjelluara që ndërtojnë këto pjesëza, është që atyre u mungojnë kategoritë e kohës, vetës e numrit. Kjo na çon në përfundimin që nuk mund të kenë si projeksion eptimin, domethënë nuk mund të jenë SEPT. Formave të pashtjelluara u mungon edhe kategoria e mënyrës, pra ato nuk mund të jenë as sintagma mënyrore SM. Na mbetet të kuptojmë nëse këto forma të pashtjelluara janë sintagma foljore SF. Le ta mendojmë që kjo hipotezë qëndron. Atëherë pjesëzat që ndërtojnë këto forma të pashtjelluara duhet të jenë në pozicionin e specifikuesit të SF, por ne sapo vumë në dukje që këtyre formave u njihet një kryefjalë PRO që mund të jetë e njëjtë ose jo me kryefjalën e pjesës drejtuese. Kjo rrëzon edhe hipotezën që format e pashtjelluara janë SF të thjeshta meqë në to nuk ka vend për vendosjen e elementeve (pjesëzave) që përcaktojnë llojin e formës foljore siç kuptohet qartë në skemën e mëposhtme:

[332] Buxheli, L. (2007). *Modelet e caktimit rasor në gjuhën shqipe*, Neraida, Tiranë, f. 105.

♦ Analizën për këto forma të pashtjelluara e gjejmë edhe nga Koleci, F. (2011). Paskajorja dhe ndërtimet e tjera foljore të pashtjelluara in Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLSH, Tiranë, f.129-138.

(156) …sepse paratë nuk mjaftojnë kurrë për të blerë lirinë... (B. Blushi, Të jetosh në ishull, f. 227)

Skema 76.



Kananaj[333] i sheh format e pashtjelluara si **folje**, duke theksuar se shtjellueshmëria është një tipar nënkategorial. Studiuesja mbështetet në gjykimin e Brian Joseph[334] (2003), i cili thotë se paskajorja është një folje e pashtjelluar dhe jo formë e pashtjelluar foljore, për të mbështetur arsyetimin se tipari kategorial i përbërësve të tipit *pa + pjesore, duke + pjesore, me të + pjesore, një të + pjesore, për të + pjesore* është ai i foljeve; si të tilla, ato konsiderohen **folje** dhe jo më forma foljore. Në trajtimin gjenerativ, sipas parimit të projeksionit të zgjeruar, vihet re se kategoria zero përfaqëson sintagma që nuk realizohen fonetikisht, pra janë [-shenjues fonetik], por që kanë një funksion të caktuar në planin sintaksor [+shenjues sintaksor]. Kananaj vëren se këto forma kanë **strukturë argumenti** dhe se janë gjithmonë fjali të nënrenditura. Megjithëse fjalitë e nënrenditura kanë statusin e SL, foljet e pashtjelluara nuk mund të marrin këtë status, pasi një gjë e tillë do të prodhonte ndërtime jogramatikore. Format e pashtjelluara kanë statusin e **sintagmave kohore (TP/ SKoh)**, por me tiparet [-Kohë, -Përshtatje]. Në bazë të Teorisë së Drejtimit dhe Lidhjes, pjesëzat *me/për/një* – në paralelizëm me to në anglishten – kanë funksionin e shprehjes së kategorisë funksionale [-Kohë, -Eptim], ndërsa pjesëzat *pa* dhe *duke* mbajnë tiparin [-Kohë], ndryshe nga ndihmëset *kam* dhe *jam*, të cilat bartin tiparin [+Kohë]. Në këtë kuadër, autorja dallon tre tipa strukturash argumentale. I pari përfshin **ndërtime me një argument**, ku argumenti i jashtëm mund të realizohet: (a) fonetikisht, nëpërmjet

[333] Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 170-174.
[334] Joseph, B. (1983). *The sincrony and diacrony of the Balkan infinitive: a study in areal, general, and historical linguistics.* Cambrige: Cambrige studies in linguistics, *Cituar sipas autores*.

kryefjalës në rasën emërore ose kallëzore përjashtimore, p.sh. *Ne do nisemi [pa dalë dielli]*; (b) si PRO i parealizuar fonetikisht, i kontrolluar nga kryefjala e fjalisë drejtuese, p.sh. *[PROi një të ardhur], ai filloi të jepte urdhra*; ose (c) si PRO i parealizuar i tipit *për të + pjesore*, p.sh. *[PRO për të humbur] është e lehtë, por [PRO për të fituar] është e vështirë*. Tipi i dytë përfshin **ndërtime me dy argumente**, një të jashtëm dhe një të brendshëm, ku: (a) argumenti i jashtëm PRO kontrollohet nga kryefjala e fjalisë drejtuese, p.sh. *Ne kursyem [PRO për të blerë orën]*; (b) nga kundrina e drejtë, p.sh. *Dhe atje ata panë një fëmijëi lindur [PROi për të qenë mbret]*; (c) nga kundrina e zhdrejtë, p.sh. *Atiji i mbetej [PROi vetëm për të rregulluar çatinë]*; ose (d) argumentohet nga një kryefjalë në rasën kallëzore përjashtimore, p.sh. *E pashë [djalin duke lexuar librin]*. Tipi i tretë përfshin **ndërtime me një argument të jashtëm dhe dy argumente të brendshme**, si në shembujt: *Dikushi kishte menduar [PROi për t'i vjedhur biznesin atij]* ose *E pa [punonjësin duke i dhënë ryshfet drejtorit]*. Këto dallime, dëshmojnë se format e pashtjelluara, edhe pse pa tipar kohe e përshtatjeje, kanë një strukturë të brendshme sintaksore të artikuluar dhe një sistem marrëdhëniesh argumentale të përcaktuara.

Në pemën e fjalisë bazuar në këtë analizë të lidhjes së përbërësve do të kishim këtë paraqitje për:

a) …duke/pa shkelur kujdesshëm …

Skema 77.



b) …për/ një/ me të dëgjuar lajmin…

Skema 78.



Probleme që kërkojnë thellim të analizës na dalin në interpretimin e rasteve kur këto forma të pashtjelluara dalin me pjesëzën ***u*** të joveprores, pjesëzës ***të*** të lidhores ose kur mes vetë pjesëzave të formave të pashtjelluara e pjesores futen elemente klitike. Për këto të fundit Savoia e Manzini arrijnë në përfundimin që "*kitikët dhe më në përgjithësi sistemet e eptimit, megjithëse i qëndrojnë një klasifikimi sipas tipareve tradicionale ose kategorive morfologjike, mund të shqyrtohen si kategori sintaksore, të mbështetura në cilësitë shenjuese të strukturave emërore. Këto kategori janë D(eterminant) për shquarësinë, R(eferencaliteti) për referimin specifik, Q(Kuantifikues) për cilësitë kuantifikuese, P(ersona) (ose veta) për cilësitë e referimit ndaj folësit ose dëgjuesit, Loc(ativus) (vendore) për referimin ndaj koordinatave hapësinore të kontekstit të diskursit, N(omen/emër) për cilësitë predikative të emrit; këyre mund t'u shtojmë edhe kategorinë Op(erator), të cilën e lidhim me cilësitë intensionale (qëllimore.shënimi ynë). Shprehur në terma tradicionalë N leksikalizon cilësinë e vetës së 3-të, P u përgjigjet vetës së 1-rë dhe të 2-të, Q cilësisë së shumësit. Gjinia nuk kategorizohet në mënyrë të pavarur, por reduktohet në ekzistencën e klasave emërore të ndryshme të lidhura me kategorinë N.*"[335] Është e pamundur që t'u drejtohemi atyre si SEPT meqenëse e arsyetuam edhe më lart që atyre u mungojnë elementet e eptimit. Kjo na vë përpara kërkimit të një analize të strukturave më të thelluar dhe zgjidhjen për këtë e ka propozuar Rizzi (1995)[336]. Flora Koleci[337] në *Paskajorja dhe ndërtimet e tjera foljore të pashtjelluara* në "Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes" e aplikon një analizë të tillë për shqipen duke sqaruar se në këtë sistem të quajtur *forcë – shtjellim* zë një vend me rëndësi sintagma e shtjellimit SShtj (Finiteness Phrase, FinP) e cila qëndron një pozicion më lart SEPT.

[335] Savoia. L. M & Manzini. M. R. (2015). "*Morfo-sintaksa e pjesores dhe paskajores në të folmen e Shkodrës*", in Savoia, L .M. Manzini M. R. & Baldi, B. (eds*)* ASHAK, (2015), *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë, f.167

[336] Shpjegimin e këtij sistemi të propozuar nga Rizzi e gjejmë në Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLSH, Tiranë, nga Turano në f. 94-98 si dhe në Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist* e Tiranë, f.174-177.

[337] Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist* e Tiranë. f. 129-138.

Ky sistem shpreh lidhjen selektuese mes sistemit komplementues dhe sistemit strukturor. Sistemi komplementues mund të ketë funksionin Topik që pasqyrohet në Topic Phrase (TopP) me kokën Top^0 e cila është një kokë funksionale që përcakton predikatin më të lartë brenda sistemit komplementues. Funksioni i tij është analog me atë të sintagmës së përshtatjes (AgrP) brenda sistemit të sintagmës SEPT që pasqyron lidhjen mes subjektit dhe predikatit gjithashtu. Po kështu edhe koka Foc^0 (e reja) projekton skemën e saj X-bar. SShtj, të cilën e përmendëm më lart, përmban pjesëzat ***të*** të lidhores apo ***me*** të gegërishtes. Pra në këtë sistem në pozicionin më të ulët të F zë vend forma bazë e foljes F^0, ndërsa në të majtë shtrihen veçoritë e ndryshme që ajo mbart. Kështu do të kishim në një pozicion më lart eptimin EPT, një pozicion më lart Eptimit tiparin e mënyrës M, pastaj në të majtë të pozicionit MP projektohet sintagma kokë e së cilës është shtjellimi $Shtj^0$, i cili në të majtë të tij ka projektimin e sintagmës Forcë (SForcë).
Kështu bazuar në këtë analizë do të kishim diagramin:

Skema 79.



Nga kjo paraqitje kuptojmë që në pozicionin më të ulët F^0 të jetë forma bazë e foljes, në M^0 të jetë pjesëza të e mënyrës lidhore, në $Shtj^0$ projektohen elementet e formës së pashtjelluar ndërsa pozicionet kokë të Forcës, Mënyrës dhe Eptimit mbeten bosh.
Kështu për ndërtimin e gegërishtes *me* + *pjesore* do të kishim:

Skema 80.



Ndërsa për ndërtimin *me të* + *pjesore* do të kishim:

Skema 81.



Tani le të shohim një rast të ndërtimit me pjesëzën ***u*** të joveprores ku SF ka si komplement një sintagmë parafjalore SP:

…zbriste për t'u këshilluar me shkoqitjen …(I. Kadare, Pallati.., f.125)

Skema 82.



Ndërkohë që në diagramën më poshtë do të kemi rastin e ndërtimit me një element klitik që si sintagmë (SKl) projektohet mbi sintagmën eptimore. Kjo do të kërkojë shtimin e një tjetër projeksioni mes SEPT dhe SM.
Sintagma foljore në këtë fjali merr si argument një SE ne funksionin e kundrinorit.

…duke i vështruar ato pjesë të trupit të saj… (I. Kadare, Dosja H, f. 12)

Skema 83.



Në analizën e ndërtimit të tipit *me e bâ*, (studim në të cilin autorët njësojnë morfologjinë me sintaksën që sipas studiueses Draçini mund të shpjegohet me eptimin[338], Manzini e Savoia identifikojnë pjesëzën *me* me leksikalizimin e një koke D në fushën C që fut ndryshoren që i përket argumentit D të pjesores. Meqenëse një kundrinor klitik paraprin formën e pjesores që ata e quajnë *të pandryshueshme*, lë të kuptohet që kjo e fundit zë një pozicion më të ulët në brendësi të fjalisë, pra pozicionin normal V të foljes. Kundrinën

[338] Draçini, Rr. (2020). Gegërishtja përmes studimeve të Leonardo M. Savoia in *Studimet albanistike në Itali*, ASHAK, (2020). Prishtinë, f. 376.

klitike, autorët e trajtojnë si leksikalizim të argumentit N të vargut emëror të projektuar nga folja.[339]

Skema 84.



Nëse krahasojmë diagramën e mësipërme me skemën 79 do vemë re që bëhet fjalë për një strukturë të ngjashme me atë të paraqitur nga Koleci (Koleci & Turano, 2011, 88) për sintagmën klitike. Duke iu referuar Sportiche-it, autorja sqaron që mes pozicioneve të sintagmës komplementuese CP dhe asaj fleksionale IP, klitikët si koka flektive projektojnë një sintagmë klitike ClP. Nëse i referohemi ndërtimit të Savoias më lart, do kishim ngjashmëri në konceptimin e dy strukturave ku autori i njeh klitikut pozicionin N që bën leksikalizimin e argumentit të vargut emëror të projektuar nga V ndërkohë që *me* gjenerohet në pozicionin e sintagmës së determinantit që në këtë rast i korrespondon asaj komplementuese të paraqitur në skemën 85 b.

Skema 85.

a.



b.



[339] Savoia. L. M & Manzini. M. R (2015). Morfo-sintaksa e pjesores dhe paskajores në të folmen e Shkodrës, in Savoia, L. M.; Manzini, M. R. & Baldi, B. (eds*)* ASHAK, (2015). *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë, f.187.

4.5.4. Një dukuri e lashtë e parë në këndvështrim gjenerativ. Mënjanimi i paskajores gege dhe zëvendësimi me lidhoren

Sh. Demiraj në artikullin "*Ç'dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?*" botuar në Studime filologjike 1-2, 2012, vë në dukje një prirje e cila do të përbënte interes për punimin tonë. Është fjala për pyetjen që vjen natyrshëm pasi autori i studimit përcakton arsyet se përse ka ndodhur ky mënjanim. Ndër të tjera ai shkruan:

"*... kemi të bëjmë, në thelb, me një nga pasojat më të dukshme të një prirjeje të vjetër të gjuhëve të Ballkanit për një qartësim sa më të madh të kumtimit gojor, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe përdorimin redondant të mjeteve gjuhësore. Përdorimi i formave vetore në vend të formës së pashtjelluar të paskajores, që nuk e dallon vetën e atij që kryen (apo të atyre që kryejnë) veprimin e shprehur nga kjo formë foljore do të ketë qenë një nga pasojat e kësaj prirjeje.*[340]

Na intereson ky arsyetim për të gjetur mbështetje për trajtimin gjenerativist që përmes ideve origjinale dhe synimit për të shpjeguar thelbin e gjuhës njerëzore, ka bërë të konvergojnë në një interesat e gjuhëtarëve, psikologëve e filozofëve. Kështu gjuha nuk shihet si një varg shprehish që njeriu i mëson përmes imitimit, struktura e saj ka një lidhje të veçantë me veprimet e trurit.[341]

Puna jonë përqendrohet në dallimin që të krahasojmë ndërtime me paskajore gege me ndërtimet me lidhore në statusin e fjalive të nënrenditura dhe më pas të paraqesim skematikisht secilin prej këtyre ndërtimeve për të kuptuar ndryshimet strukturore e kuptimore që e shoqërojnë këtë zëvendësim.

Ai kupton se dishka duen ***me mshehë***. (E. Koliqi, *Tregtar flamujsh*, f.94)	Ai e kupton se diçka duan ***të fshehin.***
Qielli i Shkodrës qi aq âmbëlsisht priret mbi qytet ndër net maji, *bânte* ***me fluturue*** *mendimet e Lecit*. (E. Koliqi, *Tregtar flamujsh*, f. 35)	…bënte (që) ***të fluturonin*** mendimet e Lecit.
Një fjalë sqarohet qiell e dhé bashkë: ajo âshtë një strajcë e në të *mundemi* ***me bartë*** *stinët e motit, akull e zjarm*. (M. Camaj, Palimpsest, f.40)	...mund ***të mbajmë*** stinët e vitit, akull e zjarr.
E at besim e fitoi me shum prova, mbasi gjithmon, kur s'dijnë tjerët, atij i takon ***me folë***. (Migjeni, Vepra, f. 183)	…atij i takon (që) ***të flasë.***

[340] Demiraj, Sh. (2012). *Ç'dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?* në *Studime filologjike,* Nr. 1-2, f.11

[341] Memushaj, R. (2008). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLSH, Tiranë, f. 85.

Në shembullin e parë:

a) Ai kupton se dishka duen me mshehë.

dhe variantit të zevëndësuar të paskajores gege me lidhoren:

b) Ai kupton se diçka duan të fshehin.

do kishim këtë paraqitje skematike sipas sistemit forcë-shtjellim:

Skema 86.

a)



b)



Në analizën e këtyre skemave fillimisht duhet të kujtojmë që të dallojmë kokat leksikore nga kokat funksionale. Këto të fundit nuk kanë kuptim të mëvetësishëm.
Në secilin prej diagrameve kokat leksikore janë foljet. Kështu lidhja mes kokave leksikore të foljeve *dua* dhe *fsheh* është më e afërt me paskajoren gege e tipit *me bâ*, ndërkohë që në ndërtimin me lidhore përfshihen më shumë koka funksionale. Në ndërtimin me lidhore, i cili vjen si sintagmë komplementuese, meqenëse ruan pozicionin e shfaqjes së lidhëzës ***që*** edhe pse ajo nuk realizohet fonetikisht, shfaqen kokat funksionale të Forcës, Mënyrës dhe Eptimit. Kjo duket se mbështet hipotezën e Sh. Demiraj: prirjen për *përdorimin redondant të mjeteve gjuhësore.*
Ajo që na intereson të theksojmë në këtë analizë lidhet me faktin që ndërtime të tilla, pavarësisht se në strukturën sipërfaqësore shfaqen si të njëvlefshme, dëshmojnë se shoqërohen me ndryshime në strukturën e frazës e si të tilla edhe në strukturën e thellë të mendimit. Njëkohësisht duam të theksojmë se prirja që vërehet sot në shqipfolësit për përdorimin e paskajores së tipit *me* + *pjesore* ka lidhje me një prej parimeve themelore të Programit Minimalist. E mbështesim këtë arsyetim duke iu referuar edhe studimit të Draçini, Rr. (dorëshkrim) e cila kur ngre pyetjen "*a i duhet shqipfolësve dhe vetë shqipes forma përfaqësuese me lexu",* i përgjigjet pozitivisht kësaj pyetjeje duke u mbështetur në dy aspekte, njëri prej të cilëve na intereson në veçanti: është fjala për prirjen e folësve drejt minimalizmit. Studiuesja na kujton një parim tepër të rëndësishëm: individi priret të përdorë sa më pak operacione për të realizuar gjuhësisht mendimin e tij duke lidhur Formën fonetike FF me formën logjike FL. Siç u pa më lart në studimin tonë, duhen shumë më tepër operacione për të realizuar komunikimin përmes paskajores së standardit, ndërsa paskajorja gege e tipit *me bâ* i shkon më shumë për shtat asaj që njihet si prirje për minimalizëm.
Ndryshe nga trajtat përfaqësuese të foljes që në shqip mbajnë tiparet e fleksionit, tipare të cilat nuk janë kategori të brendshme të foljes, por i caktohen nga kryefjala, paskajorja gege e tipit *me bâ* ka mundësinë të paraqesë konceptin abstrakt të veprimit duke e pasqyruar atë të zhveshur nga tiparet e tjera, të cilave as trajta përfaqësuese e foljes në shqipen standarde e as paskajorja standarde nuk i shmangen dot.

PËRFUNDIME

Në përfundim të përpjekjes sonë për të treguar se *si qaset shqipja përballë analizës gjenerativiste,* pasi e kemi orientuar vështrimin tonë në ndërtime të thjeshta e të ndërlikuara, por që kanë në thelb njësinë e vetme strukturore "sintagmë", në nivelin e analizës sintagmatike nominale kemi vërejtur se:

- Nyja joshquese një që paraqet një element autonom që gjendet gjithnjë para E, nuk paraqet opozicion morfologjik në lidhje me gjininë e rasën.
- Nyjat shquese në shqipe i prapavendosen E kokë, kjo shpjegohet me rregullën lëviz α, lëvizje që E kokë bën nga projeksioni i tij minimal në projeksionin e caktueshmërisë. E pasurohet me informacionin e numrit nga trupëzimi me nyjen e cila mbart informacionin e gjinisë e rasës.
- Përemrat dëftorë janë elemente deiktikë që do të thotë se mbartin tipare që sqarojnë situatat kohore dhe hapësinore të shprehjes.
- Numërorët dhe përemrat e pacaktuar mund të klasifikohen së bashku nën emërtimin sasiorët, sepse si determinantë të emrit, nuk kanë kuptimin e mirëfilltë përemëror, por *përcaktojnë një interpretim "sasior" të SE së cilës i referohen*. Sasiorët e pacaktuar klasifikohen në 1. (të brendshëm) sasiorë që i referohen (duke e treguar, përjashtuar ose veçuar) një sendi apo frymori në mënyrë të pacaktuar; dhe 2. (jo të brendshëm) sasiorë që i referohen një sasie ose tërësie të pacaktuar.
- Nga fjalët pyetëse, si determinantë funksionojnë vetëm të ashtuquajturit përemra pyetës. Ata nuk individualizojnë asnjë njësi të saktë, por vetëm sa kufizojnë rrethin ku duhet kërkuar një njësi e kjo bën që ata të mos ruajnë statusin e përemrit.
- Një E mund të paraprihet nga disa determinantë, por jo të gjitha kombinimet janë mundshme: ndërmjet determinantëve ka edhe mospërputhje, disa të rregullit semantik, kurse të tjera të regullit sintaksor, që pengojnë disa sekuenca.
- Kështu:
    - ❖ Në veçanti, nyja shquese dhe ajo joshquese përjashtojnë njëra-tjetrën
    - ❖ Nyja joshquese dhe dëftorët përjashtojnë njëri-tjetrin
    - ❖ Ndërsa bashkëpërdorimi i dëftorit me nyjën shquese në shqip nuk shfaq kontradiksion. *Analiza e sheh dëftorin si një element të tipit kokë, që realizohet mbi pozicionin D°.*
    - ❖ Përemrat pyetës janë të papajtueshëm me determinantë të tjerë, por ato mund të bashkëpërdoren me sasiorët kur kanë vlerë thirrmore.
    - ❖ Nyjet shquese dhe dëftorët mund të bashkëpërdoren me numërorët dhe sasiorët jo të brendshëm. Kur numërorët dhe sasiorët jo të brendshëm (përveç *gjithë, tërë, mbarë)* gjenden me nyjen shquese, marrin një vlerë "përshkruese" dhe sillen si komplementë predikativë.

- ❖ Fjala *tjetër* mund të bashkëpërdoret me një nyje shquese dhe joshquese (*një tjetër mikut*), por nuk mund të shfaqet në funksione predikative.
- ❖ Me numërorët nuk përdoret nyja joshquese.

- Kur në SE të bashkërenditura që tregojnë dy referentë të ndryshëm, determinanti mungon në SE e dytë, nëse këto janë në shumës dhe kanë të njëjtën gjini, përftohet "elipsa" e determinantit.
- Nëse SE e bashkërenditura janë në njëjës, mungesa e një determinanti në elementin e dytë të bashkërendimit tregon se elementet e bashkërenditur i përkasin të njëjtit referent dhe determinanti i referohet krejt sekuencës me elementë të bashkërenditur dhe asnjërit në veçanti, pra nuk ka elipsë determinanti.
- Përemrat pronorë kur shfaqen në pozicion postnominal mund të kombinohen vetëm me E të shquar, ndërsa nuk mund të përdoren në SE që kanë E të pashq, ose E të pashq me determinant një dëftor apo sasior të pacaktuar.
- Përemrat pronorë gjenerohen në specifikues të E kur ndodhen në pozicion postnominal ndaj E të shquar si dhe në ndërtimet dëftor+ E i shquar+pronor.
- Në rastet kur pronorët e farefisnisë paraprijnë E e pashq. ata përbëjnë kokën e DP sepse gjenerohet në pozicionin e determinantit dhe merr funksion deiktik.
- Nyja shquese përdoret kur bashkëbiseduesi mund ta shquajë referentin të cilit i drejtohet SE që përmban nyjen. Ekzistojnë dy strategji të shquarjes:
  - ➢ ***referimi endoforik*** ose anaforik- nëpërmjet kthimit në kontekstin linguistik
  - ➢ ***referimi ezoforik*** me SE që i drejtohet njohjeve të përbashkëta, me SE të shoqëruar me mjete paralinguistike, siç janë lëvizjet, me SE që tregojnë një klasë.

  Përdorimi i njërës nga këto strategji mund të lejojë shmangien e nyjes shquese në rastin e SE që përbëjnë një listë ose çifte të lidhua nga kënvështrimi semantik.
- E e përveçëm përbëjnë në thelb SE të shquara kjo bën që ata të përdoren kryesisht me N.shq. Kur shoqërohen nga modifikatorë postnominal N.sh është e detyrueshme, kurse kur modifikatori është Mb dhe në pozicion prenominal, ata zhvishen nga N.shq. dhe janë Mb që e thithin Nyjen.
- Te E e njerëzve dhe vendeve N.shq është e pranishme pothuajse gjithnjë. Ato nuk shmangen as kur E shoqërohet nga një modifikator.
- Kur E shoqërohen me emërtimin e tiparit gjeografik koka e SE nuk janë më ata, por emërtimi gjeografik, ata bëhen emri që gjenerohet në sintagmën e Njohur ose plotësori i SE dhe në rastin e parë e kanë N.shq, ndërsa në rastin e dytë jo
- N. joshq fut në diskutim një referent, për të cilin nuk i kërkohet bashkëbiseduesit që të bëjë dallimin nga klasa ku bën pjesë.
- Nyjat ***një*** e ***ca*** të përdorura me E mase dhe me E abstraktë të panumërueshëm veçojnë një entitet jo të perceptueshëm fizikisht.

- Kjo Nyje mund të mungojë në rastet e SE në pozicionin postverbal, SE subjekt të foljeve pavetore.
- Nyjat mungojnë edhe në SE të përdorura si thirrorë, SE në funksion të gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror, të ndajshtimit ose të përcaktorit kallëzuesor, në eksklamacione, brenda një SP e në shprehje frazeologjike.
- Kur SE është e privuar nga E që duhej të përbënte kokën e saj , determinantët marrin statusin e **përemrave.** Në rastet e shmangies së E kokë të një SE , determinantët mund të shoqërohen nga modifikatorë që i referohen E të shmangur.
- Nyja shquese mund të përdoret si një përemër në rastet kur E i shmangur është i modifikuar nga një mbiemër, por nëse E modifikohet nga një SP ose nga një fjali përcaktore, nyja nuk mund të përdoret.
- Në shqipen nyjat joshquese nuk paraqiten si proforma, prandaj nuk mund të flasim për një përdorim përemëror të tyre. Në rastet e shmangies koka nominale edhe pse leksikalisht bosh mbetet prezent si kategori.
- Dëftorët përdoren në referimin anaforik kur përdoren si proSE dhe bashkëreferojnë me SE që përbëjnë paraprijësit në ligjërimin e mëparshëm. Në këtë rast humbasin tiparet e tyre deiktike, por i ruajnë ato kur ndodh elipsa e E kokë, mqs E mund të riintegrohet.
- Sasiorët janë të klasifikuar në ata që kanë përdorim mbiemëror dhe përemëror. Në rastin e parë përdoren vetëm në prani të E si *çdo*, *njëfarë*, në rastin e dytë vetëm në mungesë të E si *kush, ndokush, askush, njeri,* etj. Të tjerët kanë të dy llojet e përdorimeve. Disa sasiorë mund të jenë veçues.
- Pronorët në përdorimin e tyre përemëror shoqërohen gjithnjë nga N.shq. Në shqipen mund të shoqërohen edhe nga determinantë të tjerë. Kur paraprihet nga një sasior mund të përdoret edhe forma përemërore e nyjes dhe e sasiorit e ndjekur nga një SP veçuese që përmban pronorin, i cili sërish shoqërohet nga nyja shquese.
- Modifikatorë të E në SE mund të jenë edhe ndajfoljet vatërzuese të cilat gjenden në pozicion fillestar në SE, paraprijnë determinantët dhe i referohen krejt SE që i ndjek.
- Ashtu si folja është një kokë që përzgjedh argumentet e saj p.sh.Subjekt dhe KD (këto të përbërë nga SE), ose tipa të tjerë plotësish bërthamash (të përbërë p.sh. nga SP)), edhe E, nëse posedojnë disa karakteristika, mund të analizohen si koka që seleksionojnë një numër të caktuar argumentesh, këto janë E argumentues të cilët janë kryesisht E abstraktë prejfoljorë.
- Në fjali argumentet nuk mund të shmangen sepse shkaktojnë jogramatikalitetin e saj, kurse në SE shprehja e argumenteve është e mundshme.
- E argumentues klasifikohen në:
    - E që i korrespondojne F jokalimtare
    - E që përshkruajnë evente psikike me dy argumente
    - E që kanë interpretim vetëm kundrinor

- E që përdoren qoftë si "veprues", qoftë si "pësorë.

- SMb janë atribute dhe shtesa.
- Mb postnominalë mund të jenë ***restriktivë*** dhe ***deskriptivë.*** Mb prenominalë janë ***konotativë.*** Në këtë pozicion ata janë të fokusuar.
- Pozicioni pre-ose postnominal, mund të ketë efekte edhe në domethënien e brendshme të disa Mb, që ruajnë kuptimin e tyre të mirëfilltë kur gjenden në pozicionin që e quajtëm kryesor, pra pas E, ndërsa marrin një kuptim tjetër në pozicion prenominal
- Ekzistojnë Mb kohorë të cilët mund të quhen **deiktikë,** por ka edhe Mb që mund të emërtohen **anaforikë,** pasi për interpretimin e tyre i duhet referuar kontekstit linguistik.
- Mb **marrëdhëniorë** japin tiparin e sendit, emrin e të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërtimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim a me një numër.
- Mb janë argumente kur kryejnë brenda SN funksionin e Subjektit, por nuk mund të kryejnë funksionin e K.D në SE
- Mb mund të bashkërenditen dhe nënrenditen brenda SE. Kur Mb postnominalë bashkërenditen shfaqen dy mundësi interpretimesh: i referohen referentit, ose bashkësisë së referentëve të shquar nga E kokë, ose çdo Mb mund t'i referohet bashkësive të ndryshme.
- Në pozicion postnominal mund të gjenden edhe Mb të nënrenditur me vlerë ngushtuese ndaj pjesës tjetër të SE.
- E mund të modifikohen nga SP të tipave të ndryshëm, që funksionojnë si plotës të kokës emërore. Përveç shprehjes së ndryshme të Subj. dhe K.D., SP plotës të E i korespondojnë në përgjithësi komplementëve që modifikojnë F. Ato mund të tregojnë vend, kohë, shoqërim, shkak, mjet, lëndë, tipar, qëllim, sasi.
- Qëndrojnë pranë E disa nga SP që janë modifikatorë "tipikë" të E, në veçanti SP me funksion të Subj. SP e tjerë modifikatorë të E janë më pak të lidhur me E kokë. Nëse një E modifikohet nga dy SP që kanë të njëjtin tip të relacionit me kokën, janë të mundur të dy rendet.
- E mund të modifikohen edhe nga fjali. Fjali të tilla nuk kanë të bëjnë me çfarëdo emri. Ky lloj modifikimi gjendet kryesisht me E argumentues. Për E prejfoljorë lloji i fjalisë së përzgjedhur është i njëjtë si për E ashtu edhe për F.
- E ashtu si F mund të modifikohen edhe nga fjali të llojit ekstranuklear.
- Një E mund të modifikohet edhe nga një SE, me funksion të *atributit*. Mqs ka gjithnjë vlerë ndajshtimore SE modifikator i E quhet **ndajshtim** i cili mund ta prijë ose ta ndjekë E kokë.

Në kapitullin e tretë që lidhet me studimin e fjalisë në këndvështrimin gjenerativist kemi arritur në këto përfundime:

- Kur flasim për funksione sintaksore, argumente dhe role tematike, nuk mund të vemë shenjë barazimi mes tyre. Jo gjithmonë argumentet me të njëjtat funksione sintaksore, marrin të njëjtat role tematike. Kjo varet nga kuptimi i foljes dhe marrëdhënia që ajo ndërton me rolet tematike.
- Funksionet sintaksore marrin role tematike të cilat i cakton predikati bazuar edhe në kuptimin e tij, nga ana tjetër është valenca e foljes ajo që përcakton numrin e argumenteve të domosdoshme.
- Në këtë punim ne mbështesim qëndrimin e Buxhelit (2007, 78) për vendosjen e shenjës së barazimit mes dy koncepteve, kur sqaron se me *komplement* ose *plotësor* kuptohet një SE ose Sept e domosdoshme që plotëson kuptimin e foljes, ndërsa *argument* është *çdo element sintaksor që kërkohet domosdoshmërisht nga një fjalë e sinonim me të është termi valencë*.
- Po kështu i shërben një analize të drejtë edhe qëndrimi i Kananaj (2015: 48) që sqaron dallimin mes komplementit dhe argumentit duke shpjeguar se të parët i takojnë rrafshit semantik, ndërsa komplementet rrafshit sintaksor. Në këteë punim mbrohet ideja se të gjithë komplementet janë argumente.
- Adjunktët, me përjashtim të disa rasteve kur janë komplementë, *përfaqësojnë pjesëmarrës fakultativë, jo të domosdoshëm për gramatikalitetin e realizimit të kuptimit semantik të foljes.*
- Informacioni leksikor që jepet sipas klasifikimit të valencës është më i gjerë sepse sqaron që struktura sintaksore e fjalisë ku ajo bën pjesë të ketë një kryefjalë dhe një kundrinor, ndryshe nga foljet njëvalente që marrin vetëm kryefjalën.
- Klasifikimi i foljeve sipas vetës dallon nga klasifikimi i foljeve sipas valencës. Kjo e fundit siç thamë përmban gjithë informacionin për argumentet e domosdoshme për realizimin e kuptimit të foljes, ndërsa nëpërmjet kategorisë gramatikore të vetës kuptojmë lidhjen mes kryefjalës dhe foljes, që nënkupton lidhjen me vetëm njërin prej argumenteve të foljes. Në shqipen, foljet, kalimtare ose jokalimtare, zgjedhohen në tri vetat, por po kështu në vetën e tretë përdoren edhe foljet njëvetore. Kjo bën që informacioni i marrë nga klasifikimi sipas vetës të jetë i dallueshëm nga ai sipas argumenteve të domosdoshëm.
- Çdo folje ka strukturën e saj argumentore që janë sintagma të kërkuara domosdoshmërisht nga ajo për realizimin e kuptimit, dhe klasifikimi mbi bazën e valencës së tyre sjell informacion më të plotë rreth lidhjeve sintaksore që nevojiten për realizimin e kuptimit të secilës prej tyre.
- Graffi vëren se ndarja e fjalive bazuar në funksionin e tyre nuk ka të bëjë aq shumë me funksionin, sesa me modalitetin.

- Për shkak të fleksionit i cili shfaqet në mënyrë të pasur në gjuhën shqipe duke i dhënë mundësinë folësit apo lexuesit të kuptojë se kush është kryefjala, meqenëse ajo është gjithmonë në rasën emërore pa parafjalë, kush është kundrina e drejtë meqenëse ajo është gjithmonë në rasën kallëzore pa parafjalë.
- Gjuhësia strukturaliste njeh dy lloje rendesh: rendin e gjymtyrëve të fjalisë dhe rendin e pjesëve të thënies (të temës e të remës).
- Një konstituent me peshë ka tendencë të spostohet në fund të fjalisë për arsye ritmike dhe për faktin që fundi i fjalisë është pikërisht vendi ku vendoset informacioni më i rëndësishëm ndërkohë që zakonisht një përbërës me peshë është zakonisht përbërës i pasur me informacion.
- Plotësorët (SE_{Kd} dhe SE_{Kzh}) në një fjali të pashenjuar ndjekin gjithmonë F qoftë kjo kalimtare apo jokalimtare e nëse kemi praninë e një SE_{Kd} ai preferohet t'u paraprijë plotësorëve të tjerë që rendi të jetë neutral. Rastet që bëjnë përjashtime shenjojnë pragmatikisht ose gramatikisht fjalinë.
- Bazuar në këndvështrimin gjenerativist, marrëdhëniet që kanë me fjalinë drejtuese i ndajnë në fjali *argumentore* dhe fjali *shtesore*.
- Për periudhën thuhet se është degëzuar djathtas (*right-branching constuction*) në rastin kur fjalia e varur vihet pas drejtueses. Degëzimi djathtas është më i natyrshëm sepse informacionit bazë që përmban fjalia drejtuese i shtohet një informacion i ri.
- Nëse fjalia e varur vendoset para drejtueses thuhet që periudha ka degëzim majtas (*left-branching construction*). Degëzimi majtas e bën marrësin të presë për informacionin e rëndësishëm, pra krijon njëfarë tensioni në tekst.
- Vendosja në mes quhet degëzim në mes (*nested construction*) atëherë kur fraza A dhe B formojnë një ndërtim të tillë ku A është tërësisht brenda B.
- Në gramatikën gjenerativiste elipsa shihet si një fenomen që ndikohet nga prirja e folësve për të ekonomizuar gjuhën dhe që sjell ngjeshjen e mendimit, ngjyrimin e komunikimit dhe vënien në dukje në ligjërim të elementeve më të qenësishme për folësin.
- Elipsa prek pothuajse të gjithë strukturat e fjalisë apo frazës duke mos u kufizuar vetëm në mungesën e kallëzuesit.
- Në këndvështrimin e gramatikës gjenerative fjalitë pyetëse klasifikohen në pyetëse ***wh-*** dhe në pyetëset ***po-jo***.
- Kemi të bëjmë me një fjali pyetëse ***wh-*** atëherë kur ajo përmban një element pyetës si *kush, kur, ku, çfarë* etj. Këto fjali ndërtohen nga lëvizja e elementit *wh* në fillim të fjalisë që emërtohet ***lëvizja wh***.
- Fjalitë pyetëse ***po-jo*** përfshijnë fjalitë të cilat marrin si përgjigje ***po*** ose ***jo*** dhe në shqip mund të formohen si pyetëse ose me pjesëzën pyetëse **a**, ose vetëm përmes intonacionit.

- Sintagmat që përmbajnë element pyetës quhen sintagma w*h*. Ato mbushin vendin e specifikuesit të lidhëzës.
- Të gjitha fjalitë pyetëse kërkojnë që elementi pyetës *wh* të zhvendoset nga pozicioni fillestar drejt periferisë së majtë të fjalisë. Meqenëse pozicioni L^0 në fjalitë pyetëse mbart tipare *wh*, elementet *wh* zhvendosen drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës komplementuese SL meqenëse SL përfaqëson periferinë e skajshme të fjalisë, edhe elementet pyetëse dalin në krye të saj.
- Meqenëse në fjalitë pyetëse kategoritë **topic** dhe **fokus** dalin shpesh, atëherë struktura e propozuar nga Rizzi e quajtur *Force-Finitennes* është më e përshtatshmja për paraqitjen e realizimit të këtyre fjalive.
- Në strukturat e fjalive pyetëse ***po-jo***, rendi i fjalëve është i ndryshëm nga ai i fjalive dëftore përkatëse. Pjesëza ***a*** që është tipike për këto lloj ndërtimesh. Meqenëse nuk ka fleksion, ka statusin e një operatori modal pyetës . Ajo nuk është në gjendje të mbajë asnjë rol tematik e për këtë arsye nuk bën asnjë zhvendosje. Pozicioni i saj është pozicionin kokë Foc^0 meqenëse ajo mund të paraprihet nga një element i topikalizuar e të dalë në fjali në të cilat të paraprihet nga një tjetër komplementues.
- Shqipja, përmes strukturave komplekse të mohimit, përputhet me disa nga parimet universale të gjuhësisë gjenerative, duke ruajtur njëkohësisht tipare të veçanta që sfidojnë disa supozime të sintaksës gjenerative standarde.
- Vendi i mohimit duhet të ndodhet sipër pozicionit të eptimit.
- Në ndërtimet e mohimit me format e foljore me pjesën ***do*** kemi një strukturë dyshe ku folja do ngrihet në pozicionin EPT në SEPT duke lënë pas një gjurmë, ndërsa mohimi ndodhet mbi pozicionin Koh, d.m.th. mbi ***do*** të së ardhmes apo kushtores.
- Elementi EPT në shqip përforcohet me pjesëzën mohuese ***as*** ose ndajfoljen ***kurrë*** që formojnë përbërësit e mohimit. Në këto raste të mohimit të shumëfishtë, elementet mohuese përbëjnë remën dhe vendosen në SFoc si specifikues dhe kokë.

Në kapitullin e katërt duke studiuar sintaksën e frazës në gjuhën shqipe u vu re se:

- Në rastet kur fjalitë drejtuese të cilat në frazë nuk janë të pavarura, sidomos në rastin kur predikati i tyre është i pangopur në valencat e tij dhe këto valenca mund të mbushen me argumente të cilat dalin edhe me vlera fjaliore, flasim për fjali argumentore.
- Këto fjali përbëjnë argumentet për foljet e fjalive me të cilat lidhen dhe një nga kriteret për t'u klasifikuar si argumente është se, ato janë *të domosdoshme* për kuptimin e këtyre predikateve.
- Fjalitë argumentore analizohen si sintagma të komplementuesit apo SL.
- Në gjuhën shqipe ka folje që mund të marrin dy argumente të shprehura me SK, në funksion të objektit e të subjektit.

- Foljet që kërkojnë argumentin e jashtëm me tipar [+human] nuk mund të marrin një SK që përbën argumentin e jashtëm.
- Kërkesa e foljeve për argument të jashtëm me tipar [+human] nuk kushtëzon disa folje për të marrë argumente të brendshme të shprehura me fjali argumentore.
- Kalimi i një foljeje nga veprorja në joveprore shoqërohet me ndryshimin e numrit të argumenteve.
- Fjalive argumentuese mund t'u caktohen role tematike kur ato janë argumente të një predikati të një fjalie drejtuese.
- Në rastet kur argumenti në gjuhën shqipe është i shprehur për të njëjtin predikat si në fjalinë drejtuese, ashtu edhe me fjali argumentore kemi të bëjmë me anafora dhe predikati i cakton rol tematik vetëm sintagmës komplementuese ndërsa përemëri i shprehur në fjalinë drejtuese nuk është argument por, një *pro plotësuese* (angl, *pro expletive*, it. *pro espletivo*) që është një *kryefjalë bosh* e që shërben për të mbushur pozicionin e kryefjalës kur kësaj të fundit i mungon roli tematik. Paravendosja e fjalisë së nënrenditur shoqërohet me shfaqjen e përemrit që e rimerr atë. Përemri nuk është i domosdoshëm, por thekson informacionin e fjalisë së nënrenditur.
- Së dyti, kjo mund të shpjegohet edhe nga pikëpamja strukturore. Gjatë paravendosjes së fjalisë së nënrenditur, krijohet një vend bosh që krijon mundësinë e vendosjes së këtij përemri.
- Ndërtimet me forma të pashtjelluara në shqipen sipas gjuhësisë gjenerative kanë strukturë argumenti dhe janë gjithmonë fjali të nënrenditura me kryefjalë PRO, përveç rasteve kur kanë të shprehur kryefjalën e tyre. Ato nuk mund të kenë si projeksion eptimin, domethënë nuk mund të jenë SEPT gjithashtu atyre u mungon edhe kategoria e mënyrës, pra ato nuk mund të jenë as sintagma mënyrore SM. Por format e pashtjelluara nuk janë as SF të thjeshta meqë në SF në pozicionin e specifikuesit nuk ka vend për vendosjen e elementeve (pjesëzave) që përcaktojnë llojin e formës foljore.
- Pavarësisht se janë fjali të nënrenditura foljet e pashtjelluara nuk mund të kenë statusin e SL pasi kjo do të përbënte ndërtime jogramatikore. Ato kanë statusin e sintagmave kohore SKoh, por me tiparet [-Kohë,-Përshtatje]. Në bazë të Teorisë së drejtimit dhe lidhjes pjesëzat *me/për/një* në paralelizëm me *to* të anglishtes kanë funksionin e shprehjes së kategorisë funksionale [-Kohë] [-Eptim], pjesëzat *pa* dhe *duke* kanë tiparin [-Kohë], ndryshe nga ndihmëset *kam* e *jam* që kanë tiparin [+Kohë].
- Për to duhet aplikuar analiza sipas Rizzit (1995) një sistem i quajtur *forcë – shtjellim* ku një vend me rëndësi zë sintagma e shtjellimit SShtj (Finiteness Phrase, FinP) e cila qëndron një pozicion më lart SEPT. Ky sistem shpreh lidhjen selektuese mes sistemit komplementues dhe sistemit strukturor. Sistemi komplementues mund të ketë funksionin Topic që pasqyrohet në Topic Phrase (TopP) me kokën Top^0 e cila është një kokë funksionale që përcakton predikatin më të lartë brenda sistemit

komplementues. Funksioni i tij është analog me atë të sintagmës së përshtatjes (AgrP) brenda sistemit të sintagmës SEPT e cila pasqyron lidhjen mes subjektit dhe predikatit gjithashtu. Po kështu edhe koka Foc^0 (e reja) projekton skemën e saj X-bar. SShtj, të cilën e përmendëm më lart, përmban pjesëzat ***të*** të lidhores apo ***me*** të gegërishtes. Pra në këtë sistem në pozicionin më të ulët të F zë vend forma bazë e foljes F^0, ndërsa në të majtë shtrihen veçoritë e ndryshme që ajo mbart kështu do të kishim në një pozicion më lart eptimin EPT, një pozicion më lart Eptimit tiparin e mënyrës M, pastaj në të majtë të pozicionit MP projektohet sintagma kokë e së cilës është shtjellimi $Shtj^0$, i cili në të majtë të tij ka projektimin e sintagmës Forcë (SForcë).

- Nga kjo paraqitje kuptojmë që në pozicionin më të ulët F^0 të jetë forma bazë e foljes, në M^0 të jetë pjesëza të e mënyrës lidhore, në $Shtj^0$ projektohen elementet e formës së pashtjelluar ndërsa pozicionet kokë të Forcës, Mënyrës dhe Eptimit mbeten bosh.
- Në rastin e ndërtimit me një element klitik një sintagmë (SKl) projektohet mbi sintagmën eptimore. Kjo do të kërkojë shtimin e një tjetër projeksioni mes SEPT dhe SM.
- Në rastet e zëvendësimit me paskajoren që përbën një prirje të gjuhëve ballkanike, dallohet që nuk kemi të bëjmë me një shndërrim të barazvlershëm as në aspektin e gjenerimit të kokave leksikore, as atyre funksionale. Kështu lidhja mes kokave leksikore të foljeve është më e afërt me paskajoren, ndërkohë që në ndërtimin me lidhore përfshihen më shumë koka funksionale duke e bërë më të largët lidhjen mes kokave leksikore.
- Ndërtimi me lidhore vjen si sintagmë komplementuese meqenëse ruan pozicionin e shfaqjes së lidhëzës ***që*** edhe pse ajo nuk realizohet fonetikisht. Në të shfaqen kokat funksionale të Forcës, Mënyrës dhe Eptimit. Kjo duket se mbështet hipotezën e Sh. Demiraj që prirja për të zëvendësuar paskajoren me lidhoren paraqet prirjen e folësve për *përdorimin redondant të mjeteve gjuhësore* duke vërtetuar që ndërtime të tilla, edhe pse në strukturën sipërfaqësore shfaqen si të njëvlefshme, dëshmojnë ndryshime në strukturën e frazës e si të tilla edhe në strukturën e thellë të mendimit.
- Prirja që vërehet sot në shqipfolësit për përdorimin e paskajores së tipit *me + pjesore* ka lidhje me parimet themelore të Programit Minimalist.
- Duhen shumë më tepër operacione për të realizuar komunikimin përmes paskajores së standardit, ndërsa paskajorja gege e tipit *me bâ* i shkon më shumë për shtat asaj që njihet si prirje për minimalizëm.
- Ndryshe nga trajtat përfaqëuese të foljes që në shqip mbajnë tiparet e fleksionit, paskajorja gege e tipit *me bâ* ka mundësinë të paraqesë konceptin abstrakt të veprimit duke e pasqyruar atë të zhveshur nga tiparet e tjera të cilave as trajta përfaqësuese e foljes në shqipen standarde e as paskajorja standarde nuk i shmangen dot.

BIBLIOGRAFI:

1. Abney, S. P. (1987). The English Noun Phrase in its sentential aspects, in http://www.ai.mit.edu/projects/dm/theses/abney87.pdf.

2. Abrashi, T. (2020). Rreth disa çështjeve të diskutueshme të sintagmës emërore të shqipes, në ASHAK, (2020). *Studimet albanistike në Itali*, Prishtinë.

3. Agalliu, F. (1975). Ndërtimi Dëftor + Emër i Shquar në gjuhën shqipe, *Studime filologjike*, Nr. 1.

4. Agani, H. (1975). Revista *Fjala*, 1 shkurt – 15 mars.

5. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

6. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II*", Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

7. Akmajian, A.; Demers, R. A.; Farmer, A. K.; Harnish, R. M. (1996). *Linguistica,* il Mulino, Bologna.

8. Aleksiadou, A. & Haegeman, L. &Stavrou, M. (2007). Noun Phrase in the Generative Perspective, Mouton de Gruyter, Berlin.

9. Beqiraj, Xh. (2016). *Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, Mirgreealb, Tiranë.

10. Bianchi, V. (1999). *Consequences of Antisymmetry for The Syntax of Headed Relative*, Doctoral Dissertation, Scuola Normale Superiore di Pisa.

11. Buxheli, L. (2007). *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë.

12. Buxheli, L. (2011). *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*, Botime albanologjike, Tiranë.

13. Buxheli, L. (2017). *Studime gramatikore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

14. Camaj, M. (1984). *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, (collaborated on and translated by Leonard Fox), Otto Harrassowitz. Wiesbaden.

15. Cardinaletti A. (2015). *Esercizi di sintassi*, Carocci Editore, Roma.

16. Carnie, A. (2006). *Syntax, A Generative Introduction*. Oxford: Blackwell Publishers Ltd.

17. Chomsky, N. (2011). *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë.

18. Chomsky, N. (1965). *Aspects of the Theory of Syntax*, Cambridge, Mass. MIT Press.

19. Chomsky, N. (1986). *Knowledge of Language: Its Nature, Origin and Use.* New York: Praeger.

20. Chomsky, N. (1988). *Lectures on Government and Binding – The Pisa Lectures*, Dordrecht – Holland/ Providence RI – USA, Foris.

21. Chomsky, N. (1995). *The Minimalist Program*. Cambridge: MIT Press.

22. Cinque, G. (1991). *Teoria linguistica e sintassi italiana*, il Mulino, Bologna.

23. Cipo, K. (1952). *Sintaksa*, Instituti i shkencave, Tiranë.

24. Cook, V. & J, Newson M. (1996). *La grammatica universale, introduzione a Chomsky*, Traduzione di Pietro Maturi, il Mulino, Bologna.

25. Çabej, E. (2008). *Hyrje në indoeuropianistikë- leksionet e Prishtinës*, botime Çabej, Tiranë.

26. Çeliku, M. (1999). Mbi statusin sintaksor të formave të pashtjelluara, *Studime Filologjike,* Nr. 3-4.

27. Çeliku, M. (2000). *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe (përbërësit sintaksorë)*, SHBLU, Tiranë.

28. Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe – përbërësit sintaksorë (vështrim i ri teorik)*", Ilar, Tiranë.

29. Çeliku, M. (2016). *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe,* ShBLU, Tiranë.

30. Çeliku, M. (2016). *Tekst ushtrimesh të sintaksës së shqipes standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)* (bot. i III). Tiranë: Ilar.

31. Çepani, A. (2007). Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe, *Studime filologjike,* Nr, 3-4.

32. Çepani, A. (2015). *Anafora në gjuhën shqipe*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë.

33. De Santis, C. (2016). *Che cos'è la grammatica valenziale*, Carocci editore, Roma.

34. Demiraj, Sh. (2012). Ç'dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?*, Studime filologjike,* 1-2.

35. Domi, M. (1955). *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa e dytë, Sintaksa,* tekst për shkollën shtatëvjeçare, Botim i Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës, Tiranë.

36. Domi, M. (2013). *Vepra I – Studime sintaksor*e, *"Mbi funksionin sintaktik të ndërtimeve me trajtat foljore jovetore"*, Kristalina KH, Tiranë.

37. Draçini, Rr. (2020). Gegërishtja përmes studimeve të Leonardo M. Savoia in *Studimet albanistike në Iali*, ASHAK, Prishtinë.

38. Dhima, Th. (2007). Probleme të njësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma), *Studime Filologjike,* Nr.3-4.

39. Dhima, Th. (2013). *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, (përmbledhje artikujsh), Infobotues, Tiranë.

40. Floqi, S. (1965). Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme, *Studime Filologjike*, Nr. 3-4.

41. Floqi, S. (1967). Disa tipe semantiko - strukturore të përiudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative. *Studime Filologjike*, Nr.3.

42. Floqi, S. (1968). Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, *Studime Filologjike*, Nr.1.

43. Floqi, S. (1976). Disa vrojtime për rendin e fjalive në periudhën, *Studime filologjike*.

44. Giusti, G. (2012). Enclitic nd proclitic artices in Albanian, Theorical and Empirical Studies in Albanian Syntax, Monaco di Baviera, LINCOM EUROPA, vol. LSIEL 39.

45. Giusti, G. (1996). Is there a FocusP and a TopicP in the noun phrase structure? University of Venice Working Papers in Linguistics. http://hdl.handle.net/10278/471

46. Giusti, G. (1997). The categorial status of determiners. In L. Haegeman (ed.), The New Comparative Syntax, 95-123. London: Longman.

47. Gosturani, Xh. (1976). Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij në gjuhën shqipe II, Llojet e mohimit gjuhësor, *Studime filologjike*, Nr.2.

48. Graffi, G, (2003). *Sintaksa- Strukturat e ligjërimit*, Dituria, Tiranë.

49. Graffi, G. (2010). *Ç'është gramatika gjenerative*, Toena, Tiranë.

50. Haegeman, (1994). L. *Introduction to Government and Binding Theory*, Blackwell Textbooks in Linguistics, Oxford UK & Cambrige USA, botimi i dytë, 1998.

51. Joseph, B. (1983). *The sincrony and diacrony of the Balkan infinitive: a study in areal, general, and historical linguistics.* Cambrige: Cambrige studies in linguistics.

52. Kallulli, D. (1995). *Clitics in Albanian.* Volume 24 of Working Papers in Linguistics, University of Trondheim, Department of Linguistics.

53. Kallulli, D (1999). *The comparative syntax of Albanian, on the contribution of syntactic types to propositional interpretation.* Doctoral thesis, Durham University. https://etheses.dur.ac.uk/1466/

54. Kallulli, D. (2001). *Direct Object Clitic Doubling in Albanian and Greek, Comparative Syntax of Balkan Language*, Oxford University Press, Edited by Maria Luisa Rivero and Angela Ralli.

55. Kananaj, A. (2015). *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

56. *Kërkime universitare 11,* (2010) revistë shkencore e Universitetit "E. Çabej", Gjirokastër.

57. Koleci, F. (2013). *Frazat relative të shqipes- parë në këndvështrimin gjenerativist*, Tiranë.

58. Koleci, F. Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë.

59. Kostallari. A, (1958). *Studime filologjike*, Tiranë.

60. La Fauci, N. (2009). *Compedio di sintassi italiana*, il Mulino, Bologna.

61. Lambertz, M. (1914 - 1915). *Die hypothetische Periode im Albanischen*, Indogermanischhe Forschungen, Strasbourg, 34.

62. Liko, B. (2017). *Trajtimi gjenerativist i përbërësve të frazës në planin funksional*, tezë doktorale. https://unitir.edu.al/trajtimi-gjenerativist-i-perberesve-te-frazes-ne-planin-funksional/

63. Lyons, J. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë.

64. Matheus, P. (2007). *Valency Theoretical, descriptive and Cognitive issues*, botuar në *Trends in linguistics, studies and monographs, 187*, Berlin-New York.

65. Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë.

66. Memushaj, R. (2008a). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë.

67. Memushaj, R. (2008b). *Hyrje në gjuhësi*, Botimet Toena, Tiranë.

68. Memushaj. R, (2008c). *Studime filologjike, 1-2*. Tiranë.

69. Mita, J. (2005). *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë.

70. Mita, J. (2008). *Rendi i fjalëve dhe struktura e fjalive kohore*, "Faik Konica", Prishtinë.

71. Mita, J. (2017). *Teoria e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, "Faik Konica", Prishtinë.

72. Përnaska, R. (2015). *Gjuhësi...gjuhësore*, Maluka, Tiranë.

73. Pollock, J. - Y. (1989). *Verb movement, UG and the structure of IP*, Linguistic Inquiry 18.

74. Prandi, M. (2014). *L'analisi del periodo*, Carocci Editore, Roma.

75. Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe (pjesa e dytë)*, Universiteti i Prishtinës, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë.

76. Prifti, S. (1966). *Elipsa në sintaksën e shqipes*, Studime filologjike, N3. Tiranë.

77. Raddford, A. (1988). *Transformational Grammar. A First Course*. Cambridge: Cambridge University Press.

78. Renzi, L. & Salvi, G. & Cardinaletti, A. (1995). *Grande Grammatica italiana di consultazione, Vol III Tipi di frase, deissi, formazione delle parole,* il Mulino, Bologna.

79. Renzi, L. & Salvi, G. & Cardinaletti, A. (2001). *Grande Grammatica italiana di consultazione,* Vol I La frase, I sintagmi nominale e preposizionale, il Mulino, Bologna.

80. Renzi, L. & Salvi, G. & Cardinaletti, A. (2001). *Grande Grammatica italiana di consultazione, Vol. II I sintagmi verbale, Aggetivale, avverbiale, La subordinazione*, il Mulino, Bologna.

81. Renzi, L. (1994). *Nuova introduzione alla filologia romanza*, (con la colaborazione di Gianpaolo Salvi), il Mulino, Bologna.

82. Riza, S. *Vepra 2*, (1997). Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 13, Prishtinë.

83. Rizzi, L. (1997). *The Fine Structure of the left Periphery*, Elements of Grammar. Dordrecht: Kluwer.

84. Robins, R. H. (2007). *Histori e gjuhësisë*, Përkthim i G.Lafe, Dituria, Tiranë.

85. Rokaj, Sh.; Belluscio, G. (2011). *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë: shqip-italisht-frëngjisht-anglisht*, (*Dizionario di equivalenca dei termini della linguistica*.) Arbëria, Tiranë.

86. Rothsttein, S. D. (1991). *Heads, projections and category determination*, në *Views on Phrase Structure*, Dordrecht, Kluwer, K. Leffel and D. Bouchard.

87. Rushiti, R. (2015). *Frazat lidhëzore në gjuhën shqipe*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë.

88. Rrokaj, Sh. (2007). *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë.

89. Rrota, J. (2005). *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër.

90. Rrota, J. (2005). *Sintaksi i shqipes për klasën II, III, IV K.U. të shkollavet të mjesme*, Shtypshkronja "A. Gj. Fishta", Shkodër, 1942, Ribotim III, Botime Françeskane, Shkodër.

91. Salvi, G. (1988). *Grande grammatica italiana di consultazione*, nën kujdesin e Lorenzo Renzit, Gianpaolo Salvit dhe Anna Cardinaletti, Mulino, Bologna.

92. Savoia. L. M & Manzini. M. R (2015). Morfo-sintaksa e pjesores dhe paskajores në të folmen e Shkodrës, in Savoia, L. M.; Manzini, M. R. & Baldi, B. (eds*)* ASHAK, (2015). *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë.

93. Shehu, H. (2005). Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, në *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*, "Mësonjëtorja", Tiranë.

94. Sheperi, I. D. (1972). *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe – sidomos e toskënishtes- për shkolla të mesme*, Vlorë, 1927, ribot, Romë.

95. Tesnière, L. (1988). *Éléments de syntaxe structurale*, Klincksieck, Paris.

96. Topalli, T. (2011). *Gramatikë e gjuhës shqipe- Sintaksa e fjalisë*, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Instituti i Studimeve Albanologjike, Shkodër.

97. Topalli. T, (2004). Fjali e përbërë, frazë apo periudhë?*, Gjuha jonë*, 1-2.

98. Totoni, M. (2000). *Fraza me nënrenditje*, SHBLU, Tiranë.

99. Totoni, M. (2012). *Sintaksa e gjuhës shqipe - Fraza e përbërë*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Arbëria, Tiranë.

100. Turano. G. (1995). *Dipendenze sintattiche in albanese.*

101. Turano. G. (2000). On Clitics and negation in Albanian, *RIVISTA DI GRAMMATICA GENERATIVA*, nr.25.

102. Turano. G. (2008). *Overt and covert dependences in Albanian*

103. Turano. G. (2020). Kontributi i studiuesve italianë për morfosintaksën e gjuhës shqipe, in *Studimet albanistike në Itali*, Prishtinë.

104. Thomai. J.; Samara, M.; Haxhillazi, P.; Shehu, H.; Feka, Th.; Goga, A.; Memisha, V. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

105. Xhuvani. A. (1938). *Sintaksa shqip –pjes'e dytë për klasët e ulta të shkollavet të mesme*, SHB "Kristo Luarasi", Tiranë.

106. Xhuvani. A. (1922). *Njohunit e para të sindaksës shqipe – pjes' e parë për klasët e nalta të fillores, "*Vlora", Vlorë.

107. https://albanian.web-corpora.net/index_sq.html

108. https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/phrase

109. https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/american_english/phrase_1

PROGRAMET QË JANË PËRDORUR PËR TË GJENERUAR SKEMAT:

1. *Syntax tree generator* i përdorshëm online përmes: https://mshang.ca/syntree/
2. *Phpsyntaxtree* i përdorshëm online përmes: jsSyntaxTree

VEPRAT E PËRDORURA PËR SHEMBUJT E ANALIZAVE TË SINTAKSËS:

Albanian National Corpus i lidhshëm përmes https://albanian.web-corpora.net/

ASHSH. (1983). *Epika Popullore*. Shtypshkronja e Re, Tiranë.

ASHSH. (1983). *Fjalë të urta të popullit shqiptar*. Shtypshkronja e Re, Tiranë.

Banushi, G. (2015). *Mëria e zanave*. SHB "Fan Noli", Tiranë

Banushi, G. (2017). *Simfonia e pambaruar*. SHB "Ditura", Tiranë.

Blushi, B. (2010). *Të jetosh në ishull*. UET, Tiranë.

Camaj, M. (2012). *Palimpsest*. Onufri, Tiranë.

Kadare, I. (1990). *Dosja H*. SHB "Naim Frashëri", Tiranë.

Kadare, I. (1990). *Eskili, ky humbës i madh*. SHB "8 Nëntori", Tiranë.

Kadare, I. (1991). *Përbindëshi*. SHBLSH, Tiranë.

Kadare, I. (1999). *Pallati i ëndrrave*. Onufri, Tiranë.

Kadare, I. (2000). *Kronikë në gur*. Onufri, Tiranë.

Kadare, I. (2003). *Hija*. Onufri, Tiranë.

Koliqi, E. (2013). *Tregtar flamujsh*. Pakti.

Kongoli, F. (2006). *Ne të tre*. Toena, Tiranë.

Kurti, D. (2005)*Përralla Kombëtare mbledhe prej gojës së popullit.* Botime Françeskane, Shkodër.

Migjeni. (1988). *Vepra*. Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë.

Xoxa, J. (1965). *Lumi i vdekur*. SHB "Naim Frashëri", Tiranë.

ABSTRACT:

This paper investigates the syntactic structures of the Albanian language within the theoretical framework of the Principles and Parameters model, developed through Noam Chomsky's Government and Binding Theory and further refined in the Minimalist Program. At the core of this study lies the alignment of Albanian syntactic data with the generative grammar framework, based on contributions from subsequent scholars in the field. The paper commences with an analysis of minimal syntactic units and advances toward more complex constructions, such as sentences and argument phrases. Particular attention is given to the noun phrase (NP), focusing on the function and distribution of its constituents in Albanian and emphasizing features that differentiate it from structurally comparable languages such as English, Italian, and French.

Applying generative theory and cross-linguistic comparison, the study identifies several phenomena in Albanian that present challenges to standard theoretical predictions. Examples drawn from artistic discourse and authentic Albanian corpora, along with syntactic tree diagrams, serve to illustrate various phrase structures. Beyond descriptive theory and terminology, the paper integrates perspectives from Albanian linguistic studies on syntax, highlighting areas where Albanian continues to pose specific challenges to generative grammar models. Thus, this study seeks to contribute to a more nuanced understanding of how Albanian functions within a universalist syntactic framework.

Among the significant findings is the observation that, within interrogative words, only interrogative pronouns function as determiners. These do not identify a specific referent but merely delimit a set of possible referents, thereby failing to retain full pronominal status. A noun phrase (NP) may be preceded by multiple determiners, though not all combinations are permissible due to syntactic or semantic incompatibilities. For instance, definite and non-definite clauses are mutually exclusive, while non-defining clauses and demonstratives also exclude each other. However, the co-occurrence of demonstratives with the definite article does not result in contradiction in Albanian, as demonstratives act as head elements realized in the D° position.

Interrogative pronouns are incompatible with other determiners, but may co-occur with quantifiers when used in exclamatory constructions. Definite articles and demonstratives can be combined with external numerals and quantifiers. In such contexts - except with the quantifiers *gjithë, tërë*, and *mbarë* - the numerals and quantifiers assume a descriptive function and behave as predicative complements. The adjective *tjetër* may co-occur with both definite and indefinite determiners (e.g., *një tjetër mikut*), but cannot appear in predicative constructions.

The indefinite article is not used with numerals. In coordinated noun phrases (NPs) referring to distinct entities, the determiner is omitted from the second NP if they are plural and of the same gender—yielding determiner ellipsis. If the coordinated NPs are singular, omission of the determiner in the second element implies that both referents point to the same entity, in which case the determiner is not elided but semantically extended to cover the entire sequence.

Postnominal possessive pronouns are compatible only with emphasized nouns and not with those preceded by a determiner, demonstrative, or indefinite quantifier. These pronouns are generated in the specifier position of the NP when postnominal and in structures such as demonstrative + noun + possessive. Kinship possessives, when presets, function as heads of the determiner phrase (DP) and assume a deictic function. Singular and definite noun forms constitute distinct NPs; the presence or absence of definite marking (N.shq.) is conditioned by the placement and nature of modifiers (e.g., prenominal vs. postnominal).

Definite forms are typically required in NPs referring to people and places, even when modifiers are present. When a noun phrase includes a geographical term, the head may shift to the geographic name, changing the syntactic status of accompanying elements. Articles may be absent in exclamatory NPs, nominal predicates, adverbial constructions, exclamations, prepositional phrases, and idiomatic expressions.

When a noun head is elided, determiners can assume pronominal status and may appear with modifiers referring to the omitted head. The definite article functions pronominally if the omitted noun is modified by an adjective, but not when modified by a prepositional phrase or a defining clause. Non-defining clauses in Albanian do not serve as pro form and do not exhibit pronominal behavior. Even when the lexical head is elided, its category remains structurally present.

Demonstratives in Albanian (e.g., *ky*, *ai*) are inherently deictic, encoding spatial and temporal relations in discourse. As part of the DP structure, they typically occupy a position above the NP, functioning in the Spec-DP or as heads of a Deictic Phrase (DeicP), and interacting with the definiteness and specificity features of the noun.

Deictic determiners in Albanian signal the speaker's epistemic stance and the relative distance of the referent. The syntactic distribution of demonstratives, especially in contrastive focus constructions or clefts, suggests a high functional layer associated with discourse structure and information packaging.

In addition to encoding spatial deixis, demonstratives may also mark contrastive focus or topicalization. Their presence may correlate with emphasis or with the identification of a referent relative to a previously established discourse set. Their position often interacts with that of quantifiers and adjectives, adding further evidence for a fine-grained articulated structure within DP.

Demonstratives may serve anaphorically as pro-NPs, co-referring with antecedents in prior discourse. In such cases, they lose their deictic force but retain it when the noun head is elliptical. Pronominal possessors are always accompanied by definite nouns and may be used with other determiners. When preceded by quantifiers, a pronominal form may also be followed by a distinctive prepositional phrase containing the possessor.

NP modifiers may include sentence-initial adverbs of frequency or manner, which precede determiners and modify the entire noun phrase. In contrast to sentences, the expression of arguments in NPs is more flexible. Arguments in NPs can reflect intransitive verb functions, psychological predicates with two arguments, or passivized roles. Postnominal

adverbs may be restrictive or descriptive; prenominal adverbs are often focused and connotative. Modifier placement influences interpretation, particularly for adjectives that shift meaning based on position.

Adjectives act as arguments when functioning as the subject within NPs, though they cannot serve as modifiers of noun heads. Within NPs, adjectives may be coordinated or subordinated, with coordinated postnominal modifiers offering dual interpretations - either applying collectively or distributivity. Subordinated postnominal modifiers may narrow the referent set. Temporal adjectives may function deictically, while relational adjectives express intrinsic relations between entities (e.g., *libri shkollor* "the schoolbook"). A further distinction can be drawn between restrictive and non-restrictive modifiers, corresponding to intersective and non-intersective interpretations.

There also exist temporal adjectives which function deictically and anaphorically, depending on whether their interpretation is context-dependent or grammatically anchored.

Moreover, certain adjectives allow for coordination with other modifiers, and this conjunction may occur either pre- or postnominal depending on the type of adjective and its semantic scope. This reflects a complex interface between syntax and semantics that affects DP internal structure and linearization.

Nouns may also be modified by prepositional phrases (PPs) expressing complements of the noun head (e.g., location, time, cause, manner). Some PPs, especially subject PPs, are more tightly bound to the head noun than others. Multiple PPs of the same type can be ordered flexibly. Sentence-level modification of nouns - particularly with argument nouns - is also attested. Such embedded clauses parallel those modifying verbs, including extraposed constructions.

Nouns may also be modified by **DPs functioning as appositives**. These structures typically bear genitive case and may precede or follow the head noun (e.g., *nxënësi, një talent i rrallë* or *një talent i rrallë, nxënësi*), serving as attributive elements that elaborate or specify the referent.

Nouns in Albanian may also be modified by full clauses. These clauses - often relative or infinitival - are generally found with abstract or eventive nouns and reflect similar selection patterns as those found in verbs. These embedded clauses may be restrictive or non-restrictive and may serve roles analogous to verbal complements, particularly with nominalizations. Furthermore, noun phrases may be modified by subordinate clauses which do not necessarily share referential identity with the noun. These extra-nuclear clause modifiers are more common with abstract nouns and share structural features with clausal adjuncts in VP domains.

An important subclass of such clauses involves sentential relatives introduced by relative pronouns like *që*, which may bind an argument position within the DP. These constructions reflect the fine-grained syntactic control available within the Albanian DP, paralleling clausal behavior.

Syntactic functions, arguments, and thematic roles are not interchangeable. Syntactic roles such as subject or object may bear different thematic roles depending on verb semantics. The verb's valency determines the number and type of arguments it selects. While person marking indicates agreement, it reflects only one argument; valency provides a broader representation of argument structure.

Complementizers in unmarked structures follow the verb, whether transitive or intransitive. When multiple complementizers co-occur, SK (the argument clause) generally precedes others for neutral order. Deviations from this order may result in marked pragmatic or grammatical effects. Ellipsis may affect virtually all syntactic structures, not solely the predicate.

In ***wh***-questions, interrogative constituents move to the specifier of the complement phrase (SL), aligning with the left periphery of the sentence where ***wh***-features are checked. In ***yes-no*** questions, the particle ***a*** has a function as an interrogative modal operator in the head position Foc°, not carrying a thematic role and not undergoing movement. It may follow topicalized elements and other complementizers.

Albanian's negation structures, though aligned with certain universal principles, retain features that challenge aspects of standard generative theory. The negation phrase dominates the polarity phrase (affirmation). In future or conditional constructions, the verb raises to the EPT position within the tense phrase (SEPT), while negation precedes the tense marker (*do*). Multiple negation is realized with *as* or *kurrë*, forming the rheme in the specifier and head of SFoc°.

Argument clauses are treated as complementizer phrases (SK). Verbs requiring an external [+human] argument do not accept SKs that serve that role. Such verbs may still select internal arguments realized as complement clauses. The transition from active to passive entails changes in argument number and structure. Argument clauses receive thematic roles from the predicates of matrix clauses. In instances of anaphora, where the same argument is expressed in both matrix and embedded clause, the subject in the matrix clause functions as a pro expletive—grammatical but thematically empty.

Substitution by infinitival clauses, often a *Balkan Sprachbund* phenomenon, does not yield structurally equivalent representations due to differences in functional projections. Infinitives express fewer functional heads than subjunctive constructions, which include Force, Manner, and Eptim projections. This supports the hypothesis that subjunctive substitution reflects a preference for redundant linguistic encoding.

Undeveloped verbal forms (e.g., *me* + participle) in Albanian represent subordinate clauses with PRO subjects, lacking the Inflection and Manner projections and thus cannot function as full SEPT (SInfl) or SM phrases. They are not simple SFs either, since these positions do not accommodate particles that indicate verbal form. These clauses function as temporal phrases (SKoh), bearing [-Time, -Inflection] features. Particles like *me*, *për*, and *një* encode these features, whereas auxiliaries *kam* and *jam* bear [+Time].

The paper applies Rizzi's (1995) split-CP model - Force-Finiteness - to analyze undeveloped forms. Here, the elaboration phrase (SShtj, FinP) connects the complement system to the structural system. Functional projections such as TopP (Top°), AgrP, FocP, and SForcë articulate distinct grammatical relationships. In constructions involving clitics, a dedicated clitic phrase (SKl) is projected, requiring an intermediary projection between SEPT and SM.

In summary, this study provides a generative account of Albanian syntax, identifying unique structural properties while situating them within broader theoretical paradigms. In doing so, it reveals both alignment with universal principles and divergence through language-specific constraints. The internal structure of the Albanian Determiner Phrase reflects a complex interaction between syntax, morphology, and discourse. From head movement and article placement to the interaction between quantifiers, demonstratives, adjectives, and clause-level modifiers, Albanian presents a rich testing ground for theories of DP structure. The distinctions in adjective placement and interpretation, the use of prepositional and clausal modifiers, and the behavior of argument-taking nouns all support the treatment of DPs as hierarchical and derivational syntactic objects.

This paper has illustrated how DP internal structure in Albanian mirrors clausal architecture, with multiple functional projections and interactions among syntactic, semantic, and pragmatic features. The application of the Principles and Parameters model, especially within its minimalist evolution, provides a robust analytical lens to capture the richness and variability of the Albanian DP.

Keywords: *Albanian language, generativist program, syntactic analysis, Nominal Phrase, Infection Phrase, Complementiser Phrase.*